

**ZGJIDHJA E MARTESËS (SHKURORËZIMI).
VËSHTRIM KRAHASUES: SHQIPËRI, KOSOVË,
MAQEDONI.**

Sulejman Ahmedi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në SHKENCA
JURIDIKE, me profil E DREJTË CIVILE, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Juela Lamçe

Numri i fjalëve: 51.056

Tiranë, Janar 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Deklaruesi

Mr. Sulejman Ahmedi

© Copyright, Sulejman Ahmedi

Të gjitha të drejtat të rezervuara 2016

ABSTRAKTI
ZGJIDHJA E MARTESËS (SHKURORËZIMI).
VËSHTRIM KRAHASUES: SHQIPËRI, KOSOVË, MAQEDONI

Zgjidhja e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj përbëjnë sot objekt debati qoftë për efekt të rritjes së ndjeshme të numrit të divorceve ndër vite, qoftë për tendencat në vitet e fundit në disa vende të Europës drejt “privatizimit” të zgjidhjes së martesës. Duke marrë shkak pikërisht nga kjo e fundit, shtrohet për debat çështja nëse në zgjidhjen e martesës, si institut që qëndron mes të drejtës private dhe asaj publike, duhet t’i jepet përparësi zgjidhjeve të ofruara nga vetë bashkëshortët (“privatizimit të institutit”), apo në të kundërt, duhet të mbizotërojë e drejta publike në rregullimin e institutit, në kuadrin e mbrojtjes së veçantë që martesa dhe familja gëzojnë nga Shteti?

Për këtë qëllim, punimi shtron si hipotezën kërkimore, si vijon: *Instituti i zgjidhjes së martesës në të drejtën shqiptare, atë kosovare dhe maqedonase ruan dhe duhet të ruajë ekuilibrin mes lirisë kontraktore të bashkëshortëve dhe ndërhyrjes së gjykatës në zgjidhjen e martesës, me qëllim shmangien e abuzimeve që mund të rrjedhin nga “privatizimi” i zgjidhjes së martesës dhe pasojave që ajo sjell.*

Nga sa më sipër është e domosdoshme të analizohet sipas qasjes krahasimore kuadri normativ, doktrina juridike dhe jurisprudenca e vendeve objekt analize mbi zgjidhjen e martesës dhe pasojave që ajo sjell. Fryma që përshkon zgjidhjet e dhëna nga vendet europiane dhe tendenca për të harmonizuar të drejtën familjare në Europë do të shërbejnë si pika orientimi për të analizuar zgjidhjet e ofruara aktualisht nga e drejta shqiptare, kosovare dhe ajo maqedonase si dhe për të dhënë rekomandimet e nevojshme *de lege ferenda*. Në mënyrë specifike do të analizohen shkaqet për zgjidhjen e martesës, mënyrat dhe aspektet proceduriale për zgjidhjen e saj, pasojat si në aspektin personal ashtu edhe në aspektin pasuror ndaj ish bashkëshortëve dhe mardhëniet e tyre me fëmijët.

Fjalët kyçe: martesë, zgjidhje martese (shkurorëzim), fëmijë, pasojat e zgjidhjes së martesës, “privatizim” i zgjidhjes së martesës.

ABSTRACT
MARRIAGE DISSOLUTION
COMPARATIVE VIEW: ALBANIA, KOSOVO, MACEDONIA

The marriage dissolution and its consequences constitute today one of the most debated topics, considering not only the significant increase of the number of divorces in years, but also the trends in recent years in some European countries to the "privatization" of divorce. As a result, the question to debate is whether to the marriage dissolution, as an institute that stands between private and public law, should be given priority to the solutions offered by the spouses ("the privatization of the institute"), or otherwise, should it prevail public law regulating the institute, considering the special protection that marriage and family in the country?

For this purpose, the research hypothesis is formulated as follows: *The institute of marriage dissolution in the Albanian, Kosovo and Macedonian law, maintains and must maintain a balance between contractual freedom of the spouses and the intervention of the court to dissolve the marriage in order to avoid abuses that may arise from the "privatization" of the marriage dissolution and its consequences.*

From the above mentioned considerations, it is necessary to analyze, according to the comparative approach, the normative framework, the legal doctrine and the case studies of these countries regarding the dissolution of the marriage and the consequences it brings. The solutions provided by the European countries and the trend to harmonize the family law in Europe, will serve as orientation points to analyze solutions currently offered by Albanian law, Kosovo and Macedonian and also to give necessary recommendations *de lege ferenda*. In particular, the subject of analysis are the reasons for the dissolution of marriage, the ways and the procedural aspects of its solution, the consequences on both personally and property terms between them and their children.

Keywords: marriage, divorce, children, consequences of divorce, "privatization" of divorce.

*Këtë punim ia dedikoj prindërve të mi, nënës Rivajetes dhe babait Ismailit,
që nuk kursyen asgjë për formimin dhe ngritjen time profesionale.*

FALENDERIME

Shteti shqiptar ka qëndruar pranë nesh dhe na ka mbështetur ne si shqiptar jashtë kufijve administrativ të tij në vazhdimësi, duke patur parasysh nevojën dhe dëshirën tonë për t'u arsimuar në gjuhën amtare shqipe. Unë pata nderin që të regjistroj studimet e mia doktorale në Universitetin European të Tiranës i cili që në fillim më tërhoqi me seriozitetin dhe respektin për shkencën dhe shkencatarët e rinj.

Më vjenë shumë mirë për zgjedhjen time të bërë për të vazhduar studimet e mia në këtë tempull të dijes dhe me këtë rast falenderoj kolegët nga departamenti im, veçanërisht udhëheqësin tim shkencor Prof. Asoc. Dr. Juelda Lamçe për ndihmën, sugjerimet dhe këshillat mjaft të vlefshme si rezultat i të cilave punimi fitoi shumë në kualitet.

Dëshiroj gjithashtu të falenderoj familjen time të çmueshme për inkurajimin dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë ketyre viteve në realizimin e këtij disertacioni doctoral.

FALEMINDERIT !

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I- HYRJE.....1

I.1. Konsiderata paraprake.....	1
I.2. Qëllimi dhe rëndësia e punimit.....	3
I.3. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore.....	6
I.4. Metodologjia e ndjekur në punim.....	8
I.5. Përparësitë dhe kufizimet.....	10
I.6. Struktura e punimit.....	13

KAPITULLI II - ASPEKTE HISTORIKE DHE TEORIKE TË INSTITUTIT TË ZGJIDHJES SË MARTESËS (SHKURORËZIMIT)16

II.1. Aspekte historike mbi kuptimin e institutit të zgjidhjes së martesës	16
II.2. Nocioni dhe natyra juridike e zgjidhjes së martesës.....	24
II.3. Zgjidhja e martesës në të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane	30
II.4. Parimet e hartuara nga <i>CEFL</i> mbi zgjidhjen e martesës	35
II.5. Shqyrtime të të dhënave statistikore rreth zgjidhjes së martesës në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë	40

KAPITULLI III - MËNYRAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS.....57

III.1. Konsiderata paraprake mbi mënyrat dhe shkaqet e zgjidhjes së martesës.....	57
III.2. Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve në Shqipëri.....	67
III.3. Shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme të bashkëshortëve në Kosovë.....	74
III.4. Shkurorëzimi me pajtim të dyanshëm të bashkëshortëve në Maqedoni.....	78
III.5. Zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort në Shqipëri.....	80
III.6. Shkurorëzimi me kërkesë të njërit bashkëshort në Kosovë	101
III.7. Shkurorëzimi me kërkesë të njërit bashkëshort në Maqedoni	108
III.8. Fajësia në zgjidhjen e martesës në vështrim krahasimor.....	119

KAPITULLI IV - PROCEDURA E ZGJIDHJES SË MARTESËS	123
IV.1 Parimet e procedurës së zgjidhjes së martesës.....	123
IV.2. Gjykata kompetente	129
IV.3. Inicimi i procedurës	133
IV.4. Zhvillimi i procedurës	140
IV.5. Marrja e vendimit	153
IV.6. Mjetet juridike të ankimimit të vendimit.....	155
 KAPITULLI V - PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS	 157
V.1. Kategorizimi i pasojave që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës	157
V.2. Pasojat e zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët.....	158
<i>V.2.1. Pasojat e zgjidhjes së martesës në marrëdhëniet personale jopasurore.....</i>	<i>160</i>
<i>V.2.2. Pasojat e zgjidhjes së martesës në marrëdhëniet personale pasurore.....</i>	<i>164</i>
V.3. Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët.....	187
 KAPITULLI VI - KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	 202
VI.1. Tabelë përmbledhëse me gjetjet e punimit.....	203
VI.2. Konkluzione dhe rekomandime	208
 Bibliografia.....	 215

LISTA E GAFIKËVE DHE TABELAVE

- Grafiku nr. 1 Shkurorëzimet sipas grup-moshës së gruas në Kosovë
- Grafiku nr. 2 Shkurorëzimet sipas grup-moshës së gruas në Maqedoni
- Grafiku nr. 3 Krahاسimi i shkurorëzimet sipas grup-moshës së gruas: Kosovë - Maqedoni
- Grafiku nr. 4 Shkurorëzimet sipas grup-moshës së burrit në Maqedoni
- Grafiku nr. 5 Krahاسim i shkurorëzimeve sipas grup-moshës së burrit: Kosovë - Maqedoni
- Grafiku nr. 6 Shkurorëzimet sipas përkatësisë etnike të gruas në Kosovë
- Grafiku nr. 7 Shkurorëzimet sipas përkatësisë etnike të gruas në Maqedoni
- Grafiku nr. 8 Shkurorëzimet sipas përkatësisë etnike të burrit në Maqedoni
- Grafiku nr. 9 Totali i shkurorëzimeve sipas përkatësisë etnike në Maqedoni
- Grafiku nr. 10 Shkurorëzimet sipas kohëzgjatjes së martesës në Kosovë
- Grafiku nr. 11 Shkurorëzimet sipas kohëzgjatjes së martesës në Maqedoni
- Grafiku nr. 12 Krahاسim i shkurorëzimeve sipas kohëzgjatjes së martesës: Kosovë-Maqedoni
- Grafiku nr. 13 Shkurorëzimet sipas numrit të fëmijëve nga martesa në Kosovë
- Grafiku nr. 14 Totali i shkurorëzimeve sipas numrit të fëmijëve në Kosovë
- Grafiku nr. 15 Shkurorëzimet sipas numrit të fëmijëve në Maqedoni
- Grafiku nr. 16 Totali i shkurorëzimeve sipas numrit të fëmijëve në Maqedoni
- Grafiku nr. 17 Krahاسim i shkurorëzimeve sipas numrit të fëmijëve: Kosovë-Maqedoni
- Grafiku nr. 18 Numri i shkurorëzimeve në Shqipëri gjithsej dhe për 100 martesa
- Grafiku nr. 19 Numri i shkurorëzimeve në Shqipëri
- Tabela nr. 1 Përmbledhje mbi gjetjet e punimit
- Harta 1. Procedura e zgjidhjes së martesës në vendet e Europës

LISTA E SHKURTIMEVE

BE-Bashkimi Evropian

CEFL-Komisioni për të Drejtën Familjare Europiane (*Commission on European Family Law*)

DUDNj-Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

ESHSM-Enti Shtetëror Statistikor i Maqedonisë

ESK-Enti Statistikor i Kosovës

GjED – Gjykata Europiane e Drejtësisë

GjEDNj-Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KADNj-Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut

KE-Këshilli i Evropës

KFRSH-Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë

LFRM - Ligji mbi Familjen i Republikës së Maqedonisë

LFRK- Ligji mbi Familjen i Republikës së Kosovës

OSBE-Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PNDKP-Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

PNDESK-Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

TBE-Traktati për Bashkimin Evropian

TFBE-Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian

KAPITULLI I

HYRJE

I.1. Konsiderata paraprahe

Bashkëshortësia paraqet institucionin themelor jo vetëm për interesin privat të subjekteve që lidhin martesë apo fëmijëve të tyre, por edhe atë publik, i cili është i interesuar për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e familjes që buron nga martesa (Omari, 2010:187). Problemet që lidhen me zgjidhjen e martesës janë të natyrës teorike dhe praktike, sidomos nëse i referohemi statistikave mbi zgjidhjen e martesës. Të dhënat demografike në Europë tregojnë për një ulje të numrit të martesave dhe për një rritje të numit të zgjidhjeve të martesës, si rezultat i ndryshimit të legjislacionit të vendeve anëtare, të cilat i njohin gjithnjë e më shumë të drejta çifteve bashkëjetuese¹.

Në shoqëritë bashkëkohore, bashkëshortësia nuk paraqet bashkësi e cila përjetësisht duhet patjetër të ngelë e të vazhdojë e tillë edhe kur marrëdhëniet e afërta emocionale mes bashkëshortëve, si një bazë e jetës familjare dhe bashkëshortore, nuk funksionojnë (Fantetti, 2011: 128-131). Sado që të mendohet në mënyrë më optimiste, ekziston një realitet që s'mund të mohohet, se në jetën bashkëshortore midis bashkëshortëve gjithsesi mund të lindin mosmarrëveshje. Shmangies të një "*jete të padurueshme*" të këtillë, i është kushtuar një kujdes i veçantë që nga periudhat e lashta të historisë së njerëzimit, për rregullimin juridik të martesës dhe po ashtu edhe të zgjidhjes së saj.

¹ Për të dhënat statistikore në Europë shih: *Marriage and divorce statistics*, në http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Marriage_and_divorce_statistics, parë në datë 20 dhjetor 2015.

Nëse bashkëshortët nuk mund të tejkalojnë problemet e tyre me marrëveshje, atëherë duhet të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që parashihen në dispozitat ligjore për shkurorëzim, e cila njëherit është edhe një lloj mjeti mbrojtës për fëmijët nga martesat e tilla "të sëmura" (Trpenovska, 2008: 130). Në të vërtetë është e pakuptimtë që të insistohet forcërisht që të mbahet në jetë bashkësisa martesore e një çifti në situatat kur vërtetohet se jeta bashkëshortore është bërë e pakuptimtë dhe e paqëndrueshme. Prandaj, shkurorëzimi është konsideruar si një rrugëdalje nga gjendja që karakterizohet nga një përkeqësim i raporteve bashkëshortore. Sot, dispozitat ligjore të vendeve të ndryshme mbajnë një qëndrim të ndërmjetëm në mes ndalimit të plotë të zgjidhjes së martesës dhe lejimit për t'i dhënë fund martesës pa asnjë kufizim.

Me zgjidhjen e martesës jeta familjare nuk merr fund kur çifti përfundon në divorc ose kur palët nuk jetojnë më së bashku (Kilkelly, 2003: 19). Madje, zgjidhja e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj në rregullimin e jetës familjare, trajtohen në kontekstin e dyfishtë, të të drejtës private dhe të së drejtës publike. I pari lidhet me rregullimin e marrëdhënieve private që lindin nga martesa; i dyti, me mbrojtjen e veçantë që familja dhe martesa gëzojnë nga Shteti. Kjo sepse, familja e krijuar nga martesa (por jo vetëm), si një nënsistem i rëndësishëm i shoqërisë për funksionimin e drejtë të saj, është e domosdoshme për ekzistencën dhe riprodhimin e bashkësisë shoqërore (Omari, 2010: 187).

Problematikat që lidhen me zgjidhjen e martesës janë aktuale, jo vetëm në vendet objekt analize, por dhe në nivel ndërkombëtar dhe europian. Kjo sidomos përse i përket afateve maksimale për zgjidhjen e martesës, lirisë kontraktore të bashkëshortëve dhe mundësisë së zgjidhjes "private" të saj, pa prezencën e gjykatës (kur plotësohen disa

kushte specifike), rregullimin e marrëdhënieve personale (për shembull, çështja e mbiemrit) apo pasurore (në varësi të regjimit pasuror të aplikueshëm në rastin konkret) si dhe lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim. Në fakt, shumë aspekte, që lidhen me zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj, janë bërë prej kohësh objekt analize edhe në nivel europian nga CEFL. Parimet e elaboruara prej saj marrin rëndësi në kuadër të asaj që njihet si *soft law* (Principles of European Family Law, 2015)².

1.2. Qëllimi dhe rëndësia e punimit

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë në vështirim krahasimor institutin e zgjidhjes së martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, në mënyrë që të evidentohen zgjidhjet më efikase në raport me vetë funksionin e institutit dhe të jepen rekomandimet përkatëse për secilin vend. Këtu i rëndësishëm është analizimi dhe studimi i hollësishëm jo vetëm i kuadrit normativ, por edhe i qëndrimeve të teorisë juridike dhe praktikës gjyqësore, veçanërisht në aspektin që i referohet të drejtës për të zgjidhur martesën, mënyrave të zgjidhjes së saj, procedurës që duhet ndjekur si dhe pasojave personale dhe pasurore që rrjedhin nga shkurorëzimi.

Në kuadër të vështimit krahasimor, shtrohen pyetjet: Cilat janë në thelb ngjashmëritë dhe dallimet në rregullimin ligjor të institutit të zgjidhjes së martesës në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni? Si ndikojnë këto dallime në pasojat që rrjedhin në praktikë në secilin vend

² CEFL, (*Commission on European Family Law*), është Komisioni i ngritur në nivel europian që në vitin 2001, me qëllim harmonizim e të drejtës familjare në Europë. Komisioni është ngritur nga studiues të Shteteve të ndryshme europiane dhe funksionon si një organi i pavarur. Ai përbëhet nga një Komitet organizues dhe nga një Grup ekspertësh dhe përfaqëson 22 shtete Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Angli dhe Wales, Irlandë, Itali, Hollandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Republikë Çeke, Rusi, Skoci, Suedi, Svicer, Spanjë, Hungari.

objekt analize? A duhet të bëhet dallim në rregullimin normativ, mes rasteve të zgjidhjes së martesës nga e cila kanë lindur fëmijë dhe atyre nga e cila nuk kanë lindur fëmijë? A duhet të merren parasysh *Parimet e CEFL* në përmirësimin e kaudrit ligjor të secilit vend në kuadrin e harmonizimit të së drejtës familjare në Europë?

Ajo që vihet re nga këto Parime është thjeshtimi dhe përsheptimi i zgjidhjes së martesës, sidomos në rastet kur nuk janë përfshirë të miturit.

Tabela e mëposhtme, mbi procedurën e zgjidhjes së martesës në vendet e Europës (Ansa, 2015), evidenton qartë tre kategori:

a) Me ngjyrën e kaltër, vendet në të cilat duhet të procedohet fillimisht me veçim vetjak dhe më pas me zgjidhje martese (Irlanda e Veriut, Polonia, Italia)³;


b) Me ngjyrën e kuqe, vendet në të cilat zgjidhja e martesës është e menjëhershme (Norvegji, Finlandë, Estoni, Lituani, Rumani, Kroaci dhe Serbi);

c) Me ngjyrën e gjelbër, vendet në të cilat përpara zgjidhjes së martesë kërkohet një periudhë paraprake ndarje faktike. Kështu për shembull, në Angli, zgjidhja e martesës mund të kërkohet pasi të ketë kaluar të paktën një vit nga lidhja e martesës; nëse zgjidhja e martesës është me pëlqim reciprok kërkohen dy vjet ndarje faktike, nëse nuk ka pëlqim reciprok kërkohen pesë vjet. Po kështu, në Gjermani, kur ka pëlqim reciprok, një vit, përndryshe, dy vjet. Në Francë, kur ka pëlqim reciprok zgjidhja e martesës është e

³ Në Itali së fundi u miratua Ligji n. 55 datë 6 maj 2015, Dispozita në fushën e zgjidhjes ose mbarimit të efekteve civile të martesës si dhe të bashkësisë ligjore mes bashkëshortëve - *Disposizioni in materia di scioglimento o di cessazione degli effetti civili del matrimonio nonche' di comunione tra i coniugi*. (GU Serie Generale n.107 del 11-5-2015). Ky ligj redukton nga tre vjet në 12 muaj kohëzgjatjen minimale të veçimit vetjak të pandërprerë përpara se të kërkohet zgjidhja e martesës, dhe në 6 muaj kur ka pëlqim reciprok.

menjëhershme, në të kundërt kërkohen dy vjet. Në Spanjë dhe Portugali, mbas tre muajsh martese mund të zgjidhet mes veçimit vetjak dhe zgjidhjes së menjëhershme të martesës.

TABELA 1



Harta 1. Procedura e zgjidhjes së martesës në vendet e Europës

Nga sa më sipër, është me interes të shihet cila është tendenca në vendet objekt analize në lidhje me institutin e zgjidhjes së martesës, si raportohet ajo me zhvillimet më të fundit europiane në këtë fushë dhe cila është qasja kritike ndaj nënçështjeve specifike problematike në fushë. Kjo për faktin se rregullimi normativ i zgjidhjes së martesës (si

pjesë e të drejtës familjare), që qëndron mes private dhe publike, ka shfaqur tendencën në vitet e fundit të një “privatizimi” të marrëdhënieve mes bashkëshortëve, ndërkohë që e drejta publike po kufizohet kryesisht në çështjet që lidhen me mbrojtjen e të miturve (Lamçe, 2015: 71).

I.3. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Duke patur parasysh konsideratat hyrëse dhe qëllimin e këtij punimi, parashtrohet edhe **hipoteza kërkimore** si vijon:

Instituti i zgjidhjes së martesës në të drejtën shqiptare, atë kosovare dhe maqedonase ruan dhe duhet të ruajë ekuilibrin mes lirisë kontraktore të bashkëshortëve dhe ndërhyrjes së gjykatës në zgjidhjen e martesës, me qëllim shmangien e abuzimeve që mund të rrjedhin nga “privatizimi” i zgjidhjes së martesës dhe pasojave që ajo sjell.

Nga sa më sipër shtrohen për zgjidhje edhe **pyetjet kërkimore** si vijojnë:

1. *Cilat janë kufizimet me të cilat ndeshet liria kontraktore e palëve në zgjidhjen e martesës për sa i përket mënyrave të zgjidhjes së martesës?*
2. *Cilat janë kufizimet me të cilat ndeshet liria kontraktore e palëve në lidhje me përcaktimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok.*
3. *Si gjen zbatim zhvillimi i seancës pajtimore në tre vendet objekt analize dhe a rezulton ai efikas në praktikë?*
4. *Cili është roli i gjykatës në lidhje me provat të cilat duhen nxjerrë në procedurë?*
5. *Cili është roli i gjykatës në përcaktimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok?*

6. *A duhet të bëhet dallim në rregullimin normativ mes rasteve të zgjidhjes së martesës nga e cila kanë lindur fëmijë dhe atyre nga e cila nuk kanë lindur fëmijë?*

7. *Cilat janë në thelb ngjashmëritë dhe dallimet në rregullimin normativ të institutit të zgjidhjes së martesës në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni?*

8. *Si ndikojnë këto dallime në pasojat që rrjedhin në praktikë në secilin vend objekt analizë?*

9. *Në kuadrin e harmonizimit të së drejtës familjare në Europë, si pozicionohen Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, në lidhje me zgjidhjet e propozuara nga CEFL në lidhje me këto çështje?*

Hipoteza kërkimore e punimit prek në thelb raportin mes lirisë së individit në zgjidhjen e martesës dhe ndërhyrjes së Shtetit në rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj. Prandaj, me qëllim që t'i jepet përgjigje hipotezës kërkimore të këtij punimi dhe pyetjeve kërkimore ndihmëse, është e domosdoshme analiza e detajuar dhe krahasimore e kuadrit normativ, doktrinës juridike dhe jurisprudencës mbi aspekte të veçanta të zgjidhjes së martesës si: kufizimet që ndeshin bashkëshortët në zgjidhjen e martesës, kushtet për zgjidhjen e martesës, mënyrat dhe aspektet proceduriale për zgjidhjen e saj, pasojat personale dhe pasurore ndaj ish-bashkeshortëve dhe marrëdhëniet e tyre me fëmijët.

Debati mbi këto çështje është aktual edhe në nivel ndërkombëtar dhe europian, sidomos përsa i përket të drejtës për të zgjidhur martesën, afateve maksimale për zgjidhjen e martesës, autonomisë kontraktore të bashkëshortëve dhe mundësisë së zgjidhjes “private” të saj, pa prezencën e gjykatës (kur plotësohen disa kushte specifike), rregullimin e marrëdhënieve personale (për shembull, çështja e mbiemrit) apo pasurore (në varësi të

regjimit pasuror të aplikueshëm në rastin konkret) si dhe lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim.

I.4. Metodologjia e ndjekur në punim

Në këtë punim doktrature analizohet instituti i zgjidhjes së martesës (shkurorëzimi) në vështrim krahasues në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Punimi fillimisht analizon zhvillimin historik të shkurorëzimit si institut juridik për zgjidhjen e martesës. Qasja kritike ndaj aspekteve krahasimore të shkurorëzimit në tre legjislacionet e përmendura, i referohet zgjidhjes së martesës si me pëlqim reciprok të bashkëshortëve, ashtu si dhe asaj me kërkesë të njërit bashkëshorti. E para, përbën zgjidhjen e preferuar nga të tre legjislacionet e vendeve të marra në analizë, për avantazhin e padiskutueshëm që ajo ka në raport me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, për sa kohë bashkëshortët janë të predispozuar të bashkëpunojnë mes tyre në interes të fëmijëve (nëse ka), si dhe të zgjidhin me marrëveshje edhe pasojat me natyrë personale dhe pasurore ndërmjet tyre. Për këtë arsye, kjo mënyrë e zgjidhjes së martesës rregullohet në të tre vendet sipas një procedure më të thjeshtuar sesa ajo e parashikuar për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort. Në fakt, dakortësia për të zgjidhur martesën dhe për të rregulluar disa pasoja që rrjedhin prej saj, për ligj thjeshtimin e procedurës, duke evituar domosdoshmërinë e parashtrimit të arsyeve të krizës martesore, të humbjes së qëllimit të martesës apo të pakthyeshmërisë së krizës mes bashkëshortëve.

Në këtë mënyrë, fillimisht analizohen në vështrim krahasimor mënyrat dhe shkaqet e shkurorëzimit të martesës, qoftë me marrëveshje ose me padi të njërit bashkëshorti. Duke

bërë krahasimin e nevojshëm, punimi ka për qëllim të evidentojë ngjashmëritë dhe dallimet mes tre Shteteve të marra në konsideratë. Në mënyrë specifike, nga analiza e shkaqeve të shkurorëzimit duhet të konstatohet nëse legjislacioni e bënë më të lehtë shkurorëzimin dhe në këtë mënyrë mbron interesin e bashkëshortëve për të zgjidhur martesën, apo në të kundërt, e bën atë më të vështirë, me qëllim mbrojtjen e familjes si bërthama e shoqërisë.

Në punim, në mënyrë krahasuese, analizohen edhe aspekte specifike që lidhen me procedurën e shkurorëzimit, rolin e gjykatës në procedurën e zgjidhjes së martesës si dhe pasojat që rrjedhin prej saj. Në mënyrë specifike, evidentohet rëndësia e seancës pajtimore si një element konstitutiv i kësaj procedure. Edhe këtu, fokusi është në sqarimin krahasues të kësaj procedure, që të vërehen ndryshimet mes tre vendeve, dhe si ato raportohen në lidhje me qasjen që ka tendencën t'i japë përparësi atonomisë private ("privatizimit të institutit") nga njëra anë, dhe qasjen që ka tendencën të rrisë rolin e Shtetit në rregullimin e institutit, nga ana tjetër, për vetë rëndësinë që ka familja (dhe martesa si një mënyrë e krijimit të saj) për çdo shoqëri.

Në punim ka vend të veçantë edhe për të dhëna statistikore, të analizuara në vështirë krahasimor në lidhje me shkurorëzimit e realizuara në vitet 2009-2013. Pa dashur të analizohen në detaje shkaqet e ndryshme sociale dhe ekonomike të shkurorëzimit, sipas të dhënave të nxjerra nga këto statistika, mund të evidentohet raporti mes rritjes/zvogëlimit të numrit të zgjidhjeve të martesës nga njëra anë dhe kriterëve të ndryshme, si për shembull: egzistenca e fëmijëve apo numri i tyre, kohëzgjatja e martesës, mosha e bashkëshortëve etj.

Natyrisht, për të fituar një pasqyrë më të pastër për shkurorëzimin si institut ligjor, dhe për të bërë krahasimin e nevojshëm, në punim iu referohemi edhe disa standardeve

ndërkombëtare të lidhura me të. Në mënyrë të veçantë bëhet fjalë për: aktet ndërkombëtare dhe ato europiane më të rëndësishme në fushë, praktikën gjyqësore të GjEDNj dhe atë të GjED si dhe, në kuadrin e *soft law*, Parimet e hartuara nga CEFL mbi zgjidhjen e martesës.

Në fund, në punim jepen konkuzione për aspektet e ndryshme krahasuese të legjislacionit të të tre shteteve lidhur me zgjidhjen e martesës. Krahasimi i tre legjislacioneve gërshetohet edhe me raportin e tyre me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për shkurorëzimin. Në të njëjtin vend jepen edhe rekomandime për zhvillimin e legjislacionit në të ardhme, pra *de lege ferenda*.

I.5. Përparësitë dhe kufizimet

Përparësitë e këtij punimi lidhen me dobishmërinë e tij teorike dhe praktike.

Nga pikëpamja teorike, ky studim, nga të paktit në fushë, thellon debatin doktrinar në çështje specifike që lidhen me zgjidhjen e martesës, siç janë për shembull, roli i autonomisë private dhe kufizimet e saj nga e drejta publike (“privatizimi” i zgjidhjes së martesës), mundësia e zgjidhjes së saj në rrugë jashtëgjyqësore, reduktimi i afateve dhe përshpejtimi i procedurës për zgjidhjen e saj, arsyet që legjitimojnë kufizimet mbi zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok, roli i palëve dhe i organit kompetent në këtë drejtim, qasja e organit kompetent ndaj pasojave me karakter personal dhe pasuror që lidhen me bashkëshortët dhe fëmijët etj. Analiza e detajuar e institutit, sipas qasjes kritike dhe krahasimore, ka për qëllim gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme në një fushë kaq dinamike, dhe kaq të ndikuar nga ndryshimet sociale dhe kulturore të shoqërisë. Studiuesit

e fushës flasin për një *konvergjencë spontane* të normave juridike në fushën e të drejtës familjare në legjislacionet e vendeve të ndryshme evropiane (Auletta, 2007: 15)⁴.

Analiza e institutit të zgjidhjes së martesës në vështrim krahasimor pasqyron stadin aktual të rregullimit normativ në tre vendet e marra në analizë, duke nxjerrë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet mes sistemeve, dhe mbi të gjitha rekomandon propozime specifike për zgjidhjen e çështjeve problematike të adresuara gjatë analizës, duke u bazuar në doktrinën dhe jurisprudencën vendase dhe të huaj si dhe në tendencat politik-bërëse më të fundit europiane.

Nga pikëpamja praktike, punimi shërben si një kontribut për zbatuesit e ligjit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat (si për shembull, avokatë, gjyqtarë, ndërmjetësues, organizata jo fitimprurëse etj.) në trajtimin dhe identifikimin e zgjidhjeve konkrete rast pas rasti, si dhe për politik-bërësit në kuadër të aderimit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë në BE, për efekt të përmirësimit të kuadrit ligjor në fushë.

Për sa i përket kufizimeve, ato lidhen si me përcaktimin e objektit të analizës, si me vështirësitë e ndeshura gjatë grumbullimit të të dhënave.

Lidhur me të parin, zgjedhja për ta kufizuar analizën e institutit të zgjidhjes së martesës në tre Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, motivohet nga disa arsye: a) janë vende të Ballkanit që kanë trashëgimi kulturore të përbashkët; b) janë vende të Ballkanit shqipfolëse; c) janë vende të Ballkanit që pritet të aderojnë në BE (edhe pse në faza të ndryshme të procesit); d) për këto vende mungon një studim i kësaj natyre.

⁴ Kjo konvergjencë spontane pasqyron një zhvillim të ngjashëm të shoqërisë ndër vite, si për shembull, kalimi nga familja patriarkale në familjen bërthamë, njohja e parimit të barazisë së bashkëshortëve, kalimi nga koncepti i *patria potestas* në atë të përgjegjësisë pridërore etj.

Përveç kufizimeve nga pikëpamja e shtrirjes gjeografike, punimi kufizohet edhe në kohë: në fakt, qëllimi i punimit është të analizojë institutin e zgjidhjes së martesës në vështirimin bashkëkohor të tij. Për këtë arsye, qasja historike do të jetë e kufizuar në funksion të argumentimit të zgjidhjeve aktuale, dhe në fokus të punimit do të jetë analiza e kuadrit normativ aktualisht në fuqi në të tre vendet, si dhe zgjidhjet respektive jurisprudenciale dhe doktrinale në fushë.

Për sa i përket kategorisë së dytë të kufizimeve, ato që lidhen me vështirësitë e ndeshura gjatë grumbullimit të të dhënave, punimi ka hasur në disa kufizime që lidhen kryesisht me:

- a) doktrinën shqipfolëse ende të pakët në fushë,
- b) vështirësi në mbledhjen e vendimeve gjyqësore për Kosovën dhe Maqedoninë (mungojnë të dhënat e vendimeve *on line*, për shkak të mos funksionimit të sistemit). Për këtë arsye ka qenë e nevojshme grumbullimi i tyre në terren.
- c) të dhënat statistikore, të cilat për Shqipërinë në raport me të dhënat për Kosovën dhe Maqedoninë janë më të kufizuara; në mënyrë specifike, duke qenë se të dhënat statistikore të Maqedonisë për vitin 2014 janë më të pakta se ato të viteve të mëparshme, është zgjedhur të përdoren të dhënat e saj deri në vitin 2013 me qëllim që qasja krahasimore me dy vendet e tjera të jetë sa më e plotë.

I.6. Strukturimi i punimit

Punimi strukturohet në gjashtë kapituj, përmbajtja e të cilëve vijon si më poshtë:

Në Kapitullin e parë “Hyrje”, janë përmbledhur konsideratat mbi qëllimin e punimit, parashtrimin e hipotezës dhe pyetjeve kërkimore, metodologjinë e ndjekur, avantazhet dhe kufizimet e punimit si dhe mënyrën e strukturimit të tij. Për sa i përket metodologjisë së ndjekur në punim, hulumtimi i temës është bazuar në një qasje shumë dimensionale, duke përdorur metodat tipike të hulumtimeve juridike si ato përshkruese, statistikore, krahasuese, të interpretimit të së drejtës dhe ato analitike. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar kuadri normativ, literatura juridike dhe jurisprudenca vendase dhe ajo e huaj.

Në Kapitullin e dytë, “Aspekte historike dhe teorike mbi institutin e zgjidhjes së martesës (shkurorëzimit)”, pas një trajtimi të shkurtër historik, vijohet me analizën e parimeve që udhëheqin zgjidhjen e martesës në të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane si dhe trajtohet debati aktual doktrinal dhe metodologjia e ndjekur në punim. Debati doktrinar fokusohet në trajtimin e institutit të zgjidhjes së martesës, si institut i së drejtës familjare që qëndron mes të drejtës private dhe asaj publike. Në mënyrë specike janë trajtuar çështjet që lidhen me të drejtën për të zgjidhur martesë dhe garantimin e efikasitetit të saj, afatet maksimale për zgjidhjen e martesës, autonominë e bashkëshortëve dhe mundësinë e zgjidhjes “private” të saj, pa prezencën e gjykatës (kur plotësohen disa kushte specifike), rregullimin e marrëdhënieve personale (për shembull, çështja e mbiemrit) apo pasurore (në varësi të regjimit pasuror të aplikueshëm në rastin konkret) si dhe lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim. Në përmbyllje të këtij kapitulli, janë analizuar statistikatat e

nxjerra në vitet e fundit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni mbi zgjidhjen e martesës sipas kritereve të ndryshme.

Në kapitullin e tretë, “Mënyrat e zgjidhjes së martesës” janë shtjelluar mënyrat e zgjidhjes së martesës në bazë të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë duke i sqaruar mënyrat e parapara me ligj e njëherit edhe duke bërë krahasime lidhur me dallimet dhe ngjashmëritë tyre për shtetet përkatëse. Gjithashtu janë paraqitur edhe shembuj nga praktika gjyqësore evropiane lidhur me mënyrat e zgjidhjes së martesës. Në këtë kapitull është trajtuar edhe çështja e fajësisë në procedurat e zgjidhjes së martesës duke paraqitur e njëherit edhe duke analizuar legjislacionet përkatëse të shteteve krahasimore lidhur me këtë çështje.

Në kapitullin e katërt, “Procedura e zgjidhjes së martesës” janë paraqitur fazat e procedurës si dhe karakteristikat e tyre, mënyra e rregullimit me ligj dhe vënia në praktikë e këtyre regullave duke bërë një krahasim mes kuadrit normativ dhe jurisprudencës së shteteve objekt analize. Në fillim të këtij kapitulli janë paraqitur parimet e procedurës së zgjidhjes së martesës, për të vijuar me kompetencën e gjykatave në rast të zgjidhjes së martesës, fazat e procedurës së divorcit si dhe mjetet juridike të ankimimit.

Në kapitullin e pestë, “Pasojat e zgjidhjes së martesës” janë paraqitur dhe analizuar në vështrim krahasimor pasojat që lindin me rastin e zgjidhjes së martesës. Pasojat shfaqen në shumë nivele. Ato shfaqen në marrëdhëniet personale dhe pasurore mes bashkëshortëve, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët. Nga sa më lart, shkurorëzimi dhe pasojat e tij, përveç aspektit teorik, në veçanti trajtohen edhe në nivelin e së drejtës krahasuese të tre shteteve të përmendura.

Së fundi, në kapitullin e gjashtë “Konkluzione dhe rekomandime” është paraqitur një tabelë përmbledhëse me gjetjet kryesore të punimit, e përvijuar nga konkluzionet dhe rekomandimet *de lege ferenda*.

KAPITULLI II

ASPEKTE HISTORIKE DHE TEORIKE TË INSTITUTIT TË ZGJIDHJES SË MARTESËS (SHKURORËZIMIT)

II.1. Aspekte historike të kuptimit të institutit të zgjidhjes së martesës

Megjithëse synim i martesës është qëndrueshmëria, vazhdushmëria dhe përhershmëria e bashkësisë jetësore midis një çifti, në praktikë jo çdo herë ndodh kështu. Përkundrazi, të dhënat statistikore vënë në dukje se përkeqësimi i marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve është në rritje e sipër. Pranimi i zgjidhjes së martesës, si një nga alternativat ligjore të mbarimit të martesës, ka kaluar prej stadi të konsideratave fetare, duke u konsideruar si një institut absolutisht i nevojshëm për të drejtën pozitive. Me të drejtë është theksuar se:

shkëputja e lidhjes shpirtërore që ka ekzistuar në lidhjen e martesës, nuk mund të mos reflektohet në një mjet ligjor, i cili duhet t'u lejojë bashkëshortëve të rifitojnë lirinë personale që e patën sakrifikuar për shkak të bashkësisë shpirtërore që i bashkonte (Omari, 2010:189).

Në fakt, qëndrueshmërisë së përhershme të martesës, të cilin krishterimi e ka mbështetur shekuj me radhë, qytetërimi modern i ka kundërvënë vlerën e lirisë së individit. Për shumë kohë vendet e influencuara nga kisha katolike, kanë refuzuar të pranojnë zgjidhjen e martesës. E vetmja mënyrë për përfundimin e saj konsiderohej vdekja e njërit bashkëshort (Topallogllu, 1995: 66). Koncepti i martesës bazohej në *consortium omnis vitae* ose *consortium totius vitae* e cila konsiderohej një bashkësi e përhershme, pasi bazohej në konceptin se pas lidhjes së martesës të dy bashkëshortët unifikoreshin në një trup të vetëm (Ralević, 1991: 47)⁵. Në të kundërt, në Islam shkurorëzimi nënkupton të

⁵ Ndër vendet e Europës, i vetmi shtet që ndalonte zgjidhjen e martesës deri në vitin 2011 ishte Malta.

drejtën si të burrit ashtu edhe të gruas për të kërkuar dhe për të fituar shkëputjen e një martesë të pasuksesshme (Lamçe, 2013: 184)⁶.

Shkurorëzimi është institut i lashtë i së drejtës martesore⁷. Ashtu siç thotë edhe Volteri: *Shkurorëzimi ka lindur njëkohësisht me martesën* (Mladenovic, 1974: 7). Shoqëritë e organizuara që nga kohërat e vjetra e kanë rregulluar zgjidhjen e martesës me norma juridike që nga e drejta romake, greke, bizantine, egjiptiane, etj, ashtu edhe e drejta zakonore shqiptare.

Në të drejtën e vjetër egjiptiane, mbizotëronte matriarkati, pra rolin drejtues në gjithë jetën ekonomike, shoqërore e familjare e luante gruaja (Mladenovic, 1982:21). Shkurorëzimi ka qenë plotësisht i lirë, ashtu si edhe lidhja e martesës, e cila është lidhur si një marrëveshje e lirë mes burrit dhe gruas. Burri, përveç gruas, mund të mbante edhe konkubina. Më vonë hasim edhe raste kur burri i është nënshtruar plotësisht pushtetit të gruas: *Ty të kam besuar që të kujdesesh për mua gjatë gjithë jetës time, kur të vdes ti do të kujdesesh për varrimin tim* (Mladenovic, 1982:21).

Në Babiloni, pushteti u ka takuar burrave dhe ky fakt dëshmon për ekzistencën e dallimeve dhe jo barazisë që është bërë midis burrit dhe gruas, si në martesë dhe me rastin

⁶ Disa metoda janë të hapura vetëm për burrin; të tjerët vetëm për gruan, pa ose me intervenim juridik; ndërsa disa të tjerë për të dy, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes procesit gjyqësor, me ose pa pëlqimin e partnerëve.

⁷ Mirëpo në të njëjtën kohë, të shumtë kanë qenë autorët që kanë kundërshtuar gjatë të gjitha kohërave konceptin e përjetësisë së martesës, duke argumentuar zgjidhjen e saj, si një mjet ligjor të domosdoshëm për të gjitha ato raste kur vërtetohet se jeta e përbashkët nuk mund të vazhdojë për të ardhmen. Me të drejtë konsiderohet se gjatë gjithë historisë njerëzore zgjidhja e martesës "*ka qenë aleati më besnik i martesës*".

e shkurorëzimit, por edhe në përgjithësi në marrëdhëniet shoqërore (Mladenovic, 1982:25)⁸.

Periudha parahistorike izraelite është karakterizuar nga matriarkati. Zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e saj, izraelitët kryesisht e përvetësuan nga e drejta egiptiane. Me Ligjin e Mojsiut parashikohej që:

Kur burri të lidh martesë dhe ndodh që ajo të mos i pëlqej, të mos jetë e bukur, atëherë le t'i shkruaj një letër për zgjidhjen e martesës dhe le ta largojë nga shtëpia (Mladenovic, 1982: 32).

India e vjetër është burim i të drejtave indoevropiane, prandaj e drejta e vjetër indiane ka shumë ngjashmëri me të drejtën romake, greke dhe shumë të drejta tjera antike. Shkurorëzimi nuk lejohej pasi martesa ishte llogaritur e shenjtë, saqë edhe gruaja e cila nuk i qëndronte besnike burrit të saj nuk mund të shkurorëzohej ose edhe nëse largohej nga bashkësia martesore, ajo nuk mund të martohej sërish, por qëndronte në shtëpinë e burrit të saj si robëreshë (Mladenovic, 1982: 323).

Në Greqinë antike, sundimi dhe udhëheqja absolute e familjes i takonte të zotit të shtëpisë, i cili kishte pushtet mbi të gjithë anëtarët e familjes dhe ai vendoste për çështjet e ndryshme brenda saj. Rreth martesës dhe zgjidhjes së saj janë shprehur edhe filozofët Aristoteli dhe Platoni. Qëndrimi i Platonit rreth martesës dhe shkurorëzimit ka qenë për barazinë e gruas dhe burrit në martesë dhe të drejtat që burojnë nga ajo, e njëherit edhe gjatë zgjidhjes së saj. Madje, ai kërkonte që ligji të ndalonte qytetarët e martuar të kishin

⁸ Gratë janë ndarë në tre nivele: gratë e nivelit të parë janë quajtur *SAL ME dhe ashatum*, pastaj gratë e nivelit të dytë janë quajtur *shugetim* të cilat për nga pozita e tyre kanë qenë në mes grave që u kanë takuar nivelit të parë dhe robëreshave. Ndërkaq gratë e nivelit të tretë kanë qenë robëreshat. Mbretëria babilonase është karakterizuar si shtet juridik. Dokumenti më i rëndësishëm juridik i kësaj mbretërie është Ligji i Hamurabit, i cili u hartua 2000 vjet para erës sonë. E drejta familjare zë një vend të veçantë në këtë ligj, kështu që nga 252 nene, 64 rregullojnë marrëdhëniet shoqërore nga e drejta familjare si dhe të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve në këto marrëdhënie, si të burrit dhe gruas ashtu edhe fëmijëve.

marrëdhënie jashtë martesore. Ndryshe nga Platoni, Aristoteli ishte kundër barazisë gjinore të bashkëshortëve në martesë dhe në rast të shkurorëzimit (Mladenovic, 1982:38).

*Në të drejtën romake, me Ligjin e 12 tabelave, bashkësia familjare mund të prishej*⁹: a) për shkaqe që nuk vareshin as nga burri as nga gruaja - kjo ndodhte nga vdekja e njërit nga bashkëshortët, më vonë për shkak të rënurit rob, ose, për shkak të humbjes të së drejtës qytetare; b) për shkak të kërkesës së gruas ose të burrit. Që në kohën e Romulit, u lejua zgjidhja e martesës, por vetëm si e drejtë e burrit dhe në favor të tij. Më vonë, në periudhën prej vitit 134 para erës sonë e deri te ardhja e Konstandinit, martesë mund të zgjidhej shumë lehtë, gjë që solli edhe rritjen e numrit të shkurorëzimeve. Në periudhën e sundimit të Konstandinit, zgjidhja e martesës u kufizua mjaft, pasi që sërisht u futën elemente fetare dhe u rrit ndikimi i doktrinës krishtere, dhe si rrjedhojë u zvogëluar shumë numri i shkurorëzimeve. Ai theksonte se "*Martesa e lidhur me marrëveshje të të dy bashkëshortëve, nuk mund të zgjidhej në të njëjtën mënyrë*" (Mladenovic, 1982:55)¹⁰.

Me ardhjen e Justinijanit në pushtet u ndryshuan dhe u kodifikuan mjaft ligje si edhe dispozitat për zgjidhjen e martesës, të cilat u morën si bazë nga ligjvënësit e shumë shteteve tjera, sidomos në territorin e Bizantit dhe Rusisë. Sipas tij, zgjidhja e martesës nuk ishte vetëm detyrim i bashkëshortit por edhe e drejtë e tij, si dhe njohu sërisht të drejtën e zgjidhjes së martesës me marrëveshjen e të dy bashkëshortëve (Mladenovic, 1982:53).

⁹ Ligji i XII tabelave është përpiluar nga plejbejasit në periudhën 451-450 p.e.s. dhe konsistonte në rregullimin e çështjeve nga sfera e të drejtës civile, si ajo pronësore, detyrimore, por edhe marrëdhëniet familjare dhe martesore.

¹⁰ Konstandini riktheu sërisht në fuqi dënimin me vdekje për gruan e cila nuk i qëndronte besnike burrit të saj, duke e konsideruar si një nga shkaqet më të rënda që ndikonte në zgjidhjen e martesës. Nga ana tjetër, i njohu gruas e cila e kishte burrin ushtar, të drejtën e kërkesës për zgjidhje të martesës, në qoftë se ai mungonte në periudhë prej pesë vitesh.

Gjithashtu, ai parashihte dënime më të lehta për gruan që tradhëtonte burrin e saj dhe për bashkëfajtorin e saj.

Në epokën bashkëkohore evropiane, që nga shek. XVII duke filluar me Skocinë, dhe më pas me Anglinë, ku vendoset shkurorëzimi gjyqësor, janë të dhënat në të cilat mund të referohemi dhe të konstatojmë se zgjidhja e martesës rregullohej juridikisht. Por që në atë kohë procedurat ishin shumë të vështira, të ndërlikuara dhe shumë të shtrenjta, çka nënkupton se shkurorëzimi parashikohej për personat e pasur dhe se deri në vitin 1857 bashkëshortësia mund të shkurorëzohej vetëm me vendim të Parlamentit (Stone, 1990:5).

*Në Evropën kontinentale, një numër i shteteve ishin nën sundimin e Napoleonit, ku gjente zbatim Kodi Civil Francez i Napoleonit edhe në të drejtën familjare (Glendon, 1989: 88)¹¹. Këto vende më parë e kishin konsideruar martesën si lidhje hyjnore të pashkëputshme deri në vdekje dhe nuk lejonin zgjidhjen e saj. Në vend të zgjidhjes së martesës gjente zbatim ndarja nga shtrati dhe tryeza -*separatio quod thorum et mensam* (Abdul'ati & Haxhi, 1995: 161). Në vendet që ndalohej shkurorëzimi, martesa juridikisht mbetej, por bashkëshortëve u mundësohej ndërprerja e jetës faktike të përbashkët, gjë që mundësonte krijimin e lidhjeve jashtëmartesore, pasi bashkëshortët nuk mund të lidhnin martesë të re. Sipas nenit 7 të Kushtetutës të Francës të vitit 1791, "*Ligji e konsideron martesën si kontratë civile*".*

¹¹ Sipas dispozitave ligjore të këtij ligji, shkurorëzimi ishte juridikisht i lejuar dhe siguronte barazinë gjinore për kërkesë të zgjidhjes së martesës dhe të drejta të barabarta si për burrin ashtu edhe për gruan. Mirëpo, në disa shtete si Italia, Spanja, Irlanda, Lihtenshtajni, Kili, Argjentina, Kolumbia, Brazili, etj., për shkak të ndikimit të fuqishëm të Vatikanit si dhe ashpërsisë së normave zakonore, numri i shkurorëzimeve ishte vetëm simbolik.

Bazuar në konceptin e *së drejtës kanonike*, për shumë kohë vendet e influencuara nga kisha katolike, kanë refuzuar të pranojnë zgjidhjen e martesës. E vetmja mënyrë për përfundimin e saj konsiderohej vdekja e njërit bashkëshort. Koncepti i martesës bazohej në *consortium omnis vitae ose consortium totius vitae* e cila konsiderohej *një bashkësi e përjetshme* pasi bazohej në konceptin se pas lidhjes së martesës të dy bashkëshortët unifikoreshin në një trup të vetëm¹².

Nga ana tjetër, *Kisha protestante* lejonte zgjidhjen e martesës: a) për shkak të shkeljes së besnikërisë bashkëshortore nga ana e gruas; b) braktisja e pa arsytuar e bashkësisë martesore; c) nëse ekzistonin shkaqe tjera si për shembull: nëse njëri bashkëshort refuzonte të kishte marrëdhënie martesore, nëse burri e keqtrajtonte gruan e tij vazhdimisht dhe pa arsye dhe sëmundja e rëndë e njërit bashkëshort. Gjithashtu edhe *Kisha Romake* njihte të drejtën e martesës së re, me rastin e vdekjes së njërit bashkëshort. Por nga ana tjetër shekuj me radhë, Kisha Katolike duke dashur të mbante nën kontroll pushtetin e Perandorisë romake dhe pushtetin gjyqësor, zbatonte masa disiplinore kundër besimtarëve të cilët nuk i respektonin rregullat fetare martesore, pa marrë parasysh nëse kjo ishte në kundërshtim me aktet juridike shtetërore (Mladenovic, 1982:74).

E drejta islame nuk e ka ndaluar shkurorëzimin rreptësisht, sepse një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me natyrën njerëzore dhe me vetë frymën e martesës, por gjithashtu nuk është edhe krejtësisht liberale ndaj çështjes së shkurorëzimit, konstatim ky i cili mund

¹² Zbatimi i këtij parimi *-erunt duo, in carne una-*, argumentonte dhe njëkohësisht për ligjtin mosnjohjen e zgjidhjes së martesës, pasi pas këtij bashkimi rezultonte një subjekt i vetëm i cili nuk mund të ndahej veçse si pasojë e vdekjes.

të nxirret nga thënia e profetit Muhamed i cili thotë: *Nga gjërat e lejuara më e urryer tek Zoti është shkurorëzimi* (Lamçe, 2009: 41).

Në Librin e Shenjtë të myslimanëve - Kur'anin, pas theksimit të masave dhe metodave për pajtimin e bashkëshortëve, emërimit të arbitërve dhe rolit të tyre, thuhet (Kurani 4:130): *Por, nëse ndahen prej njëri tjetrit, All-llahu begaton me mirësinë e Tij secilin prej tyre. All-llahu është Bujar i Madh, i Plotëdijshëm* (Ahmeti, 1988). Shprehja shkurorëzim, *Et-Telak*, në të drejtën islame nënkupton prishjen e kontratës së martesës përmes aktit konkret (Abazi *et al*, 1996: 299). Juristët e së drejtës së sheriatit islam, shkurorëzimin e kanë ndarë në dy lloje:

➤ *Shkurorëzimi me të drejtë rikthimi të bashkëshortes*, i cili është një lloj shkurorëzimi i cili nuk mënjanon dispozitat që rregullojnë bashkësinë e bashkëshortësisë e as që pezullon të drejtën e bashkëshortit. Bashkëshortësia akoma vazhdon të mbetet përderisa gruaja e shkurorëzuar është në ditët e *iddetit*¹³, pra, ditët e pritjes, andaj burri duhet ta rikthejë brenda kësaj periudhe. Nëse nuk e rikthen brenda periudhës së *iddetit*, atëherë ajo në këtë rast ndahet, me ç'rast ky nuk posedon të drejtë rikthimi pos me pëlqimin paraprak të gruas dhe krijimit të një kontrate të re juridike. Ky lloj shkurorëzimi mund të bëhet me fjalë që përmbajnë domethënie të qartë për shkurorëzimin si për shembull “ti je e shkurorëzuar”, apo “të kam shkurorëzuar”.

➤ *Shkurorëzimi përfundimtar*.

¹³ Pasi të kryhet procesi i ndarjes, ekziston një periudhë e pritjes apo periudhë provuese që normalisht zgjatë 3 muaj gjatë së cilës gruan e ndarë ende e mbanë dhe e përkrahë ish-burri i saj. Ajo nuk ka të drejtë të martohet edhe një herë para se të kalojë kjo periudhë.

Në lidhje me *shkaqet* që e drejta islame i konsideron bazë të zgjidhjes së martesës, ato janë:

- a) *Pëlqimi i bashkëshortëve për zgjidhje të martesës;*
- b) *Shkurorëzimi apo shkëputja e martesës përmes procesit gjyqësor.*

Në të drejtën shqiptare, veçanërisht gjatë sundimit osman, zgjidhja e martesës ishte dukuri mjaft e rrallë për shkak të rrethanave dhe kushteve ekonomiko-shoqërore në të cilat ndodhej shoqëria shqiptare dhe për shkak të karakterit patriarkal të marrëdhënieve martesore¹⁴. *Gjatë periudhës mesjetare*, në menyrë specifike, feudalizmit, personat dalloheshin për nga pozita e tyre në shoqëri, që njëherit edhe të drejtat dhe detyrimet e tyre në marrëdhëniet shoqërore dallonin nga klasa të cilën ato u përkasin (Mladenovic, 1982: 64)¹⁵. Ky dallim ekzistonte edhe në të drejtën familjare e martesore, si edhe me rastin e zgjidhjes së martesës. Nëse një person i takonte shtresës së pasur, ai mund shkurorëzohej lehtësisht për dallim nga shtresa e mesme ose e varfër.

Kuptimi i martesës sipas Kanunit të Lekë Dukagjini shprehej në nenin 28 të tij, sipas të cilit: *Me u martue sipas kanunit do me thanë me u ba shpi, me ia shtue një rob ma tepër*

¹⁴Zgjidhja e martesës shkaktonte ndërlikime të ndryshme për rritjen e fëmijëve, probleme pasurore ndërmjet bashkëshortëve, nga ana tjetër një martesë e re kërkonte shpenzime të reja të cilat mund të ishin të papërbalueshme për familjet e zakonshme, etj. Por, mbi të gjitha zgjidhja e martesës mund të çonte në armiqësi ndërmjet familjes së burrit dhe të gruas dhe në zbatimin e gjakmarrjes ndërmjet tyre, si në rastet e parashikuara në kanun, ashtu edhe në ato të paparashikuara. Meqënëse kishte shumë vrasje me rastin e zgjidhjes së martesës, Idriz Suli - mendimtar dhe luftëtar shqiptar nga Zhulati që në historinë shqiptare njihet si autori i Kanunit të Labërisë, shekulli XVIII-XIX - formuloi normën e re, sipas së cilës ndarja e gruas ishte e ligjshme. Gruaja vritej vetëm për shkelje të besnikërisë bashkëshortore dhe për asnjë shkak tjetër.

¹⁵ Nga ana tjetër, Kisha Ortodokse e Evropës juglindore lejonte zgjidhjen e martesës. Gjatë periudhës mesjetare në rregullimin e marrëdhënieve familjare dhe martesore ka patur ndikim të madh religjioni, qoftë i krishterë, ortodoks apo islam. Feudalizmi karakterizohej nga familjet patriarkale, në të cilën pushteti sërish i takonte burrit i cili përveç detyrës që të mbronte pasurinë dhe pronën e tij, kishte për detyrë të mbronte gruan e cila i takonte dhe ishte nën pushtetin e tij. Kështu, gruaja ishte e lidhur për burrin e saj, ashtu siç ai ishte i lidhur me tokën dhe feudet e tij. Në një gjendje të tillë zgjidhja e martesës ka qenë një fenomen i rrallë, por nga ana tjetër ndikoi që të përhapej poligamia, prostitucioni dhe amoraliteti.

sa për krah të punëve e sa për ti shtu fmit. Sipas këtij neni, përcaktimi për martesë, konsiderohet krijimi i një tërësie të vogël ekonomike e cila ka edhe funksionin e saj biologjik, ku femra llogaritet si një lloj robëreshe, e cila nuk ka të drejtë të vendosë për çështjet familjare të zgjidhjes së martesës (Gjerçovi, 1989:9). Mbi zgjidhjen e martesës, merr rëndësi Kanuni i Labërisë, sipas të cilit normë e re ishte ajo e ndarjes së gruas, pa sjellë si pasojë vrasjen (Elezi, 2006: 34). Me rëndësi mbi kuptimin e martesës ishin gjithashtu, K.C. i Mbretërisë Shqipëtare i vitit 1929, i cili ndaloi poligaminë e cila zbatohet si formë e lidhjes së martesës ndërmjet personave myslimanë, njohu si formë ligjore të martesës vetëm atë civile, duke eliminuar kështu martesat fetare.

Për shumë kohë zgjidhja e martesës ishte e ndaluar pasi ajo konsiderohej në kundërshtim me interesin publik dhe mbrojtjen e interesave të fëmijës. Në këtë kuptim i jepej përparësi interesave të grupit në raport me lirinë individuale (Omari, 2010:188).

Legjislacionet e shumë shteteve as që e ndalojnë zgjidhjen e martesës dhe as e lejojnë atë në mënyrë të pakufizuar. Një ndalesë e plotë do të ishte e papajtueshme me lirinë e individit për të zgjidhur një marrëdhënie të krijuar me vullnetin e tij. Nga ana tjetër, liberalizimi i plotë i shkurorëzimit, pra lënia tërësisht në vullnetin e bashkëshortëve të pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës, do të rezultonte e papërshtatashme për të garantuar mbrojtjen efektive të të miturve dhe të bashkëshortit më të dobët ekonomikisht.

II.2. Nocioni dhe natyra juridike e zgjidhjes së martesës (shkurorëzimit)

Doktrina identifikon thelbin e institutit të martesës në bashkëndarjen e ndjenjave dhe të jetesës dhe të ndihmesës së ndërsjelltë (Bonlini, 2006:69). Edhe pse martesë nënkupton një bashkësi dhe bashkëjetesë ligjore ndërmjet një çifti me synim që ajo të jetë e qëndrueshme, unike dhe bashkësi e vazhdueshme dhe e përhershme, kjo në praktikë nuk ndodh çdo herë.

Përkundrazi, të shumta janë rastet kur lind nevoja për shkurorëzim, pasi jeta shoqërore, faktikisht jeta martesore në shoqëri, ka dimensione dhe dinamika të ndryshme.

Sikurse vetë çështja e zgjidhjes së martesës, e cila i është nënshtruar një ndryshimi të vazhdueshëm, të njëjtën dinamikë ka ndjekur edhe përcaktimi i natyrës juridike të zgjidhjes së martesës (Puhan, 1969: 184) ¹⁶. Edhe ky përcaktim ka pësuar ndryshime në funksion të konceptit të ligjvënësit rreth faktit që për ligj zgjidhjen e martesës. Zgjidhja e martesës, si institut i së drejtës martesore është e lidhur ngushtësisht me martesën dhe lidhjen e saj: çdo marrëdhënie shoqërore, njëherë e krijuar, duhet rregulluar dhe përcaktuar për sa i përket kushteve, shkaqeve dhe mënyrave të shuarjes së saj (Vasilev & Haxhi, 1980: 126).

E drejta e shkurorëzimit është e drejtë krejtësisht personale dhe u takon ekskluzivisht bashkëshortëve. Martesa edhe pse lidhet me vullnetin e palëve bashkëshortëve, zgjidhja e saj duhet të bëhet sipas rregullave ligjore, burri dhe gruaja nuk mund ta zgjidhin vetë (Zaçë, 1996: 18). Në mënyrë që bashkëshortësia të mund të përfundojë në mënyrë definitive, duhet të ekzistojnë arsye të caktuara me ligj dhe në procedurë ligjore, të zgjidhet me aktgjykim të plotfuqishëm të organit kompetent shtetëror, në mënyrë specifike, gjykatës (Podvorica, 2006: 120). Shkurorëzimi mund të kërkohet vetëm për sa kohë të dy bashkëshortët janë gjallë. Supozimi i cekur duhet të ekzistojë për tërë kohën e zgjatjes së procedurës së shkurorëzimit. Në shumë legjislacione është përkufizuar nocioni bashkëshortësi, e cila paraqet bashkësinë e rregulluar të jetës së burrit dhe gruas në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, të familjes si dhe të shoqërisë. Kur kjo bashkësi

¹⁶ Martesa, sipas kësaj rryme doktrinare përkufizohet si lidhja ndërmjet një burri dhe një gruaje që përmban një jetesë të përbashkët të pazgjidhshme.

shpirtërore dhe interesash, përfundon jetesa e përbashkët kthehet në një gjendje të vështirë për t'u përballur (Brestovci, 2006: 117). Në këto raste shtrohet çështja e zgjidhjes së martesës.

Në zgjidhjen e martesës, në tre format e parashikuara nga legjislacionet e shteteve objekt analize, liria e palëve për të zgjidhur martesë kufizohet nga parimi i ligjshmërisë së martesës (Mandro *et al.*, 2006: 68), sipas të cilit martesa lidhet dhe zgjidhet vetëm me plotësimin e disa kushteve dhe ndjekjen e disa procedurave të parashikuara shprehimisht në ligj. Në fakt, edhe në rastet kur bashkëshortët bien dakort për zgjidhjen e martesës dhe për rregullimin e (disa) pasojave që rrjedhin prej saj, kërkohet domosdoshmërisht kontrolli nga ana e gjykatës dhe miratimi i projekt marrëveshjes për t'i dhënë fund ligjërisht lidhjes martesore.

Në të drejtën pozitive me termin *shkurorëzim* nënkuptojmë zgjidhjen e një martese të vlefshme që dallon thellësisht nga anulimi i martesës, sepse anulimi i martesës është zgjidhje e një martese të pavlefshme, ndërsa shkurorëzimi është zgjidhje e një martese të vlefshme (Aliu & Gashi, 2007: 158). Nga ky përkufizim rezultojnë këto veçori më kryesore të shkurorëzimit të martesës:

- a) martesa e vlefshme zgjidhet në mënyrë juridike;
- b) martesa zgjidhet gjatë jetesës së përbashkët;
- c) gjykata, si rregull, si organ kompetent shtetëror, e merr vendimin për shkurorëzim¹⁷,
- ç) shkaqet e zgjidhjes së martesës duhet të jenë të parapara me ligj;

¹⁷ Vihet re tendenca në Europë për zgjerimin e autonomisë së palëve në zgjidhjen e martesës (kur nuk ka të mitur) për ta zgjidhur martesën edhe pa vendim gjykate (për shembull, me asistencën e një avokati ose noteri).

d) procedura për zgjidhjen e martesës duhet po ashtu të jetë e paraparë me ligj.

Martesa si veprim juridik, *sui generis* që dallon nga veprimet e tjera juridike të bazuara në lirinë kontraktore të palëve, zgjidhet me vendim të gjykatës dhe jo me pëlqimin e bashkëshortëve. Sipas KFRSH të vitit 1982, gjykatat ishin të detyruara të përmendin shkaqet që kishin sjellë tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore dhe të përcaktonte bashkëshortin për fajin e të cilit zgjidhet martesa. Nga ato shkaqe mund të jenë disa, dhe konkretisht: keqtrajtimet; fyerjet e rënda; shkelja e besnikërisë bashkëshortore; sëmundja psikike e pashërueshme; dënimi penal i ndonjërit nga bashkëshortët; shkaqe tjera që mund të tronditin martesën deri në atë masë sa që jeta e përbashkët e tyre është e pamundur, dhe martesa ka humbur qëllimin e saj, etj. (Begeja, 1985: 270). Nëse bëhet zgjidhja e martesës pa shqyrtuar fajësinë e bashkëshortëve, gjykata nuk ka për detyrë të zbulojë dhe të çmojë ato veprime negative të njërit apo të tjetrit bashkëshort, që janë bërë shkak për tronditjen e thellë të marrëdhënieve bashkëshortore. Në të kundërtën, gjykata ka për detyrë të zbulojë shkakun që ka sjellë zgjidhjen e martesës.

Në propozimin e parashtruar para Komisionit ligjor në Angli për miratimin e *Divorce reform act* në vitin 1969 theksohet se: *nëse bashkëshortësia është e pasuksesshme, qëllim i të drejtës duhet të jetë - sigurimi i varrosjes dinjitoze të saj* (Glendon, 1989:88). Kjo duhet bërë në mënyrë të drejtë, me pasoja minimale për të gjithë të interesuarit, duke përfshirë si bashkëshortët po ashtu edhe fëmijët. Edhe sipas juristit të mirënjohur francez *Commaile*:

qëllimi i ligjvënësit nuk është të ndikojë në zgjedhjen e sjelljes në jetën private të njerëzve, e në këtë aspekt edhe të zgjidhjes së martesës, por t'i zgjidhë pasojat sociale të saj (De Singley, 1985:34).

Në të drejtën franceze të vitit 1984, parashikohej se nëse prindërit pas shkurorëzimit nuk paguajnë alimentacion për fëmijët, atë automatikisht e paguante Arka shtetërore për ndihmë familjare¹⁸.

Duke u nisur nga rregullativa ligjore e një numri të konsiderueshëm të shteteve, që nga kushti se bashkëshortësia paraqet bashkësi vullnetare të burrit dhe gruas për jetë, ajo mund të ndërpritet edhe me shkurorëzim, por vetëm nën kushte dhe në mënyrë të caktuar me ligj. Pra, zgjidhja e martesës paraqet mbarimin e bashkëshortësisë së plotfuqishme për jetë bashkëshortore për shkak të arsyeve të parashikuara me ligj. Bazuar në rolin që i njihej instrumentit ligjor të zgjidhjes së martesës ndeshim tre sisteme:

a) Zgjidhja e martesës si një *sanksion ligjor* - Sipas këtij sistemi, zgjidhja e martesës pranohet nga gjykata si një sanksion për veprime me faj të njërit apo të të dy bashkëshortëve. Në këto kushte, zgjidhja e martesës nuk mund të vendoset kundër bashkëshortit që nuk ka faj për zgjidhjen e martesës. Nevoja që të dëshmohej faji sillte deri tek diskutimet e ashpra dhe fajësime midis bashkëshortëve, që i dëmtonte edhe më shumë marrëdhëniet e tyre dhe ndikonte negativisht mbi mundësinë që të arriheshin marrëveshje për fatin e fëmijëve. Gjatë historisë, bashkëshortësia për një kohë të gjatë mund të zgjidhej vetëm për shkak të fajit të njërit bashkëshort, pra shkurorëzimi paraqitej si një sanksion, që autorët francezët e quanin “*komedi gjyqësore*” (Cretny, 1986: 85). Vetëm për të kënaqur kushtet ligjore, bashkëshortët shpiknin fajin e njërit bashkëshort që të zgjidhin martesën.

¹⁸ Tendencë e përgjithshme gati në të gjitha vendet evropiane është që të dy prindërit ta mbajnë të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në rast të shkurorëzimit – kështu është e rregulluar në Gjermani, në Holandë nga viti 1995; zgjidhje e këtillë është e parashikuar edhe në Francë me ligjin e vitit 1987 si dhe në Angli me miratimin e *Children Act* e vitit 1989.

b) Zgjidhja e martesës si një *mjet shërues* - Sipas këtij koncepti, zgjidhja e martesës paraqitet si alternativa më e mirë për bashkëshortët, në rastet kur vazhdimësia e martesës do të dëmtonte rëndë interesat e tyre. Në këto kushte, zgjidhja e martesës vendoset për motive që nuk kushtëzohen nga faji i bashkëshortëve, por nga tronditja e thellë e marrëdhënieve bashkëshortore, e cila e bën të pamundur vazhdimin e jetës së përbashkët, të paktën në drejtim të njërit bashkëshort (Podvorica, 2006: 120).

c) Zgjidhja e martesës si një *natyrë mikse*, e cila ndërthur elemente të sanksionit ligjor dhe mjetit shërues. Sipas këtij kombinimi ndërmjet konceptit të sanksionit ligjor dhe mjetit shërues, zgjidhja e martesës vendoset nga gjykata në ato raste kur si pasojë e një veprimi të fajshëm të njërit apo të të dy bashkëshortëve, jeta e përbashkët është bërë e pamundur (Omari, 2010: 191).

Nga sa më sipër, gjithnjë e më shumë pranohet një sistem objektiv, sipas së cilit bashkëshortësia zgjidhet nëse ka përjetuar mospasë. Shkurorëzimi mund të bëhet vetëm për shkaqe të parapara me ligj. Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohet me ligj*. Sipas nenit 37 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen me barazinë e bashkëshortëve*. Legjislacionet e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës, e kanë përvetësuar sistemin e përzier në të cilin parashihen shkaqet e përgjithshme dhe shkaqet e veçanta për të kërkuar shkurorëzim.

II.3. Zgjidhja e martesës në të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane

Zgjidhja e martesës (apo divorci) në tre vendet objekt analize, nuk mund të analizohet pa një referim në të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane. Në të dyja rastet dallojmë ato akte të së drejtës pozitive që përbëjnë “ligjin e fortë”, nga ato që njihen me termin “ligj i butë” (Zyberi, 2011: 118). Këto të fundit i referohen instrumentave gati ligjorë të cilat nuk kanë fuqi ligjore detyruese të të parave, apo forca detyruese e të cilëve është disi e “dobët” krahasuar me forcën detyruese të së drejtës tradicionale. Edhe pse instrumentet e ligjit të butë konsiderohen zakonisht si jodetyruese, ato në vetvete mbajnë shumë potencial për krijimin e “ligjit të fortë” (të drejtës së kodifikuar) në të ardhmen. Kjo mund të realizohet ose duke iu referuar “ligjit të butë” në procesin e traktat-bërjes, qoftë në krijimin e normave të së drejtës zakonore (Zyberi, 2011: 119). Të tilla janë në nivel ndërkombëtar apo rajonal parimet deklaratat, kodet e sjelljes, kodet e praktikës, udhëzimet etj. Ndër to, me rëndësi të veçantë në nivel europian përmendim edhe Parimet e CEFL, të cilat do të thellohen në vijim.

E drejta për jetë private dhe familjare, garantohet nga një sërë aktesh ndërkombëtare si: neni 12 DUDNj, neni 8 KEDNj, neni 11 KADNj. dhe neni 17 PNDCP, ndërkohë që neni 10 PNDESK garanton mbrojtje të veçantë për familjen, nënat dhe fëmijët. E drejta për martesë përfshin të drejtën për martesë, të drejtën për të formuar familje dhe të drejtën e barazisë mes bashkëshortëve, por nuk garanton të drejtën për të zgjidhur martesë (Daci, 2011: 335)¹⁹. Neni 12 i DUDNj-së. garanton të drejtën për të formuar familje, por kjo e drejtë nënkupton detyrimin e Shtetit për të mos ndërhyrë në gëzimin e kësaj të drejte dhe

¹⁹ Megjithatë, garantohet e drejta për t’u martuar sërish pas një divorci.

nuk përmban detyrime positive për shtetin për të siguruar këtë të drejtë (Daci, 2011: 338). Barazia ndërmjet bashkëshortëve, përveç dispozitave që garantojnë barazinë para ligjit të gjithë individëve, garantohet edhe nga neni 5 i Protokollit nr. 7 i KEDNj, ndërkohë që instrumentet kryesore që garantojnë të drejtat e grave janë: CEDAW (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave), neni 24 PNDCP, neni 10 i PNDESK si dhe Preambula e DUDNj.

Në nivel europian, Traktati i Lisbonës e bëri të detyrueshëm Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së nëpërmjet nenit 6 TBE. Dispozitat që lidhen me respektimin e jetës private dhe familjare (të parashikuara në nenin 7), dhe e drejta për të lidhur martesë (e parashikuar në nenin 9), marrin një dimension të ri. Karta aplikohet në mënyrë universale: përdorimi i shprehjes “çdo individ” dhe jo “çdo shtetas që ka shtetësinë e një prej shteteve anëtare të BE-së”, tregon se sfera e saj subjektive e zbatimit nuk kufizohet vetëm në lidhje me shtetasit që mbartin shtetësinë e një prej shteteve anëtare të BE-së (Canaj, 2014: 42).

Nenet 67 dhe 81 TFBE, origjina e të cilave gjendet në Traktatin e Amsterdimit, i japin kompetencë BE-së të nxjerrë aktet e nevojshme në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet civile, për të cilat zbatohet procedura e zakonshme legislative. Përjashtim bëjtë çështjet që lidhen me të drejtën familjare ndërkufitare, për të cilat kërkohet vendimi unanim i Këshillit pasi të jetë konsultuar Parlamenti. Në këto çështje ka gjetur zbatim procedura e bashkëpunimit të përforcuar e parashikuar nga nenet 326-334 të TFBE.

Pikërisht sipas kësaj procedure është nxjerrë edhe *Rregullorja 1259/2010*, “Mbi vendosjen e bashkërendimit mbi ligjin e zbatueshëm përsa i përket marrëdhënieve familjare dhe divorcit”, (e njohur si *Roma III*). Ajo i referohet çifteve me shtetësi të

ndryshme dhe ka për qëllim të shmangë situatat në të cilat njëri bashkëshort depoziton i pari padinë për zgjidhjen e martesës për t'u siguruar që të gjejë zbatim legjislcioni më i favorshëm ndaj tij²⁰. Disa akte te tjera ndërkombëtare dhe europiane të rëndësishme për zgjidhjen e martesës janë edhe:

- Konventa e Hagës (1970), *“Për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore”*.
- Konventa e Hagës (1973), *Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me detyrimin për ushqim*.
- Rregullorja nr. 2201/2003, e njohur si *Bruxelles II bis*²¹, (e cila ka zëvendësuar Rregulloren nr. 1347/2000, e njohur si *Bruxelles II*²²), parashikon një procedurë të përbashkët të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në BE²³. Qëllimi i saj është që zgjedhja e shtetasve për t'u spostuar nga një shtet në tjetrin të mos kushtëzohet nga njohja ose mosnjohja e statusit personal dhe familjar²⁴. Sipas saj, palët mund të përcaktojnë ligjin e zbatueshëm në marrëdhëniet e tyre, nëpërmjet një marrëveshje që mund të lidhet në çdo kohë.
- Direktiva 2004/38 “Mbi të drejtën e shtetasve të vendeve të BE-së dhe të familjarëve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e Shteteve anëtare”.

²⁰ Sipas saj, bashkëshortët mund të bien dakort mbi ligjin e zbatueshëm në rast zgjidhje martesës, me kusht që të bëhet fjalë për ligjin: a) e shtetit të vendqëndrimit të zakonshëm në momentin e lidhjes së marrëveshjes; b) e shtetit të vendqëndrimit të fundit të zakonshëm të bashkëshortëve nëse njëri prej tyre qëndron ende aty; c) e shtetit, shtetas i të cilit është njëri prej bashkëshortëve në momentin e lidhjes së marrëveshjes; d) “lex fori”, pra, ligji i vendit në të cilin ndodhet autoriteti gjyqësor i zgjedhur nga palët.

²¹ Rregullorja nr. 2201/2003 “Mbi kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën e marrëdhënieve bashkëshortore dhe pergjegjësisë prindërore”.

²² Rregullorja nr. 1347/2000 “Mbi kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën e marrëdhënieve bashkëshortore dhe pergjegjësisë prindërore mbi fëmijët e pvrbashkët”.

²³ Ndryshimi që ka sjellë Rregullorja nr. 2201/2003 në raport me parashikimet e Rregullores nr. 1347/2000 është njohja e barazisë ndërmjet të miturve të lindur si në rregjim martesor, ashtu edhe jashtë martese.

²⁴ Neni 3 i saj parashikon rregullat e përgjithshme për individualizimin e organeve kompetente gjyqësore, për zgjidhjen dhe anulimin e martesës, si edhe ndarjen ligjore ndërmjet bashkëshortëve.

- Direktiva 2003/86 “Mbi të drejtën për ribashkim familjar”, e cila ka për qëllim të përcaktojë kushtet mbi bazën e të cilave mund të ushtrohet e drejta për ribashkim familjar për shtetasit e vendeve të treta të cilët qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në BE.

Në nivel europian, zgjidhja e martesës merr rëndësi për pasojat që ajo sjell në raport me të drejtën e qëndrimit në territorin e BE-së²⁵. Në këtë drejtim, problematike është edhe çështja e martesave fiktive. Legjislacioni i BE-së njeh dhe respekton të drejtën për të lidhur martesë dhe të drejtën për jetë familjare. Por kjo e drejtë shpesh abuzohet për qëllime të hyrjes në shtetet anëtare (Ikononi, 2009: 136)²⁶.

Shumë aspekte që lidhen me zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj, pritet të harmonizohen në nivel europian nëpërmjet Parimeve të CEFL (Principles of European Family Law, 2015). Ajo që vihet re nga këto Parime është thjeshtimi dhe përshpejtimi i zgjidhjes së martesës, sidomos në rastet kur nuk janë përfshirë të miturit. Megjithatë, ky proces i harmonizimit të së drejtës familjare në Europë ka ndeshur në kritika doktrinare, të cilat argumentojnë mbi vështirësitë e këtij procesi për shkaqe që lidhen me faktorë socialë, kulturorë dhe faktorë të tjerë, të ndryshëm mes vendeve (Patti & Cubeddu, 2011:96). Mes faktorëve socialë renditen për shembull: tregu i punës dhe aksesit i gruas në të, siguria sociale dhe politikat e asistencës së të miturve. Këto kritika shtrojnë për debat çështjen nëse në fushën e të drejtës familjare ka patur një konvergencë sponatane të sistemeve të

²⁵ Kështu, sipas një vendimi të GjED, mbi zbatimin e dispozitave të Direktivës 2004/38 “Mbi të drejtën e shtetasve të vendeve të BE-së dhe të familjarëve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e Shteteve anëtare”, përcaktohet se, nëse procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës mes një shtetasi të një vendi anëtare dhe një shtetasi të një vendi të tretë, paraprihet nga largimi i shtetases nga Shteti anëtar ku ajo ka vendbanimin, i ndryshëm nga ai i shtetësisë, bashkëshorti i vendit të tretë nuk mund të gëzojë më të drejtën e qëndrimit.

²⁶ *Acquis* parashikonte që në vitin 1997 në një rezolutë të veçantë – Rezolutën e Këshillit të 4 dhjetorit 1997 – për masat që duheshin marrë për të luftuar martesat me qëllim dokumentacioni.

ndryshme ligjore (traditë juridike perëndimore), apo në të kundërt, një cedim i (“shitje” e) traditave nga vendet politikisht më të dobta drejt vendeve politikisht më të forta? (Lamçe, 2014: 1).

Një tjetër çështje e debatueshme në nivel europian lidhet me konsideratën se, tashmë shihet si i tejkaluar koncepti i mbizotërimit të së drejtës publike në çështjet familjare, për shkak të zgjerimit të autonomisë kontraktore, veçanërisht në lidhje me aspektet pasurore (Cassano, 2009: 85). “Privatizimi” i jetës familjare përkufizohet nga doktrina si *rritja e hapësirës së autonomisë kontraktore dhe rënia graduale e kufizimeve të mëparshme të konceptuara si të pashmnagshme* (Oberto, 2012: 117). Nga ana tjetër, “privatizimi” i martesës trajtohet edhe si një çështje që shkon përtej qasjes juridike. Kështu për shembull, Gary Becker i referohet konceptit ekonomik të martesës duke e lidhur atë me konceptin e *“dobishmërisë”*: *martesa do të zgjidhet nëse fitimi që do të merret prej saj do të jetë më i madh sesa humbja si në terma financiarë ashtu edhe në ato fizike-emotive* (Cerutti, 2014: 954).

Mes studiuesve, ka dhe opinione si ato të Richard Thaler dhe të Cass Sustein, sipas të cilit termi *“martesë”* nuk duhet të shfaqet më në asnjë ligj, dhe duhet zëvendësuar me termin *“lidhje civile”*, të privatizuar totalisht (Cerutti, 2014: 954). Një pjesë e doktrinës vë në dukje, ndër të tjera, edhe:

rrezikun se lidhja në çift mund të konsiderohet se nuk përbën një vlerë me rëndësi sociale, por një fakt ekskluzivikisht privat, i cili nuk meriton as përpjekjen e gjykatës për të pajtuar palët. (Belletti, 2015).

Sygjerimi i kësaj rryme mendimi është që: *t’iu ofrohen çifteve në krizë mjetet e nevojshme për t’i ndihmuar të kalojnë krizën.*

Në lidhje me arsyet e “privatizimit” të zgjidhjes së martesës, doktrina rendit si më poshtë (Gorgoni, 2009: 174): a) kalimin e disa nocioneve si privatësi dhe autonomi nga e drejta kushtetuese në të drejtën familjare; b) refuzimin e roleve gjinore tradicionale femër/mashkull (burrë/grua); c) rritjen e rolit të analizës ekonomike në sistemin e të drejtës dhe zbatimi i saj në të drejtën familjare. Shembulli më evident i privatizimit të zgjidhjes së martesës është rivlerësimi i rolit të fajit (dikur i domosdoshëm, sot jo më) për zgjidhjes e martesës. (Velletti & Calo' 2012: 93-94).

II.4. Parimet e hartuara nga CEFL mbi zgjidhjen e martesës

CEFL, i krijuar me qëllim harmonizim e të drejtës familjare në Europë, ka përzgjedhur sektorët ku do të fokusohet analiza e institutive më me rëndësi për të drejtën familjare, në kontekstin kombëtar dhe atë europian. Analiza ka nisur pikërisht nga instituti i zgjidhjes së martesës dhe ai i detyrimit për ushqim (parimet e të cilave u publikuan nga *CEFL* në vitin 2004²⁷), tregues ky i faktit të impaktit që ka zgjidhja e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj në të drejtën familjare. Nga pikëpamja e metodës së punës të ndjekur nga *CEFL*, ajo bazohet në (Lamçe, 2014: 3):

1. Përgatitjen e një raporti mbi gjendjen aktuale të kërkimit në nivel krahasues lidhur me harmonizimin e të drejtës familjare në secilin prej vendeve europiane.
2. Shkëmbimin reciprok të eksperiencave dhe koordinimin e punës kërkimore që do të zhvillohet në të ardhmen.

²⁷ Shih Shtojcën II bashkangjitur këtij punimi. Për më gjerë shih <http://ceflonline.net/principles/>, parë në datë 10.11.2013.

3. Identifikimin e një baze të përbashkët për të zgjidhur problemet e ndryshme juridike, nëpërmjet një analize krahasuese të rendeve juridike europiane.

4. Përcaktimin e rolit që do të luajnë Shtetet e tjera, që potencialisht mund të jenë në të ardhmen anëtare të BE-së.

Rezultati final që pritet të arrihet si rezultat i punës së Komisionit në fjalë, konsiston në formulimin e parimeve të së drejtës familjare europiane, të domosdoshëm për harmonizimin e së drejtës familjare në Europë.

Megjithatë, sipas Bradley:

metoda e ndjekur nga Komisioni kritikohet për mungesë legjitimiti (konsensusi), pasi ndryshimi i rregullave duhet të pranohet nga të gjithë: në të kundërt ato nuk mund të gjejnë zbatim në praktikë (Fantetti, 2011: 128).

Sipas tij, *tendencat konservatore apo progresiste ndryshojnë nga një vend në tjetrin; ato ndikohen nga zgjedhjet politike dhe nga trashëgimia kulturore e një vendi.*

Për efekte të analizës krahasimore, ndër Parimet e hartuara nga CEFL, paraqesin interes të veçantë ato që lidhen me: rastet e zgjidhjes së martesës nga e cila nuk kanë lindur fëmijë të cilat trajtohen ndryshe nga ato me fëmijë (CEFL, 2015)²⁸; përsheptimi i procedurës së zgjidhjes së martesës si dhe mundësia për ta zgjidhur atë në rrugë jashtë gjyqësore; funksioni i seancës pajtimore, i parashikuar si i detyrueshëm para zgjidhjes së martesës, si dhe efikasiteti i saj në praktikë etj. Në mënyrë specifike:

Parimi 1.1. - Lejimi i zgjidhjes së martesës: (1) “Ligji rekomandohet të lejojë zgjidhjen e martesës”. (2) “Nuk rekomandohet të kërkohet një kohëzgjatje e martesës”.

²⁸ Shih dispozitat mbi periudhën e reflektimit të pasqyruara në parimin 1.5, e cila në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë shkon nga tre deri në gjashtë muaj, në varësi të faktit nëse bashkëshortët kanë rënë dakort ose jo mbi të gjitha pasojat që rrjedhin nga zgjidhja e martesës.

Mungon referimi në veçimin vetjak apo në shkaqet e zgjidhjes së martesës, si parakushte për zgjidhjen e saj (Zatti, 2011: 113). Tashmë në të gjitha vendet e BE-së lejohet zgjidhja e martesës: Malta ishte shteti i fundit i BE-së që deri vonë (në vitin 2011) nuk lejonte zgjidhjen e martesës (Castellaneta, 2011). Përveç kësaj, nuk është e nevojshme që martesa të ketë zgjatur një periudhë të caktuar kohore, apo që përpara zgjidhjes së saj të ketë domosdoshmërisht një periudhë ndarje faktike mes bashkëshortëve: kërkesa për zgjidhjen e martesës mund t'i paraqitet organeve kompetente edhe menjëherë pas lidhjes së saj.

Parimi 1.2. – Procedura ligjore dhe autoriteti kompetent: (1) “Procedura e zgjidhjes së martesës rekomandohet që të përcaktohet me ligj”. (2) “Zgjidhja e martesës rekomandohet që të vendoset nga organi kompetent, i cili mund të jetë një organ gjyqësor ose administrativ”. Në dallim nga parashikimet e CEFL, në tre vendet e marra në analizë, autoriteti kompetent për zgjidhjen e martesës mund të jetë vetëm ai gjyqësor.

Parimi 1.3. – Mënyrat e zgjidhjes së martesës: “Rekomandohet që ligji të lejojë si zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok ashtu edhe zgjidhjen e martesës pa pëlqimin e njërit bashkëshort”. Ky parim bazohet në lirinë dhe vullnetin e palëve dhe refuzohet koncepti i zgjidhjes së martesës si sanksion. (Lamçe, 2015: 75).

Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok

Parimi 1.4. - Pëlqimi reciprok . Kjo formë e zgjidhjes së martesës nuk presupozon që kriza (thyerja) të jetë e pakthyeshme, por mjafton dakortësia dhe nuk kërkohet të plotësohet kusht tjetër për të kërkuar zgjidhjen e martesës. Nuk kërkohet as ndarje faktike.

Parimi 1.5. – Periudha e reflektimit: Periudha e reflektimit kur zgjidhja e martesës është me pëlqim reciprok parashikohet si e detyrueshme në dy raste specifike dhe varion nga tre-gjashtë muaj: a) nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur nën moshën 16 vjeç, do të duhen tre muaj nëse ata kanë rënë dakort mbi të gjitha pasojat, ose gjashtë muaj nëse ata nuk kanë rënë dakort mbi të gjitha pasojat; b) nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur nën moshën 16 vjeç, por ata nuk kanë rënë dakort mbi të gjitha pasojat, do të duhen tre muaj periudhe reflektimi përpara se të kërkohet zgjidhja e martesës. Periudha e reflektimit kur martesa zgjidhet me pëlqim reciprok nuk është e nevojshme në dy raste: a) nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur nën moshën 16 vjeç dhe ata kanë rënë dakort mbi të gjitha pasojat nuk është e nevojshme një periudhë reflektimi; b) nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur nën moshën 16 vjeç dhe ata kanë jetuar të ndarë faktikisht për një periudhë gjashtë mujore.

Parimi 1.6. – Forma e projekt marrëveshjes: Si elementë përbërës të projekt marrëveshjes, e cila parashikohet të jetë me shkrim, renditen: a) përgjegjësia prindërore, nëse është e nevojshme, duke përcaktuar vendin dhe mënyrën e takimit me fëmijët; b) kontributin ndaj fëmijëve, nëse është e nevojshme; c) ndarjen ose rishpërndajen e pasurisë (reallocation); d) kontributin ndaj ish bashkëshortit. Nga leximi i kombinuar i Parimeve 1.6 dhe 1.7 deduktohet se paraqitja e projekt-marrëveshjes nuk përbën *conditio sine qua non* për zgjidhjen e martesës (Lamçe, 2015: 78). Kjo sepse, sipas autores, në praktikë mund të paraqiten raste kur bashkëshortët nuk kanë rënë dakort as mbi pikat c) dhe d) të Parimit 1.6 (mundësi kjo e parashikuar pikërisht nga Parimi 1.7), dhe as mbi pikat a) dhe b) të Parimit 1.6 (të cilat ndiqen nga fraza “nëse është e nevojshme”).

Parimi 1.7. – Përcaktimi i pasojave: Në të gjitha rastet e zgjidhjes së martesës autoriteti kompetent duhet të përcaktojë mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë pindërore dhe kontributin për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Çdo marrëveshje e bashkëshortëve do të merret parasysh nëse është në interesin më të lartë të të miturit. Nëse bashkëshortët nuk kanë rënë dakort, ose kanë rënë pjesërisht dakort mbi ndarjen ose rishpërndajen e pasurisë (*reallocation*) dhe/ose kontributin ndaj ish bashkëshortit, atëherë autoriteti kompetent mund t'i përcaktojë ato me kërkesë të palëve.

Zgjidhja e martesës pa pëlqimin e njërit bashkëshort

Parimi 1.8. – Ndarja faktike: “Zgjidhja e martesës pa pëlqimin e njërit bashkëshort duhet të lejohet nëse ka patur ndarje faktike prej një viti, pavarësisht nga rrethanat e tjera”. Në këtë rast ndarja faktike e bën peridhën e reflektimit jo të domosdoshme (Amram & D’Angelo, 2011: 128).


Parimi 1.9. – Pamundësi e jashtëzakonshme (exceptional hardship) për palën kërkuese: Në parimet e CEFL nuk ka një përkufizim apo shpjegim të *exceptional hardship*. Megjithatë, doktrina specifikon se nuk mund të përshihet në këtë kategori çdo lloj sjellje e paligjshme, por vetëm ato ekstreme të keqtrajtimit, të dhunës familjare apo ato me natyrë financiare (Boele-Woelki, 2005: 96).

Parimi 1.9. – Përcaktimi i pasojave: Autoriteti kompetent duhet të përcaktojë pasojat që lidhen jo vetëm me fëmijët por edhe me bashkëshortët. Lidhur me pasojat vlen parimi i vetëpërgjegjesisë, sipas të cilit pas zgjidhjes së martesës secili bashkëshort përballon vetë shpenzimet për nevojat e tij (Amram & D’Angelo, 2011: 131). Për sa i përket *kontributit ndaj ish-bashkëshortit*, sipas Parimit 2.1., ai i nënshtrohet të njëjtave rregullave pavarësisht

nga mënyra e zgjidhjes së martesës. Është e debtaueshme në doktrinë nëse kontributi kompensues duhet të përfshijë vetëm humbjen e të ardhurave që rrejdhin nga zgjidhja e martesës apo edhe ruajtjen e një standarti jetese specifik (Lamçe, 2015: 80).

II.5. Shqyrtime të të dhënave statistikore rreth zgjidhjes së martesës në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës si dhe Republikën e Maqedonisë.


Në grafikët e mëposhtëm janë analizuar zgjidhjet e martesës prej vitit 2009-2013, për Kosovën, Maqedoninë dhe Shqipërinë, sipas veçorive kryesore si: mosha, gjinia, përkatësia kombëtare, përgatitja shkollore, numri i fëmijëve të lindur në këtë martesë, ndarja e fëmijëve etj. Burimet e shfrytëzuara janë: Enti Statistikor i Kosovës, Enti Shtetëror i Statistikave i Maqedonisë dhe Instituti i Statistikave i Shqipërisë (INSTAT). Njësi raportuese për shkurorëzime kanë qenë Gjykatat Themelore dhe të dhënat janë grumbulluar me pyetësor statistikor të veçantë për Shkurorëzime. Rezultatet e statistikave për shkurorëzime janë përpunuar sipas parimit të vendbanimit të përhershëm të fundit të përbashkët të të martuarve.



Grafiku 1. Shkurorëzimet sipas grup-moshës së gruas në Kosovë
(burimi Enti Statistikor i Kosovës [ESK], 2015)

Nga ky grafik rezulton se në Kosovë:


- 1) niveli i shkurorëzimeve sipas grup-moshës së gruas ka një tendencë në ulje ndër vite:
- 2) numri më i lartë i shkurorëzimeve në krahasimin mes grupmoshave është për kategorinë 25-34, ndërkohë që për grupmoshën 45-49 dhe 50 e më shumë kjo është më e ulët, me një tendencë që ruhet ndër vite; pra, moshat e reja kanë një tendencë të zgjidhin martesë më shumë se të tjerat: kjo mund të ndikohet nga disa faktorë social dhe ekonomik (si emancipimi i gruas dhe pavarësia e saj ekonomike).
- 3) është e kuptueshme që zgjidhja e martesës për kategorinë nën 20 vjeç është më e ulët sepse martesat nën këtë moshë janë më të vogla në numër.



Grafiku 2. Shkurorëzimet sipas grup-moshës së gruas në Maqedoni
(burimi Enti Shtetëror i Statistikave i Maqedonisë [ESHSM], 2015)


Ndërkaq në Maqedoni sa i përket shkurorëzimeve sipas grupmoshës së gruas vërejmë se:

- 1) niveli i shkurorëzimeve ka një tendencë në rritje ndër vite:
- 2) numri më i lartë i shkurorëzimeve në krahasimin mes grupmoshave është për kategorinë 25-34 ndërkohë që për grupmoshën 45-49 dhe 50 e më shumë kjo është më e ulët, me një tendencë që ruhet ndër vite: pra moshat e reja kanë një tendencë të zgjidhin martesë më shumë se të tjerat që mund të ndikohet nga disa faktorë social, dhe ekonomik.
- 3) është e kuptueshme që zgjidhja e martesës për kategorinë nën 20 vjeç është më e ulët sepse martesat nën këtë moshë janë më të vogla në numër.



Grafiku 3. Krahasimi i shkurorëzimet sipas grup-moshës së gruas: Kosovë - Maqedoni (burimi ESHSM dhe ESK, 2013)

Në grafikun më sipër kemi bërë krahasim për shkurorëzimet sipas grup moshës së gruas në Kosovë dhe Maqedoni nga ku rezulton se në Maqedoni numri i shkurorëzimeve është dukshëm më i madh se në Kosovë, sidomos prej moshës 25. Ndër shkaqet kryesore mund të merren shkaqet ekonomike.




Grafiku 4. Shkurorëzimet sipas grup-moshës së burrit në Maqedoni (burimi ESHSM, 2013)

Ndërkaq në Maqedoni sa i përket shkurorëzimeve sipas grupmoshës së burrit vërejmë se:

1) niveli i shkurorëzimeve ka një tendencë në rritje ndër vite:


2) numri më i lartë i shkurorëzimeve në krahasimin mes grupmoshave është për kategorinë 30-39, për dallim nga mosha e gruas ku kishim rritje prej moshës 25-34, kjo sepse meshkujt lidhin kurorë në moshë më të rritur se femrat, prandaj dhe te këto grupmosha kemi numrin më të madh të shkurorëzimeve, ndërkohë që për grupmoshën 45-49 dhe 50 e më shumë kjo është më e ulët, me një tendencë që ruhet ndër vite: pra moshat e reja kanë një tendencë të zgjidhin martesë më shumë se të tjerat.

3) është e kuptueshme që zgjidhja e martesës për kategorinë nën 20 vjeç është më e ulët sepse martesat nën këtë moshë janë më të vogla në numër.




Grafiku 5. Krahasimi i shkurorëzimeve sipas grup-moshës së burrit: Kosovë-Maqedoni (burimi ESHSM dhe ESK, 2013)

Në grafikun më sipër kemi bërë krahasim për shkurorëzimet sipas grup moshës së burrit në Kosovë dhe Maqedoni nga ku rezulton se në Maqedoni numri i shkurorëzimeve është dukshëm më i madh se në Kosovë, sidomos prej moshës 30.




Grafiku 6. Shkurorëzimet sipas përkatësisë etnike të gruas në Kosovë
(burimi ESK, 2013)

Sa i përket shkurorëzimeve sipas përkatësisë etnike të gruas në Kosovë vërejmë se shkurorëzimet janë me numër shumë të madh te shqiptarët. Kjo për shkak se në Kosovë shumica e popullsisë janë të përkatësisë etnike shqiptare.




Grafiku 7. Shkurorëzimet sipas përkatësisë etnike të gruas në Maqedoni (burimi ESHSM, 2013)

Sa i përket shkurorëzimeve sipas përkatësisë etnike të gruas në Maqedoni vërejmë se këtu shkurorëzimet janë me numër shumë të madh te maqedonasit, e më pas ky numër është më i madh te shqiptarët, sidomos gjatë vitit 2012 dhe 2013. Kjo për shkak se në Maqedoni shumica e popullsisë janë të përkatësisë etnike maqedone dhe shqiptare.




Grafiku 8. Shkurorëzimet sipas përkatësisë etnike të burrit në Maqedoni (burimi ESHSM, 2013)

Sa i përket shkurorëzimeve sipas përkatësisë etnike të burrit në Maqedoni vërejmë se edhe këtu shkurorëzimet janë me numër shumë të madh te maqedonasit, e më pas ky numër është më i madh te shqiptarët, sidomos gjatë vitit 2012 dhe 2013. Kjo për shkak se në Maqedoni shumica e popullsisë janë të përkatësisë etnike maqedone dhe shqiptare.



Grafiku 9. Totali i shkurorëzimeve sipas përkatësisë etnike në Maqedoni 2009-13 (burimi ESHSM, 2013)


Edhe nga ky grafik konkludojmë se varësisht të numrit të popullsisë, ashtu edhe shkurorëzimet janë me numër më të madh të maqedonsait e më pas të shqipëtare dhe etnitë e tjera.



Grafiku 10. Shkurorëzimet sipas kohëzgjatjes së martesës në Kosovë
(burimi ESK, 2013)

Nga grafiku i mësipërm vërejmë se numri i tyre më i madh është për martesat me kohëzgjatje prej 5-9 vjet por që në vitin 2012 dhe 2013 ky numër është më i vogël. Është e kuptueshme që shkurorëzimet për martesat më pak se një vit është dukshëm më i vogël, pasi që bashkëshortët janë në fazën e hershme të bashkjetesës së tyre. Vihet re gjithashtu se për vitin 2011 ka një nivel shumë më të lartë, të sproporcionuar të zgjidhjes së martesës në raport me vitet e tjera. Nga intervistimet e gjyqtarëve kosovarë, rezulton se *disa raste janë fiktive dhe nuk paraqesin gjendjen reale të bashkëshortëve sepse kanë qëllime për*


rregullimin e dokumentacionit në botën e jashtme dhe se gjyqtarët e dinë se ato janë fiktive²⁹.



Grafiku 11. Shkurorëzimet sipas kohëzgjatjes së martesës në Maqedoni (burimi ESHSM, 2013)

Në Maqedoni vërejmë se nuk ka luhatje të ndjeshme për martesat e reja (me kohëzgjatje një vjeçare), por ka një rritje të ndjeshme të shkurorëzimeve për kategorinë e martesave me kohëzgjatje të më të madhe (5-9 vjet dhe më shumë se 15 vjet), ndërkohë që shkurorëzimet për martesat më pak se një vit është dukshëm më i vogël, pasi që bashkëshortët janë në fazën e hershme të bashkjetesës së tyre.


²⁹ Shih artikullin me titull: *50 Kërkesa në Muaj për Shkurorëzim*, në <http://kallxo.com/gink/50-kerkesa-ne-muaj-per-shkurorezim/>, parë në datë 18.11.2015.




Grafiku 12. Krahasim i shkurorëzime sipas kohëzgjatjes së martesës: Kosovë-Maqedoni (burimi ESHSM dhe ESK, 2013)

Nga grafiku i më sipërm sa i përket kohëzgjatjes së martesës si në Kosovë ashtu edhe Maqedoni rezulton se:

- 1) numri më i madh i shkurorëzimeve vjen pas martesave me kohëzgjatje prej 1 dhe 2 vjet, kjo sepse bashkëshortët nuk mund të përshtaten jetesës së përbashkët, mentalitetit të njëri tjetrit dhe shumë faktorë të tjerë,
- 2) gjithashtu numër të madh të shkurorëzimeve kemi edhe te martesat prej 5 deri në 9 vjet, sidomos në vitet e fundit dhe kjo për shkaqe të ndryshme sociale dhe ekonomike,
- 3) në Maqedoni kemi rritje të shkurorëzimeve te martesat prej 15 e më shumë vjet për dallim nga Kosova.




Grafiku 13. Shkurorëzimet sipas numrit të fëmijëve nga martesat në Kosovë (burimi ESK, 2013)




Grafiku 14. Totali i shkurorëzimeve sipas numrit të fëmijëve në Kosovë (2009-2013) (burimi ESHSM dhe ESK, 2013)

Nga grafikët e mësipërme vërejmë se numri më i madh i shkurorëzimeve ndodh në martesat pa fëmijë, kjo sepse bashkëshortët nuk i lidh asgjë pas shkurorëzimit, përgjegjësit e tyre janë më të vogla. Ky numër varësisht nga numri i fëmijëve që bashkëshortët kanë nga martesa e tyre zvogëlohet.




Grafiku 15. Shkurorëzimet sipas numrit të fëmijëve në Maqedoni (2009-2013)
(burimi ESHSM, 2013)




Grafiku 16. Totali i shkurorëzimeve sipas numrit të fëmijëve në Maqedoni (2009-2013)
(burimi ESHSM, 2013)

Nga grafikët e mësipërme vërejmë se numri më i madh i shkurorëzimeve ndodh në martesat pa fëmijë, kjo sepse bashkëshortët nuk i lidh asgjë pas shkurorëzimit, përgjegjësit e tyre janë më të vogla. Gjithashtu numër më të madh të shkurorëzimeve kemi te martesat me një fëmijë. Ky numër varësisht nga numri i fëmijëve që bashkëshortët kanë nga martesa e tyre zvogëlohet. Por duke analizuar statistikat ndër vite shohim se numri i shkurorëzimeve edhe me fëmijë po rritet.



Grafiku 17. Krahasim i shkurorëzimeve sipas numrit të fëmijëve: Kosovë-Maqedoni (2009-2013) (burimi ESHSM dhe ESK, 2013)

Në grafikun më sipër kemi bërë krahasim sa u përket shkurorëzimeve në bazë të numrit të fëmijëve në Kosovë dhe Maqedoni, e nga ku rezulton se ky numër zvogëlohet dukshëm varësisht se sa fëmijë kanë nga martesa.



Grafiku 18. Numri i shkurorëzimeve në Shqipëri (2009-2013): gjithsej dhe për 100 martesë (burimi INSTAT, 2013)

Nga statistikat për Shqipëri vërejmë se edhe në Shqipëri ndër vite numri i shkurorëzimeve është rritur mjaft, qoftë duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të shkurorëzimeve, qoftë numrin e shkurorëzimeve për 100 martesë.



Grafiku 19. Numri i shkurorëzimeve në Shqipëri (2009-2013)³⁰

³⁰ Shih artikullin me temë: *Shtimi i divorceve në Shqipëri, si po e ndikon negativisht rritjen ekonomike*, në <http://www.monitor.al/divorci-si-e-ndikon-negativisht-rritjen-ekonomike-2/>, parë në datë 16.11.2015.

Studimet sociologjike tregojnë gjithashtu, se ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e numrit të zgjidhjeve të martesës në Shqipëri pas viteve '90 janë migrimi, problemet ekonomike dhe niveli i ulët arsimor i njërit bashkëshort, sidomos i burrit³¹. Gjithashtu, studimet ndërkombëtare tregojnë se ka një lidhje mes zgjidhjes së martesës dhe dhunës në familje të cilat ndikojnë në mënyrë reciproke te njëra tjetra: ashtu si dhuna në familje është një ndër faktorët që mund të çojë në zgjidhjen e martesë, po ashtu, ndarja martesore dhe zgjidhja e martesës përbëjnë një ndër faktorët që, të vetëm apo të kombinuar me të tjerë, shoqërohen me një rritje të rrezikut dhunës në marrëdhëniet familjare (OSBE, 2013: 6). Sipas neni 3/b të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave me “dhunë në familje” nënkuptohen *të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve apo ish-partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.*

Nga të dhënat statistikore të analizuara në këtë punim, rezulton se, përveç se është rritur numri i shkurorëzimeve në përgjithësi, vërehet një rritje e numrit të shkurorëzimeve me marrëveshje midis bashkëshortëve të moshës së re, në mënyrë specifike, të rinjve të moshës 20 deri 30 vjeç. Me këtë rast, parashikimi i shkurorëzimit me marrëveshje si mënyrë dhe shkak për zgjidhje të martesës nga ana e ligjvënësit, përveç efekteve pozitive që ka sjellë në sistemin gjyqësor, por edhe në dobi të palëve kontestimore me rastin e procedurës së shkurorëzimit, mund të themi se prodhon edhe efekte negative. Kështu me

³¹ Shih artikullin e Bërxfholi A., *Divorci, shkaqet dhe pasojat* (2015), në <http://www.panorama.com.al/divorci-shkaqet-dhe-pasojat/>, parë në datë 22.11.2015.

rastin e shkurorëzimit me marrëveshje është lehtësuar mjaft puna e gjykatësit, pasi që në këtë rast nuk nxirren prova për të vërtetuar shkaqet thelbësore që kanë sjellë deri te tronditja e marrëdhënieve martesore nga njëra anë, ruajtja e privatësisë së bashkëshortëve dhe mos nxjerrja e problemeve të tyre publikisht që shpeshherë mund të sjellin degradimin e tyre si persona nga ana e shoqërisë. Mirëpo mund të themi se si efekt negativ për shoqërinë në përgjithësi që sjell shkurorëzimi me marrëveshje, është se bashkëshortëve u mundësohet që të ndahen edhe për shkaqe më banale duke vërtetuar vetëm vullnetin serioz dhe të lirë të tyre për një gjë të tillë.

KAPITULLI III

MËNYRAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS

III.1. Konsiderata paraprake mbi mënyrat dhe shkaqet e zgjidhjes së martesës

Martesa dhe shkurorëzimi janë çështjet kyçe të cilat janë me rëndësi të veçantë në shoqëri, pasi me to drejtëpërsëdrejti çënohen edhe interesat e personave të cilët janë të përfshirë në këto marrëdhënie. Me martesën, si institut i së drejtës familjare që rregullon me ligj jetësën e përbashkët në çift të burit dhe gruas, përveç interesave të bashkëshortëve dhe familjes realizohen edhe interesat e bashkësisë shoqërore³². Nga kjo rrjedh edhe arsyeshmëria e interesimit të shoqërisë që me norma imperative të rregullojnë marrëdhëniet që vendosen në këto grupe shoqërore.

E drejta e barabartë juridiko-civile midis burrit dhe gruas për prishjen e martesës triumfoi mbi të drejtën zakonore apo burokratike të shtetit të njëanshme (vetëm për burrin), si dhe mbi ndikimin e të drejtës fetare, kristiane apo islame (Beqja, 2000: 53). Divorci, edhe pse një e drejtë e individit, përfaqëson një problem sociale: *social për nga përmasat, social për nga origjina dhe shkaqet, social për nga pasojat që shkakton (...)* (Beqja, 2000: 60). Ai përbën një dukuri sociale, që ndikohet jo vetëm nga vullneti i individëve por edhe nga shkaqe të tjera: faktorët social që ndikojnë në divorc kanë specifika dhe ndryshojnë sipas kulturave, popujve, periudhave. Në lidhje me arsyet e zgjidhjes së martesë, sociologët bëjnë dallimin mes martesës që shfaqet si lidhje horizontale ose vertikale (Tushi, 2012: 73). Në të parën, sundojnë parimet e njohura të dashurisë dhe respektit

³² Qëllimi i çdo shoqërie është krijimi i familjes e cila bazohet në vlera siç është dashuria, respekti i ndërsjellë dhe ndihma e përbashkët të cilat si të atilla do të paraqesin një rreth të shëndoshë në të cilën do të krijohet familja.

reciprok të partnerëve, ndërrokohë që në të dytën janë më shumë të pranishme marrëdhëniet e forcës, ndikimet deformuese të martesës, për shkak të dhunës dhe të kultivimit të kulturës së pushtetit sundues vertical të burrit. Divorci si shenjë e emancipimit të gruas, është tregues i rritjes së vetëdijes sociale dhe i formimit të personalitetit të saj (Tushi, 2012: 75).

Shkaqet që çojnë deri tek shkurorëzimi janë të ndryshme për nga karakteri dhe natyra. Kështu për shembull, nga analiza e statistikave të vitit 2007 në Maqedoni, doktrina (Mughal, 2015: 102-103) rendiste ndër shkaqet që justifikonin numrin e lartë të martesave dhe njëkohësisht numrin e ulët të divorceve, ato norma fetare dhe kulturore që dënojnë moralisht kryerjen e marrëdhëniet seksuale jashtë lidhjes martesore. Në Shqipëri, studimet sociologjike të viteve të fundit (Molla, 2015: 449) rendisin ndër shkaqet sociale dhe ekonomike dhunën në familje, papunësinë dhe migracionin e cila nga ana tjetër çon në ftohjen e marrëdhënieve në çift dhe/ose në shkeljen e besnikërisë bashkëshortore.

Në lidhje me mënyrat e zgjidhjes së martesës dallohet ajo me pëlqim reciprok dhe ajo me kërkesë të njërit bashkëshort. Kjo e fundit përfshin, për disa vende, edhe rastin e zgjidhjes së martesës për ndërprerje të jetës së përbashkët. Rast i veçantë i zgjidhjes automatike të martesës ,paraqet zgjidhja automatike e martesës për shkak të ndryshimit të seksit të njërit prej bashkëshortëve nëpërmjet ndërhyrjes kirurgjikale dhe njohjes së këtij ndryshimi me vendim gjyqësor. Është ky rasti i paraqitur përpara Gjykatës së Strasburgut, ku ankuesi pretendoi, në veçanti, se sipas neneve 8 dhe 14 të Konventës³³. Në këtë rast pretendohet se e drejta për jetë private dhe familjare ishin shkelur kur njohja e plotë e

³³ GjEDNj, *H. c. Finlanda*, vendimi i datës 13 nëntor 2012, sipas së cilës, legjislacioni finlandez që parashikon zgjidhjen automatike të martesës për efekt të ndryshimit të gjinisë nuk bie në kundërshtim me nenet 8 dhe 12 të KEDNj-së.

gjinisë së tij kishte sjellë për pasojë transformimin e martesës së tij në një partneritet civil³⁴. Gjykata e Strasburgut pohon se në këtë rast ka ndërhyrje në të drejtat e njeriut, por e konsideron atë si të nevojshme dhe të proporcionuar, sepse legjislacioni finlandez i njeh mundësinë partnereve të zgjedhin transformimin *ex lege* të martesës në *partnership* civile të regjistruar. Gjithashtu, prej vitesh GjEDNj., është shprehur se është në kundërshtim me nenin 12 K.E.D.Nj. legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar, i cili duke mos lejuar ndërrimin e të dhënave mbi seksin ndalonte martesën mes personit që kishte ndryshuar seksin nëpërmjet një ndërhyrje kirurgjikale me person biologjikisht të të njëjtit seks (çështja *Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁵).

a) Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve

Sipas doktrinës, kjo mënyrë e shkurorëzimit është më dinjitozja për bashkëshortët se jeta e tyre, konfliktet dhe problemet nuk shfaqen në gjykatë (Podvorica, 2006: 118). Kjo mënyrë zgjidhjeje krijon komoditet për respektimin e gjithçkaje për të cilën është rënë dakord duke e kthyer procesin e shkurorëzimit në një proces të ekuilibruar emocionalisht. Kjo, pasi shpesh herë zgjidhja e martesës shoqërohet me një sërë efektesh dhe pasojash

³⁴ Ankuesi ka lindur mashkull në 1963 dhe jeton në Helsink. Në vitin 1996 ai u martua me një grua dhe në vitin 2002 ata patën një fëmijë. Kërkuesi ka filluar të mos ndjehet mirë në këtë martesë në vitin 2004, dhe në vitin 2005 vendosi të kërkojë ndihmë mjekësore. Në prill 2006 ai u diagnostikua si transgjinnor. Që nga ajo kohë, ai ka jetuar si një grua. Më 29 shtator 2009 ai iu nënshtrua operacionit për ri-caktimin e gjinisë. Më 7 qershor 2006 aplikanti ndryshoi emrin e tij të parë dhe rinovoi dokumentet e identifikimit, por me numër të njëjtë identifikimi i cili tregon se tashmë *ajo* është mashkull. Në vitin 2007 aplikuesi kërkoi nga Zyra lokale që ta regjistronte atë si femër, ndërsa që ato refuzuan një gjë të tillë. Kështu aplikanti parashtroi ankesë te Gjykata Administrative e Helsinkit, por ajo e hodhi poshtë ankesën e aplikantit për të njëjtat arsye si Zyrës lokale e regjistrimeve. Ajo konstatoi se vendimi i kundërshtuar i 19 qershorit 2007 nuk ishte në kundërshtim me nenin 6 të Kushtetutës që partnerët e të njëjtës gjini kishin mundësi, duke e regjistruar marrëdhënien e tyre, për të përfutur nga mbrojtja e ligjit të familjes në një mënyrë pjesërisht të krahasueshme me një martesë.

³⁵ GjEDNj, çështja *Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 17 tetor 1986, aplikimi nr. 9532/81.

personale dhe pasurore. Në të gjithë këto hapa të këtij procesi, gjykata është autoriteti që kontrollon dhe monitoron vullnetin e pastër, serioz dhe real si dhe pëlqimin e lirë të secilit bashkëshort. Kështu për shembull, sipas nenit 39 të LFRM, gjykata vendos zgjidhjen e martesës nëse vërtetohet se pëlqimin e kanë dhënë me vullnetin e tyre të lirë, serioz dhe të pakushtëzuar. Termat "real", "lirisht" dhe "serioz", të përzgjedhur nga legjislatori shqiptar, duhet të jenë të shprehura qartë dhe të dukshme nga të dy bashkëshortët, si cilësi e kësaj mënyre të zgjidhjes së martesës (Mandro, 2009: 308).

Kërkesa dhe projekt-marrëveshja për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok duhet të paraqiten së bashku³⁶. Bashkëshortët nuk dalin në pozicionin e paditësit dhe të paditurit, por të kërkuarit (Mandro, 2009: 307). Kjo padyshim nuk ka të bëjë me cënimin e parimit të kontradiktoritetit. Këtë e përforcon edhe mënyra se si rregullohet paraqitja e kësaj kërkeje. Dispozita e nenit 125/2 të KFRSH nënvizon se *kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre*.

Praktika gjyqësore, shpesh herë ka rezultuar se ka riprodhuar brenda të njejtë vendim përmbajtjen e marrëveshjes që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës, e cila është miratuar si e tillë nga gjykata. Megjithatë, ka dhe raste kur gjykata miraton në parim marrëveshjen dhe përfshin në vendim çështjet më të rëndësishme, duke bashkangjitur përmbajtjen e saj si pjesë të vendimit gjyqësor³⁷.

Ndryshe nga të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së martesës rëndësi nuk ka shkaku, pra *shkaku nuk është kusht për zgjidhjen e martesës*. Gjatë vlerësimit të projekt-marrëveshjes

³⁶ Apo siç quhet ndryshe në LFRK, Nr.2004/32, propozim marrëveshja.

³⁷ Është rasti i parashikimeve të legjislacionit të Kosovës dhe atij të Maqedonisë, në të cilët projekt-marrëveshja është e domosdoshme vetëm kur në zgjidhjen e martesës janë përfshirë të miturit.

së bashkëshortëve, në disa vende, gjykata është e detyruar të marrë mendimin edhe nga institucionet e tjera, që në mënyrë direkte apo indirekte ndërlidhen me problematikën në fjalë, në mënyrë specifike, për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve³⁸. Vetëm pas këtij hapi të ndërmarrë, gjykata mund të sjellë vendimin e vet. Gjukata kështu fiton kompetenca më të mëdha, të cilat pa dyshim burojnë nga ligji, për sa i përket shqyrtimit të kërkesës së paraqitur të shprehur në marrëveshjen e bashkëshortëve, nga shkakut se mbahet llogari për interesin e fëmijëve që ka rëndësi të madhe psikologjike dhe sociale (Mnookin, 1992: 75)³⁹.

Edhe sipas parimeve të *CEFL* (Parimi 1.4.), zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok nuk presupozon që kriza (thyerja) të jetë e pakthyeshme, por mjafton dakortësia mes bashkëshortëve. Në këtë rast nuk parashikohet si e detyrueshme një seancë pajtimore, por parashikohet një periudhë reflektimi në raste specifike nëse ata nuk bien dakort për të gjithë elementët e projekt marrëveshjes. (Parimi 1.5). Periudha e reflektimit kur martesa zgjidhet me pëlqim reciprok nuk është e nevojshme në dy raste: a) nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur nën moshën 16 vjeç dhe ata kanë rënë dakort mbi të gjitha pasojat nuk është e nevojshme një periudhë reflektimi; b) nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur nën moshën 16 vjeç dhe ata kanë jetuar të ndarë faktikisht për një periudhë gjashtë mujore. Ndryshe nga Parimet e *CEFL*, të tre vendet parashikojnë si të detyrueshme

³⁸ Siç është, për shembull, në Maqedoni Qendra për Punë Sociale, apo në Kosovë, Organi i Kujdestarisë.

³⁹ Gjatë përcaktimit për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, gjykata vendos edhe lidhur me kufijtë e ushtrimit të përbashkët të saj. Pra, ajo përcakton mënyrën e ushtrimit *in concreto* të drejtave e detyrimeve nga ana e prindit që nuk i është besuar fëmija.

zhvillimin e seancës pajtimore. Kosova dhe Maqedonia, në dallim nga Shqipëria parashikojnë ndërhyrjen e organeve specifike kur janë të përfshirë të mitur⁴⁰.

Për sa i përket projekt-marrëveshjes, ajo sipas parimeve të CEFL nuk përbën *conditio sine qua non* për zgjidhjen e martesës, pasi edhe nëse nuk janë bërë përcaktimet përkatëse, ato, me kërkesë të palëve mund të përcaktohen nga autoriteti kompetent. Ndërkohë që, në Kosovë dhe Maqedoni projekt-marrëveshja është e domosdoshme vetëm kur ka të mitur dhe duhet të përmbajë detyrimisht rregullimet që lidhen me ta. Në Shqipëri, formulimi i dispozitave ligjore lë vend për debat dhe doktrina nuk është e uniformuar në këtë drejtim. Sipas një rryme doktrinare, projekt-marrëveshja është e domosdoshme vetëm kur ka të mitur (Omari, 2010: 230), ndërkohë që sipas një tjetër rryme doktrinare (Mandro, 2009:388) ajo përbën *conditio sine qua non* për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok në të gjitha rastet, pra edhe kur nuk ka të mitur.

Vihen re disa dallime thelbësore përsa i përket përmbajtjes minimale që duhet të ketë projekt-marrëveshja sipas parimeve të CEFL dhe legjislacioneve të vendeve të marra në analizë. Kështu sipas parimeve të CEFL (Parimi 1.6), ajo përfshin ndarjen ose rishpërndajen e pasurisë (*reallocation*) dhe kontributin ndaj ish bashkëshortit si dhe, *nëse është e nevojshme*, mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke përcaktuar vendin dhe mënyrën e takimit me fëmijët dhe kontributin ndaj fëmijëve. Ndërkohë që për legjislacionin shqiptar, fraza *nëse është rasti*, i referohet marrëdhënieve pasurore mes bashkëshortëve dhe jo marrëdhënieve me fëmijët. Sipas këtij formulimi (neni 127/2), projekt-marrëveshja do të konsiderohej e domosdoshme vetëm atëherë kur ka të mitur,

⁴⁰ Respektivisht Organi i Kujdestarisë në Kosovë dhe Qendra për punë sociale në Maqedoni.

ashtu siç parashikon edhe legjislacioni i Republikës së Kosovës dhe ai i Republikës së Maqedonisë.

b) Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve

Në këtë rast kërkesa për zgjidhje paraqitet me padi vetëm nga njëri prej bashkëshortëve. Sipas Parimeve të CEFL, kjo mënyrë e zgjidhjes së martesës mund të verifikohet në dy raste:

a) ku ka patur *ndarje faktike prej të paktën një viti (Parimi 1.8)*, pavarësisht nga rrethanat e tjera; b) për *pamundësi të jashtëzakonshme* për palën kërkuese për të vazhduar marrëdhënien martesore (*Parimi 1.9*). Afati një vjeçar gjen zbatim si në Kosovë ashtu dhe në Maqedoni, ndërkohë që në Shqipëri ky afat është tre vjet. Në Shqipëri dhe Maqedoni ndarja faktike renditet si një mënyrë më vete e zgjidhjes së martesës, përkrah dy të tjerave (me pëlqim reciprok dhe me kërkesë të njërit bashkëshort), ndërkohë që në Kosovë, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, përbën një nga shkaqet për shkurorëzim (neni 69 LFRK).

Ndërkohe, sipas Parimit 1.9 të CEFL mbi *pamundësinë e jashtëzakonshme* i lihet hapësirë gjykatës të vlerësojë rast pas rasti rrethanat konkrete që e bëjnë të pamundur jetesën e përbashkët për bashkëshortin kërkuar. Në të njëjtën mënyrë, edhe legjislacioni i Republikës së Maqedonisë shprehet në terma të *përkeqësimit të marrëdhënieve bashkëshortore deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme* (neni 40 i LFRM), por në dallim nga legjislacioni shqiptar nuk rendit shkaqe specifike. Legjislacioni shqiptar parashikon bashkëekzistencën e pamundësisë së jetës së përbashkët

për njërin ose të dy bashkëshortët me shkaqe specifike të renditura në nenin 132 të KFRSH. LFRK, paraqitet i ngjashëm me LFRM, pasi nuk rendit shkaqe specifike por i referohet *çrregullimit serioz ose të vazhdueshëm të marrëdhënieve martesore, ose shkaqeve të tjera, si pasojë e të cilave martesa është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme neni* (neni 69/1 LFRK). Jurisprudenca kosovare ka theksuar se:

Martesa duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj dëshira e njërit bashkëshort (Buletini i Praktikës Gjyqësore, 2013: 918)⁴¹.

Logjika juridike kërkon që në aktgjykimin për shkurorëzimin e bashkëshortësisë, gjykata është e detyruar të vërtetojë nëse janë të prishura marrëdhëniet deri në atë shkallë që e bën të padurueshme jetën bashkëshortore. Kjo nënkupton se patjetër duhet të vërtetohen shkaqet për të cilat arrihet deri tek zgjidhja e martesës (Totaj & Hamzaj, 2009: 111)⁴². Me këtë rast, nëse çifti bashkëshortor ka fëmijë, gjykata duhet të vendosë mes të tjerash, për interesat e tyre. Ajo ka për detyrë që me aktin e sjellë me të cilin e zgjidh martesën, të vendosë për kujdesin, edukimin dhe mbështetjen materiale të fëmijëve të përbashkët, duke përfshirë këtu jo vetëm fëmijët të lindur në bashkëshortësi, porse edhe ata fëmijë të lindur jashtë bashkëshortësisë si dhe për fëmijët që vetëm njëri prej bashkëshortëve është prind, kurse bashkëshorti tjetër është adoptues. Me rastin e zgjidhjes së martesës, të thirur në këtë bazë, faji për prishjen e marrëdhënieve midis bashkëshortëve

⁴¹ Shih vendimin 29 tetor 2012 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (Aktgjykimi, Ac. nr. 65/2012), i cili refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren C. nr. 125/2012 të 27 korrikut 2012.

⁴² Doktrina përkufizon shkaqet jo të fshehta të shkurorëzimit, si ato të cilat janë paraqitur në mënyrë të natyrshme dhe si të tilla nuk mund t'i vihen në barrë asnjërisht palë bashkëshortore (si mospërputhja e karaktereve, qasja e ndryshme, etj).

është pa rëndësi, sepse bashkëshortësia do të shkurorëzohet pavarësisht nga fakti se cili prej bashkëshortëve është fajtor për marrëdhëniet e prishura.

c. Ndërprerja e jetës së përbashkët (ose ku bashkësia bashkëshortore ka pushuar) për një periudhë të caktuar kohore.

Ky rast është parashikuar më vete në të tre legjislacionet e vendeve të marra në analizë. Ndërkohë që sipas parimeve të CEFL (Parimi 1.8), ndarja faktike prej një viti, pavarësisht nga rrethanat e tjera, përfshihet në rastet e zgjidhjes së martesës pa pëlqimin e njërit bashkëshort. Ndarja në aspektin hapësinor e bashkëshortëve me qëllim të nevojës për shkollim të mëtijshëm, specializim në profesionin e ndonjërit prej tyre, nuk mund të merret si shkak për zgjidhje të martesës, pasi në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me ndarje faktike të bashkëshortëve për një periudhë të caktuar, dhe jo edhe prishje të marrëdhënieve midis tyre (Bakievska, 2007: 44).

Nga analiza krahasimore vihet re një afat i ndryshëm mes tre vendeve: një vit për Maqedoninë dhe Kosovën kundrejt tre viteve për Shqipërinë. Për këtë arsye shtrohet pyetja nëse afati tre vjeçar i parashikuar në legjislacionin shqiptar është i përshtatshëm për garantimin e të drejtës për zgjidhje të martesës brenda afateve të arsyeshme? Kjo pyetje parashtrohet edhe në raport me parashikimet e CEFL në kuadrin e tentativës për harmonizim të së drejtës familjare në Europë.

Nëse bashkëshortësia shkurorëzohet mbi këtë bazë, faji i cildo qoftë bashkëshorti për përfundimin faktik të bashkësisë bashkëshortore, nuk është me rëndësi për shkurorëzimin e bashkëshortësisë. Gjykata vërteton vetëm gjendjen nëse bashkësia bashkëshortore ka

përfunduar faktikisht, pra nëse bashkëshortët nuk jetojnë bashkërisht më gjatë se një vit kalendarik (neni 41 LFRM).

Nëse mënyrat për zgjidhjen e martesës janë tre në të tre vendet e marra në analizë, shkaqet për shkurorezim të martesës janë të shumta dhe, në varësi të llojeve të tyre, ligji parashikon edhe procedurën që duhet të ndiqet në secilin rast si dhe pasojat që rrjedhin prej tyre. Shpeshherë, ndodh që gjykata të vendoset përballë analizës së fakteve, të sjelljeve dhe të mospërbushjes të drejtave dhe obligimeve të cilat në tërësi vlerësohen si shkelje e detyrimeve martesore. Statistikat e përgjithshme botërore, si dhe ajo në vendet objekt analize, tregojnë se përkeqësimi i raporteve ndërmjet bashkëshortëve është në rritje, për shkaqe të ndryshme⁴³. Kështu për shembull, studimet ndërkombëtare tregojnë se ka një lidhje mes zgjidhjes së martesës dhe dhunës në familje të cilat ndikojnë në mënyrë reciproke te njëra tjetra: ashtu si dhuna në familje është një ndër faktorët që mund të çojë në zgjidhjen e martesë, po ashtu, ndarja martesore dhe divorci përbëjnë një ndër faktorët që, të vetëm apo të kombinuar me të tjerë, shoqërohen me një rritje të rrezikut dhunës në marrëdhëniet familjare (OSBE, 2013: 6). Po kështu, ndër shkaqet që sjellin deri te zgjidhja e martesës janë edhe ato me natyrë ekonomike, për shkak të migracionit, ashtu si dhe diversiteti kulturor i bashkëshortëve, pra mënyra e tyre e jetesës para se të lidhin kurorë. Në disa martesë është vështirë të gjendet një mënyrë e përbashkët për të tejkaluar këto diversitete kulturore çka edhe sjellin tronditjen e marrëdhënieve mes bashkëshortëve (Stone, 1990: 5).

⁴³ Shih, Shqyrtime të të dhënave statistikore rreth zgjidhjes së martesës (shkurorezimit) në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës si dhe në Republikën e Maqedonisë.

Nga analiza krahasimore mes tre vendeve objekt analize dhe parimeve të CEFL dallohen dy kategori shkaqesh të zgjidhjes së martesës:

a) *shkaqe të përgjithshme*, të cilat në thelb i referohen pamundësisë për të vazhduar marrëdhënien martesore: parimet e CEFL (Parimi 1.9) i referohen *pamundësisë së jashtëzakonshme për palën kërkuese për të vazhduar marrëdhënien martesore*; neni 132 i KFRSH i referohet rastit kur:

jeta e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa humbet qëllimin e saj për njërin ose të dy bashkëshortët; sipas legjislacionit kosovar, kur ka çrregullim serioz ose të vazhdueshëm të marrëdhënieve martesore, ose kur (...) martesa është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme; sipas legjislacionit maqedonas, kur jeta e përbashkët është bërë e padurueshme.

b) *shkaqet e veçanta*, të cilat janë caktuar taksativisht me norma ligjore: Kështu për shembull, sipas nenit 132 të KFRSH, nga shkaqet e veçanta që mund të sjellin deri tek zgjidhja e martesës, mes tjerash numërohen: *grindjet e vazhdueshme, fyerjet e rënda, shkelja e besnikërisë bashkëshortore; sëmundja mendore e pashërueshme* etj.

III.2. Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve në Shqipëri

Për shkak të rolit të rëndësishëm që i njihet në këtë rast "*vullnetit të bashkëshortëve*", kjo mënyrë e zgjidhjes së martesës ka qenë objekt i polemikave të vazhdueshme, ndaj edhe rregullimi ligjor ka variuar në funksion të konceptit mbi martesën (Omari, 2010: 194). Kjo formë e zgjidhjes së martesës nuk pranohej nga legjislacioni shqipëtar i mëparshëm, zgjidhje kjo e përkrahur edhe nga literatura juridike, e cila nën ndikimin e ideologjisë së kohës e konsideronte një mjet juridik që kthen martesën në një institut me karakter privat (Begeja, 1984: 264).

Zgjidhja e martesës me marrëveshje të bashkëshortëve u parashikua për herë të parë në legjislacionin shqipëtar pas ndryshimeve politike të viteve '90⁴⁴. Si pasojë e ndryshimeve të realizuara në K.Pr.C., nenet 358 deri 368 të tij, parashikonin (në kuadrin e gjykimeve të posaçme që lidhen me martesën) edhe një mënyrë të re për zgjidhjen e martesës, e cila realizohej nëpërmjet padisë së përbashkët të të dy bashkëshortëve. KFRSH e rregullon zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve në nenet 125 deri 128, duke i grupuar kështu në të njëjtin akt normativ jo vetëm të gjithë rastet e zgjidhjes së martesës, por edhe disa dispozita që rregullojnë procedurën nëpër të cilën ajo kalon⁴⁵.

Edhe pse nga emërtimi i këtij rasti evokohet ideja e zgjidhjes së martesës si rezultat i vullnetit të përbashkët të bashkëshortëve, duke theksuar se edhe në këtë rast zgjidhja e martesës vendoset nga gjykata. Si edhe në rastin e lidhjes së martesës, vullneti i bashkëshortëve nuk konsiderohet i mjaftueshëm, pasi që të realizohet kjo është e nevojshme që një autoritet publik të verifikojë plotësimin e disa kushteve të nevojshme për zgjidhjen e martesës. Ndryshe nga rastet e tjera të zgjidhjes së martesës marrëveshja e bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës, e cila përbën premisën për nisjen e kësaj procedure dhe njëkohësisht njërin prej kushteve themelore, sjell si pasojë një angazhim më pak aktiv të gjykatës dhe për pasojë një mundësi më të kufizuar në drejtim të refuzimit të kërkesës për zgjidhje të martesës.

Shkurorëzimi me marrëveshje para së gjithash bazohet në lirinë dhe pavarësinë e vullnetit të bashkëshortëve, të cilët mund të vendosin lirisht t'i japin fund marrëdhënies

⁴⁴ Kodi i Procedurës Civile është miratuar me ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996, ndërkohë që ndryshimet që parashikojnë zgjidhjen e martesës me marrëveshje të bashkëshortëve janë miratuar me ligjin Nr. 8181, më datë 23.12.1996 "për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile".

⁴⁵ Me hyrjen në fuqi të KFRSH, neni 318 i këtij Kodi, si dhe nenet 358 deri 368 të K.Pr.C. janë shfuqizuar.

martesore (Omari, 2010: 195). Nga ana tjetër, gjithashtu ky parashikim ligjor vjen në zbatim të parimit të mbrojtjes së lirisë së jetës private, parashikuar nga neni 35 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet mundësisë që i njihet bashkëshortëve për zgjidhje të martesës me pëlqim reciprok, ata nuk janë të detyruar të provojnë para gjykatës shkakun e zgjidhjes së martesës, si pasojë e të cilit ekspozohen elementë të jetës private dhe personale të tyre.

Parë në këtë këndvështrim, kjo mënyrë e zgjidhjes së martesës paraqet edhe mënyrën më të natyrshme dhe të qytetëruar për t'i dhënë fund martesës. Sipas doktrinës, *zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok, si pasojë e mungesës së konflikteve, kufizimeve të ndërsjellta, ekspozimit të marrëdhënieve intime para opinionit publik, u mundëson bashkëshortëve një shkurorëzim të dinjitetshëm* (Nerimana & Suzana, 2007: 84). Gjithashtu me zbatimin e parimeve të së drejtës civile, si çdo veprim që bazohet në shfaqjen e vullnetit edhe martesa duhet të përfundojë nëse të dy bashkëshortët deklarojnë vullnetin për përfundimin e saj. Kjo zgjidhje e martesës paraqet dhe shembull ilustrues të veprimit *intuitu personae*, pra që lidhet ngushtësisht me vlerësimin personal të bashkëshortëve. Megjithatë, për shkak të marrëdhënieve të përkeqësuar personale ndërmjet bashkëshortëve, të cilat shpeshherë janë shkak i pushimit *de facto* të marrëdhënieve martesore, ky rast i zgjidhjes së martesës edhe pse më efikas, gjen zbatime të ralla në praktikë.

Kështu, sipas nenit 125 të KFRSH, *kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën edhe një projekt-marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës*. Nga analiza e kësaj dispozite

rezulton se për të zgjidhur martesën me marrëveshje të të dy bashkëshortëve, dy janë kushtet ligjore që duhet të plotësohen dhe konkretisht (Mandro, 2009: 306)⁴⁶:

- a) rënia dakord e bashkëshortëve mbi faktin e zgjidhjes së martesës, dhe
- b) një marrëveshje e dytë, posaçërisht projekt-marrëveshja, e cila ka për objekt rregullimin e disa prej pasojave që rrjedhin nga martesa.

a) Në zbatim të nenit 125, kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës i paraqesin gjykatës kërkesën për zgjidhjen e martesës. Kjo kërkesë paraqitet në formë të shkruar dhe njëherit përfaqëson vullnetin e lirë të të dy bashkëshortëve dhe jo vetëm të njërit prej tyre për t'i dhënë fund marrëdhënies martesore (Bonilini, 2002: 211). Marrëveshja për zgjidhje të martesës mund të lidhet vetëm nga bashkëshorti që ka zotësi të plotë për të vepruar. Gjithashtu duke qenë një veprim ngushtësisht personal, përjashtohet mundësia që marrëveshja të lidhet nga kujdestari i bashkëshortit (Mandro, 2009: 104).

Në kërkesën e përbashkët drejtuar gjykatës, bashkëshortët nuk janë të detyruar të paraqesin formula të përcaktuara, por është e nevojshme, e njëherit e mjaftueshme që nga kjo kërkesë të kuptohet qartë që bashkëshortët kanë arritur në një mirëkuptim për zgjidhjen e martesës. Në të kundërt, në rast të mungesës së vullnetit të ndërsjelltë, bashkëshorti që synon zgjidhjen e martesës duhet t'i drejtohet gjykatës me një kërkesë padi (Omari, 2010: 195).

⁴⁶ Marrëveshja nëpërmjet së cilës bashkëshortët vendosin t'i japin fund jetës së përbashkët, përfaqëson një kategori të veprimit juridik, me të cilën do të shuhet në të ardhmen marrëdhënien martesore midis bashkëshortëve. Për vlefshmërinë e saj duhet të plotësohen kushtet thelbësore të parashikuara nga K.Pr.C., miratuar me ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996, në drejtim të çdo veprimi juridik. Nga tërësia e këtyre kushteve, rëndësi i kushtohet zotësisë për të vepruar dhe vullnetit të lirë të secilit bashkëshort.

Si rregull, një ndër elementet kryesorë që vërteton pëlqimin reciprok për zgjidhjen e martesës është nënshkrimi i secilit bashkëshort në kërkesën drejtuar gjykatës, që në këto rrethana përfaqëson një kusht formal për vazhdimësinë e procedurës për shkurorëzim. Megjithatë, në ligj nuk ekziston kushti i nënshkrimit, ndaj nuk përjashtohet mundësia që kërkesa të hartohet dhe të nënshkruhet vetëm nga njëri bashkëshort, apo përfaqësuesi i tij dhe më pas bashkëshortët të paraqesin pëlqimin reciprok në ditën që do të paraqiten personalisht para gjykatës. Ndërkaq, neni 126 i KFRSH parasheh se ndryshe nga të dy rastet e tjera të zgjidhjes së martesës, është e nevojshme të paraqiten personalisht të dy bashkëshortët. Në ditën e caktuar për gjykim, gjykata do të verifikojë jo vetëm nëse kërkesa është bërë me pëlqim të të dy bashkëshortëve, por edhe nëse ata janë në vazhdimësi dakord me zgjidhjen e martesës në këtë mënyrë.

Gjykata pasi shqyrton kërkesën, dëgjon secilin nga bashkëshortët individualisht, e më pas ata bashkarisht. Pëlqimi që jepet para gjykatës duhet të jetë i qartë dhe të shprehë një vullnet të pakushtëzuar për zgjidhjen e martesës (Omari, 2010: 196). Në të kundërtën, në qoftë se gjykata vëren hezitim ose vullneti nuk shprehet qartë, do ta rrëzojë kërkesën për zgjidhje të martesës me pëlqim reciprok.

Duke qenë se, edhe në këtë mënyrë të zgjidhjes së martesës, martesë zgjidhet si pasojë e vendimit të gjykatës dhe jo vetëm pëlqimit të bashkëshortëve, secili prej tyre deri në përfundim të gjykimit, mund të tërheqë pëlqimin e dhënë. Nëse gjykata vërteton se kërkesa është bërë me pëlqimin e lirë të të dy bashkëshortëve dhe njëkohësisht konstaton vazhdimësinë e këtij qëllimi, do të kalojë në shqyrtimin e kushtit tjetër. Duhet theksuar se gjatë procedurës për shkurorëzim me kërkesë të përbashkët të të dy bashkëshortëve,

gjykata nuk duhet dhe nuk është e detyruar të kërkojë prova në drejtim të shkakut që ka sjellë deri te zgjidhja e martesës dhe as të vërtetojë fajin e bashkëshortëve në këtë drejtim (Mandro, 2009: 387).

b) Për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok, përveç marrëveshjes mbi zgjidhjen e martesës, bashkëshortët duhet të bien dakord edhe për pasojat e zgjidhjes së martesës. Bashkëshortët janë të detyruar t'i bashkangjisin kërkesës së përbashkët për shkurorëzim, edhe projekt-marrëveshjen, e cila sipas nenit 127 të KFRSH përmban: *lëinen për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur* - nuk janë përfshirë fëmijët ndaj të cilëve vazhdon ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, për shembull, ata me aftësi të kufizuara, ose ata që vazhdojnë studimet universitare (Lamçe, 2015:76) - *të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar*. Mosparaqitja e saj e bën të papranueshme kërkesën për zgjidhje të martesës dhe në këtë rast gjykata do të pezullojë gjykimin dhe do t'i udhëzojë palët në hartim të një marrëveshje të tillë. Nëse palët nuk e respektojnë këtë kërkesë brenda afatit të caktuar nga gjykata, kërkesa e përbashkët për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok do të rrezohet si e pa bazë⁴⁷. Për sa i përket marrëdhënieve pasurore mes bashkëshortëve, ato do të përfshihen në projekt-marrëveshje vetëm nëse është rasti dhe nëse është e mundur.

Nga interpretimi literal dhe logjik i nenit 127 paragrafi 2 që parashikon përmbajtjen e marrëveshjes, rezulton se vetëm disa nga këto pasoja janë të detyrueshme të rregullohen nga palët, ndërkohë që pjesa tjetër janë fakultative (Omari, 2010: 197). Sipas kësaj rryme

⁴⁷ Neni 125/1 i referohet "projekt marrëveshjes që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës" dhe në zbatim të kësaj dispozite neni 127/2 parashikon cilat janë ato pasoja që bashkëshortët duhet t'i rregullojnë me marrëveshje.

doktrinare, do të konsiderohen elementë të detyrueshme të projekt-marrëveshjes: lënia për rritje dhe edukim e fëmijëve të mitur; të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e fëmijës; detyrimi për ushqim ndaj ish bashkëshortit në nevojë; përcaktimi i së drejtës së përdorimit mbi banesën familjare; përcaktimi i kontributit kompensues ndaj ish bashkëshortit dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të fituar gjatë martesës. Detyrimi për ushqim nuk është përfshirë shprehimisht si element i domosdoshëm i projekt-marrëveshjes mes bashkëshortëve: paragrafi i dytë i nenit 127 të KFRSH i referohet “kontributit” që secili bashkëshort i detyrohet bashkëshortit nevojtar, term ky që sjell vështirësi në interpretim.

Sa i përket rolit të gjykatës në procedurën e zgjidhjes së martesës e inicuar me kërkesën e përbashkët të të dy bashkëshortëve për shkurorëzim, kjo është rregulluar me nenet 127 paragrafi 1 dhe 128 të KFRSH. Në këtë rast, roli i gjykatës nuk është mirëfilltazi juridiksional, sipas të cilit gjykata pasi çmon faktet e pretenduara dhe provat e paraqitura nga secila palë, vendos në favor të pretendimit të asaj pale që është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastin e zgjidhjes së martesës me pëqim reciprok, edhe pse objekti i gjykimit është zgjidhja e martesës, palët nuk kanë kundërshtime lidhur me këtë fakt, pasi të dy bashkëshortët synojnë zgjidhjen e martesës. Kryesisht roli i gjykatës përmbledhet në një veprimtari kontrolli të kushteve themelore që duhet të përmbushë pëlqimi i dhënë për zgjidhjen e martesës dhe ai që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës⁴⁸.

⁴⁸ Këto kushte janë: zotësia e subjekteve; ekzistenca e vullnetit të lirë; shkaku i ligjshëm dhe forma e kërkuar nga ligji, te marrëveshja e parë dhe e dytë.

Duhet theksuar se roli juridiksional i gjykatës nuk mungon tërësisht, pasi në rastin e marrëveshjes që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës, gjykata vlerëson duke çmuar interesat e secilit bashkëshort dhe ato të fëmijës (Mandro, 2009: 388). Në këtë kuptim ajo jep drejtësi, pra çmon cili është interesi që përputhet me dispozitat e ligjit në drejtim të njëres prej palëve në gjykim. Pikërisht si pasojë e kësaj veprimtarie juridiksionale, zgjidhja e martesës fiton autoritetin e gjësë së gjykuar, duke i dhënë marrëveshjes së bashkëshortëve të njëjtën forcë detyruese që i njihet vendimeve të gjykatës. Pas momentit kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë, bashkëshortët nuk mund të tërheqin në mënyrë të njëanshme apo me konsensus ndërmjet tyre nga pëlqimi i dhënë për zgjidhjen e martesës. *Përgjatimisht* në zbatim të nenit 160 të KFRSH *për shkaqe me rëndësi*, njëri prej tyre mund të kërkojë nga gjykata ndryshimin e marrëveshjes që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.

Së fundi, është me rëndësi për t'u theksuar se, përsa i përket lënies së fëmijëve për rritje dhe edukim, në këtë lloj procedure, ashtu si në çdo procedurë tjetër që lidhet me të miturin, është e domosdoshme që ai të dëgjohet, t'i merret mendimi apo pëlqimi, nën praninë e një psikologu. Për këtë arsye doktrina shqiptare rekomandon që:

projekt-marrëveshjes së prindërve t'i bashkangjitet edhe një raport psikologjik, e cila të jetë bazë për rregullimet që ata bëjnë përsa i përket ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (Save the children & Shkolla e Magjistraturës, 2009: 59).

III.3. Shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme të bashkëshortëve në Kosovë

Sipas LFRK, bashkëshortët mund të kërkojnë zgjidhjen e martesës edhe me marrëveshje, nëse janë marrë vesh njëri me tjetrin për zgjidhjen e saj (neni 68 LFRK). Propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës ata mund ta parashtrojnë pranë gjykatës

kompetente. Nga kjo rezulton se zgjidhja me marrëveshje e martesës ekziston kur dy bashkëshortët këtë e dëshirojnë dhe e kërkojnë. Fakti se propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje është paraqitur pranë gjykatës kompetente, tregon më së miri për ekzistencën e kërkesës së përbashkët për zgjidhjen me marrëveshje të martesës, që do të ketë pastaj rol vendimtar gjatë zbatimit të procedurës gjyqësore. Në këto raste kemi të bëjmë me marrëveshje të të dy bashkëshortëve për zgjidhje të martesës, prandaj edhe procedura gjyqësore është me e shkurtër dhe më pak e komplikuar se sa në shkurorëzimet me kërkesë padi nga ana e njërit bashkëshort, pasi që në të nuk analizohen shkaqet dhe nuk nxiren prova për të vërtetuar po të njëjtat, ngase të dy palët janë pajtuar në lidhje me zgjidhjen e martesës (Aliu & Gashi, 2007: 165). Gjithashtu edhe kur vetëm njëri bashkëshort ka paraqitur padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore nuk e kundërshton padinë, konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozim për shkurorëzim me marrëveshje (neni 68/4 LFRK).

Rol vendimtar në zgjidhjen e martesës me marrëveshje të të dy bashkëshortëve, sidomos me inicimin e procedurës përbën vullneti i lirë, serioz dhe real i bashkëshortëve në marrjen e një vendimi të tillë për shkurorëzim. Mirëpo, është e vërtetë që ky propozim ndonjëherë nuk pasqyron edhe dëshirën e vërtetë të të dy bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, për shkak të fakteve e rrethanave të reja, të cilat mund të krijohen rreth saj. Sipas nenit 70 të LFRK:

bashkëshortët nuk do të mund të parashtrojnë padi për shkurorëzim apo propozim për zgjidhje të martesës me marrëveshje, gjatë shtatzanisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t'i ketë mbushur një vit.

Këtë dispozitë LFRK e parasheh si për të mbrojtur nevojat dhe kërkesat qoftë materiale apo shpirtërore të gruas, duke mos dashur ta vejë atë në pozitë të palakmueshme, ashtu edhe për të mbrojtur fëmijën e përbashkët në të cilin edhe ndikojnë më shumë pasojat nga zgjidhja e martesës. Kjo mbrojtje shtrihet edhe mbi pasurinë e të miturit, sidomos kur marrëdhënia përfshin element të huaj⁴⁹.

Përveç propozimit për shkurorëzim, me marrëveshje të dyanshme sipas paragrafit 2 të po këtij neni, bashkëshortët janë të detyruar të parashtrojnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët dhe propozimin me shkrim për organizimin e kontakteve personale të dy bashkëshortëve me fëmijët në të ardhmen. Detyrë e gjykatës është të vlerësojë nëse duhet zbatuar procedurën provuese, në pjesën e marrëveshjes për kujdesje të fëmijëve. Nëse propozimi për shkurorëzim bashkëshortët nuk i kanë bashkangjitur edhe marrëveshjen për përkujdesje të fëmijëve, gjykata do t'i detyrojë që këtë ta bëjnë brenda një afati të kuptueshëm. Me aktvendim gjykata hedh poshtë propozimin për zgjidhje të martesës me marrëveshje, si çdo shkresë tjetër të parregullt, në qoftë se ka kaluar afati i caktuar, ndërsa bashkëshortët nuk kanë parashtruar marrëveshjen për kujdesje ndaj fëmijëve të përbashkët.

Gjykata mund ta ndryshojë marrëveshjen për përkujdesje ndaj fëmijëve, në qoftë se vërteton se ndryshimi i saj do të jetë në funksion të mbrojtjes së interesave të fëmijëve. Bashkëshortëve të pakënaqur me modifikim të marrëveshjes nuk iu mbetet gjë tjetër veçse,

⁴⁹ Kështu, sipas *nenit 60/1 i Konventës mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve* (Ligji nr. 9443, datë 16.11.2005), “Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën e juridiksionit të autoriteteve të veta për të marrë masa për mbrojtjen e pasurisë së fëmijës në territorin e vet, si dhe rezervon të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo të një mase për sa kohë nuk është në përputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e veta, në lidhje me këtë pasuri, siç është parashikuar në paragrafin e parë të nenit 55 të Konventës”.

duke ankimuar pjesën e vendimit për fëmijët, të tentojnë që t'i anulojnë modifikimet e bëra (Komar, *et al.*, 1999: 160) Gjithashtu, si mundesi e dytë është që të heqin dorë nga zgjidhja e martesës me marrëveshje, në qoftë se tregojnë vendosmërinë për anulimin e këtyre modifikimeve (Podvorica, 2006: 127).

Ndërkaq, mund të thuhet se me dispozitat e paragrafit të tretë të nenit 70 të LFRK janë paraparë kufizime për sa i përket zgjidhjes së martesës me marrëveshje të përbashkët të bashkëshortëve. Gjykata mund të refuzojë propozimin për shkurorëzim në bazë të marrëveshjes së përbashkët nëse konstaton se një gjë të tillë e kërkojnë interesat e fëmijëve të mitur të përbashkët. Mundësia e kufizimit të zgjidhjes së martesës me marrëveshje të përbashkët, siç është paraparë me këtë dispozitë, nuk është në funksion të stabilitetit të marrëdhënieve të çrregulluara martesore dhe të mënjanimin të shkaqeve që kanë shkaktuar padurimin e jetës së përbashkët të bashkëshortëve, por kjo bëhet me qëllim të mbrojtjes të interesit të fëmijëve të mitur të përbashkët dhe të interesit të përgjithshëm shoqëror (Komar, *et al.*, 1999: 161). Me këtë çenohet e drejta për zgjidhje të martesës, po aq e rëndësishme sa edhe e drejta për lidhjen e saj.

b) Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur të përbashkët apo fëmijë të birësuar, ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore, ata mund ta zgjidhin martesën me marrëveshje, madje pa kufizime ligjore. Gjykata krejt në mënyrë të thjeshtë dhe praktike e zgjidh martesën me marrëveshje kur bashkëshortët paraqesin propozimin e përbashkët. Marrëveshja e bashkëshortëve, njësoj sikur ajo e lidhjes së martesë, para organit kompetent shtetëror është e mjaftueshme për zgjidhje të martesës. Fati i martesës dhe kohëzgjatja e saj është në duart e vetë bashkëshortëve. Në këtë rast bashkëshortët nuk

kanë detyrë që t'i theksojnë shkaqet e zgjidhjes së martesës, madje as gjykata që t'i vërtetojë ato (Nerimana & Suzana, 2007: 84).

Mund të thuhet, se përcaktimi ligjor që martesa pa fëmijë të mitur të përbashkët të zgjidhet pa asnjë kufizim ligjor është e kritikueshme, për arsye se ajo mund të çojë në rritjen e numrit të zgjidhjes së martesave, për faktin se procedura gjyqësore është lehtësuar dhe thjeshtësuar në mënyrë të dukshme. Përveç kësaj, martesa humb kuptimësinë e vet nëse zgjidhet pa kufizime ligjore, sepse fati i martesës do të varej enkas nga vullneti i çiftit bashkëshortor. Megjithatë, siç u theksua dhe më lart, një pjesë e doktrinës e konsideron atë si një rrugë më efikase se ajo e zgjidhjes së martesës me anë të padisë pai zgjidhja e martesës me marrëveshje u mundëson bashkëshortëve shkurorëzim të dinjitetshëm (Nerimana & Suzana, 2007: 85).

III.4. Shkurorëzimi me pajtim të dyanshëm të bashkëshortëve në Maqedoni

Marrëdhëniet në mes bashkëshortëve themelohen në vendim të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në barazinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjelltë dhe ndihmës reciproke (LFRM)⁵⁰. Prandaj, përveç padisë për shkurorëzim - të cilën e inicion njëri prej bashkëshortëve për shkak të prishjes së marrëdhënieve martesore, deri në atë masë sa që bashkëjetesa është bërë e padurueshme dhe për shkak të ndërprerjes faktike të bashkëshortësisë më tepër se një vit - shkurorëzimi mund të inicohet edhe me propozim marrëveshje për shkurorëzim, të cilin e inicojnë të dy bashkëshortët në cilësinë e propozuesve.

⁵⁰ Barazia e bashkëshortëve si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi garantohet edhe në aktet më të rëndësishme ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Për sa i përket termit me të cilën përshkruhet ky veprim kontestimor, në teori shpesh herë jepen vërejtje për termin e përdorur në LFRM. Kështu që në nenin 229 paragrafi 2 LFRM thuhet:

në rastë se bashkëshortët kërkojnë që martesë të zgjidhet me pajtim të dyanshëm, procedura inicohet me padi me “propozim marrëveshje për shkurorëzim”, ndërsa më tej në ligj përdoret termi “propozim për shkurorëzim me marrëveshje.”

Autori Kirill Çavdar jo vetëm që fjalën "padi" e paraqet si gabim redaktues, por shton se gabimisht është emëruar “*propozim marrëveshje për shkurorëzim*”, e cila duhet të jetë “*propozim për shkurorëzim me marrëveshje*” (Çavdar, 1995). Neni 125 i KFRSH përdor termin *projekt-marrëveshje*, për sa kohë ajo nuk është miratuar nga gjykata: vetëm pas këtij momenti mund të flitet për marrëveshje.

Sipas nenit 39 LFRM:

Martesa mund të zgjidhet me pajtim të dyanshëm të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë të rritur të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të parashtrohet marrëveshje për mënyrën e kryerjes së të drejtave dhe detyrimeve prindërore si dhe përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve. Gjykata do të sjell vendimin për zgjedhje të martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve nëse vërtetohet se pëlqimin e kanë dhënë me vullnetin e tyre të lirë, serioz dhe të pakushtëzuar.

Në lidhje me përmbajtjen e projekt-marrëveshjes, LFRK (ashtu si dhe LFRM), në dallim nga KFRSH, përfshin rregullimet jo vetëm në lidhje fëmijët e mitur (me përcaktimin e mëtejshëm “të përbashkët”), por edhe *fëmijët e rritur ndaj të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore*. Jemi të mendimit se edhe në legjislacionin shqiptar duhet të përfshihet kjo kategori. Marrëveshja për mënyrën e kryerjes së të drejtave prindërore dhe për dhënien në besim të fëmijëve në mirëmbajtje dhe edukim mund të parashtrohet me

shkrim ose po të shprehet gojarisht në procesverbalin e gjykatës së shkallës së parë përkatëse.

III..5. Zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort në Shqipëri

Nëse bashkëshortët nuk bien dakord për zgjidhje të martesës me pëlqim reciprok, atëherë në zbatim të nenit 132 të KFRSH, secili prej tyre mund t'i kërkojë i vetëm gjykatës zgjidhjen e martesës. Zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, e cila në legjislacionin e mëparshëm të Shqipërisë ka përfaqësuar të vetmin rast të zgjidhjes së martesës, edhe sot mbetet mënyra më e ndeshur në praktikën gjyqësore (Mandro, 2009: 402). Në këtë hipotezë martesa zgjidhet për një shkak të caktuar, i cili ka sjell si pasojë pamundësinë e vazhdimit të jetës së përbashkët ndërmjet bashkëshortëve. Roli qëndror i vlerësimit të shkakut për të cilën kërkohet zgjidhja e martesës dhe të pasojave që ky ka sjell në drejtim të humbjes së qëllimit të martesës, i përket vetëm gjykatës. Prandaj "pamundësia e jetës së përbashkët" dhe "humbja e qëllimit të martesës", përfaqësojnë pasojën apo efektin negativ që vjen rezultat i shkakut për të cilën bashkëshorti paditës pretendon zgjidhjen e martesës. Pikërisht ekzistenca e këtij kushti dëshmon se zgjidhja e martesës nuk është një sanksion në drejtim të bashkëshortit që ka shkelur detyrimet martesore, por shkurorëzimi shihet si domosdoshmëri, si mjet shërimi, për të gjitha ato martesa që nuk realizojnë funksionin themelor për të cilin janë lidhur (Omari, 2010: 205).

Ndryshe nga zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok, ku roli i gjykatës është i kufizuar në verifikimin e pëlqimit të lirë të bashkëshortëve, në këtë rast gjykata ka një rol juridiksional, pasi është e vetmja që mund të vlerësojë si seriozitetin e shkakut të

pretenduar nga bashkëshorti paditës, ashtu edhe tronditjen e marrëdhënies bashkëshortore. Në vijim të kësaj veprimtarie dhe bindjes së saj të brendshme gjykata mund ta pranojë zgjidhjen e martesës apo ta rrëzojë atë, nëse vlerëson se qëllimi i kësaj martese nuk ka humbur ne mënyrë të pakthyeshme. Sipas dispozitave të nenit 132 të KFRSH, *pamundësia e jetës së përbashkët* duhet të vërtetohet për të dy bashkëshortët ose të paktën për bashkëshortin paditës. Ndërkaq, kur nuk vërtetohet pamundësia e jetës së përbashkët për bashkëshortin paditës, gjykata nuk mund të vendosë zgjidhjen e martesës.

Ndryshe nga shkaku i cili paraqet një rrethanë objektive dhe si e tillë është më i thjeshtë për t'u provuar, tronditja e marrëdhënieve martesore paraqet një pasojë, e cila shpeshherë paraqet një karakter të theksuar subjektiv për bashkëshortin paditës (Mandro, 2009: 406). Në këto rrethana, për të vërtetuar faktin që vazhdimësia e jetës së përbashkët është e pamundur, gjykata do t'i referohet marrëdhënies ndërmjet bashkëshortëve pas periudhës së shfaqjes së shkakut të pretenduar nga paditësi. Kështu administrohen prova në drejtim të marrëdhënies *post factum*, duke u krahasuar atë me marrëdhëniet personale para shfaqjes së shkakut për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës (Omari, 2010: 205). Mirëpo gjatë procedurës së shkurorëzimit, gjithashtu gjykata duhet të vërtetojë lidhjen shkakësore ndërmjet shkakut dhe pamundësisë së jetës së përbashkët, gjëgjësisht se çfarë motivi ka sjellë si pasojë pamundësinë e vazhdimit të jetës së përbashkët. Në këto kushte gjykata do të shqyrtojë seriozitetin e shkaqeve të parashtruara nga bashkëshortët dhe rëndësinë e shkakut të paraqitur, e në disa raste duhet të ketë edhe një kohëzgjatje të caktuar.

Ndërkaq, në nenin 132 të KFRSH janë cituar taksativisht kushtet ligjore për të cilat në qoftë se janë prezentë ne një martesë, njëri nga bashkëshortët mund të inicojë me padi

zgjidhjen e martesës⁵¹. Pas analizës së bërë këtij neni, konkludohet se në rastin e zgjidhjes së martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, gjykata duhet të vërtetojë përmbushjen e tre kushteve (Omari, 2010: 203):

- Shkakun, posaçërisht kushtin ligjor për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës;
- Pamundësinë e jetesës së përbashkët dhe humbjen e qëllimit të martesës;
- Lidhjen shkakësore ndërmjet shkakut për të cilën kërkohet zgjidhja e martesës dhe pamundësisë së jetës së përbashkët

Shkaku, i cili ka sjellë tronditjen e marrëdhënieve martesore deri në atë pikë sa që *jetesa e përbashkët midis bashkëshortëve është bërë e pamundur* (neni 132 KFRSH), duhet të vërtetohet nga bashkëshorti i cili me padi kërkon zgjidhjen e martesës. Shkaku i cili ka sjellë deri të prishja e martesës, përbën njëherit faktin juridik i cili si pasojë ka sjellë deri te tronditja e marrëdhënieve midis bashkëshortëve në atë masë që e bën të pamundur vazhdimësinë e jetës bashkëshortore.

Përveç shkaqeve që janë përmendur taksativisht në nenin 132 të KFRSH, do të përbëjë shkak për zgjidhjen e martesës edhe *çdo shkelje e përsëritur e detyrimeve që rrjedhin nga martesë*. Këto rrethana dhe fakte i vërteton gjykata individualisht nga rasti në rast, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe në praktikën gjyqësore, duke pasur parasysh faktin se në ligj parashikohen shprehimisht ato shkaqe që përbëjnë "*shkelje të përsëritur*" të detyrimeve bashkëshortore (Omari, 2010: 204). Kjo gjithashtu sjell dilema në zbatimin e

⁵¹ Neni 132 i KFRSH: "*secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur për shkak të grindjeve të vazdhueshme, të keqtrajtimit, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose të dy bashkëshortët*".

ligjit në praktikën gjyqësore, pasi shpesh herë gjykata përballlet me raste kur marrëdhëniet martesore janë tronditur në atë masë sa që jetesa e përbashkët është bërë e pamundur, mirëpo fakti që ka ndikuar nuk është një veprim apo mos veprim i “përsëritur” gjatë jetës së përbashkët, por shpesh herë paraqet një veprim apo mosveprim nga ana e bashkëshortit që e ka bërë të pamundur vazhdimin e martesës midis bashkëshortëve.

Parë në prizmin e faktit juridik, shkaku për zgjidhjen e martesës mund të jetë si rregull i kategorisë së veprimeve njerëzore të bashkëshortëve, e në disa raste edhe kategorisë së ngjarjeve. Lidhur me verpimet e bashkëshortëve duhet theksuar se shkaku mund të konsistojë si në veprime ashtu edhe në mosveprime të tyre (Mandro 2009: 407). Nga veprimet mund të jetë dëmtimi i shëndetit dhe integritetit të bashkëshortit; keqtrajtimet e kryera ndaj njërit bashkëshort; fyerjet e rënda ndaj bashkëshortit, ekzistenca e marrëdhënieve jashtëmartesore me një tjetër person⁵²; shpenzimi i të ardhurave të përbashkëta apo administrimi i keq i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve; largimi nga banesa e përbashkët dhe të tjera. Ndërsa nga mosveprimi i bashkëshortit mund të llogariten mospërbushja e një detyrimi; mosmarrja e një mase apo moskryerja e një veprimi të caktuar; do të konsiderohet shkelje e detyrimeve martesore në të gjitha ato raste kur sipas ligjit apo zakoneve të mira veprimi duhej të kryhej apo masa duhej të ndërmerrej nga bashkëshorti që ka qëndruar pasiv (Omari, 2010: 205).

⁵² Kështu për shembull, sipas vendimit nr. 2824 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë i sjellë më datë 27.02.2014 vërejmë se në këtë rast zgjidhja e martesës bëhet me kërkesën e njërit bashkëshort sepse *paditësi pretendoi se ai nuk është babai i fëmijëve*. Për këtë shkak Gjykata në vitin 2012, duke u bazuar në nenet 127 dhe 297/b të K.Pr.C., vendosi pezullimin e gjykimit për zgjidhjen e martesës, deri në përfundimin e çështjes civile të lartpërmendur, gjegjësisht vendimin në bazë të kërkesë padisë së paditësit për çështjen lidhur me atësinë.

Gjithashtu me rastin e vlerësimit të shkakut që ka sjellë si pasojë kërkesën e njërit bashkëshort për zgjidhje të martesës, gjykata do të vlerësojë në mënyrë objektive secilin rast veç e veç pasi që, pavarësisht ngjashmërive që mund të paraqitën në raste të kësaj natyre të zgjidhjes së martesës me arsye të lartpërmendura, gjykata duhet ta shqyrtojë secilin rast në veçanti (Mandro, 2009: 426). Ajo duhet ta mbështesë sjelljen e vendimit për miratimin apo mosmiratimin e kërkesë padisë së njërit nga bashkëshortit në provat materiale dhe provat gojore, me të cilat do të vërteton gjendjen faktike si dhe shkaqet që kanë sjellë deri në zgjidhjen e kësaj martese. Gjykatat duhet të mbrojnë jetën personale dhe familjare të bashkëshortëve, e cila mund të cënohet rëndë në rastin e zgjidhjes së martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, ku bashkëshortët janë të detyruar të bëjnë publike aspekte të jetës së tyre private⁵³. Pa dyshim detyrimi i bashkëshortëve për të provuar para gjykatës shkakun e zgjidhjes së martesës, i detyron ata të shpalosin elemente apo ngjarje nga jeta e tyre intime dhe private. Kjo, sepse një rrethanë e caktuar mund të paraqesë shkak për zgjidhjen e martesës ndërmjet dy bashkëshortëve, ndërkohë që e njejta rrethanë nuk ka një vlerë të tillë për dy subjekte të tjerë.

Për përcaktimin e lidhjes shkakësore, gjykata do të bazohet në personalitetin e bashkëshortëve, nivelin e tyre të shkollimit dhe edukimit; moshën dhe kushte të tjera të personalitetit të tyre. Gjykata duhet të ketë kujdes të përcaktojë shkakun e zgjidhjes së

⁵³ Ky kufizim i së drejtës së privatësisë, i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit, i cili sipas nenit 17 të Kushtetutës, detyron ligjvënësin që kufizimi i cili i bëhet jetës private duhet të jetë në përputhje me qëllimin që kërkohet të arrihet. Kështu, detyrimi për të shpalosur pjesë nga jeta private e bashkëshortëve, mund të justifikohet vetëm në rastet kur njëri bashkëshort kundërshton zgjidhjen e martesës, prandaj bashkëshorti tjetër duhet të vërtetojë shkaqet për të cilat kërkon zgjidhjen e martesës. Nga ana tjetër, në rastet kur të dy bashkëshortët janë dakord me zgjidhjen e martesës, vërtetimi i fakteve e ngjarjeve që kanë bërë të pamundur bashkjetesën e tyre, kalon përtej qëllimit të interesit publik për të kontrolluar shkakun që ka tronditur në mënyrë të pakthyeshme marrëdhënien bashkëshortore.

martësës, duke mos u bazuar vetëm në pretendimet e palëve, por duke u kërkuar atyre të provojnë pretendimet e tyre (Mandro 2009: 426). Nëse vërtetimi i një rrethane të caktuar si, sëmundje e rëndë e njërit bashkëshort; shkelja e besnikërisë bashkëshortore; grindjet e vazhdueshme; etj, nuk shoqërohen nga vërtetimi i pamundësisë së vazhdimësisë së jetesës së përbashkët, gjykata nuk mund të vendosë zgjidhjen e martësës⁵⁴.

Në bazë të KFRSH, *faji* nuk parashihet si kusht ligjor për pranimin e padisë së zgjidhjes së martësës, gjëgjësisht faji nuk luan rol gjatë zgjidhjes së martësës dhe nuk prodhon pasoja juridike ndaj asnjërit bashkëshort, që nënkupton se martesa do të zgjidhet edhe nëse vërtetohet se fajtor për zgjidhjen e martësës është bashkëshorti paditës⁵⁵. Gjithashtu, nisur nga shkaqet e theksuara në nenin 132 të KFRSH, ka raste të tilla që ndodhin pavarësisht vullnetit të bashkëshortit, rasti i sëmundjes mendore si dhe ka të tjera që prishin harmoninë dhe jetën në çift si rezultat i vullnetit të bashkëshortit ose bashkëshortëve, të cilët me sjelljen e tyre e shkaktojnë këtë, siç mund të jenë grindjet e vazhdueshme, keqtrajtimi, fyerjet e rënda, etj. (Mandro, 2009: 316).

Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë të zgjidhë martësën për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, që e bëjnë jetën bashkëshortore të pamundur për t'u vazhduar. Shkaku i cili paraqitet para gjykatës për zgjidhjen e martësës i nënshtrohet një shqyrtimi objektiv: ai mund të jetë veprim ose mosveprim. Për këtë gjykatës do t'i duhet të shqyrtojë vetëm ato që konsiderohen sjellje të jashtme edhe nëse shkaqet janë personale, do të duhen të merren në konsideratë reagimet dhe qëndrimet e jashtme (Omari, 2010:

⁵⁴ KFRSH, neni 132.

⁵⁵ Ndryshe nga zgjidhja e kontratës e cila mund të kërkohej vetëm nëse mospërbushja e detyrimeve është kryer me faj nga pala mospërbushëse, vërtetimi i fajit nuk kushtëzon zgjidhjen e martësës.

203). Kështu karakteri i kundërligjshëm i këtyre qëndrimeve sjell si pasojë shkeljen e detyrimeve të cilat kthehen në shkak për zgjidhje të martesës. Për të bërë një vlerësim objektiv gjykata duhet të ndajë qëndrimin emocional dhe psikologjik nga shkelja eventuale e detyrimeve. Detyrimi për vërtetimin e shkakut që shtyn në zgjidhjen e martesës është i bashkëshortit që kërkon zgjidhjen, i cili para gjykatës duhet të vërtetojë motivin e pamundësisë së jetës së përbashkët.

Sipas nenit 132 të KFRSH, shkaqet mund të jenë: grindjet e vazhdueshme, shkelje e besnikërisë bashkeshortore, keqtrajtimet, fyerjet e rënda, dënimi penal i bashkëshortit, sëmundja mendore e pashërueshme, ose *çdo shkelje tjetër e përsëritur e detyrimeve që rrjedhin nga martesa*. Praktika sjell në vëmendje një seri rastesh që vijnë nga shkaqe të papërmendura shprehimisht në ligj. Ndaj në një interpretim deduktiv të nenit, duhet të kemi parasysh tërësinë e gjithë atyre shkaqeve (edhe të patheksuara shprehimisht në Kod), të cilat çojnë në pamundësinë e jetës së përbashkët (Omari, 2010: 204). Shkaku nuk është vetëm motivi, i cili mbetet në sferën e brendshme të individit, por përfaqëson vetë tronditjen, e cila shfaqet në sferën e jashtme të individit, që sjell si pasojë ndarjen. Kjo tronditje duhet të jetë e tillë që e bën të pamundur dhe të pakthyeshme marrëdhënien bashkëshortore. Ndryshe nga zgjidhja me pëlqim reciprok, ku mjafton pëlqimi i palëve, në këtë rast gjykata vlerëson ligjshmërinë e shkakut po ashtu dhe vërtetësinë e tronditjes së jetës bashkëshortore.

Bazuar pikërisht në kriterin e mënyrës së vlerësimit të motivit që çon në zgjidhjen e martesës, legjislacionet ndahen në: sisteme që parashikojnë *shkaqe absolute të zgjidhjes së martesës* dhe sisteme që parashikojnë *shkaqe relative të zgjidhjes së martesës* (Podvorica,

2006: 123). Sipas këtij klasifikimi konsiderohen *shkaqe absolute për zgjidhjen e martesës* ato të cilat përcaktohen në mënyrë taksative si të tilla me ligj. Në kë të rast nuk është e nevojshme që gjykata të vlerësojë rast pas rasti rëndësinë e këtij shkakut në raport me marrëdhënien e bashkëshortëve në gjykim, por mjafton vetëm konstatimi i ekzistencës së njërit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht me ligj, që martesë të zgjidhet. Në këtë sistem vlerësimi i tronditjes së marrëdhënies martesore nuk bëhet nga gjykata, por ai prezumohet *in abstracto* nga ligjvënësi në secilin nga motivet e parashikuara shprehimisht në ligj.

Ndryshe, në rastin e sistemit të *shkaqeve relative për zgjidhjen e martesës*, shkakut që ka tronditur marrëdhënien martesore nuk përcaktohet në ligj, por vlerësohet rast pas rasti nga gjykata, në secilin proces gjyqësor për zgjidhje martesore. Në këto kushte, zgjidhja e martesës mund të vendoset për çfarëdo shkakut që konsiderohet nga gjykata si përcaktues në tronditjen e marrëdhënies bashkëshortore. Ndaj konkretisht duhet të kuptojmë se ka motive dhe detyrime që imponohen nga rregullat e jetës bashkëshortore dhe koncepti i jetës së përbashkët, që jo gjithmonë parashikohen në mënyrë të detajuar me ligj, por që praktikisht mund të përbëjnë shkaqe të shkurorëzimit, për sa kohë përbëjnë shkelje të përsëritur të detyrimeve bashkëshortore⁵⁶.

Shkakut përfaqëson një rrethanë objektive dhe si i tillë është më i thjeshtë për t'u provuar, por tronditja e jetës bashkëshortore është një pasojë që ka karakter të theksuar subjektiv për atë bashkëshort i cili kërkon zgjidhjen e martesës (Omari, 2010: 278). Midis

⁵⁶ Nga interpretimi i nenit 50/2 KFRSH: *Nga martesë lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës*, rezulton se rastet e shkeljes nuk mund të jenë shteruese pasi varen nga vlerësimi që vetë bashkëshortët i bëjnë rast pas rasti këtyre detyrimeve, së pari morale, e më pas ligjore.

tyre duhet bërë një lidhje logjike shkakësore, apo lidhja motiv-pasojë. Prandaj gjykatës i lind detyra të vlerësojë vlefshmërinë dhe seriozitetin e motivit të pretenduar nga palët dhe rëndësinë e pasojave në marrëdhënien e përbashkët. KFRSH parashikon si shkaqe të zgjidhjes së martesës rastet e mëposhtme⁵⁷:

grindjet e vazhdueshme, keqtrajtimet, fyerjet e rënda, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, sëmundja mendore e pashërueshme, dënimi penal i njërit bashkëshort (Mandro, 2009: 316).

Grindjet e vazhdueshme - Për të konsideruar grindjet e vazhdueshme si një shkak të ligjshëm duhet që gjykata të shqyrtojë dhe të konstatojë vazhdueshmërinë e mosmarrëveshjeve dhe shpeshtësinë e tyre. Grindjet do të përfaqësojnë rastet e mungesës së komunikimit, të zënkave që cojnë në shpërthime të jetës së përbashkët apo rastet kur ka ndërprerje të jetës së përbashkët edhe pse bashkëshortët jetojnë në një banesë (Omari, 2010: 206). Shkaku i cili paraqitet para gjykatës për zgjidhjen e martesës i nënshtrohet një shqyrtimi objektiv: ai mund të jetë veprim ose mosveprim. Për këtë gjykatës do t'i duhet të shqyrtojë vetëm ato që konsiderohen sjellje të jashtme edhe nëse shkaqet janë personale, do të duhen të merren në konsideratë reagimet dhe qëndrimet e jashtme. Kështu karakteri i kundërligjshëm i këtyre qëndrimeve sjell si pasojë shkeljen e detyrimeve të cilat kthehen në shkak për zgjidhje të martesës. Për të bërë një vlerësim objektiv gjykata duhet të ndajë qëndrimin emocional dhe psikologjik nga shkelja eventuale e detyrimeve (Mandro 2009: 406). Motivi i grindjeve është jo relevant për gjykatën, sigurisht ky motiv mund të tregojë se sa e rëndë është tronditja e shkaktuar, por ai është dhe subjektiv.

Duke supozuar se secili nga bashkëshortët e sheh motivin subjektivisht, i takon gjykatës të konsiderojë vlefshmërinë e motivit. Gjithashtu gjykata duhet të shohë te gjitha

⁵⁷ Neni 132 KFRSH.

mundësitë për të shmangur këtë motiv, dhe nëse me shmangien e tij mund të realizohet edhe parandalimi i grindjeve. Nëse gjykata vërteton se është e pamundur që ky motiv të shmanget dhe të zhdukët, rrjedhimisht konstaton edhe humbjen e qëllimit për jetesë të përbashkët dhe tronditjen e jetës bashkëshortore. Në praktikë shpesh ndeshen motive nga më të ndryshmet për grindjet; në ato raste kur njëri nga bashkëshortët ka një sjellje të papranueshme dhe është në faj sipas ligjit, sepse për shembull, nuk përmbush detyrimet familjare; mospërputhja e karaktereve dhe probleme të rënda me komunikimin; bashkëjetesa dhe me të afërm të tjerë; mosrespektimi i lirisë individuale dhe i të drejtës së korrespondencës.

Keqtrajtimet - Bashkëjetesa në martesë nënkupton një seri të drejtash dhe detyrimesh reciproke, por gjithmone synon respektin reciprok të integritetit moral dhe atij fizik. Gjithmonë e më shumë në praktikën gjyqësore po ndeshen raste të keqtrajttimeve dhe dhunës brenda në familje. Me dhunë kuptohet *çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim jo vetëm të integritetit fizik por edhe atij moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik që ushtrohet midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare*⁵⁸. Pra, çdo formë e vuajtjes fizike apo morale mund të cilësohet keqtrajtim, veçanërisht kur cënon, siç u theksua më lart, integritetin moral dhe atë fizik.

Sipas një raporti të vitit 2009 mbi zbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në 91.51% të vendimeve të monitoruara, paditëset janë gra dhe në 8.49% të rasteve paditësit janë burra: në 42.85% paditëset, viktimat të dhunës në

⁵⁸ Shih përkufizimin e nenit 3/1, të Ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, nr. 9669, datë 18.12.2006.

marrëdhëniet familjare janë të martuara, dhe në 9.82% të rasteve paditëset janë të divorcuara (Qendra për nisma ligjore qytetare, 2006)⁵⁹. Ndërkohë që studimet më të fundit arrijnë në konkluzionin se, dhuna në familje pësohet më shumë nga femrat sesa nga meshkujt dhe se vetëm një pjesë e vogël e viktimave të dhunës në familje (4%) e denoncojnë rastin e tyre në polici (Berzani & Osmani, 2012: 82). Sipas këtij raporti, (...)

forma më e përhapur e dhunës në familje është ajo emocionale, pasuar nga dhuna psikologjike. Të dyja këto forma shihen si më "të lehta", më të zakonshme, të pranueshme dhe gati të pashmangshme në jetën familjare, si pasojë janë edhe format më pak gjasa për t'u raportuar. Dhuna fizike është deklaruar të jetë përjetuar nga më pak njerëz, dhuna seksuale nga akoma edhe më pak. Të dyja këto forma shihen si më "të rënda", por stigma që i shoqëron ato është e lartë, ndaj edhe këtu gjasat e raportimit janë të ulta, por gjithsesi më të larta sesa abuzimi emocional e psikologjik (...).

Format e keqtrajtimit janë nga më të ndryshmet, si ai fizik, mendor, seksual edhe ekonomik. Të tilla mund të jenë: abuzimit fizik siç është goditja me shuplakë, rrahja, përdredhja e krahut, goditja me thikë, mbytja, djegja, goditja me shqelma, kërcënimi me armë dhe vrasja⁶⁰. Në Kosovë, dhuna në familje përkufizohet si *çdo veprim i qëllimshëm apo mosveprim që rezulton me keqtrajtim, kur kryhet nga një person që është ose ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën ashtu që kjo dhunë mund të shfaqet si: keqtrajtim fizik, keqtrajtim psikik, keqtrajtim seksual, keqtrajtim ekonomik* (Gashi & Berisha, 2014: 49).

⁵⁹ Shifra prej 9.82% e paditësve të divorcuar, tregon se zgjidhja e martesës shoqërohet me probleme të mprehta sociale, të cilat shfaqen si dhunë midis ish-bashkëshortëve. Midis të tjerave, kjo ndikohet edhe nga fakti se në një përqindje të lartë të rasteve, pas zgjidhjes së martesës, ish-bashkëshortët vazhdojnë të jetojnë në të njëjtën banesë dhe hasin vështirësi e probleme të mirërritjes, edukimit dhe kontributit për fëmijët. Shpesh ata nuk e gjejnë gjuhën e përbashkët dhe përballen edhe me probleme të tjera të mentalitetit patriarkal, të cilat gjenerojnë konflikte dhe mosmarrëveshje të ndryshme.

⁶⁰ Gjithashtu edhe format e abuzimit seksual do të konsiderohen kryerja e marrëdhënieve seksuale nëpërmjet kërcënimit, frikësimit ose forcës fizike. Keqtrajtimi mendor shprehet me dhunë psikologjike me forma të ndryshme: ai përfshin sjellje që kanë për qëllim të frikësojnë ose persekutojnë dhe që merr formën e kërcënimeve për abandonim dhe abuzim, mbyllje në shtëpi, survejim, kërcënim për të marrë fëmijët, thyerje të objekteve, izolim, agresion verbal dhe fyerje të vazhdueshme.

Vlen të theksohet se në rastin e zgjidhjes së martesës nuk është kusht që keqtrajtimi të përmbushë kushtet për të qënë një vepër penale, sepse edhe një formë e lehtë e tij mund të quhet shkak për zgjidhje të martesës: kjo për arsye se në themel të martesës qëndron respekti reciprok dhe ndjenja afektive. Nëse veprimet keqtrajtuese janë të shpeshta dhe të përsëritura, apo edhe nëse ato shfaqen të shkëputura në periudha të ndryshme, mjafton të vërtetohet se ato janë bërë me synim keqtrajtimi dhe si pasojë kanë tronditur normalitetin e jetës së përbashkët. Gjykata duhet të vërtetojë me anë të provave për të pasur bindjen se keqtrajtimi është aq i rëndë sa ka shkaktuar një tronditje të pakthyeshme në jetën bashkëshortore. Shpeshtësia e keqtrajtimit do të përcaktohet rast pas rasti nga gjykata, sipas shkallës së tronditjes bashkëshortore për atë bashkëshort që kërkon zgjidhjen e martesës.

Fyerjet e rënda - Analiza e këtij shkakut është subjektive sepse interpretimi i një fyerje nuk është i njëjtë për persona të ndryshëm. Me fyerje të bashkëshortit do të kuptohet çdo lloj komunikimi, me fjalë apo me gjeste, me veprime apo mosveprime, që cënojnë personalitetin dhe integritetin e bashkëshortit tjetër (Mandro, 2009: 317). Ato mund të jenë të formave të ndryshme, për shembull me deklarata fyese, fjalë të rënda, denigruese, injoruese dhe përçmuese në drejtim të njërit bashkëshort. Sipas rastit ato mund të bëhen në publik apo privatisht⁶¹. Fyerja e bërë ndaj bashkëshortit duhet të jetë aq e rëndë sa të trondisë në mënyrë të atillë jetën e përbashkët sa të mos ketë më mundësi pajtimi midis bashkëshortëve. Kriteri i vlerësimit është një faktor subjektiv dhe një moment shumë

⁶¹ Edhe fyerja nuk është e nevojshme që të përmbushë elementët e veprës penale. Nëse konstatohet se fyerja si shkak për zgjidhjen e martesës përmbush edhe elementët penalë, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës ka të drejtë të ngrejë një padi tjetër ndaj bashkëshortit të paditur, sipas dispozitave të legjislacionit penal.

delikat, sepse gjykatës i duhet të gjykojë objektivisht, por duhet të vlerësojë se si do të ndihej çdo person përpara një situatë të tillë, sa e rëndë është fyerja në rrethanat që është bërë dhe sidomos cili është efekti emocional që ka pasur tek bashkëshorti kjo fyerje. Gjithashtu gjykata duhet të marrë parasysh dhe veçoritë e personalitetit dhe të karakterit të secilit prej bashkëshortëve.

Ndryshe nga grindjet që kanë si kusht vazhdueshmërinë, fyerja e drejtuar bashkëshortit çon në zgjidhje të martesës edhe pse mund të mos jetë e vazhdueshme, por është aq e rëndë sa ka çuar në humbjen e qëllimit të martesë (Mandro, 2009: 318). Fyerja duhet t'i drejtohet patjetër njërit prej bashkëshortëve nga bashkëshorti tjetër, dhe jo nga persona të tretë. Prandaj, sado të rënda të jenë fyerjet që vijnë nga persona të afërm me çiftin nuk mund të jenë në këtë kuptim shkak për ndërprerje të martesës. Pra, si përfundim mund të themi se për fyerjen, që të konsiderohet si shkak për zgjidhjen e martesës nuk është e nevojshme të përmbushë kushtet për veprë penale dhe nuk është e nevojshme vazhdueshmëria.

Shkelja e besnikërisë bashkëshortore - Besnikëria bashkëshortore është një nga detyrimet që rrjedhin nga martesë⁶². Ajo nënkupton të drejtën e çdo bashkëshorti të pretendojë nga bashkëshorti tjetër shmangien e çdo marrëdhënie afektive me persona të tretë. Sipas doktrinë, besnikëria përputhet me “harmoninë e brendshme të bashkëshortëve” dhe, në mënyrë të përgjithshme, me “stabilitetin e bërthamës familjare, si dhe të interesit të fëmijëve” (Mandro, 2009: 238-239)⁶³. Veprimi fizik i kryerjes së

⁶² Shih nenin 132 KRFSH. Duke u nisur dhe nga barazia juridike midis bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë vlerësohet në të njëjtën masë nga të dy bashkëshortët dhe vlerësohet si cënim i detyrimit të ndërsjelltë të ruajtjes së besnikërisë, nga fillimi i martesës deri në fund të saj.

⁶³ Kjo marrëdhënie asimetrike, ku njëri nga bashkëshortët qëndron besnik ndaj martesës dhe tjetri jo, vjen me edhe me disa pasoja psikologjike. Ka raste kur ka një shpërthim afektive midis bashkëshortëve, të cilët

marrëdhënieve seksuale, jo gjithmonë paraqitet si një kusht i domosdoshëm për shkeljen e këtij detyrimi. Në ditët e sotme, ku divorcet po shtohen, tradhëtia bashkëshortore është në krye të listës së shkaqeve. Sipas një rryme doktrinare të mendimit juridik shqiptar, shkelja e këtij detyrimi merr një formë të re interpretimi sepse nuk bazohet aq në marrëdhëniet seksuale sa në mungesën e respektit ndaj bashkëshortit (Omari, 2010: 282; Mandro, 2009: 318).

Një tjetër element i rëndësishëm që lidhet me tradhëtinë bashkëshortore është përcaktimi i periudhës gjatë së cilës kjo tradhëti mund të verifikohet. Shtrohet pyetja, a duhet të konsiderohet për këtë qëllim vetëm periudha nga lidhja e martesës deri në zgjidhjen e saj, apo mund të përfshihet edhe periudha e bashkëjetesës para lidhjes së martesës? Sipas Gjykatës së Lartë italiane:

në rast të ndarjes gjyqësore, përcaktimi i fajit në zgjidhjen e martesës duhet t'i referohet edhe periudhës së bashkëjetesës para-martesorë, nëse kjo periudhë në raport me martesën konsiston në një bashkëjetesë të vazhdueshme, e cila bën të mundur vlerësimin kompleksiv të jetës në çift dhe të përgjegjësive reciproke të bashkëshortëve⁶⁴.

Sëmundja mendore e pashërueshme - Sëmundja mendore e pashërueshme është një shkak i ligjshëm sipas të cilit martesa mund të zgjidhet. Kjo lidhet me parimin se një nga detyrimet kryesore të bashkëshortëve gjatë martesës është mbështetja morale dhe emocionale. Me sëmundjen e njërit bashkëshort, bashkëjetesa pëson një ndryshim të madh sepse përveç përkujdesjes që bashkëshorti tjetër duhet të tregojë, ndodh një shpëputje e

edhe pse të martuar ndihen të vetmuar. Në shumë raste të tjera kjo shpëputje vjen si pasojë e marrëdhënieve shoqërore të secilit bashkëshort, të cilët për motive të ndryshme janë më të hapur dhe më të prirur drejt njohjeve të reja.

⁶⁴ Gjykata e Lartë italiane, vendimi nr. 15486, datë 20.06.2013.

madhe emocionale. Kjo e fundit është një pasojë veçanërisht në rastet e një sëmundje mendore e cila transformon nga ana psikologjike njërin bashkëshort dhe vendos tjetrin në pozita të ndryshme intelektuale dhe materiale. Kjo mundësi jepet nga dispozitat e KRFSH, si një mjet që i jep të drejtën secilit prej bashkëshortëve, përfshirë këtu edhe atë i cili vuan nga sëmundja, për t'i dhënë fund gjendjes së krijuar. (Mandro, 2009: 412)⁶⁵. Që martesë të zgjidhet dhe shkaku të jetë i ligjshëm duhet që sëmundja të jetë mendore, gjë e cila përcaktohet dhe në Kod. Pra, një sëmundje tjetër, edhe pse mund të ketë sjellë pasojë në jetën e përbashkët, nuk është shkak ligjor për zgjidhjen e martesës sipas këtij neni.

Në rastin e një sëmundje tjetër, zgjidhja e martesës mund të kërkohet për mospërbushje të detyrimeve që vijnë nga martesë. Sëmundja duhet të vërtetohet para gjykatës me raport mjeko-ligjor, gjithashtu edhe me vendimin e gjykatës i cili ka hequr apo kufizuar të drejtën për të vepruar, edhe pse ky i fundit nuk është kusht thelbësor për të konstatuar sëmundjen mendore. Akti mjeko-ligjor duhet të përcaktojë nëse sëmundja është e shërueshme apo jo dhe nëse është e tillë gjykata e rrëzon kërkesën për zgjidhje të martesës sipas këtij shkak. Theksohet se, gjykata duhet të marrë në konsideratë se sa është prekur bashkëshorti që kërkon zgjidhjen nga sëmundja e bashkëshortit dhe sa ka ndikuar ky fakt në tronditjen e jetës së përbashkët.

Dënimi penal i rëndë i njërit bashkëshort - Ky shkak i përcaktuar po ashtu në Kod, nuk tregon se cilat janë ato dënime që konsiderohen aq të rënda sa të çojnë në zgjidhjen e martesës. Rrjedhimisht gjykata do të duhet të bazohet në vendimin e gjykatës e cila ka gjykuar çështjen penale, duke vlerësuar kështu edhe se sa e rëndë është kjo vepër. Sipas

⁶⁵ Neni 132 KRFSH.

nenit 132 të KRFSH, duket se legjislacioni i Republikës së Shqipërisë i referohet *dënimit penal të rëndë*, por sigurisht ky dënim paraqet dhe rrezikshmërinë e veprës penale. Sigurisht masa e dënimit tregon dhe rrezikshmërinë që bashkëshorti i dënuar paraqet, e në këtë kuptim jo vetëm për shoqërinë por dhe për familjen. Nëse njëri bashkëshort është dënuar për një krim të kryer brenda familjes apo kundrejt bashkëshortit tjetër, tregon për një rrezikshmëri më të lartë brenda rrethanave që po diskutohen, ndaj sërish vlerësohet se martesë e ka humbur qëllimin e saj (Mandro, 2009: 414). Nëse bashkëshorti i dënuar ka kryer një vepër penale që ka marrë dënim me shumë vite burgim, edhe këtu bashkëshortit tjetër i lind e drejta që të kërkojë zgjidhjen e martesës.

Ndër shkaqet e përmendura në KFRSH përfshihet edhe *çdo shkelje e përsëritur e detyrimeve që rrjedhin nga martesë*⁶⁶. Prandaj në praktikë, ka shumë rrethana ku KFRSH duhet interpretuar në mënyrë të zgjeruar dhe duke konceptuar të gjitha shkaqet që mund të përbëjnë një shkelje të përsëritur të detyrimeve bashkëshortore që kanë çuar në humbjen e qëllimit të martesës. Në ditët e sotme në Shqipëri ku jeta shoqërore ka dimensione dhe dinamika të ndryshme, arsyet e çifteve për të zgjidhur martesën janë po ashtu të larmishme. Jo rrallë herë gjykata vendoset përballë fakteve ku duhet të analizojë një tërësi sjelljesh e veprimesh, mospërmbyllja e të cilave do të cilësohet si shkelje e detyrimeve martesore.

Braktisja e bashkëshortit apo refuzimi për një jetë të përbashkët, është një shkak që vjen nga shkelja e drejtpërdrejtë e detyrimit të bashkëshortëve për të pasur jetë të përbashkët. Kjo braktisje duhet të ndodhë pa shkaqe të arsyeshme dhe duhet të vërtetohet se nuk ka ndodhur për një periudhë më të shkurtër se tre vjet. Në këtë rrethanë nuk është e

⁶⁶ Neni 132 i KRFSH

nevojshme që nga ana e gjykatës të vërtetohet tronditja e jetës së përbashkët (Mandro, 2009: 314)⁶⁷. Bashkëshorti që ka shkelur detyrimin nuk mund të bazohet në fajin e vet (*propria turpitudine*) për të kërkuar zgjidhjen e martesës, ky fakt nuk do të ishte i legjitimuar (Omari, 2010: 205). Për gjykatën lind detyra të vërtetojë nëse kjo shpërbërje është e rastësishme apo e vazhdueshme. Kështu, nëse vëretohet se kjo ndërprerje është faktike, pra *de facto* dhe është e pakthyeshme atëherë gjykata vërteton faktin që martesa e ka humbur qëllimin e saj⁶⁸.

Shkelja e parimit të barazisë, bazohet në faktin që bashkëshortët gëzojnë të drejta reciproke dhe kjo nga ana ligjore përkthehet në një pozitë juridike të barabartë si në përmbushjen e detyrimeve ashtu dhe në ushtrimin e të drejtave. Shkelja e këtij parimi të së drejtës familjare është dhe shkelje e parimit kushtetues, ndaj asnjëri prej bashkëshortëve nuk duhet të marrë përsipër një rol më të madh në jetën e përbashkët apo në ushtrimin e përgjegjësiave prindërore. Nëse ky fakt ndodh atëherë bashkëshorti tjetër mund të kërkojë zgjidhjen e martesës.

Mospërmbushja e detyrimeve materiale për familjen dhe martesën, kërkon një analizë të veçantë, pasi jo gjithmonë mospërmbushja e detyrimeve çon në humbjen e qëllimit të martesës. Në këtë rast flitet për një detyrim pasuror, ndaj gjykata duhet të vërtetojë së pari të ardhurat e bashkëshortëve. Në praktikë me rastin kur bashkëshorti shpërdoron pasurinë e

⁶⁷ Sipas një interpretimi, bashkëshorti i larguar nuk mund të ngrejë padi për zgjidhje të martesës nëse largimi është rezultat i veprimeve të tij të paligjshme.

⁶⁸ Pa u përmbushur afati 3 vjeçar bashkëshorti i larguar mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për motive të tjera, në të kundërt duhet të presë plotësimin e afatit 3 vjeçar për të legjitimuar kërkesën e tij.

përbashkët, dhe kështu bashkëshorti tjetër mund të kërkojë ndarjen e pasurisë së përbashkët, për shkak se bashkëshorti tjetër nuk e mirëadministron atë⁶⁹.

Mungesa e suportit emocional e moral, rrjedh nga bashkëjetesa që bazohet në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok⁷⁰. Në rastet kur tregohet një tërheqje e njërit prej bashkëshortëve në momente të vështira emocionale, të shqetësimeve shëndetësore apo problemeve të çdo lloji të bashkëshortit tjetër, mund të konsiderohet se marrëdhënia ka pësuar një tronditje. Pra, thelbi i marrëdhënies është pikërisht lidhja emocionale që në terma ligjorë përkthehet në mbështetje reciproke si një detyrim që bazohet në parimin e mirëkuptimit reciprok. Mungesa e kësaj mbështetje tregon humbjen e lidhjes emocionale, sidomos kur është një mungesë e vazhduar dhe e përsëritur. Bashkëshorti që ndjen këtë mungesë të theksuar, ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e martesës për tronditjen e jetës së përbashkët.

Mospërbushja e detyrimeve prindërore, është një tjetër detyrim thelbësor dhe nënkupton se prindërit kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët e tyre (neni 98 i KRFSH). Ka dhe disa raste të tjera të cilat edhe pse në Kod nuk citohen si shkelje specifike të detyrimeve martesore, çojnë në zgjidhjen e martesës sipas praktikës gjyqësore. Ka ndodhur shpesh në praktikë zhdukja e bashkëshortit për një periudhë kohe të gjatë, dhe në këtë situata bashkëshortit tjetër legjitimohet të kërkojë zgjidhjen e martesës (Mandro, 2009: 416). Roli i gjykatë në këtë rast është të vërtetojë nëse jeta e përbashkët është ndërprerë

⁶⁹ Kjo gjë mund të realizohet edhe pa kërkuar zgjidhjen e martesës, por në mendimin tonë nëse arrihet në këtë fazë me shumë mundësi gjendja mund të vazhdojë edhe pas pjestimit të pasurisë, duke u ndjekur nga mosdhënia e kontributit në interes të familjes, dhe për rrjedhojë martesa e humbet qëllimin e saj në mënyrë të pakthyeshme.

⁷⁰ Neni 1 i KRFSH

për shkaqe objektive apo jo. Nëse nuk është ndërprerë për shkaqe objektive, atëherë jemi përballë rastit të braktisjes së bashkëshortit dhe refuzimit për jetë të përbashkët. Zhdukja faktike e njërit prej bashkëshortëve është një formë braktisje, pavarësisht nga rrethanat që kanë kushtëzuar zhdukjen, por gjithmonë ato duhet të jenë të tilla që të përjashtojnë braktisjen pa shkak (Omari, 2010: 205). Pra, ka rëndësi objektiviteti i rrethanave. Sigurisht kjo vlen për të dy bashkëshortët dhe në rastin kur njëri prej tyre ka qëndrime që dëmtojnë dhe çenojnë mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve, bashkëshorti tjetër mund të kërkojë zgjidhjen e martesës. Këtu gjykata duhet të vlerësojë tërësinë e sjelljeve e të qëndrimeve të cilat vlerësohen si çënues për interesin më të mirë të fëmijës.

Shfaqja e mungesës së respektit, është në fakt një detyrim që buron nga ndjenja e dashurisë ndërmjet bashkëshortëve. Respekti dhe detyrimi që kjo ndjenjë të jetë e ndërsjelltë është një nga bazat e mirë funksionimit të jetës martesore dhe familjare. Mungesa e përsëritur e tij çon në tronditje të marrëdhënies dhe bëhet shkak për zgjidhjen e martesës.

Sëmundja e rëndë dhe e pashërueshme, është një tjetër shkak që legjitimon kërkesën për shkurorëzim. Në këto raste bëhet fjalë për një sëmundje mendore ose edhe sëmundje të tjera, të cilat kanë shkaktuar një tronditje të marrëdhënies në atë pikë që bashkëshorti i sëmurë nuk mund të plotësojë psikologjikisht dhe emocionalisht kushtet për të qënë i barabartë në martesë, duke theksuar këtu faktin që jo çdo sëmundje kronike do të cilësohet si shkak për të zgjidhur martesën (Mandro, 2009: 417)⁷¹.

⁷¹ I tillë mund të jetë steriliteti (apo pamundësia për të lindur fëmijë), i cili mund të jetë shkak që vërteton tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore, vetëm kur ky fakt ka sjellë për pasojë grindje të vazhdueshme.

Një tjetër shkak për zgjidhjen e martesës është *mospajtimi i karaktereve*. Sigurisht që persona të ndryshëm kanë karaktere të ndryshme dhe martesa nënkupton mundësinë e mirëkuptimit reciprok dhe të përshtatjes. Objektivisht, nëse mospajtimi i karaktereve çon në grindje të vazhdueshme dhe të përsëritura në një periudhë kohe, dhe të gjitha këto rrethana e bëjnë të pamundur vazhdimin e bashkëjetesës, atëherë bashkëshortët janë të legjitimuar të kërkojnë zgjidhjen e saj⁷².

Duhet patur gjithashtu parasysh se egzistojnë disa *të meta personale të bashkëshortëve* që mund të sjellin shkeljen apo mospërbushjen e detyrimeve të martesës. Duke marrë në konsideratë këto motive, edhe pse mund të jenë shumë personale, gjykatës do t'i duhet të theksojë mosmarrëveshjet dhe grindjet e vazhdueshme që vijnë si pasojë e tyre. Këto të meta, të cilat mund të kenë qënë ekzistuese ose të kenë lindur gjatë martesës, duhet të vërtetohen nga bashkëshorti paditës, gjithmonë në rast se ai s'ka patur dijeni më parë⁷³. Në të kundërt, pra nëse ka qënë në dijeni të tyre kur ka lidhur martesën, do t'i duhet të vërtetojë se vazhdimësia e martesës është bërë e pamundur për shkak të tyre. Nëse këto të meta janë fshehur nga bashkëshorti tjetër, ai që padit mund të kërkojë edhe pavlefshmëri të martesës për këtë shkak.

Motive të tilla mund të jenë: paaftësia seksuale, sepse përbën një shkelje të detyrimit për jetë të përbashkët dhe gjithashtu kjo lidhet dhe me një nga qëllimet kryesore të martesës që është riprodhimi dhe lënia e trashëgimtarëve. Kjo e fundit merr me shumë një

Në të kundërt, Kodi Civil i vitit 1929 i cili e parashikonte sterilitetin si shkak për zgjidhjen e martesës (neni 209).

⁷² Jeta bashkëshortore përfshin edhe të drejtën për jetë seksuale të përbashkët, ndaj në rastet kur ka një mungesë të harmonizimit të kësaj natyre të marrëdhënies, gjykata mund të konstatojë një shkak që ka tronditur jetën e përbashkët. Bashkëshorti që ngre padinë duhet të vërtetojë që ka *mungesë të përshtatshmërisë fiziologjike* dhe ky motiv çon në pamundësinë e vazhdimin të jetës së përbashkët.

⁷³ Ky rast përbën shkak për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës.

rëndësi morale se sa juridike, për shkak të qëllimit natyror të martesës. Në kushtet kur në ditët e sotme shkenca ka arritur të rregullojë defektet fiziologjike të lidhura me riprodhimin, ka mundësi që ky problem fiziologjik të rregullohet (Omari, 2010: 207). Megjithatë nëse gjykata konstaton një tronditje të rëndë të jetës së përbashkët dhe vërtetohet se ka humbur qëllimi i marrëdhënies për këtë motiv, palët legjitimohen për të kërkuar zgjidhjen e martesës.

Statistikat dhe sondazhet tregojnë se ndër shkakët kryesore për zgjidhjen e martesës renditen: dhuna fizike dhe psikologjike në familje, faktorët ekonomikë, mosmarrja e përgjegjësisë të përbashkëta për mirëqënien psiko-sociale dhe ekonomike të fëmijëve, konflikte që gjenerojnë nga kërkesa për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës/ve nga secili prej prindërve (Daka, 2015:). Kështu për shembull, në një rast, pala paditëse, bashkëshortja kërkon zgjidhjen e martesës për arsye se ajo pretendon se ndaj saj është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike, dhe se ka pasur mungesë të kontributit material të bashkëshortit për mirërritjen e fëmijëve⁷⁴. Për shkak se paditësja ka kërkuar zgjidhjen e martesës pa përcaktuar fajësinë, gjykata nuk ka bërë një analizë të shkaqeve, por bazuar në nenin 132 të KFRSH, ka vendosur zgjidhjen e martesës. Po kështu, në një tjetër vendim, shpjegohet se shkak i zgjidhjes së martesës janë mosmarrëveshjet dhe

⁷⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 655, i datës 31.01.2012. Paditësja E.H. deklaroi se marrëdhëniet bashkëshortore asnjëherë nuk kanë funksionuar normalisht për shkak të mentalitetit diskriminues të të paditurit lidhur me pozitën e bashkëshortes në familje, të manifestuar me përjashtimin e saj në të gjitha vendimmarrjet për çështje familjare. Paditësja deklaroi gjithashtu se i padituri ka mbajtur qëndrim problematik edhe në raport me mënyrën e administrimit të të ardhurave në familje, duke refuzuar kryerjen e shpenzimeve të domosdoshme për të dhe dy fëmijët. Paditësja relatonte këto si shkaqet kryesore për grindje e mosmarrëveshje të vazhdueshme në çift, gjatë të cilave ajo pretendon të jetë dhunuar fizikisht e psikologjikisht nga i padituri, edhe në prani të fëmijëve të mitur.

mospërputhja e karaktereve⁷⁵. Bashkëshortët e kishin ndërprerë bashkëjetesën me njëri-tjetrin dhe martesë kishte mbetur formale. Paditësja kërkonte zgjidhjen e martesës me bashkëshortin. Gjykata, pasi dështoi në përpjekjet për pajtim, shqyrtoi shkakun e shkurorëzimit pa përcaktuar fajësinë, që nuk ishte kërkuar nga pala paditëse.

Jeta e veçuar mes bashkëshortëve përbën një tjetër shkak të ndeshur në praktikën gjyqësore për zgjidhjen e martesës⁷⁶. Gjykata çmon se marrëdhëniet bashkëshortore janë tronditur thellë pasi jeta e përbashkët është bërë e pamundur dhe se martesë “de facto” e ka humbur qëllimin e saj dhe e si e tillë duhet zgjidhur. Gjykata në vendimin për zgjidhjen e martesës vuri në dukje, ndër të tjera, se bashkëshortët kishin rreth katër vjet që jetonin të veçuar nga njëri-tjetri⁷⁷.

III.6. Zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort në Kosovë

LFRK organizohet duke prezantuar fillimisht në nenin 3 të tij parimet themelore të rregullimit të marrëdhënieve familjare. Më pas formulohen nenet me të cilat rregullohet marrëdhënia martesore, aftësia, kushtet, procedura për lidhjen e saj. Ndryshe nga KFRSH, ky ligj në Kosovë përmban edhe mënyrën për lidhjen e një martesë sipas rregullave fetare. Pjesa e tretë, kapitulli III, është pjesa e Ligjit ku trajtohet dhe zgjidhja e martesës apo

⁷⁵ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 4759, datë 06.06.2011

⁷⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 4329, datë 02.05.2012. Bashkëshorti paditës kërkon zgjidhjen e martesës me A.I. dhe parashtroi, se pas lidhjes së martesës paditësi është larguar në Greqi, ku jetonte dhe punonte si emigrant ekonomik prej disa vitesh, ndërsa e paditura ka qëndruar në Shqipëri në pritje të përfundimit të procedurave të bashkimit familjar.

⁷⁷ Shkaku paraqitet i ndërlikuar për arsye se në fillim martesë nuk është konsumuar për shkaqe objektive, siç është emigracioni, dhe pas bashkimit familjar ndodh aksidenti i bashkëshortit, dhe siç shihet në arsyetim, bashkëshortja A.I. nuk i ka qëndruar pranë të shoqit, dhe për më tepër interpretohet nga ana e A.Sh. si mungesë afeksioni dhe respekti. Duke qënë se kjo është vetëm një martesë formale, gjykata arsyeton se marrëdhënia është tronditur në atë pikë sa bashkëjetesa është bërë e pamundur prej më shumë se tre vjetësh, ndaj shpall dhe zgjidhjen e martesës midis A.Sh. dhe A.I.

shkurorëzimi. Theksohet shprehimisht se: *martesa do të cilësohet e përfunduar vetëm me një vendim përfundimtar të gjykatës kompetente (neni 60/2 LFRK).*

LFRK, si një ndër mënyrat e zgjidhjes së martesës apo shkurorëzimit një dhe mënyrën e marrjes së iniciativës me kërkesë padi të inicuar nga njëri prej bashkëshortëve, nëpërmjet së cilës ai i cili inicon procedurën e shkurorëzimit llogaritet paditës, ndërsa pala tjetër i paditur.

Sipas nenit 69 i LFRK shpjegon dhe shkaqet e njohura me ligj për shkurorëzim:

Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mes tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit⁷⁸.

Gjithashtu sipas këtij Ligji parashikohet se:

nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër deri në përfundimin e seancës gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje (neni 68/4 LFRK).

Procedura e shkurorëzimit në bazë të LFRK inicohet me padi ose me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve. Shkurorëzimi me padi nënkupton shkurorëzimin e inicuar me kërkesë të njërit nga bashkëshortët, e cila paraqitet në rastet kur nuk ekziston pajtimi i bashkëshortëve për shkurorëzim. Shkaqet e paraqitjes së padisë mund të jenë *shkaqet e*

⁷⁸ Siç shihet, ky nen i përbërë nga dy pika, shpjegon se martesa mund të zgjidhet nëse ajo ka pësuar një tronditje dhe është e pakthyeshme për situatën bashkëshortore. Në shkaqet që përmenden janë rasti kur jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme për shkak të grindjeve; shkelja e besnikërisë bashkëshortore që siç është shpjeguar dhe në analizën teorike është një nga detyrimet themelore të bashkëshortëve në martesë. Keqtrajtimi serioz, si ai fizik ashtu dhe ai mendor, lënia për motive të paqarta dhe të paarsyeshme, dhe nëse kjo ndodh për një periudhë më të gjatë se një vit. Gjithashtu parashikohet dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme, pra kur të dy palët janë të vetëdijshëm që martesa e ka humbur qëllimin e saj e bien dakort t'i japin fund asaj me mirëkuptim.

përgjithshme të cilët kanë sjellë çregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore ose shkaqet e veçanta të renditura shprehimisht në ligj. Sipas nenit 69/2 LFRK: Shkaqet e shkurorëzimit janë mes tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.

Sikurse te shkurorëzimi me marrëveshje, edhe shkurorëzimi me padi, bëhet vetëm me vendim të gjykatës. Gjykata do ta marrë vendimin në lidhje me shkurorëzimin në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj (Aliu & Gashi, 2007: 165). Gjithashtu gjykata është kompetente, e njëherit edhe e detyruar që në çdo rast konkret të vërtetojë rrethanat që kanë ndikuar në keqësimin e marrëdhënieve midis bashkëshortëve, nëse një martesë është tronditur në një shkallë të tillë sa vazhdimi i saj është bërë i pamundur (Begeja, 1985: 269).

Në qoftë se gjatë procedurës së shkurorëzimit vërtetohet se qëllimi i martesës ka humbur, kjo sjell vendim për shkurorëzim⁷⁹. Gjykata e ka zgjidhur martesën e ndërgjyqësve, duke gjetur se martesa në mes ndërgjyqësve e ka humbur qëllimin e ekzistimit të saj. Sipas saj:

(...) mjafton vetëm të dëgjohet njëra palë ndërgjyqëse. Vetë fakti se e paditura në mënyrë të qartë ka sqaruar raportet e çrregulluara martesore në aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Komunale në Prishtinë, është e mjaftueshme për këtë gjykatë, për të përfunduar se raportet e bashkëshortëve janë çrregulluar seriozisht dhe kanë marrë karakter të përhershëm (...).

Gjithashtu ka raste kur padia për shkurorëzim nuk mund të parashtrohet para se të kalojë afati i përcaktuar me ligj. Neni 70/1 LFRK parashikon se: *padia për shkurorëzim*

⁷⁹ Shih aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren C. nr. 125/2012 të 27 korrikut 2012.

nuk mund të parashtrohet nga asnjëri bashkëshort gjatë shtatzanisë së gruas dhe deri sa fëmija i përbashkët të ketë mbushur një vit. Ndalimi i parashtrimit të padisë bëhet me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijës së përbashkët. Për disa shkaqe, e drejta për padi për zgjidhjen e martesës, nuk është e lidhur me afat, ngase ajo fitohet me lindjen e shkakut (Podvorica, 2006: 124). Në praktikë këto janë raste më të shumta sesa ato të lidhura me afat. Si të tilla konsiderohen shkelja e besnikërisë bashkëshortore, atentati kundër jetës së bashkëshortit, lënia qëllimkeqe dhe pa arsye e bashkëshortit, etj.

Padia mund të paraqitet me lindjen e shkakut, ndërsa e drejta për ngritjen e padisë nuk mund të parashkruhet me kalimin e një intervali kohor. Ndërkaq neni 68/3 i po këtij ligji thekson se:

e drejta për ngritjen e padisë për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë.

Ndërsa paragrafi 4 parashikon se:

nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundim e seancës kryesore gjyqësore deklaron se shprehimisht nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesë padisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozim për shkurorëzim me marrëveshje.

Pra, edhe pse procedura është inicuar nga ana e njërit bashkëshort me padi, do të konsiderohet se zgjidhja e martesës është bërë me marrëveshje të të dy bashkëshortëve dhe procedura e shkurorëzimit do të zhvillohet sikurse të ishte inicuar me marrëveshje të të dy bashkëshortëve.

Nga analiza e rasteve të praktikës gjyqësore në Kosovë, rezulton se faktorët kryesorë që shkaktojnë çrregullime në jetën bashkëshortore, dhe që paraqiten si shkaqe më të shpeshta për zgjidhjen e martesës, janë: pozita favorizuese e burrit në familje në proceset e vendimmarjes, epërsia e burrit në menaxhimin e buxhetit familjar, primati i burrit dhe

familjes së tij në rregullimin e jetës së përditshme të anëtarëve të tjerë të familjes, mungesa e të drejtës së gruas në planifikimin familjar, ndërhyrja arbitrare e anëtarëve të familjes së burrit në jetën e çifteve, qoftë atyre që jetojnë në bashkësi familjare apo edhe të atyre që jetojnë ndaras nga bashkësia familjare, ndërhyrja e anëtarëve të familjes së burrit në edukimin e fëmijëve, konsiderimi i gruas dhe të fëmijëve si pronë private e burrit-pronë kjo me të cilën ka "të drejtë" të bëjë çka të dojë, pamundësia e komunikimit të ndërsjellë, gjendja psikofizike jostabël e bashkëshortit/es, papjekuria e çifteve për jetë martesore, mungesa e dëshirës për bashkëjetesë, sindromi postraumatik si pasojë e luftës, mungesa e dëshirës për të pasur marrëdhënie seksuale, tradhëtia ndërbashkëshortore, etj.

Në fakt, do të ishte e palogjikshme që ligjvënësi me përcaktimin e shkaqeve për shkurorezim të përcaktonte të gjithë rrethanat e mundshme të cilat si pasojë sjellin tronditjen e marrëdhënieve martesore midis bashkëshortëve, por një gjë e tillë është përgjithësuar me nenin 69 paragrafi 1 të LFRK, ku thuhet: *"Bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorezim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme"*. Nga praktika gjyqësore vërejmë se bashkëshortët paraqesin kërkesë padi për shkurorezim duke u bazuar në dispozitën ligjore të sipërpërmendur, ndërsa detyrë e gjykatës është që pa marrë parasysh arsyen, (dhe aq më tepër fajin e njërit bashkëshort), që ka sjellë deri te tronditja e marrëdhënieve martesore, të konstatojë nëse ky çrregullim është serioz dhe nëse është një veprim (apo mosveprim) i vazhdueshëm nga ana e njërit apo të dy bashkëshortëve⁸⁰.

⁸⁰ Shih vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës me numër 384/12, ku shkaku relevant që ka sjellë tronditjen e marrëdhënieve martesore ka qenë xhelozia nga ana e të paditurit. Pas punësimit të paditëses në vitin 2010, i padituri filloi të kufizojë bashkëshorten e tij në shumë aspekte, të mbikëqyrë çdo sjellje të saj, të

Një nga arsytet që ndeshet shpesh në praktikën gjyqësore të Kosovës, por edhe në atë të Shqipërisë dhe Maqedonisë, është *largimi i njërit bashkëshort jashtë shtetit*. Emigracioni ndër shekuj ka qenë një dukuri e njohur për shqiptarët e që njëherit ka ndikuar edhe në zhvillimin normal të marrëdhënieve familjare, si në raportin midis bashkëshortëve ashtu edhe në raportin prind-fëmijë⁸¹. Në kohët e sotme, duke u ndikuar mjaft edhe nga emancipimi i femrave, (të cilat janë më të pavarura ekonomikisht dhe nuk janë më të detyruara të durojnë një martesë që nuk funksionon më), kjo dukuri ka rritur edhe numrin e shkurorëzimeve.

Kjo vërtetohet nga praktika gjyqësore, ku si shkak që përmendet në kërkesë padi është *tronditja e marrëdhënieve martesore* për shkak të largimit të bashkëshortit nga bashkësia familjare⁸². Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe pas shqyrtimit të provave e pranoi tërësisht kërkesë padinë e paditëses duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 1 pasi që: *shkaku i paraqitur nga ana e paditëses për zgjidhje të martesës paraqet një veprim të vazhdueshëm të të paditurit i cili seriozisht ka tronditur marrëdhëniet martesore*. Në këtë rast, edhe pse shkaqet e largimit nga bashkësia martesore ishin të arsyeshme, ato sërish kishin ndikuar në tronditjen e marrëdhënieve martesore e njëherit familjare. Nga ana tjetër, *largimi i*

përgjojë telefonatat e saj, madje duke e ndaluar atë që të vizitojë të afërmit dhe shoqërinë e saj. Me këtë rast gjykata nuk përcakton fajësinë e bashkëshortëve, gjegjësisht nëse xhelozia e të paditurit ishte e arsyeshme apo jo, por me vetë faktin se veprimet e tilla ishin të vazhdueshme dhe kishte tronditur seriozisht martesën e tyre.

⁸¹ Në fakt, nga vetë natyra e marrëdhënies martesore, rrjedh edhe përkufizimi ligjor i saj si: *bashkësi midis një burri dhe një gruaje me qëllim të jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes* Neni 14/1 i LFRK.

⁸² Shih vendimin 186/13 të Gjykatës së Qarkut Prishtinë. Shkaku i tronditjeve në mënyrë të vazhdueshme të marrëdhënieve të tyre martesore ka qenë punësimi i bashkëshortit jashtë shtetit, gjegjësisht në Gjermani.

*bashkëshortit nga banesa familjare pa shkak të arsyeshëm, përbën shkak më vete për të kërkuar zgjidhjen e martesës*⁸³.

Një rast tjetër interesant, nga pikëpamja e arsyeve për zgjidhjen e martesës, është ai i paditësit i cili kërkon zgjidhjen e martesës me të paditurën *për arsye të humbjes së besimit*⁸⁴. Kjo ka ardhur si pasojë e një krimi që e paditura ka kryer dhe nuk ka pranuar t'ia tregojë bashkëshortit të saj⁸⁵.

Shkak për shkurorëzimin e martesës i ndeshur në praktikë është edhe *shkelja e besnikërisë bashkëshortore*⁸⁶. Duke qenë se gjykata nuk e përcakton fajin dhe në aktvendimin për shkurorëzim ajo nuk shprehet lidhur me të, faji i bashkëshortit që ka sjellë deri te prishja e marrëdhënieve bashkëshortore nuk paraqet pengesë për sa i përket ndarjes së pasurisë së përbashkët martesore apo mbajtjes së bashkëshortit i cili është i papunë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme materiale për jetesë. Shpeshherë në praktikën gjyqësore ndeshen edhe raste të *zgjidhjes së martesës në bazë të kërkesë padisë të njërit bashkëshort, por që shkurorëzimi i tillë konsiderohet si shkurorëzim me marrëveshje*, në bazë të nenit 68 paragrafi 3 i LFRK⁸⁷.

⁸³ Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi nr. 214/13. Në vitin 2012, për shkaqe të panjohura, e paditura është larguar nga bashkësia martesore në drejtim të panjohur dhe që atëherë nuk është kthyer më. Për këtë arsye paditësi kërkon nga gjykata zgjidhjen e martesës duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 2 pika 5 dhe 7 të LFRK, për shkak se: *martesa ka pushuar së ekzistuari për shkaqe të paarsyeshme prej më shumë se një viti*.

⁸⁴ Gjykata e Qarkut Prishtinë, Vendimi nr. 169, datë 26.10.2011.

⁸⁵ Gjykata vërtetoi se marrëdhëniet midis bashkëshortëve janë prishur në mënyrë të pakthyeshme pas krimit të kryer nga A.R. në gusht të vitit 2010 dhe se vepra penale për të cilin e paditura është dënuar është vrasje e rëndë. Që nga ky moment e paditura vuan dënimin dhe gjatë kësaj kohe marrëdhëniet midis palëve janë përqesuar sepse bashkëjetesa e tyre është bërë e pamundur. Gjykata ka vlerësuar se martesa ka një tronditje serioze dhe të pakthyeshme dhe nuk mund të rivendoset bashkëjetesa midis tyre. Kështu duke u bazuar në nenin 69 të LFRK, gjykata vendos që martesa midis palëve të zgjidhet dhe fëmijët t'i lihen për rritje dhe edukim babait të tyre M.R.

⁸⁶ Gjykata e Qarkut Prishtinë, Vendimi nr. 140, datë 26.10.2011.

⁸⁷ Shih vendimet: 90/13 të Gjykatës së Qarkut Prishtinë; nr. 37, datë 05.10.2012, të Gjykatës së Qarkut Prishtinë; nr. 51 datë 12.04.2012 të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, ku sipas nenit 68, paragrafi 4 të LFRK:

III.7. Zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort në Maqedoni

Në Republikën e Maqedonisë si mjet juridik për fillimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) së përbashkët të bashkëshortëve është edhe kërkesa e njërit bashkëshort, pra me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort. Në pajtueshmëri me nenin 237 të LFRM, *pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, para dorëzimit të padisë të paditurit mbahet seanca për pajtim të bashkëshortëve*. Seanca e pajtimit nuk do të mbahet nëse njëri nga bashkëshortët është i paaftë për t'u gjykuar; nëse njëri nga bashkëshortët nuk jeton në Maqedoni; nëse nuk i dihet vendbanimi për më shumë se 6 muaj; dhe nëse tentativa për pajtim pas paraqitjes së padisë ka qënë e pasuksesshme. Padia për shkurorëzim nga njëri bashkëshort mund të iniciohet për shkak të prishjes së marrëdhënieve deri në atë masë që bashkëjetesa është bërë e padurueshme edhe pse bashkësia martesore faktikisht është ndërprerë së ekzistuari më gjatë se një vit. Ajo me ndonjë afat të caktuar, as që është kufizuar me kushte të caktuara dhe nuk ka vjetërsim⁸⁸.

Shkaqet apo mënyrat për të shkurorëzuar një martesë, në LFRM kategorizohen në tre grupe: a) pëlqimi i përbashkët i bashkëshortëve për ndarjen e tyre (neni 39/1), b) nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë përkeqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme (neni 40), dhe c) nëse marrëdhëniet martesore në mënyrë faktike kanë pushuar të funksionojnë më gjatë se një vit (neni 41).

Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.

⁸⁸ Me Ligjin Për procedura të veçanta procedurale në kontestet martesore, kjo është përcaktuar në nenin 7 të të njëjtit ligj, sipas të cilit *e drejta e padisë në kontestin e shkurorëzimit nuk vjetërsohet dhe nuk kufizohet me kushte edhe afate tjera në rastë se në këtë ligj nuk është ndryshe e përcaktuar.*

Procedura e shkurorëzimit paraqet procedurë të veçantë kontestimore në kontestet martesore të cilët paraqesin lloj specifik të kontesteve familjare. Ligji i Procedurës kontestimore të Republikës së Maqedonisë nuk përmbahen rregulla të veçanta të procedurës në kontestet familjare, por këto konteste janë të rregulluara me LFRM⁸⁹. Procedura e shkurorëzimit bën pjesë në grupin e procedurave në kontestet martesore, në mesin e të cilëve bën pjesë edhe procedura e prishjes së martesës dhe procedura e vërtetimit të ekzistimit apo mos ekzistimit të martesës, e cila nuk është e regulluar si procedurë e veçantë kontestimore dhe për të njëjtën vlejné rregullat e procedurës së përgjithshme kontestimore (Mladenovic, 1990: 115).

LFRM nuk përkufizon atë çka paraqesin kontestet martesore. Sipas autorit Branko Çalija *“kontestet martesore janë vetëm ato të cilët dalin si rrjedhojë nga martesa si raport statusoro-juridik”*. Ndërkaq, sipas Borivoj Pozniq:

kontesti martesorë ka të bëjë me statusin martesor, ndërsa inicohet me padi për shkurorëzim, padi për prishje të martesës apo padi për vërtetim se a ekziston apo nuk ekziston martesa” (Poznic, 2012: 376).

Po ashtu, edhe autori Georgievski thekson se:

“konteste martesore janë kontesti për shkurorëzim dhe kontesti për prishje të martesës, ndërsa në mes tyre sipas Ligjit mbi familje nuk numërohen kontestet për vërtetimit të ekzistimit apo të mos ekzistimit të martesës” (Georgievski, 2000: 414).

Për ne më i plotë duket definicioni që japin autorët Janevski dhe Kamillovska sipas të cilëve:

kontestet martesore janë konteste që kanë të bëjnë me statusin martesor, ato janë konteste me të cilin kërkohet të ndryshohet statusi aktual martesor i bashkëshortëve me shkurorëzim apo me prishje të martesës, apo në të cilët kërkohet të vërtetohet ekzistenca apo mos ekzistenca e martesës.

⁸⁹ Ligji Mbi procedurën kontestimore i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare, nr. 79/05, i datës 21.09.2005.

Kontestet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet pronësore-juridike të bashkëshortëve nuk kanë karakter të kontesteve martesore. Këto konteste zgjidhen sipas rregullave të procedurës së përgjithshme kontestimore dhe nuk mund të ngjiten me kontestet martesore, përveç kontesteve për mirëmbajtje dhe alimentacion (Janevski & Kamiloska, 2009: 505).

Në procedurën e shkurorëzimit si palë mund të paraqiten vetëm bashkëshortët. Në këtë procedurë legjitimimi procedural për mbajtjen e kontestit u njihet vetëm bashkëshortëve. Kjo e drejtë e tyre për të ngritur padi për shkurorëzim është e drejtë e rreptë personale e cila u takon vetëm bashkëshortëve dhe nuk mund të bartet tek trashëgimtarët e tyre. Në rast të sukcesionit universal⁹⁰, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur i cili e ka ngritur padinë mund të kërkojnë vërtetim se padia për shkurorëzim ka qenë e bazuar dhe e njëjta vlen edhe kur procedura është iniciuar pas propozimit për shkurorëzim me marrëveshje (neni 230 LFRM).

Bashkëshorti i cili e inicion padinë dhe e dërgon të njëjtën deri në gjykatë e ngre atë në cilësinë e paditësit, kundër bashkëshorti tjetër, i cili merr pjesë në proces në cilësinë e të paditurit. Kur bashkëshortët arrijnë pëlqim të ndërsjellë për ta zgjidhur martesën e tyre, me parashtrim të propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, marrin cilësinë e propozuesve. Procedura në kontestet martesore iniciohet me padi, kur kërkesa paraqitet veëm nga njëri bashkëshort, dhe kur bashkëshortët kërkojnë të shkurorëzohen me marrëveshje dy palëshe, me propozim marrëveshje për shkurorëzim (neni 229 LFRM). Padinë për shkurorëzim mund ta definojmë si veprim kontestimor që paraqet shprehjen e vullnetit të njërit nga bashkëshortët dhe paraqet akt iniciues për nisje të procedurës me të cilën kërkohet nga

⁹⁰ Ligji Mbi procedurën kontestimore i Republikës së Maqedonisë, neni 203/1.

gjykata të sjellë vendim me të cilën zgjidhet martesë. Në pajtueshmëri me neni 237 të LFRM, *para dorëzimit të padisë të paditurit mbahet seancë për pajtim të bashkëshortëve.*

Seancë për pajtim të bashkëshortëve nuk do mbahet në këto raste (Spirovic, 2013: 120):

1. nëse njëri nga bashkëshortët është i paaftë për të gjykuar;
2. nëse njëri ose të dy bashkëshortët jetojnë në botën e jashtme;
3. nëse është i panjohur vendbanimi i njërit bashkëshort më tepër se gjashtë muaj;
4. nëse pas parashtrimit të kundërpadisë për shkurorëzim, pa marrë parasysh kur është parashtruar, tentimi për pajtim të bashkëshortëve ka qenë i pasuksesshëm.

Sipas nenit 237 LFRM:

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, tentativa për pajtim të bashkëshortëve realizohet nga Qendra për Punë Sociale

Gjykata në afat prej 8 (tetë) ditësh njofton me shkrim Qendrën për Punë Sociale lidhur me të dhënat se kur është iniciuar procedura e shkurorëzimit, arsyet kryesore pse kërkohet shkurorëzimi dhe të dhënat për fëmijët. Qendra për Punë Sociale është e obliguar që në afat prej 3 (tre) muajve nga pranimi i njoftimit me shkrim ta përfundojë seancën për pajtim të bashkëshortëve.

Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, procedurën për pajtimin e bashkëshortëve e zhvillon gjykata, por vetëm nëse nuk vlerësohet se është më mirë që procedura për pajtim të zhvillohet nga Qendra për Punë Sociale (Neni 123 i8 LFRM).

Padia për shkurorëzim ka *karakter konstitutiv dhe juridiko-ndryshues* pasi me vendim gjykate kërkohet të bëhen ndryshime në marrëdhënien juridike aktuale, kështu që marrëdhënia martesore që ka qenë deri atëherë me plotfuqishmërinë e vendimit të vetë të ndërpritet së ekzistuari (Gagacef, 1994: 241). Padia është shprehje e kërkesës juridiko-garantuese e paditësit të autorizuar me të cilën ai kërkon nga gjykata që t'i jepet mbrojtje

ligjore me të cilën do të sjellë aktgjykim që do ta zgjidhë martesën si përgjigje meritore nga kërkesa e parashtruar.

Në Republikën e Maqedonisë, ashtu siç u evidentua në këtë punim, ka një shtim të martesave fiktive të cilat i lejojnë bashkëshortët të cilët kanë emigruar të lidhin një martesë të re kryesisht për t'u pajisur me dokumentat e nënshtetësisë të një prej vendeve të BE-së. Nga rastet e praktikës gjyqësore të analizuara në këtë punim, si shkaqe për çrregullimin e marrëdhënieve martesore evidentohen: mosmarrëveshjet e vazhdueshme ndërmjet bashkëshortëve; dallimi i madh në moshë midis burrit dhe gruas; mosmarrëveshjet e njërit nga bashkëshortët me familjarët e bashkëshortit tjetër; dallimi në përkatësinë fetare midis partnerëve; dyshimet e vazhdueshme të xhelozisë; ofendimet e rënda të drejtuara ndaj njëri tjetrit; zënka të shpeshta dhe sulme fizike midis partnerëve; përdorimi i alkoolit nga njëri bashkëshort; impotencia, në menyrë specifike, ftohja e plotë e marrëdhënieve bashkëshortore; mungesa e aftësisë së gruas për të lindur fëmijë; të jetuarit vetëm nga ana e njërit bashkëshort, si dhe shkaqe të tjera. Megjithatë, bashkëshortët janë ata të cilët do të vendosin se cilin nga shkaqet do ta marrin si bazë për shkurorëzimin e tyre (Bakievska, 2007: 33-34).

Çdo rast i shkurorëzimin është i ndryshëm nga tjetri, duke u bazuar në problemet dhe karakterin e ndryshëm të personave, si dhe qasjen dhe mënyrën e të jetuarit në një bashkësi martesore. Mirëpo, të gjitha arsyet që përbëjnë shkaqe për ndarjen e një martese duhet të sjellin për pasojë *jetën e padurueshme* të përbashkët. Këtë shkak e parasheh edhe LFRM, sipas të cilit:

martesa mund të zgjidhet me kërkesë të njërit bashkëshort nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë përkeqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme (neni 40).

Sa i përket mos funksionimit të martesës faktikisht, merren parasysh ato veprime të cilët vështirësojnë komunikimin dhe përmbushjen e detyrimeve familjare në mënyrë të përbashkët. Ndarja në aspektin hapësinor e bashkëshortëve me qëllim të nevojës për shkollim të mëtejshëm, specializim në profesionin e ndonjërit nga ta, nuk mund të merret si shkak për zgjidhje të martesës, pasi në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me ndarje faktike të bashkëshortëve për një periudhë të caktuar, e jo edhe prishje të marrëdhënieve midis tyre (Bakievska, 2007: 44).

Duke marrë në analizë disa vendime të Republikës së Maqedonisë, synohet të evidentohen problemet e ndeshura në praktikën gjyqësore të RM-së përsa i përket shkaqeve të zgjidhjes së martesës. Në një nga rastet e marra në konsideratë, parashtrohet çështja e zgjidhjes së martesës sipas nenit 39 të LFRM⁹¹. Paditësi kërkon zgjidhjen e martesës me S.Gj. *për arsye se kjo martesë nuk është konsumuar*. Pas lidhjes së martesës bashkëshortët kanë jetuar jashtë shtetit, e martesë nuk ka funksionuar. Në vendim thuhet shprehimisht se: “Edhe pse palët kanë lidhur kurorë ligjore, ato asnjëherë nuk kanë formuar bashkësi martesore për shkak se secili nga ata në atë kohë ka qenë në punë jashtë vendit, ku gjenden edhe sot. *Palët nuk kanë fëmijë dhe as nuk presin të kenë*. Duke qenë se bashkësia martesore nuk ka funksionuar, palët pajtohen që të shkurorëzohen”⁹².

⁹¹ Gjykata Themelore Kërçovë, Vendimi nr. 106, i datës 08.11.2012

⁹² Gjykata merr në konsideratë faktin që nga provat e nxjerra palët pranojnë që të kryhet zgjidhja e martesës dhe se ky vendim është marrë lirisht dhe pa dyshime. Duke pasur parasysh se bashkësia martesore e palëve nuk ka funksionuar, gjykata konkludon se janë plotësuar kushtet e parapara në dispozitën e paraqitur ligjore për zgjidhjen e martesës.

Në një tjetër vendim, paditësja kërkon zgjidhjen e martesës sipas nenit 41 të LFRM, pra për ndërprerje të jetës së përbashkët për një periudhë më shumë se një vjeçare⁹³. Duke vërtetuar se i padituri e ka braktisur bashkësinë martesore për më shumë se një vit, gjykata vërteton në këtë mënyrë përmbushjen e kushteve të nenit 41 të LFRM. Pra, konstatohet se për një periudhë prej më shumë se një vjeçare ka prishje të bashkësisë martesore për shkak të mosfunksionimit të saj.

Zgjidhja e martesës vjen edhe si rezultat i *martesave fiktive* dhe formale që bashkëshortët lidhin për shkak presioneve që u bëhet atyre nga familjaret apo rrethanat tjera në të cilat jetojnë. Në çështjen *O'Donoghue dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj ka trajtuar të drejtën për martesë kundrejt avantazheve që krijohen ndaj emigrantëve çka mund ta vendosë martesën në një lidhje fiktive, sa për sy e faqe⁹⁴.

Zgjidhja e martesave të tilla në procedurë gjyqësore bazohet në një nga shkaqet e shkurorëzimit siç është shkelja e besnikërisë martesore, por që në realitet për martesë të tilla mund të ishte kërkuar shpallja e pavlefshmërisë së tyre⁹⁵. Në aktvendimin për zgjidhje të martesës së Gjykatës themelore të Gostivarit, ndarja vjen si pasojë e lidhjes jashtë martesore që paditësja-ish bashkëshortja ka pasur që më parë me personin N.N., mirëpo

⁹³ Gjykata Themelore e Gostivarit, Vendimi nr. 90, i datës 27.09.2012. Pasi kanë qëndruar të martuar për një periudhë kohe disa vjeçare dhe kanë pasur një fëmijë, për të cilin paditësja pretendon të drejtën e rritjes dhe të edukimit, ata kanë ndërprerë bashkëjetesën prej një viti. Për këtë arsye Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet që të vihet në zbatim neni 41 i LFRM, ku parashikohet se njëri nga bashkëshortët mund të kërkojë shkurorëzim nëse lidhja martesore është shpëputur për një periudhë më shumë se një vit. Në këtë rast, gjykata konstaton faktikisht se bashkëshortët nuk jetojnë më së bashku, dhe vërteton me një akt psikologjik se paditësja është e aftë për marrëdhënie personale dhe të drejtpërdrejta me fëmijën.

⁹⁴ Çështja *O'DONOGHUE dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 14 dhjetor 2010, aplikimi 34848/07.

⁹⁵ Gjykata Themelore e Gostivarit, vendimi nr. P1.34/13 dhe Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi nr. 54/14, tregon se martesë midis bashkëshortëve do të shkurorëzohet si pasojë e shkeljes së besnikërisë bashkëshortore.

për shkak të presioneve nga familja e saj ka lidhur kurorë me të paditurin A.I. të cilën martesë nuk ka mundur ta kundërshtojë që në fillim. Me kalimin e kohës pasi personi N.N. ka vendosur ti ofrojë martesë dhe kanë siguruar kushtet për të jetuar së bashku, ajo vendos që të kundërshtojë familjen e saj e njëherit edhe martesën me të paditurin, kështu ka kërkuar zgjidhjen e saj. Ndërkaq martesë midis palëve gjyqësore kurrë nuk është konsumuar si e tillë, prandaj edhe pse ligjërisht si shkak për zgjidhjen e kësaj martese mund të parashtrohet shkelja e besnikërisë bashkëshortore, kjo martesë mund të ishte kërkuar të shpallej e pavlefshme. Raste të martesave të lidhura pa pëlqimin e lirë, të cilat kërkohen të zgjidhen (në vend që të shpallen të pavlefshme), konstatohen edhe në jurisprudencën shqiptare. Në këto raste, me të drejtë doktrina argumenton se, nëse është provuar mungesa e pëlqimit të lirë nga gjykata, ajo mund të mos pranojë padinë për zgjidhjen e martesës sepse shkak nuk ka të bëjë me marrëdhënien martesore por me lidhjen e martesës (Mandro, 2014: 50)⁹⁶.

Pamundësia për të pasur fëmijë bën pjesë në shkaqet e veçanta që nuk janë të përmendura taksativisht në ligj si shkaqe për të cilat mund të kërkohet zgjedhja e martesës, por si të tilla janë të përfshira si një tërësi në nenin 40 ku përfshihet:

çdo rrethanë apo sjellje e bashkëshortëve nga të cilat linden grindjet e vazhdueshme dhe njëherit sjellin deri tronditja e lidhjeve martesore deri në atë masë sa që jetesa e tyre është bërë e pamundur.

⁹⁶ Shih vendimin nr.284/10.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Vlorës.

Ligjvënësi jo rastësisht ka hartuar një nen të tillë, ku si kriter thelbësor për të cilin mund të lejohet zgjidhja e martesës përmendet jeta e padurueshme në çift, pasi që shkaqet dhe motivet që sjellin deri në atë pikë ndryshojnë nga rasti në rast⁹⁷.

Në një vështrim të përgjithshëm shihet se në tërësi shkaqet e zgjidhjes së martesës në Republikën e Maqedonisë janë mospërputhja e karaktereve dhe grindjet e mosmarrëveshjet e vazhdueshme. Dhjetë vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë janë karakterizuar nga një shkallë e gjerë ndryshimesh të sistemit shoqëror, ekonomik dhe politik. Të gjitha këto procese kanë ndikimin e tyre në jetën e përditshme të familjes.

Sipas vendimit nr. 125/13 të Gjykatës Themelor të Gostivarit të sjellë në bazë të padisë së paditësit për shkurorëzim të martesës, baza ligjore e saj është neni 40 i LFRM, i cili parashikon se:

Martesa mund të zgjidhet me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve nëse marrëdhëniet martesore janë prishur deri në atë masë sa që jeta e përbashkët midis bashkëshortëve është bërë e padurueshme.

Gjykata duke marrë parasysh se bashkëshortët nga martesa e tyre kanë një fëmijë të përbashkët të mitur, parashtroi kërkesë te Qendra për Punë Sociale e Gostivarit për të realizuar procedurën për pajtim të bashkëshortëve. Nëse kjo procedurë nuk do të ketë sukses, Qendra për Punë Sociale duhet të japë mendim profesional në lidhje me përcaktimin e prindërit se kujt do t'i ndahet fëmija i mitur, për rritje, edukim dhe përkujdesje. Ndërkaq në Shqipëri procedura për pajtim të bashkëshortëve zhvillohet para

⁹⁷ Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi C.nr.164/15, i cili ka të bëjë pikërisht me zgjidhjen e martesës ku shkak për këtë është impotenca e bashkëshortit. Pas paraqitjes së padisë për shkurorëzim në Gjykatë nga ana e ish bashkëshortes H.M., në seancën e dëgjimit të palëve, paditësi, pra ish bashkëshorti e kundërshton një gjë të tillë. Kështu e paditura kërkon vërtetimin e gjendjes së tillë nga gjykata. Gjykata pas raportit të mjekut-gjegjësisht specialistit përkatës pasi vërteton një fenomen të tillë vendos të zgjidhë martesën e tillë duke vendosur në favor të paditëses edhe për mbështetjen materiale nga ana e paditësit duke analizuar rrethana dhe pamundësinë e të paditurës që të vetë financohet.

gjykatës, në bazë të nenit 134 i KRFSH i cili parashikon se: *Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seancë pajtimi, në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët. Gjyqtari mund t'i dëgjojë ata veçmas secilin dhe më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre. Kur arrihet pajtimi, mbahet procesverbal dhe gjykimi pushohet për këtë shkak.*

Komisioni i formuar nga Qendra për punë sociale Gostivar, për zhvillimin e procedurës për pajtim midis palëve konstatoi e njëherit njoftoi gjyqin se procedura për pajtim nuk ka qenë e mundur të zhvillohet pasi që e paditura është jashtë shtetit e njëherit nuk ka mundur të japë propozim-mendim për ndarjen e fëmijut të mitur⁹⁸. Duke u bazuar në nenin 40 të LFRM, si dhe duke pasur parasysh prishjen e marrëdhënieve martesore midis bashkëshortëve si dhe ndërprerjen e jetës së tyre të përbashkët më shumë se një vit, vendosi që martesa midis palëve të zgjidhet. Pra, në rastin e mësipërm, gjykata vendos për zgjidhjen e martesës për shkak të prishjes të marrëdhënieve martesore dhe ndërprerjes të jetës së përbashkët: nuk dallohet mes dy mënyrave të veçanta të zgjidhjes së martesës, të parashikuara shprehimisht nga nenet 40 dhe 41 të LFRM.

Një tjetër rrethanë, që paraqitet shpesh para gjykatës si shkak për zgjidhje të martesës, është *mospërshtatja e karaktereve midis bashkëshortëve*, mentaliteti i ndryshëm i tyre

⁹⁸ Bashkëshortët kanë lidhur martesë në vitin 2006 nga e cila ka lindur fëmija E.M. Sipas deklaratës së paditësit marrëdhëniet martesore janë tronditur për shkak shkeljes së besnikërisë bashkëshortore nga ana e të paditurës, gjë që ka sjellë në prishjen e harmonisë martesore, zënkave të vazhdueshme si pasojë e të cilës jetën e tyre bashkëshortore e ka bërë të pamundur që të vazhdojë. Palët për më shumë se një vit *de facto janë ndarë* pasi që e paditura me fëmijën e tyre të mitur ka ikur në drejtim të panjohur. Sipas të dhënave të stacionit policor Gostivar gjykata është njoftuar se e paditura ndodhet në adresë të panjohur në Republikën e Gjermanisë.

lidhur me jetën, traditat dhe mënyrën e të jetuarit⁹⁹. Në këtë rast u vërtetua se bashkësia martesore midis bashkëshortëve faktikisht është ndërprerë më shumë se një vit. Prandaj duke u bazuar në nenin 41 të LFRM i cili thotë: "Njëri nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës nëse bashkësia martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari më shumë se një vit", gjykata pranoi kërkesë padinë si të bazuar dhe vendosi që kjo martesë të zgjidhet.

Ndikim të madh në ndryshimin e karaktereve midis të rinjve kanë mënyra e jetesës së bashkëshortëve para martesës në familjet nga ato e kanë prejardhjen; rrethi me të cilin shoqërohen; vendi apo lokaliteti ku ata janë rritur; mosha e tyre gjatë momentit të lidhjes së martesës që nënkupton marrjen e një vendimi të tillë nga ana e bashkëshortëve pa menduar mirë pasojat e një martese të tillë dhe pa analizuar mirë kushtet dhe rrethanat në të cilat jeton bashkëshorti tjetër. Ky vendim i marrë nga ana e bashkëshortëve shprehimisht mund të quhet pakujdesi e tyre dhe papërgjegjësi lidhur me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga martesa, e që njëherit sjellin edhe pasoja të rënda me rastin e mospërshtatjes së tyre. Janë të shumta rastet kur zgjidhja e martesës për shkak të mentaliteteve të ndryshme,

⁹⁹ Gjykata Themelore e Gostivarit, vendimi nr. 182/13 i datës 15.06.2013. Gjatë seancës kryesore gjykata mori në pyetje paditësin në cilësi të palës, i cili pohoi se marrëdhëniet martesore midis tyre janë përkeqësuar aq shumë saqë jetesa e tyre e përbashkët është bërë e pamundur. Ai sqaroi se me të paditurën kanë lidhur martesë në Hollandë nga edhe e kishte prejardhjen e paditura. Në fillim të martesës së tyre kanë pasur harmoni në jetën bashkëshortore. Bashkëshortët kanë vendosur që të jetojnë në Holandë, ku edhe lindën tre fëmijë nga martesa e tyre e përbashkët. Njëherit e paditura ka pasur një fëmijë jashtëmartesor me person tjetër, i cili ka jetuar me të. Pas 10 vite martesë, palët kanë vendosur që të kthehen në vendlindjen e paditësit, gjegjësisht në një fshat në rrethinën e Tetovës. Me ardhjen e bashkëshortëve në Maqedoni filluan mospajtimet lidhur me mënyrën e jetesës siç janë kushtet, traditat dhe mentaliteti për jetën bashkëshortore. Kjo ka qenë dhe shkak i grindjeve të tyre të vazhdueshme që kanë sjellë deri te tronditja e marrëdhënieve martesore midis bashkëshortëve, me çka pas 7 vite jetese në Republikën e Maqedonisë e paditura ka lëshuar bashkësinë martesore bashkë me fëmijët e tyre të përbashkët dhe fëmijën e saj jashtëmartesor dhe është larguar në adresë të panjohur në vendlindjen e saj, që atëherë gati se një vit paditësi nuk mund të gjejë mënyrë për të kontaktuar me të paditurën që të arrihet një marrëveshje për shkurorëzim.

kërkohej pasi që bashkëshortëve t'u kanë lindur fëmijë të përbashkët. Me këtë rast, pasojat e një shkurorëzimi të tillë nuk prekin vetëm bashkëshortët si individ, por edhe fëmijët e tyre që fatkeqësisht vuajnë pasojat më të rënda të cilat padyshim ndikojnë edhe në edukimin dhe mirëqenien e tyre.

III.8. Fajësia në zgjidhjen e martesës në vështrim krahasimor

Sa i përket përcaktimit të fajësisë të bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit, te kjo mënyrë e zgjidhjes së martesës, edhe sipas LFRM dhe nga praktika gjyqësore në Republikën e Maqedonisë, kuptojmë se gjykata nuk është e obliguar të vërtetojë se me fajin e cilit bashkëshort ka ardhur deri te prishja e marrëdhënieve martesore, apo se cilat janë shkaqet dhe arsyet që kanë sjellë deri te kjo gjendje. Në këtë rast, gjykata ka për detyrë të vërtetojë vetëm vullnetin e lirë dhe real të të dy bashkëshortëve për zgjidhje të martesës, duke mos u ndalur në procedurë të provave për të vërtetuar fajësinë e ndonjërit nga bashkëshortët .

Edhe pse në parim, gjykatat gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës nuk duhet të analizojnë arsyet në përcaktimin e fajësisë së bashkëshortëve, megjithatë dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje të shteteve në fjalë parashikojnë mundësinë që bashkëshorti i interesuar të kërkojë përcaktimin e bashkëshortit fajtor për zgjidhjen e martesës (neni 133 KFRSH). Përcaktimi i fajit në rastin e zgjidhjes së martesës paraqet hetimin gjyqësor dhe përcaktimin e bashkëshortit të cilit i ngarkohet shkaku i tronditjes së marrëdhënieve bashkëshortore në vendimin me të cilin zgjidhet martesa. Faji mund të kërkohej vetëm në rastin e zgjidhjes së martesës me kërkesë të njërit bashkëshort dhe në rastin e ndërprerjes

së jetës së përbashkët. Faji për zgjidhjen e martesës mund t'i ngarkohet njërit apo të dy bashkëshortëve dhe nuk ka asnjë rëndësi shkalla e fajit që ka secili prej bashkëshortëve. Martesa do të zgjidhet me faj të të dy bashkëshortëve, pavarësisht se nëse njëri nga bashkëshortët ka shkelur me qëllim detyrimet bashkëshortore apo të njëjtat i ka kryer nga pakujdesia (Omari, 2010: 211)¹⁰⁰.

Në doktrinë është e diskutueshme çështja nëse përcaktimi i fajit mund të kërkohej me padi të veçantë edhe pas zgjidhjes së martesës. Sipas një rryme doktrinare një gjë e tillë është e mundur pasi faji është element i pavarur i cili mund të vlerësohet edhe pasi të zgjidhet martesa (Bonilini, 2002: 195). I debatueshëm është gjithashtu edhe fakti nëse zgjidhjen e martesës mund ta kërkojë bashkëshorti i cili është shkaktar i tronditjes së marrëdhënieve martesore. Sipas një rryme doktrinare (Omari, 2010: 212), kjo është e mundur pasi zgjidhja e martesës nuk paraqet sanksion juridik, faji i bashkëshortëve nuk parashikohet si kusht ligjor i nevojshëm për të lejuar zgjidhjen e martesës. Prandaj martesa do të zgjidhet edhe në rastin kur një gjë e tillë e kërkon bashkëshorti i cili është fajtor për tronditjen e marrëdhënieve martesore.

Përcaktimi i fajit gjatë zgjidhjes së martesës nuk shkakton asnjë pasojë juridike në drejtim të bashkëshortit fajtor, pra nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet ndërmjet ish bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës dhe marrëdhënieve prind-fëmijë. Nga ana tjetër nëse veprimet e fajshme të njërit bashkëshort me të cilët ka ndikuar në tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore përmbushin elemente të veprës penale, ndaj tij do të vihet

¹⁰⁰ Përcaktimi i fajësisë mund të kërkohej me rastin e zgjidhjes së martesës gjatë procedurës që do të zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë, ndërkaq përjashtohet mundësia që përcaktimi i fajit të kërkohej në gjykimin në shkallë të dytë, nëse gjatë procedurës në shkallë të parë ka munguar një pretendim i tillë.

në lëvizje përgjegjësia penale. Gjithashtu nëse me veprimet e tij të kundërligjshme njëri bashkëshort i shkakton bashkëshortit tjetër dëm në personalitetin apo sendet e tij, ky i fundit mund të kërkojë dëmshpërblim (Omari, 2010: 212)¹⁰¹.

Ndryshe nga marrëdhëniet juridike pasurore, marrëdhënia martesore është marrëdhënie jo pasurore pasi shkak i formimit të familjes bazohet në ndjenjën që i lidh bashkëshortët. Mungesa e kësaj ndjenje sjell humbjen e qëllimit për të cilin është lidhur martesa. Mungesa e ndjenjave nuk ndodh as për arsye të qëllimshme e as nga pakujdesia. Kjo sjellje nuk mund të imponohet në mënyrë të detyrueshme.

Kemi konstatuar në të gjithë llojet e përgjegjësisë juridike se ka edhe veprime të paligjshme që kryhen pa faj. Kështu edhe me rastin e zgjidhjes së martesës vetëm nëse mund të flitet për qëndrim psikik ndaj ndjenjës për një kontroll të saj nga ana e subjektit, atëherë mund të flitet për elementin subjektiv, pra fajin e personit që ka shkelur detyrimet që rrjedhin nga martesa. Në praktikën gjyqësore të vendeve tjera ndeshim në tendencën e kufizimit të kriterëve të përcaktimit të fajit, ku shkelja e besnikërisë bashkëshortore, ndërprerja e jetës së përbashkët, mungesa e ndihmës morale, nuk konsiderohen *ipso facto* veprime të fajshme (Omari, 2010: 213). Këto konsiderohen sjellje të fajshme vetëm në qoftë se si pasojë shkaktojnë dëm në personalitetin e bashkëshortit tjetër. Nëse

¹⁰¹ Edhe kur kemi të bëjmë me përgjegjësi penale ose përgjegjësi civile jashtëkontraktore, faji i përcaktuar gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar përgjegjësinë penale apo civile të bashkëshortit fajtor. Faji i cili përcaktohet në rastin e zgjidhjes së martesës i referohet qëndrimit psikik të bashkëshortit ndaj mos përmbushjes së detyrimeve martesore. Për të përcaktuar përgjegjësinë civile jashtëkontraktore është e nevojshme edhe plotësimi i disa kushteve tjera, fakti i paligjshëm, dëmi i pësuar dhe lidhja shkakësore midis faktit të paligjshëm edhe dëmit. Nga ana tjetër edhe faji i përcaktuar në gjykimin e zgjidhjes së martesës nuk mund të shërbejë edhe për gjykimin e përgjegjësisë së dëmit jashtëkontraktor, e aq më tepër përgjegjësisë penale. Në rastin e përgjegjësisë penale jo çdo formë e fajësisë paraqet plotësimin e kushteve për ekzistim të veprës penale. Ndërsa kur kemi të bëjmë me përgjegjësi civile së pari duhet përcaktuar nëse shkak i zgjidhjes së martesës të cilit i referohet faji është i njëjtë me faktin e pa ligjshëm që ka shkakuar dëmin.

mospërbushja e këtyre detyrimeve i sjell si pasojë një dëm moral apo pasuror bashkëshortit tjetër, vetëm atëherë mund të flitet për veprime të fajshme të bashkëshortit që ka shkelur këto detyrime.

Në lidhje me *kërkimin e fajësisë* nga pala e interesuar gjatë procedurës për zgjidhjen e martesës, Gjykata e Lartë shqiptare përcakton se: *pretendimet mbi fajësinë duhet të ngrihen gjatë gjykimit në formën e kërkuar nga ligji (...) dhe se nëse këto pretendime nuk i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor, ato nuk mund të përbëjnë kërtime, për të cilat duhet të shprehet gjykata në vendimin përfundimtar*¹⁰².

¹⁰² Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë Shqiptare Vendimi nr. 91, më datë 02.03.2010.

KAPITULLI IV

PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS

IV.1. Parimet e procedurës së zgjidhjes së martesës (shkurorëzimit)

Procedura për zgjidhjen e martesës, në të tre vendet objekt anamlize, është rregulluar nëpërmjet Kodit të Familjes (ose Ligjit mbi Familjen) dhe ligjin mbi procedurën civile të shteteve në fjalë. Këto dispozita ligjore e rregullojnë zgjidhjen e martesës si një gjykim të posaçëm, ku parashikohen disa elementë që nuk ndeshen në gjykime të tjera civile. Para së gjithash, marrëdhëniet të cilat rregullohen në kontestet martesore janë të natyrës personale, prandaj dallojnë nga marrëdhëniet pronësore juridike, si për nga rëndësia ashtu edhe për nga natyra. Kjo është një specifikë e rëndësishme e kontesteve martesore. Martesa do të konsiderohet e zgjidhur, vetëm pasi që gjykata kompetente do të sjellë vendim për këtë, duke vlerësuar plotësimin e kushteve të parapara në të drejtën materiale.

Duhet thënë se procedura e shkurorëzimit i ka disa specifika, të cilat janë rrjedhojë e natyrës së marrëdhënieve familjare. Çështjet familjare janë mjaft të ndjeshme, posaçërisht në procedurën e shkurorëzimit sepse preken të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Prandaj ligjvënësi ka paraparë parimet që duhet respektuar gjatë zhvillimit të kësaj procedure, kompetencën e gjykatës¹⁰³, mbrojtjen e veçantë për personat pa përkujdesje, etj. Në mungesë të dispozitave të veçanta për

¹⁰³ Kështu për shembull, neni 30 paragrafi 2, pika 1, Ligji Mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.58/06, 35/08, 150/10), përcakton kompetencën lëndore të gjykatave themelore të cilat janë kompetente të gjykojnë për zgjidhjen e martesës.

procedurën e shkurorëzimit zbatohen dispozitat e procedurës civile në mënyrë sekondare.

Parimet e procedurës së zgjidhjes së martesës janë analizuar si më poshtë.

a) Parimi i barazisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Marrëdhëniet martesore janë rregulluar mbi parimin e barazisë së bashkëshortëve, si me rastin e lidhjes së martesës ashtu edhe gjatë ekzistencës dhe zgjidhjes së martesës. Bashkëshortët janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj (Aliu & Gashi, 2007: 166). Prandaj kjo e drejtë bashkëshortëve u garantohet edhe në procedurën për shkurorëzim. Kjo nënkupton faktin që gjatë procedurës së shkurorëzimit asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të jetë i privilegjuar, por që të dy duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykata gjatë gjithë procedurës së shkurorëzimit.

b) Parimi i mbrojtjes së veçantë

Në procedurën e shkurorëzimit, gjykata duke u bazuar në këtë parim, duhet të kujdeset për personat të cilët nuk janë në gjendje t'i mbrojnë të drejtat e tyre, si p.sh mbrojtjen e interesave të fëmijëve të mitur, të personave të sëmurë dhe të personave me të meta psikike, bashkëshortin e pa siguruar, etj. (Podvorica, 2006: 129)¹⁰⁴. Kështu, legjislacionet e marra në analizë parashikojnë se *bashkëshortët nuk do të parashatrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe deri sa fëmija i tyre i përbashkët t'i ketë*

¹⁰⁴ Po kështu, sipas nenit 68 paragrafi 1, Ligji Për mbrojtje sociale i Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.79/09, 3666/11, 51/11), “të drejtë për ndihmë financiare të personave të cilët deri në moshën 18 vjet kanë pasur status të fëmijut pa prindër apo pa përkujdesje prindërore, kanë personat që nuk kanë të ardhura dhe pronë nga e cila mund të vetë financohet, deri në moshën 26 vjeçare”. Ky kriter i moshës nën 18 vjeç gjendet edhe në nenin 1 par.1.3 të Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare të Kosovës, (nr.02/17, datë 21 prill 2005), i cili e përkufizon fëmijën si personi i cili është nën moshën 18 vjeç.

*mbushur një vit*¹⁰⁵. Me këtë rast gjykata duhet të kujdeset për mbrojtjen e interesave të fëmijëve duke mos e pranuar padinë.

Sipas po këtij neni, *kur bashkëshortët parashtrojnë propozim për shkurorëzim me marrëveshje, ata janë të detyruar të paraqesin marrëveshje me shkrim për mënyrën e mbajtjes, edukimin dhe shkollimin e fëmijëve si dhe mënyrën e mbajtjeve të kontakteve me fëmijët*. Ligjvënësi e ka paraparë mundësinë që për shkak të interesave të fëmijëve mund të refuzojë padinë për shkurorëzim ose të shtyjë për një kohë, përderisa ruajtja e martesës bëhet për arsye specifike dhe të domosdoshme për interesat e fëmijëve (Aliu & Gashi, 2007: 167). Gjatë procedurës në kontestet martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padinë, mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin në nevojë dhe për vendbanimin e tij.

c) Parimi i oficialitetit

Sipas këtij parimi gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit mund të shqyrtojë *ex officio* (për efekt të detyrës zyrtare), të gjitha ato fakte dhe prova të cilat i konsideron të nevojshme për zgjidhjen e kontestit martesor, pra edhe faktet të cilat nuk i kanë paraqitur bashkëshortët. Kështu, faktet në të cilat pala e mbështet kërkesën e vet në kontestet martesore, gjykata mund t'i konsiderojë të kontestueshme edhe atëherë kur ato fakte janë të pakontestueshme në mes palëve (Aliu & Gashi, 2007: 167). Gjkata, veçanërisht ka përgjegjësi që gjatë procedurës së shkurorëzimit të kujdeset për interesat e fëmijëve.

¹⁰⁵ Neni 70 të i LFRK dhe neni 137 i KRFSH.

ç) Parimi i dispozicionit

Parimi i dispozicionit nënkupton faktin se bashkëshortët gjatë procedurës në konteste martesore mund t'i paraqesin të gjitha faktet dhe provat të cilat i konsiderojnë të domosdoshme. Sipas këtij parimi, bashkëshortët e kanë në dispozicion mundësinë e paraqitjes së fakteve dhe provave sipas vullnetit të tyre në procedurën e shkurorëzimit. Se cilat prova bashkëshortët do t'i paraqesin para gjykatës, kjo varet nga bindja e tyre se cilat prova janë më të rëndësishme për zgjidhjen e martesës (Komar *et al.*, 1996: 61). Gjatë kontestit martesor gjykata ka rol aktiv dhe mund t'i hetojë faktet mbi të cilat palët mbështesin kërkesat e tyre dhe kur palët nuk i kontestojnë ato.

dh) Parimi i përjashtimit të publikut

Duke pasur parasysh faktin se kontestet martesore janë mjaft të ndërlikuara, dhe se në këto konteste mund të paraqiten fakte dhe prova të cilat prekin të drejtat personale të bashkëshortëve dhe personave të tjerë, të cilat kanë të bëjnë me jetën private të tyre, nuk do të ishte e arsyeshme që këto marrëdhënie të shpaloseshin para publikut. Prandaj ligjvënësi kosovar e ka paraparë mundësinë e përjashtimit të publikut nga seanca gjyqësore gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës (neni 75 LFRK). Kështu, publiku në procedurat e kontesteve familjare është i përjashtuar *ex lege*, që nënkupton se publiku në procedurat e kontesteve martesore dhe procedurës për vërtetimin e atësisë është e përjashtuar me ligj, si në seancën kryesore ashtu edhe në seancën për tentim pajtimi të bashkëshortëve. Ndërkohë që në Shqipëri është gjykata e cila vlerëson në bazë të neneve 26 dhe 173 të K.Pr.C. nëse është rasti për të përjashtuar publikun dhe për të zhvilluar seancën me dyer të mbyllura.

Ndërkaq, sipas nenit 224 të LFRM: *publiku është i përjashtuar si në seancën kryesore ashtu edhe në atë pajtimore. Përjashtimisht kryetari i Këshillit, mund të lejojë që në seancë kryesore të marrin pjesë të punësuar në institucioni publike dhe profesionale, të cilet merren me probleme martesore dhe familjare, si dhe persona të cilët palët do t'i propozojnë.*

e) Përshpejtimi i procedurës

Ky parim vlen sidomos gjatë procedurave të kontesteve martesore. Në procedurat gjatë të cilave gjykata vendos për kontestet martesore dhe konteste tjera të këtij ligji, nëse palët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore si dhe në raste të dhunës familjare, procedohet në mënyrë urgjente (neni 223 LFRM). Thelbi i këtij parimi përbëhet në atë se në këtë procedurë palët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore, prandaj për shkak specifikës së këtyre lëndëve dhe për shkak mbrojtjes së interesave të fëmijëve, paraqitet nevoja për trajtim të veçantë të këtyre procedurave nga ana e organeve shtetërore. Ky parim nënkupton zbatimin e tij në të gjitha fazat e procedurës nga ana e organeve kompetente dhe institucioneve.

Në Kosovë dhe në Maqedoni, në procedurën për zgjidhje të martesës si organ kompetent për veprim në këto konteste janë respektivisht edhe Organi i Kujdestarisë dhe Qendra për Punë Sociale¹⁰⁶, në ato rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të

¹⁰⁶ Gjykata në afatin prej tetë ditësh e lajmëron me shkrim Qendrën për Punë Sociale për të dhënat: se kur ka filluar procedura për shkurorëzim, shkaqet kryesore për të cilat kërkohet shkurorëzimi si dhe të dhënat mbi fëmijët. Qendra për punë sociale është e detyruar që në afat prej tre muajsh nga pranimi i lajmërimit nga ana e gjykatës, të mbarojë procedurën për pajtim të bashkëshortëve. Duke analizuar nenin 259/ 2 të LFRM parashtrohet pyetja nëse ligji mundëson zbatim të drejtë të këtij parimi përmes dispozitave të tij.

përbashkët ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore. Në doktrinë është e debatueshme nëse afati prej tre muajsh është periudhë e cila i përshtatet këtij parimi ose i njëjti afat paraqet periudhë të gjatë, i cili nuk është në interes të palëve të procedurës. Në lidhje me këtë çështje shpeshherë janë paraqitur kritika. Sipas mendimit të gjykatësit Stevan Stojçevski: *Ky afat vetëm se e thellon dhe e vazhdon agoninë e bashkëshortëve dhe fëmijëve të mitur, dhe thjesht si afat i përshtatet Qendrës për punë sociale në zbatimin e seancës për pajtim* (Stojçevski, 1994: 231).

Në Shqipëri, seanca pajtimore zhvillohet në gjykatë, e cila ka detyrimin të njoftojë palët për mundësinë e zgjidhjes së konfliktit me ndërmjetësim. Sipas nenit 4/2 të Ligjit Nr.10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”:

Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës apo familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve: a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve; b) në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i KFRSH.

Gjithashtu, sipas nenit 6 të KFRSH në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme (...).

Ndërkaq, në Shqipëri procedura për pajtim të bashkëshortëve zhvillohet para gjykatës¹⁰⁷. Gjatë seancës për pajtim gjykata merr rolin e ndërmjetësuesit, dhe si një person i paanshëm, bën përpjekje që bashkëshortët t'i drejtojnë për të marrë një vendim ndryshe nga ai me të cilin martesa e tyre do të merrte fund. Nëse gjykata do të ketë sukses dhe bashkëshortët do të pajtohen mes tyre, atëherë gjykata mban procesverbal dhe pushohet gjykimi për shkurorëzim. Me pushimin e gjykimit, në bazë të nenit 300 të K.Pr.C. të

¹⁰⁷ Neni 134 i KFRSH ku shprehimisht thuhet: "Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seancë pajtimi.. "

Shqipërisë, nuk shuhet e drejta e padisë, prandaj bashkëshortët në të ardhmen, në çdo kohë, mund t'i drejtohen gjykatës për zgjidhje të martesës. Ndërsa, nëse nuk arrihet pajtimi i bashkëshortëve, gjykata do të vazhdojë me procedurën për shkurorëzim.

Në Maqedoni, kundër aktvendimit të shkallës së parë me të cilin zgjidhet martesa me propozim të përbashkët për shkurorëzim, palët kanë të drejtë ankimi brenda prej 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Afati prej 15 ditësh paraqet afat të përgjithshëm për ankesë i përcaktuar me Ligjin për Procedurën Kontestimore¹⁰⁸. Parashtrohet pyetja: *Pse LFRM e përcakton afatin e përgjithshëm për ankesë prej 15 ditësh?* Për shkak të rëndësisë së kontesteve martesore, jemi të mendimit se afati prej 15 ditësh nuk është në përputhshmëri me nevojën e zgjidhjes urgjente të kontesteve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet martesore. Për këtë arsye, në të ardhmen LFRM duhet të bëjë precizimin e këtij parimi duke përcaktuar afat më të shkurtër kohor prej 8 ditësh për paraqitje të ankesës, në mënyrë që ai të mundësojë zbatim të drejtë të këtij parimi (Stojčevski, 1994: 231).

IV.2. Gjykata kompetente

Ligjet në fuqi mbi familjen të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës, nuk parashikojnë dispozita të posaçme në drejtim të gjykatës kompetente për gjykimin e çështjeve që kanë për objekt zgjidhjen e martesës. Në këto rrethana, përcaktimi i kompetencës lëndore dhe tokësore, për shqyrtimin e zgjidhjes së martesës do të bëhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin mbi procedurën civile. Në drejtim të kompetencës *lëndore*, për gjykimin e

¹⁰⁸Ligji për Procedurën Kontestimore i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e R.M, nr. 79/05,110/08,83/09,116/10 dhe 7/11.

zgjidhjes së martesës kompetenca i përket gjykatës së shkallës së parë, seksioni familjar¹⁰⁹.

Sa i përket kompetencës *tokësore*, padia për zgjidhjen e martesës mund të ngrihet në një nga gjykatat e mëposhtme (Omari, 2010: 213):

- në gjykatën e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e fundit të përbashkët;
- në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, sipas parimit të përgjithshëm, *actor sequitur forum rei* (neni 228 i LFRM).

Rregulli sipas të cilit, përveç gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, në kontestet martesore kompetencë territoriale ka edhe gjykata në të cilin territor bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e tyre të fundit, është sjellë duke pasur parasysh ekonominë e procedurës, kontesti të zgjidhet atje ku edhe kanë ndodhur shkaqet që kanë sjellë deri te kontesti, ku edhe gjenden provat që gjykata duhet t'i nxjerrë gjatë kësaj procedure (Çavdar, 1998: 378). Në jurisprudencën e vendeve europiane është evidentuar prej kohësh rreziku i atij që njihet si *forum shopping*, praktika që ka për qëllim ngritjen e kërkesë padisë për zgjidhjen e martesës pranë gjykatës, të cilën pala e konsideron si më të favorshme për të. Bëhet fjalë për mundësinë që Rregullorja nr. 2201/2003 e Këshillit, e datës 27 nëntor 2003, mbi kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën e marrëdhënieve bashkëshortore dhe përgjegjësinë prindërore (“Bruxelles II bis”), i jep paditësit t’i drejtohet gjykatës së vendbanimit të tij zakonshëm, nëse ky i fundit ka jetuar aty gjashtë muaj para ngritjes së kërkesë padisë¹¹⁰. Për këtë arsye, së fundi Gjykata

¹⁰⁹ Sips nenit 349 të K.Pr.C.: *Kompetencat lëndore - Seksionet për shqyrtimin e mos marrëveshjeve familjare pranë gjykatave të shkallës së parë janë kompetente për: a) Shqyrtimi i mos marrëveshjeve për zgjidhjen e martesës me shkurore, për pavlefshmërinë dhe për anulimin e martesës.*

¹¹⁰ England and Wales Family Court Decisions - High Court Judges, në çështjen Rapisarda v Colladon (Irregular Divorces) [2014] EWFC 35 (30 Shtator 2014). Për më gjerë shih, Castellaneta M., *Forum*

angleze, ka anuluar vendimet e zgjidhjes së martesave të gjykatave angleze të cilat rezultonin të ishin kryer në mashtrim të ligjit, duke deklaruar adresën e të njëjtës shoqëri me qëllim që t'i drejtoheshin gjykatës që do të vendoste më shpejt për zgjidhjen e martesës (Castellaneta, 2014).

E drejta e zgjidhjes së një prej gjykatave të mësipërme, i përket bashkëshortit paditës, i cili këtë të drejtë e ushtron nëpërmjet ngritjes së padisë. Në rastin e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok, e drejta për të vendosur gjykatën që do ta shqyrtojë kërkesën e përbashkët për zgjidhjen e martesës, u përket të dy bashkëshortëve, të cilët duhet të vendosin gjithashtu me marrëveshje ndërmjet tyre. Gjithashtu, në zbatim të ligjit të procedurës civile, bashkëshortëve u njihet mundësia ta ndryshojnë me marrëveshje me shkrim kompetencën tokësore, në mënyrën që të përcaktojnë gjykatën më të përshtatshme për mbrojtjen e interesave të tyre.

Në kontestet martesore, në shkallë të parë në Kosovë vendos trupi gjyqësor i përbërë prej një gjykatësi profesional dhe gjykatësi porotë. Ndërsa në shkallë të dytë vendos trupi i përbërë nga tre gjykatës profesional (neni 73 LFRK). Në procedurat për shkurorëzim me marrëveshje në Maqedoni mund të vendosë edhe gjykatësi individual nën kushtet e përcaktuara me ligj (neni 226 LFRM). LFRM parashikon se, në rastet kur bashkëshortët nuk kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë ndaj të cilëve është e vazhduar e drejta prindërore, mund të vendosë kryetari i trupit gjykues si gjykatës individual.

shopping per il divorzio breve: stop dai giudici inglesi në <http://www.marinacastellaneta.it/blog/forum-shopping-per-il-divorzio-breve-stop-dai-giudici-inglesi.html>, parë në datë 16.10.2015.

Nga praktika gjyqësore shqiptare evidentojmë disa raste kur kontesti midis palëve lind pikërisht rreth kompetencës lëndore dhe tokësore të Gjykatës. Një vendim që i refereohet martesës me elementë të huaj ka të bëjë me *kontestin mbi juridiksionin e gjykatave të vendit lidhur me detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve pas zgjidhjes së martesës*¹¹¹. Pretendimi i palës paditëse është se kjo çështje nuk mund të gjykohet nga gjykatat shqiptare, pasi jemi në kushtet kur ajo është duke u shqyrtuar nga një gjykatë italiane, e cila ka marrë një vendim për përcaktimin e një detyrimi për ushqim me efekt të menjëhershme për palën e paditur dhe për fëmijët e saj. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e gjen me vend të parashtrojë se Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 109/2012 ka ratifikuar “Konventën mbi njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore”, ku në nenin 12 të saj parashikohet se:

Procedimi për divorc ose ndarje ligjore i filluar në një Shtet Kontraktues mund të pezullohet, kur procedimi në lidhje me statusin martesor të dy palëve është në pritje të zgjidhjes në një shtet tjetër kontraktues.

Nga interpretimi literal i kësaj dispozite, rezulton se kjo normë nuk ka karakter ndalues dhe nuk autorizon ndërprerjen e procesit gjyqësor, të iniciuar përpara gjykatës shqiptare as

¹¹¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 2737 i datës 26.02.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim të veçantë pala e paditur, që kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rrëzimin e kërkesës së palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare. Kolegji Civil konstaton se: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka zbatuar drejtë dispozitat procedurale lidhur me juridiksionin gjyqësor të gjykatës shqiptare duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor në mbështetje të nenit 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNj”. Në nenin 59 të K.Pr.C. parashikohet shprehimisht se: “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor...(...)” Për rastin në shqyrtim, evidentohej se marrëdhënia civile e krijuar nga palët ndërgjyqëse është një marrëdhënie civile me elemente të huaj. Në lidhje me këtë çështje, sipas nenit 9 të Konventës së Hagës “Për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore” (Ligji nr.12743/1 datë 31.12.2012): *Shtetet Kontraktuese mund të refuzojnë të njohin një divorc ose ndarje ligjore nëse ajo është e papajtueshme me një vendim të mëparshëm që përcakton statusin martesor të bashkëshortëve dhe se vendimi ose është dhënë në Shtetin në të cilin kërkohet njohja, ose është njohur, ose i përmbush kushtet e kërkuara për njohje, në atë Shtet.*

duke pushuar gjykimin as duke pezulluar atë, për shkak se palët e kanë çuar të njëjtën mosmarrëveshje para një gjykate të huaj e cila eventualisht mund të jetë shpallur kompetente, por është lënë si alternativë e mundshme, nga ana e gjykatës në varësi të çështjes gjyqësore që është duke u gjykuar pranë gjykatës shqiptare.

IV.3. Inicimi i procedurës

Për sa i përket *subjekteve në procedurën për zgjidhjen e martesës* ato janë gjykata dhe bashkëshortët, pa të cilat subjekt nuk mund të ekzistojë procedura për shkurorëzim dhe që paraqesin subjekt procedural në kuptim të ngushtë. Procedura kontestimore *est actus trium perosonarum: actoris, rei, iudicis* dhe si e tillë paraqet marrëdhënie procedurale tri palësh midis gjykatës dhe palëve kontestuese të cilët, janë bartësit kryesor të të drejtave dhe detyrimeve procedurale. Megjithatë në procedurën për zgjidhje të martesës mund të marrin pjesë edhe subjekte të tjera, siç janë përfaqësuesit e palëve, ndërmjetësuesit, dëshmitarët, ekspertët, interpretuesit, përkthyesit dhe persona të tjerë të cilëve ligji u mundëson që të marrin pjesë gjatë kësaj procedure që të arrihen qëllimet e përcaktuara procedurale ose mbrojtjen e interesit të palëve dhe si të tillë emërohen si palë në kuptimin më të gjerë.

- Në një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë¹¹², kërkesja ka pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor¹¹³. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, kërkesja nuk ishte paraqitur

¹¹² Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 109, i datës 07.10.2013.

¹¹³ Më konkretisht, kërkesja ka parashtruar se: a) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër nuk duhej të vendoste pushimin e çështjes, pasi pavarësisht se kërkesja ka qenë në mungesë gjatë gjykimit në shkallë të parë, vëllai i saj, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë, ka qenë i pranishëm; b) Martesa e kërkeses me subjektin e interesuar është fiktive dhe nuk ishte e nevojshme të zhvillohej seanca e pajtimit; c) Vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi, nuk plotësojnë standardin e arsyetimit të vendimit, sipas nenit 142/1 të Kushtetutës.

në gjykim, ndërkohë që ishte paraqitur personi i autorizuar prej saj, i vëllai. Nisur nga objekti i mosmarrëveshjes, në menyrë specifike, zgjidhje martesë, gjykata e ka sqaruar përfaqësuesin e kërkueses se *duhej të zhvillonte fillimisht seancën e pajtimit, seancë në të cilën kërkuësja duhej të paraqitej personalisht*. Edhe në seancën pasardhëse kërkuësja nuk ishte paraqitur dhe në këto kushte gjykata kishte vendosur pushimin e gjykimit. Megjithatë, jemi të mendimit se në këtë rast, ashtu si dhe në raste të tjera të trajtuara në këtë punim, *për sa kohë pretendohej se martesa ka qenë fiktive*, duhej të ishte kërkuar shpallja e pavlefshmërisë së martesës dhe jo zgjidhja e saj¹¹⁴.

Në Maqedoni, Qendra për Punë Sociale ka rol të rëndësishëm si palë në proceset kontestimore të zgjidhjes së martesës, qëllimi i të cilit është mbrojtja e interesave të palëve, më saktësisht mbrojtja e interesave të fëmijëve në kontestet martesore. Ky organ është themeluar si institucion publik për mbrojtje sociale, i cila ka kompetencë në procedurat në të cilat vendoset për kontestet martesore dhe familjare. Në procedurën për shkurorëzim, Qendra për Punë Sociale ka rol të rëndësishëm, pasi ajo realizon procedurën për pajtim të bashkëshortëve të cilët kanë fëmijë të mitur, ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore, dhe i jep gjykatës mendimin e saj për përcaktimin se cilit prind do t'i takojnë fëmijët në rastin kur është iniciuar procedura për shkurorëzim. Roli i veçantë që ka

¹¹⁴ Gjykata e Apelit Tiranë, vendimi nr.172, i datës 24.04.2014. Argumenton se nenet 134 dhe 135 të KRFSH parashikojnë në mënyrë taksative zhvillimin e një seance pajtimi, në rastet e zgjidhjes së martesës, gjatë së cilës prania dhe pyetja personalisht e palëve është e domosdoshme. Kërkuësja ka qenë në mungesë, si gjatë gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër ashtu edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. *Kolegji vlerësoi se pretendimet e ngritura nga kërkuësja, në drejtim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ishin haptazi të pabazuara, prandaj vendosi që çështja të mos kalojë për shqyrtim në seancë plenare.*

Qendra për punë sociale vihet re në procedurat për shkurorëzim, ku si pjesëmarrës në këto procedura paraqitet si:

a) *palë*; b) *përfaqësues ligjor*; c) *ndërmjetësues*; ç) *autorizues*.

a) Në kontestet martesore, Qendra për Punë Sociale mund të paraqitet në rolin e *palës*, në ato rastet kur është e autorizuar të iniciojë procedurën me paraqitje të padisë. Në këto raste, duke qenë se për ngritje të padisë janë të legjitimuar vetëm bashkëshortët, Qendra për Punë Sociale mund të jap leje për ngritje të padisë për personat nën përkujdesje. Kjo nënkupton, për ato persona të cilët për shkak të sëmundjeve psikike dhe që njëkohësisht janë të paaftë për të gjykuar si dhe për personat që kanë ngecje në zhvillimin psikik, përderisa bëjnë pjesë në grupin e personave me ngecje të rëndë mentale, me koeficient inteligjence (IQ) nën 36⁰ (Zavod za socijalna ranota, 2007: 57)¹¹⁵.

b) Qendra për Punë Sociale mund të paraqitet në rolin e *përfaqësuesit ligjor* në rastet kur parashikohet funksioni i saj për përkujdesje të familjes dhe anëtarëve të saj, sidomos të të miturve. Në këtë rol mundet, në emër të fëmijës të mitur të fillojë kontestin për mirëmbajtje, në menyrë specifike, për rritjen e masës së ushqimit kur prindi tek i cili gjendet fëmija, pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e shfrytëzon këtë të drejtë. Kështu, Qendra për punë sociale mund të japë propozim për përcaktim të masave të përkohshme për dhënien e masës së ushqimit fëmijëve të përbashkët dhe për përcaktimin e tyre për rritje dhe edukim.

¹¹⁵ Për këto persona padi për shkurorëzim mund të paraqesë kujdestari i tyre vetëm me leje paraprake nga Qendra për punë sociale. Në rastet kur kujdestar është bashkëshorti tjetër, Qendra për punë sociale do të caktojë kujdestar të përkohshëm, personit që gjendet nën kujdestari (neni 174 LFRM).

c) Sa i përket rolit të Qendra për Punë Sociale si *ndërmjetësues*, mund të themi se në këtë rast ka rol të intervenuesit *ex lege*, gjithmonë kur në procedurë vendoset për rritje, përkujdesje, mirëmbajtje dhe edukim të fëmijëve. Në këtë rast, gjykata fton Qendrën për punë sociale që të marrë pjesë në seancë për shkak të mbrojtjes së interesave të fëmijëve, duke i dorëzuar njëherit të gjitha vendimet e marra gjatë procedurës. Në këtë rol Qendra për Punë Sociale ka të drejtë të japë propozim për rritje, përkujdesje, mirëmbajtje dhe edukim të fëmijëve dhe mundet, në kufijtë e këtij propozimi *të paraqesë fakte dhe prova të cilët palët nuk i kanë paraqitur dhe të ndërmarrë veprime të tjera procedurale në interes të fëmijëve* (neni 249 LFRM).

ç) Gjithashtu, Qendra për Punë Sociale mund të paraqitet edhe në rolin e *autorizuesit*.

Në doktrinën juridike ky rol i qendrës për punë sociale përcaktohet si:

Organi i kujdestarisë mund të paraqitet në rolin e autorizuesit me pëlqim paraprak të personave të moshuar dhe të pa aftë, në emër të tyre të nisë dhe të vazhdojë kontestin për realizimin e të drejtës për mirëmbajtje dhe kundrejt familjarëve të cilët me ligj janë të detyruar t'i mirëmbajnë (Çalija, 1986: 675).

Padia për zgjidhje të martesës - Procedura e shkurorëzimit fillon me padi ose me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve. Padi për shkurorëzim mund të përkufizohet si:

veprimi kontestimor, i cili paraqet shprehjen e vullnetit të njërit bashkëshort dhe njëherit paraqet aktin fillestar për ngritjen e procedurës me të cilën kërkohet nga gjykata që të sjellë aktvendim me të cilin martesa do të zgjidhet (Gagacef, 1994: 239).

Padia për shkurorëzim ka karakter konstitutiv, pasi që nga gjykata kërkohet që me aktvendim të ndryshohet marrëdhënia juridike e deri atëherëshme, ashtu që marrëdhënia bashkëshortore e cila ka ekzistuar deri atëherë me aktvendim të plotfuqishëm do të pushojë së ekzistuari (Mandro, 2009: 315). Padinë për shkurorëzim, njëri bashkëshort mund ta paraqesë për shkak të marrëdhënieve të tronditura martesore deri në atë shkallë sa që jeta e

përbashkët është bërë e padurueshme dhe nëse bashkësia martesore ka pushuar së ekzistuari *de facto* në periudhë më të gjatë se një vit. Ndërkohë, theksohet se KFRSH parashikon mundësinë e zgjidhjes së martesës për ndërprerje të jetës së përbashkët për më shumë se tre vjet (neni 139) .

Bazuar në praktikën gjyqësore, kërkesë padia për zgjidhjen e martesës, përveç përbërësve të cilët duhet të përmbajë çdo padi, duhet të përmbajë edhe identitetin e fëmijëve të mitur, duke treguar edhe prindin pranë të cilit do të jetojë fëmija. Nëse nga martesa nuk kanë lindur fëmijë, ky fakt do të shënohet gjithashtu në kërkesën apo padinë për zgjidhjen e martesës¹¹⁶. Parimisht, padinë mund ta paraqesin vetëm bashkëshortët. Kjo do të thotë se padia është e lidhur ngushtë me personalitetin e bashkëshortit (Vojisllav, 1980: 197). Padinë mund ta paraqesë secili bashkëshort, pavarësisht se cili është fajtor për tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore (Zaçë, 1996: 141). Sipas nenit 153 të KFRSH, nenit 68 të LFRK dhe nenit 229/1 të LFRM, *njëri apo të dy bashkëshortët mund të paraqesin padi për shkurorëzim*.

E drejta për paraqitjen e padisë nuk mund t'i kalohet trashëgimtarëve, mirëpo trashëgimtarët e paditësit mund ta vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë. Megjithatë, në legjislacion është paraparë edhe një përjashtim. Sipas nenit 74 të LFRK, nenit 232 të LFRM dhe nenit 142 KFRSH, kujdestari mund të parashtojë padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit i cili vuan nga sëmundjet psikike të diagnostikuara, ose në emër të personit të paaftë për të vepruar. Këtë padi kujdestari mund ta paraqesë

¹¹⁶ Natyrisht, do të figurojnë në kërkesë vetëm fëmijët e mitur, pasi vetëm për këta shtrohet çështja e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës. Konsiderohen fëmijë të bashkëshortëve jo vetëm ato të lindur nga martesa, por edhe fëmija i birësuar prej të dy bashkëshortëve apo fëmija biologjik i njërit bashkëshort dhe njëkohësisht i birësuar nga bashkëshorti tjetër.

vetëm me pëlqimin e mëparshëm të Organit të Kujdestarisë. Prandaj, përveç bashkëshortëve në raste të sëmundjes psikike dhe paaftësisë për të vepruar të bashkëshortit, padinë në emër të tij mund ta paraqesë kujdestari (Aliu & Gashi, 2007: 168).

Ndërkaq, neni 142 i KFRSH parashikon se:

Në rastin e burgimit të bashkëshortit, e drejta e ngritjes së padisë për zgjidhjen e martesës mund të ushtrohet nga kujdestari ose përfaqësuesi ligjor vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e bashkëshortit që vuan dënimin” (Omari, 2010: 214).

Në gjykimin tonë, duke zbatuar me analogji hipotezën e parashikuar nga neni 142, e njëjta zgjidhje duhet pranuar në çdo rast që bashkëshorti ndodhet në pamundësi objektive për t’u paraqitur personalisht në gjykim. Duke zbatuar parimin *ubi idem est ratio, ibi idem solutio*¹¹⁷, duhet pranuar se paditësi, i cili vërteton ekzistencën e një shkakut me rëndësi, mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi i caktuar me prokurë të posaçme edhe në seancën e parë të gjyqimit të padisë së zgjidhjes së martesës (Omari, 2010: 215).

Legjislacioni në fuqi i shteteve objekt analize nuk ka paraparë ndonjë afat të caktuar kohor për të paraqitur padinë për zgjidhje të martesës. Nga kjo nënkuptohet se padia për shkurorëzim mund të paraqitet çdo herë kur marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar seriozisht edhe nëse kjo ndodh vetëm pas disa ditëve pas lidhjes së martesës. Në procedurën e shkurorëzimit mund të paraqitet kundërpadi nga bashkëshorti tjetër deri në përfundimin e seancës kryesore (Oruçi, 1994: 98). I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi, pasi e pranon padinë e paditësit. Kështu, të paditurit i mundësohet që në kundërpadi të paraqesë fakte dhe prova të reja që mund të kenë ndikim në vendimin e

¹¹⁷ Sipas këtij parimi të interpretimit të ligjit civil, kur vërtetohet se qëllimi i ligjit është i njëjtë, e njëjtë duhet të jetë edhe zgjidhja që do të zbatohet interpretuesi i ligjit.

gjykatës (Gagacef, 1994: 240). *Ndërkaq bashkëshortët nuk mund të ngrenë padi për shkurorëzim derisa grua ja është shtatzënë dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të ketë mbushur një vit (neni 70 LFRK)*¹¹⁸. Kur njëri bashkëshort ka paraqitur padinë, ndërsa bashkëshorti tjetër nuk e ka kundërshtuar më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore, do të konsiderohet se bashkëshortët e kanë paraqitur propozimin e tyre të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje (neni 68/4 LFRK). Ndërsa gjatë procedurës paditësi mund ta tërheqë padinë deri në përfundim të seancës kryesore. Kur bashkëshortët e kanë paraqitur propozimin e përbashkët për shkurorëzim, së bashku me propozimin duhet të paraqesin edhe marrëveshjen për mbajtjen e fëmijëve, ushqimin, edukimin, shkollimin si dhe për mënyrën e mbajtjes së kontakteve me fëmijët. Për shkak të pozitës specifike të fëmijës, organi i cili vendos për të drejtat dhe detyrimet të prindërve ndaj fëmijës, gjithmonë duhet të ketë parasysh se vendimi që do të sillet duhet të jetë në interes të fëmijës. Gjykata, duke vepruar në bazë të marrëveshje për shkurorëzim, të njëjtën mund ta pranojë atë vetëm nëse projekt-marrëveshja është në interes të fëmijës. Gjithashtu, ligji parasheh autorizime të zgjeruara të gjykatës kur bëhet fjalë për fëmijët, ashtu që me rastin e sjelljes së aktvendimit me të cilin do ta zgjidhë martesën, gjykata do të ketë parasysh marrëveshjen e dorëzuar, mirëpo nëse vlerëson se e njëjta është në kundërshtim me interesat e fëmijëve, ajo do ta refuzojë këtë marrëveshje, ose do të bëjë ndryshimet e nevojshme¹¹⁹.

¹¹⁸ E drejta e padisë shuhet me vdekjen e njërit apo të të dy bashkëshortëve.

¹¹⁹ Në dallim nga legjislacioni shqiptar, (shih nenin 128 KFRSH), në të cilën marrëveshja nuk mund të plotësohet nga gjykata, por vetëm të miratohet ose të refuzohet në tërësinë e saj, në Kosovë dhe Maqedoni, pasi të jetë marrë mendimi nga organi përkatës (respektivisht Organi i Kujdestarisë dhe Qendra për Punë

Në rastin e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok, është e debatueshme çështja nëse është e detyrueshme prezenca personale e bashkëshortëve, apo nëse është e mjaftueshme paraqitja e kërkesës së nënshkruar nga të dy bashkëshortët. Sikurse e kemi trajtuar në kapitullin e mësipërm mbi shkurorëzimin me pëlqim reciprok të bashkëshortëve, kontrolli i vullnetit të secilit bashkëshort është kusht ligjor për zgjidhjen e martesës, prandaj si rregull prezenca personale e bashkëshortëve është e detyrueshme. Përveç kësaj seanca pajtimore është e detyrueshme në çdo rast, prandaj prezenca e vetë bashkëshortëve është e domosdoshme.

E drejta e tërheqjes së padisë, po ashtu, është e lidhur ngushtë me personalitetin e bashkëshortëve. Kështu, vetëm paditësi e ka të drejtën e tërheqjes së padisë deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e të paditurit, kurse me pajtimin e të paditurit gjithnjë derisa procedura të përfundojë me vendim të plotfuqishëm (nen 68/1 LFRK). Ndërsa sa i përket propozimit të përbashkët, bashkëshortët mund ta tërheqin deri sa aktgjykimi të marr formën e prerë. Gjithashtu do të konsiderohet se është tërhequr propozimi edhe kur vetëm njëri nga bashkëshortët heq dorë prej tij (neni 86/2 LFRK)

IV.4. Zhvillimi i procedurës

a) Procedura e pajtimit është fazë e veçantë në procedurën e pajtimit, përmes së cilës tentohet të arrihet pajtimi i bashkëshortëve dhe pengimi i zgjidhjes së martesës. Gjatë kësaj seance aktiviteti i gjykatës nga juridiksional, shndërrohet në një ndërmjetësim ku pikërisht gjykata luan rolin e ndërmjetësit. Gjykata ka detyrimin t'i informojë palët për mënyrat

Sociale), gjykata mund të marrë vendimet e nevojshme, të ndryshme nga ato të parashikuara në projekt-marrëveshjen e palëve.

alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, pastaj janë palët që zgjedhin nëse do t'i drejtohen ose jo ndërmjetësimit¹²⁰. Nga momenti i pranimi të padisë nga gjykata, ajo ka për obligim të fillojë procedurën e pajtimit të bashkëshortëve¹²¹. Ligjvënësi e ka kushtëzuar sjelljen e aktgjykimit për shkurorëzim, vetëm pasi gjykata të ketë zhvilluar procedurën e pajtimit. Aktgjykimi për shkurorëzim iu dërgohet palëve vetëm pas përfundimit të procedurës dhe vetëm nëse pajtimi nuk ka pasur sukses.

Në Maqedoni, procedura e pajtimit zhvillohet para gjykatës kur bashkëshortët nuk kanë fëmijë. Në të do të marrin pjesë vetëm dy bashkëshortët dhe kryetari i trupit gjykues.

Seanca e veçantë nuk do të mbahet kur njëri prej bashkëshortëve nuk ka zotësinë e veprimit. Seanca nuk do të mbahet edhe në rastin kur njëri apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit dhe kur nuk dihet vendbanimi i bashkëshortëve (neni 237 LFRM).

Qëllimi i pajtimit është që bashkëshortët të rivlerësojnë mundësitë për ruajtjen e martesës, me anë të së cilës gjykata tenton t'iu shpjegojë bashkëshortëve rëndësinë e martesës, pasojat që do të shkaktohen me rastin e shkurorëzimit. Nëse njëri ose të dy bashkëshortët mungojnë dhe nuk paraqiten në seancën e pajtimit dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar ndërsa janë të ftuar në mënyrë të rregullt, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, gjykata do të çmojë nëse do të caktojë seancë të re, apo në të kundërt, nëse përpjekja për pajtim ka dështuar (Aliu & Gashi, 2007: 171).

Në rastet kur procedura e shkurorëzimit ka filluar me propozimin e përbashkët, ndërsa njëri apo të dy bashkëshortët mungojnë në seancën e pajtimit dhe mungesën e tyre nuk e arsyetojnë, do të konsiderohet se e kanë tërhequr propozimin. Sipas një rryme doktrinare (Omari, 2010: 218), në rastin e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok të

¹²⁰ Ligji “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” i Republikës së Shqipërisë, Nr. 10385, i datës 24.02.2011.

¹²¹ Shih nenin 76 LFRK, nenin 134 KFRSH dhe nenin 237 LFRM.

bashkëshortëve, gjykata nuk duhet të bëjë përpjekje për pajtim, por të kalojë drejtpërdrejtë në seancën kryesore për të shqyrtuar kërkesën e përbashkët të bashkëshortëve, pasi që në këtë rast palët nuk kanë ndonjë mendim kontradiktor ndërmjet tyre, ndaj faza e pajtimit do të ishte jo efikase dhe e pajustificueshme. Në këtë rast vetë zgjidhja e martesës bazohet në "*pajtimin*" ndërmjet opinionit të të dy bashkëshortëve, si pasojë e të cilit ato kanë konkluduar t'i japin fund marrëdhënies së tyre bashkëshortore.

Një çështje me rëndësi në procedurën e zgjidhjes së martesës, ashtu si dhe nëçështje të tjera, është edhe ajo e kohëzgjatjes së arsyeshme të veprimeve procedurale. Sipas GjEDNj, *te zgjatja e procedurave të zgjidhjes së martesës ekzistuese konsiderohet si shkelje e së drejtës për martesë*¹²². Nuk mungojnë në praktikë raste të mosrespektimit të këtyre afateve, të cilat çenojnë të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor. Në një vendim të Këshillit të Lartë i Drejtësisë Këshillit u konstatua zvarritje e gjykimit në çështje me objekt zgjidhje martese¹²³. Në rastin në fjalë rezultoi se nga data e marrjes së çështjes për gjykim për herë të parë, çështja ka zgjatur për një afat prej 1 vit e 5 muaj, ende pa u mbyllur gjykimi me vendim përfundimtar themeli. vendimin e parë të analizuar.

¹²² Çështja *V.K kundër Kroacisë*, 27 nëntor 2012, aplikimi nr. 38380/08.

¹²³ Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vendimi nr. 101, i datës 16 korrik 2014. Kjo zvarritje ka ardhur për shkak të dy vendimeve të gabuara të gjyqtarës A.Z për pushimin e gjykimit, megjithëse Gjkata e Apelit Vlorë ka urdhëruar vazhdimin e gjykimit në fazën e mbetur, me qëllim për të mos shkaktuar zvarritjen e gjykimit, gjyqtarja A.Z në rigjykim pas 2 muajsh ka vendosur përsëri pushimin e gjykimit. Në këtë mënyrë procesi gjyqësor është zvarritur dhe i është mohuar paditësit e drejta kushtetuese për gjykimin e çështjes nga një gjykatë e paanshme dhe brenda një afati të arsyeshëm. Këshilli i të Lartë i Drejtësisë përcaktoi dërgimin e gjyqtarës për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtut nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr. 8811, data 17 maj 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar. Në rastin në fjalë, gjykimi i kësaj mosmarrëveshjeje familjare, ka kapërcyer në mënyrë të konsiderueshme, afatin e caktuar nga vendimi i KLD-së "Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore".

Një vendimi tjetër i marrë në analizë lidhet me dhënien e detyrimit për ushqim sipas masës së përcaktuar nga gjykata. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor, si dhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jo pasuror nga ana e Zyrës Përmbaremore Elbasan¹²⁴. Gjykata është shprehur se *vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të veprimeve procedurale*, duke nënvizuar se përdorimi nga ana e kërkuesit të gjithë procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Gjithashtu gjykata çmon se:

kërkuesja nuk i ka shfrytëzuar të gjithë mundësitë ligjore për përmbushjen e të drejtave të fituara me vendim gjyqësor dhe për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit brenda një kohe të arsyeshme.

Në Shqipëri, procedura për pajtim të bashkëshortëve zhvillohet nga vetë gjykata (neni 134 /1 i KFRSH). Gjyqtari, gjatë veprimeve përgatitore, bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Për këtë qëllim, kur është rasti, urdhëron edhe paraqitjen e vetë palëve. Gjyqtari mund t'i dëgjojë ata veçmas secilin e pastaj bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre (neni 134/2 i KFRSH). Fillimisht gjykata verifikon paraqitjen e rregullt të palëve, bën bashkimin e ankimeve të bëra kundër të njëjtit vendim dhe bën përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim. Ligji shqiptar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” nr. 10385 i datës

¹²⁴ Vendimi nr. 24 datë 21.4.2014. Gjykata vlerëson se mos shterimi i mjetit të kërkimit për njohje dhe ekzekutim vendim pranë autoriteteve gjyqësore përkatëse nga ana e kërkueses, ka sjellë vonesë në përmbushjen e të drejtave të fituara në rrugë gjyqësore. Gjykata vëren se përmbaruesi gjyqësor, në cilësinë e subjektit procedural në fushën e ekzekutimit ka kryer të gjitha veprimet procedurale për ekzekutimin e vendimeve, fakt i pretenduar nga kërkuesja se nuk është realizuar.

24.02.2011, neni 2.4. parashikon se: *Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës apo familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve: a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve; b) në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes.*

Në Kosovë, në qoftë se bashkëshortët kanë fëmijë të mitur procedura e pajtimit do të zhvillohet para Organit të Kujdestarisë¹²⁵. Në këtë rast, gjykata brenda tetë ditëve lajmëron me shkresë Organin e Kujdestarisë për të dhënat se kur është iniciuar procedura për shkurorëzim, shkaqet themelore për të cilat kërkohet zgjidhja e martesës dhe të dhëna mbi fëmijët. Zhvillimi i procedurës së pajtimit para Organit të Kujdestarisë, arsyetohet me faktin se ky Organ përmes metodave të ndryshme të punës sociale, metodave profesionale dhe duke i shfrytëzuar shërbimet këshilluese për martesë dhe familje, do të arrijë pajtimin e bashkëshortëve.

Për mbrojtjen e interesave të fëmijëve, organi i kujdestarisë ndërmerr masa të nevojshme për sigurimin e edukimit, sigurimin fizik dhe mbrojtjen financiare të fëmijëve të mitur, duke bërë përpjekje të pareshtura për t'i bindur bashkëshortët se pajtimi është rrugë më e drejtë se sa zgjidhja e martesës¹²⁶. Kompetencat territoriale e organit të

¹²⁵ Me LFRM është paraparë që kjo fazë të zhvillohet para Qendrës për punë sociale, ndërsa në KFRSH parashihet që nëpërmjet autoritetit të një personi të paanshëm gjykata do të mbajë seancën për pajtim.

¹²⁶ Sipas nenit 6, pika 4 LFRK, *Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmerr veprime*

kujdestarisë për pajtimin e bashkëshortëve, caktohet në bazë të vendbanimit të të paditurit ose vendqëndrimit të tij. Mirëpo, përveç kësaj kompetence, kompetent do të jetë edhe organi i kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e tyre të përbashkët (neni 81/1 LFRK). Ndërsa, kur procedura e shkurorëzimit fillon me propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje, kompetent për të zhvilluar procedurën do të jetë organi i kujdestarisë në territorin e të cilit, njëri bashkëshort e ka vendbanimin ose vendqëndrimin, si dhe organi i kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e tyre të përbashkët (neni 81/1 LFRK).

Organi i kujdestarisë është kompetent për të zhvilluar procedurën e pajtimit të bashkëshortëve brenda afatit të përcaktuar me ligj. Ligjvënësi ka përcaktuar këtë afat, në mënyrë që organet kompetente të jenë efektive në punën e tyre dhe procedura mos të zvarritet pa arsye, sepse kjo do të ishte me pasoja për marrëdhëniet bashkëshortore (Aliu & Gashi, 2007: 188). Procedura e pajtimit pranë organit të kujdestarisë nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, mirëpo ky afat mund të vazhdohet nëse bashkëshortët pajtohen që të vazhdojnë procedurën edhe pas përfundimit të këtij afati.

Organi i Kujdestarisë është i detyruar t'i dërgojë gjykatës pa vonesë raportin me shkrim lidhur me rezultatet e procedurës së pajtimit. Kur arrihet pajtimi i bashkëshortëve duhet të përpilohet procesverbal i cili nënshkruhet nga të dy bashkëshortët si dhe nga gjykatësi përkatës (kryetari i trupi gjykues). Pajtimi i bashkëshortëve i regjistruar në procesverbal ka si efekt juridik shuarjen e padisë konkrete për shkurorëzim (Zaçe, 1996: 144). Në të gjitha këto raste gjykata duhet të konstatojë se bashkëshortët e kanë tërhequr padinë ose

tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet.

propozimin e tyre të përbashkët për shkurorëzim. Në të kundërt, kur gjykata konstaton se pajtimi nuk është arritur, e vazhdon procedurën e shkurorëzimit dhe pa vonesë duhet t'i caktojë masat e përkohshme. Njëkohësisht, në qoftë se tentativa për pajtim të bashkëshortëve nuk arrihet, mirëpo të ata arrijnë marrëveshje për çështjen e caktimit se cili prind do t'i takojnë fëmijët për përkujdesje dhe edukim¹²⁷.

Po kështu, edhe sipas LFRM, gjykata përpara se të vendosë në lidhje me çështjet që prekin interesat e të miturve, do të marrë mendimin e Qendrës për punë sociale. Kështu, nëse bashkëshortët nuk kanë lidhur marrëveshje lidhur me çështjen se kujt do t'i lihet fëmija për rritje dhe edukim ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijës, *për këtë do të sjell vendim Qendra për punë sociale* (neni 78LFRM). Gjithashtu:

nëse në afat prej dy muajsh prindërit nuk pajtohen për mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve personale dhe kontakteve me fëmijun, Qendra për punë sociale sjell vendim për këtë (neni 79 LFRM)¹²⁸.

Nga praktika gjyqësore e vendeve objekt analize paraqitet edhe problemi i shkurorëzimeve të *martësive fiktive*. Në këto raste duhet të kërkohej pavlefshmëria e martesës dhe jo zgjidhja e saj. Bëhet fjalë për procedura të shkurorëzimit ku shkaku për zgjidhje të martesës nuk janë marrëdhëniet e tronditura midis bashkëshortëve, por marrëveshjet që martesa të zgjidhet me qëllim të punësimit jashtë shtetit (ose për arsye të

¹²⁷ Në atë rast Organi i Kujdestarisë do të lajmërojë gjykatën se nuk është arritur pajtimi i bashkëshortëve, por që ato kanë arritur marrëveshje se te cili prind do të jetojnë fëmijët, që në fakt paraqet edhe mendimin e Organit të Kujdestarisë, duke qenë se marrëveshja e prindërve është në interes të fëmijëve. Ndërkaq nëse nuk është arritur pajtimi midis dy bashkëshortëve dhe as që është arritur ndonjë marrëveshje midis tyre se kujt do t'i takojnë fëmijët për përkujdesje dhe edukim, atëherë vazhdon faza e dytë para këtij organi, e ashtuquajtur formimi i mendimit për t'ia besuar fëmijët njërit prind.

¹²⁸ Roli i Nëse prindërit nuk kanë lidur marrëveshje për këtë ose nëse marrëveshje nuk i përgjigjet interesave të fëmijut, gjykata pasi që të marrë mendimin e Qendrës për punë sociale dhe do ti shqyrtoj të gjithë rrethanat, do të vendos nëse fëmijët do të qëndrojnë për rritje dhe edukim te njëri prind ose do të qëndrojnë tek e ëma, e disa te babai ose të cithë do ti besohen një personi të tretë ose enti.

tjera), duke lidhur martesë me shtetas të shteteve të huaja¹²⁹. Në momentin që bashkëpunëtorët profesionalë të organit të kujdestarisë vërtetojnë se nuk ka tronditje të marrëdhënieve martesore, por qëllimi i shkurorëzimit është shkurorëzim me marrëveshje për punë jashtë shtetit, nuk përgatisin mendim, por vetëm raport për procedurën e realizuar me anë të së cilës venë në dijeni gjykatën. Njëkohësisht, ata analizojnë marrëveshjen e bashkëshortëve, nëse ajo është në interes të fëmijëve të tyre, i paralajmërojnë për pasojat që rezultojnë nga shkurorëzime të tilla dhe për rreziqet e mundshme të cilat mund të paraqiten dhe njëkohësisht për të gjitha këto e lajmërojnë gjykatën. Sipas mendimit tonë, për shkak të numrit të madh të këtyre shkurorëzimeve formale, është e nevojshme që të hapet diskutim profesional për këtë dukuri me qëllim që në ligj të parashihen sanksione penale për rastet e martesave fiktive.

b) Caktimi i masave të përkohshme

Gjatë gjykimit të zgjidhjes së martesës, gjykata mund të marrë disa masa të përkohshme të cilat do të kenë fuqi juridike deri në përfundim të gjykimit për shkurorëzim. Caktimi i masave të përkohshme ka të bëjë me ushqimin dhe vendbanimin e fëmijës dhe të bashkëshortit të pasiguruar gjatë kohëzgjatjes së gjykimit të zgjidhjes së martesës. Gjykata me vendim do të caktojë detyrimin e ushqimit, edukimit, shkollimin, vendosjen e fëmijës (Zaçë, 1996: 144). Masat e përkohshme caktohen edhe për ushqimin dhe vendosjen (vendbanimin) e bashkëshortit të pasiguruar.

¹²⁹ Problemi të këto shkurorëzime qëndron se ato në fillim paraqesin martesa formale, ndërsa me kalimin e kohës shndërrohen në martesa reale dhe gruaja qëndron vetëm në vendlindje për t'u kujdesur për fëmijët. Për detajet mbi problemet e ndeshura në praktikën gjyqësore të vendeve të marra në analizë, shih referencat numër 29 dhe 113 të këtij punimi.

Gjykata kur është fjala për caktimin e masave të përkohshme për fëmijët, vendos sipas detyrës zyrtare. Ndërsa për caktimin e masave të përkohshme për bashkëshortin e pasiguruar gjykata i cakton këto masa vetëm sipas propozimit të bashkëshortit (Oruçi, 1994: 100). Është e rëndësishme të theksohet se, edhe pse ka filluar gjykimi i zgjidhjes së martesës, martesë ende nuk konsiderohet e përfunduar ndaj të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë vazhdojnë të ekzistojnë. Nga ana tjetër, duhet pranuar faktin se gjatë periudhës që gjykohej zgjidhja e martesës, tronditja faktike e marrëdhënies martesore shoqërohet me mospërmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga martesë. Në këtë kuptim me të drejtë në literaturën juridike konsiderohet se nga momenti i ngritjes së padisë së zgjidhjes së martesës e deri në përfundim të këtij gjykimi "gjendja *de jure* e bashkëshortëve nuk i korrespondon gjendjes *de facto* ndërmjet tyre" (Filipescu, 1995: 122). Në literaturën juridike, pranohet gjithashtu se masat e përkohshme që mund të merren gjatë gjykimit të zgjidhjes së martesës paraqesin këto veçori dalluese (Omari, 2010: 223):

- mund të vendosen nga gjykata vetëm *me kërkesën e palës së interesuar* në gjykim.

Në këto kushte gjykata nuk mund të ndërmarrë asnjë nga masat e mësipërme¹³⁰;

- kanë karakter *sekondar* në raport me kërkesën kryesore të zgjidhjes së martesës;
- kanë karakter *të përkohshëm*¹³¹;

¹³⁰ Masat e përkohshme do të merren nga gjykata vetëm nëse ekziston një padi për zgjidhjen e martesës dhe ajo është në gjykim e sipër. Në zbatim të parimit të së drejtës, *accessorium sequitur principalem*, masat e përkohshme do të ndjekin fatin e objektit kryesor të gjykimit pra, zgjidhjes së martesës. Për rrjedhojë, nëse gjykata pushon gjykimin për zgjidhjen e martesës të njëjtën pasojë do të kenë edhe masat e përkohshme të marra gjatë këtij gjykimi.

¹³¹ Kohëzgjatja e tyre varet nga ajo e procesit të zgjidhjes së martesës. Masat e marra nga gjykata do të zgjasin për aq kohë sa zgjat gjykimi. Gjithashtu theksojmë se, nëse gjykata pezullon gjykimin e padisë apo pezullon shpalljen e vendimit, zgjidhja e martesës konsiderohet e papërfunduar ndaj edhe masat e përkohshme do të vazhdojnë të sjellin pasojë gjatë gjithë këtij intervali kohor.

- janë të *ndryshueshme*: masat e përkohshme mund të shfuqizohen apo të ndryshohen edhe gjatë gjykimit të zgjidhjes së martesës, nëse vërtetohet ndryshimi i rrethanave që kanë detyruar gjykatën të marrë këtë masë, apo kur masa është marrë mbi të dhëna jo të sakta;

- marrja e masës së përkohshme *nuk kushtëzon vendimin përfundimtar*, në drejtim të përmbajtjes së pasojave të zgjidhjes së martesës¹³².

Sipas nenit 70 të LFRK, *bashkëshortët nuk do të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t'i ketë mbushur një vit*. Arsytet që lidhen me gjendjen shëndetësore dhe emocionale të bashkëshortes në gjendje shtatëzanie dhe interesi për mbarëvajtjen e shtatëzanisë, kanë detyruar ligjvënësin të parashikojë një rregull të veçantë procedural në rastin e gjykimit të padisë së zgjidhjes së martesës. Njëkohësisht, kjo mund të llogaritet si një masë e përkohshme për të mbrojtur interesat e fëmijëve dhe të bashkëshortes.

Edhe pse parashikohet shprehimisht vetëm afati maksimal të këtij pezullimi, ai nuk mund të zgjasë më tepër se një vit nga lindja e fëmijës. Nga interpretimi logjik i kësaj dispozite është e kuptueshme se me këtë përcaktohet edhe një afat minimal, që është koha nga data e kërkesës për pezullim deri në atë të lindjes së fëmijës. Në këto kushte, afati i pezullimit nuk mund të jetë më i vogël se sa intervali i shtatzënisë që ka mbetur deri në çastin e lindjes së fëmijës, pasi qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e këtij pezullimi ka

¹³² Marrja e masës së përkohshme në favor të njërit bashkëshort nuk përjashton mundësinë që duke u bazuar në provat e administruara, gjykata të japë një zgjidhje përfundimtare në favor të bashkëshortit tjetër. Kështu p.sh, nëse nëpërmjet masës së përkohshme fëmija i është besuar njërit prind, në vendimin përfundimtar ai mund t'i besohet prindit tjetër. Gjithashtu, nëse nëpërmjet masës së përkohshme gjykata ka përcaktuar një shumë të caktuar për kontributin e prindit me të cilin nuk banon fëmija, si rezultat i një hetimi më të plotë të rrethanave konkrete, kjo shumë mund të zvogëlohet, rritet apo sipas rastit, të mbetet e pandryshuar.

qenë pikërisht mbarëvajtja e shtatzënisë dhe realizimi i lindjes së fëmijës në kushte emocionale të favorshme për nënën e fëmijës. Në fakt, ajo që do të përcaktojë gjykata si kohë pezullimi është pikërisht periudha pas lindjes së fëmijës, pasi muajt e shtatzënisë konsiderohen *ispo lege* të pezulluar. Prandaj si kriter referimi për përcaktimin e afatit të pezullimit, do të merret data e lindjes së fëmijës dhe jo data kur gjykata vendos pezullimin e zgjidhjes së martesës. Nga ana tjetër, pezullimi nuk mund të zgjasë më tepër se një vit nga data e lindjes së fëmijës, pasi ky afat maksimal rregullohet në mënyrë nga dispozitat ligjore¹³³.

Gjithashtu, kur bashkëshortët kanë paraqitur një projekt-propozim të përbashkët për zgjidhje të martesës, ata gjithashtu duhet t'i bashkëngjisin atij edhe marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, ushqim dhe edukim të fëmijëve si dhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve me fëmijët. Ligjvënësi ka paraparë edhe një masë të përkohshme lidhur me lejimin e shtyrjes së shkurorëzimit për interesa të fëmijëve (Aliu & Gashi, 2007: 172). *Leja* për shkurorëzim mund të mos jepet ose mund të shtyhet edhe pse martesa ka dështuar, vetëm në raste të veçanta nëse dhe përderisa ruajtja e martesës bëhet për arsye specifike, të domosdoshme për interesat e fëmijëve (neni 70/3).

Përveç masave të përkohshme lidhur me fëmijët gjykata mund të përcaktojë edhe masa të përkohshme për bashkëshortin i cili nuk ka të ardhura të mjaftueshme për një jetë normale. Kështu, gjatë procedurave të kontesteve martesore gjykata me vendim duke u bazuar në padi mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për

¹³³ Bazuar në hipotezën e këtij teksti ligjor, teorikisht afati maksimal gjatë të cilit do të pezullohet zgjidhja e martesës, do të jetë një vit e 8 muaj, nëse në datën kur gruaja pretendon pezullimin e gjykimit, ndodhet në muajin e parë të shtatzënisë.

bashkëshortin dhe vendosjen e tij. Ankesa kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij. Në kuadër të masave të përkohshme, duhet llogaritur edhe caktimi i masës së përkohshme për përkujdesje dhe administrimin e pasurisë së përbashkët derisa të përfundojë procedura.

c) Seanca kryesore apo prezantimi i provave

Seanca kryesore, ose procedura e provave, paraqet fazën qendrore të procedurës së shkurorëzimit. Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve të kontestit martesor, të cilët kanë të bëjnë me mbledhjen, ekzaminimin dhe çmuarjen, me qëllim të vërtetimit të gjendjes materiale juridike. Konstatimi i gjendjes faktike është detyrë e gjykatës dhe e subjekteve të procedurës¹³⁴. Gjykata mund të vërtetojë saktësinë e fakteve mbi të cilat palët mbështesin kërkesën e tyre dhe kur ato fakte nuk janë kontestuese mes palëve (Vojisllav, 1980: 201).

Procedura e shkurorëzimit dhe gjykimi i çështjes së tillë zhvillohet sipas parimit procedural civil të kontradiktoritetit (Zaçë, 1996: 145). Në këtë kontekst duhet theksuar që gjykata do të vlerësojë me shumë kujdes dëshminë e fëmijës që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, i cili sipas legjislacionit shqiptar, do të pyetet në prani të psikologut (Omari, 2010: 221). Në disa raste do të shërbejë si provë edhe kallëzimi penal i njërit bashkëshort ndaj tjetrit, edhe pse më pas ky është i tërhequr, vërtetimi i organeve të rendit, raporti mjekësor, ose vizita apo mjekimi në një qendër spitalore të cilat vërtetojnë dëmtimet që ka pësuar njëri nga bashkëshortët.

¹³⁴ Kështu, gjykata nuk është e lidhur me propozimin e palëve sa i përket administrimit të provave, sepse sipas detyrës zyrtare me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, mund të urdhërojë edhe vetë nxjerrjen e provave që palët nuk i kanë propozuar.

Gjykata përveç këtyre provave, mund të angazhojë edhe ekspertë të ndryshëm për të dhënë mendimet e tyre profesionale lidhur me ndonjë çështje. Mendimi i ekspertëve do të shërbejë si provë të cilën gjykata do ta shqyrtojë së bashku me provat e tjera. Nuk përjashtohet administrimi i provave shkencore, letra, telegrame, kartolina, e-mail, etj, nga të cilat mund të rezultojë si shkak që ka tronditur marrëdhëniet martesore ashtu edhe pamundësia e vazhdimit të jetës së përbashkët. Gjithashtu, gjatë administrimit të provave për zgjidhjen e martesës duhet të garantohet e drejta e jetës intime dhe private e çdo bashkëshorti¹³⁵.

Kur bashkëshortët kanë paraqitur propozimin e tyre të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje, gjykata si rregull nuk zhvillon procedurë të provave. Faktet dhe provat të cilët janë paraqitur në marrëveshje nuk analizohen dhe vërtetohen. Megjithatë, gjykata mund të zhvillojë procedurë të provave, kur sipas padisë vlerëson se është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të fëmijës (Aliu & Gashi, 2007: 174). Gjithashtu, nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, gjykata mund t'i hetojë të gjitha faktet kur bashkëshortët e kanë paraqitur marrëveshjen për përkujdesje, ushqim dhe shkollim të fëmijëve. Këtë shqyrtim gjykata mund ta bëjë nëse bindet se marrëveshja e bashkëshortëve për fëmijët nuk garanton se është në interes të fëmijëve¹³⁶.

¹³⁵ Duhet theksuar se gjykata nuk mund të administrojë prova shkresore të cilat cenojnë lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës, pasi secili nga bashkëshortët gëzon këtë të drejtë themelore të parashikuar nga Kushtetuta e vendeve në fjalë.

¹³⁶ Një specifikë e legjislacionit kosovar është se: *kur procedura ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me anë të marrëveshjes së dyanshme, faktet në të cilat është mbështetur propozimi nuk hetohen, sidoqoftë gjykata mund të vendosë që të zhvillohet procedura e provave, sikurse sipas padisë për shkurorëzim, nëse në procedurën e pajtimit çmon se për arsye fundamentale fëmijët e përbashkët të mitur kërkojnë që të ruhet martesa (neni 84 LFRK).*

IV. 5. Marrja e vendimit

Marrja e vendimit paraqet fazën e fundit në procedurën e shkurorëzimit, ku gjykata vendos me aktgjykim, pavarësisht se procedura është e filluar me padi apo me propozim të përbashkët. Gjykata me aktgjykim mund të refuzojë padinë dhe propozimin për shkurorëzim ose të lejojë shkurorëzimin. Në procedurën e shkurorëzimit nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesës ose në bazë të pohimit (Vojisllav, 1980: 201). Gjykata ka rol vendimtar në kontestet të zgjidhjes së martesës dhe nuk është vetëm ndërmjetësuese, edhe kur është fjala për zgjidhje me marrëveshje të martesës, për shkak se është organ i cili vendos në mënyrë meritore (Komar *et al.*, 1996: 172).

Mund të ndodhë që procedura për shkurorëzim të ndërpritet, edhe atë për shkak të tërheqjes së padisë. Kështu që, sipas dispozitave ligjore të përgjithshme të procedurës kontestimore, nëse paditësi e tërheq padinë para se të fillojë seanca kryesore, nuk i nevojitet pëlqim nga i padituri. Ndërkaq, prej fillimit të seancës kryesore e deri në përfundim të saj, për tërheqjen e padisë nevojitet edhe pëlqimi i të paditurit. Heqja dorë nga padia ka pasoja juridike si edhe tërheqja e padisë (Aliu & Gashi, 2007: 174). Në momentin kur paditësi e tërheq padinë, në pajtim me dispozitat ligjore, gjykata do të sjellë vendim me të cilin do ta vërtetojë atë, pra tërheqjen e padisë. Në qoftë se padia tërhiqet pas sjelljes së vendimit të shkallës së parë, gjykata e shkallës së parë do të sjellë vendim dhe do të konstatojë se padia është e tërhequr, kështu, aktvendimi i shkallës së parë nuk do të ketë efekte juridike dhe procedura do të ndërpritet¹³⁷.

¹³⁷ Deklarata për tërheqjen e padisë lëshohet deri te gjykata e shkallës së parë edhe atëherë kur procedura sipas mjeteve të rregullta juridike të ankimit ka filluar. Në këto raste gjykata e shkallës së parë do t'i kërkojë

Një nga çështjet e rëndësishme në drejtim të shkurorëzimit, është përcaktimi i momentit kur martesë do të konsiderohet e zgjidhur. Përcaktimi i ditës së saktë të zgjidhjes së martesës ka rëndësi të veçantë praktike, pasi nga ky moment nuk mund të ushtrohen më të drejtat që lindin nga martesë dhe gjithashtu nuk ekziston detyrimi ligjor për përmbushjen e detyrimit që vijnë prej saj. Nga ana tjetër, përcaktimi i këtij momenti është i rëndësishëm për lindjen e disa të drejtave dhe detyrimeve të reja që i njihen ish bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës¹³⁸.

Regjistrimi i vendimit të zgjidhjes së martesës përfaqëson një mjet publiciteti, nëpërmjet të cilit fakti juridik i zgjidhjes së martesës i bëhet i njohur ndaj çdo personi të tretë që ka interes për këtë ndryshim të gjendjes civile të bashkëshortëve. Ky funksion publikues i regjistrimit ka rolin e një publikimi deklarativ (Galgano, 1999: 879). Ky regjistrim është i nevojshëm në mënyrën që pasojat e zgjidhjes së martesës të mund t'i drejtohen edhe personave të tretë. Pas regjistrimit të zgjidhjes së martesës, askush nuk mund të pretendojë se nuk ka dijeni për faktin që, personat me të cilët të tretët kanë marrëdhënie juridike, nuk kanë më cilësinë e bashkëshortit.

shkresat nga gjykata e shkallës së dytë dhe do të sjellë vendim ku do të konstatojë se padia është tërhequr, kështu vendimi nuk do të ketë efekte juridike dhe procedura do të ndërpritet.

¹³⁸ Vendimi i gjykatës për shkurorëzim i fillon efektet për bashkëshortët nga data që ai merr formën e prerë, ndërsa për të tretët, nga data kur regjistrohet në zyrën e gjendjes civile. Vendimi i zgjidhjes së martesës që ka marrë formë të prerë përfaqëson një vendim që ndryshon një nga përbërësit e gjendjes civile të individit dhe konkretisht statusin martesor. Vendimi i zgjidhjes së martesës që ka marrë formë të prerë i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile. Në bazë të këtij vendimi nëpunësi i gjendjes civile, pasqyron në regjistrin e gjendjes civile ndryshimin që ka pësuar njëri nga përbërësit e gjendjes civile të individit dhe konkretisht statusi martesor. Si pasojë e këtij ndryshimi, personi nga "i/e martuar", do të konsiderohet "i shkurorëzuar". Duhet theksuar se vendimi për zgjidhjen e martesës është vendim krijues konstitutiv, pasi ai krijon një gjendje të re juridike. Ky vendim, nga ana tjetër, për shkak pasojave të rëndësishme që sjellë është e nevojshme t'u bëhet i njohur edhe të tretëve.

IV.6. Mjetet juridike të ankimit të vendimit

a. Mjetet e rregullta juridike – ankesa- Ankesa si mjet i rregullt juridik paraqitet kundër aktgjykimit i cili nuk e ka marrë formën e prerë. Me rastin e nxjerrjes së vendimit për refuzimin ose lejin e shkurorëzimit, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit (Podvorica, 2006: 134). Lidhur me ankesën vendos gjykata e shkallës më të lartë. Ankesa mund të paraqitet për: a) shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, b) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe c) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike (Komar *et al.*, 1996: 172).

Ndërsa kur procedura ka filluar me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve, ankesa është e kufizuar. Aktgjykimi me të cilin zgjidhet martesë sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje mund të goditet vetëm për shkak të: a) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore ose b) për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e dhunës, kanosjes, mashtrimit ose lajthimit (Aliu & Gashi, 2007: 176).

b. Mjetet e jashtëzakonshme juridike - Meqenëse edhe procedura e shkurorëzimit është procedurë civile, si mjete të jashtëzakonshme konsiderohen: a) revizioni, b) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë; c) propozimi për përsëritjen e procedurës. Mjetet e jashtëzakonshme juridike mund të paraqitet vetëm nëse janë shfrytëzuar mjetet e rregullta juridike (ankesa). Pasi, të ketë marrë formën e prerë vendimi i dhanë sipas ankesës, mund të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme. Nëse martesë është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkurorëzim dhe për anulimin e martesës nuk mund të goditet me mjet të jashtëzakonshëm juridike (Podvorica, 2006: 135). Me këtë rast,

vendimi me të cilin gjykata e ka lejuar ose refuzuar shkurorëzimin nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme vetëm në pjesën që i përket lejimit ose refuzimit. Ndërsa në pjesët tjera të aktgjykimit siç janë: vendosja lidhur me mbajtjen e fëmijëve, mbajtjen e bashkëshortit (alimentacionit) etj., mund të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme juridike. Në të gjitha rastet në mungesë të dispozitave të veçanta për procedurën e shkurorëzimit në mënyrë subsidiare, zbatohen dispozitat e procedurës kontestimore.

KAPITULLI V

PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS

V.1. Kategorizimi i pasojave që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës

Me rastin e zgjidhjes së martesës i jepen fund marrëdhënieve juridike ndërmjet bashkëshortëve të krijuara si rezultat i lidhjes së martesës. Në këtë kuptim, zgjidhja e martesës përfaqëson një fakt juridik me vërtetimin e të cilit ligji parashikon shuarjen e marrëdhënies martesore. Sikurse dhe fakti juridik i vdekjes së njërit bashkëshort, edhe zgjidhja e martesës sjell pasoja për të ardhmen. Disa autorë përmendin si pasoja juridike të shkurorëzimit: pasojat emocionale, ligjore, ekonomike, sociale dhe psikike dhe pasojat rreth bashkëpunimit me rastin e shkurorëzimit (Weisberg & Appleton, 1998: 538-540)¹³⁹. Pasojat konsistojnë në pushimin, ndryshimin apo krijimin e disa të drejtave e detyrimeve ndërmjet ish bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre. Vendimi gjyqësor, pasi merr formën e prerë, i jep fund martesës dhe prodhon pasoja juridike të karakterit personal dhe pasuror të lidhura me bashkëshortin dhe fëmijët (Zaçë, 1996: 149). Në bazë të kriterit të *subjekteve* për të cilat rrjedhin këto pasoja, do të dallojmë:

- a) pasojat që rrjedhin nga zgjidhja e martesës ndërmjet ish bashkëshortëve;
- b) pasojave që rrjedhin ndërmjet secilit prej tyre dhe ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijëve që kanë lindur nga kjo martesë.

¹³⁹ Efektet juridike të shkurorëzimit të natyrës emocionale reflektohen në emocionet e bashkëshortëve, duke qenë se prishja e martesës nënkupton edhe prishjen e lidhjes emocionale me ish bashkëshortin. Efektet ligjore shfaqen në aspektin e zhvillimit të procedurave ligjore me rastin e shkurorëzimit, duke qenë se shkurorëzimi bëhet vetëm me procedurë gjyqësore. Shkurorëzimi përfshin edhe efekte ekonomike që reflektohen në pasurinë e bashkëshortëve dhe ndarjen e kësaj pasurie me rastin e shkurorëzimit.

Ndërsa në bazë të kriterit të *objektit* të pasojave që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës, si në rastin e marrëdhënieve ndërmjet ish bashkëshortëve, ashtu edhe marrëdhënies prindërore (Omari, 2010: 225), do të dallojmë ndërmjet: a) pasojave personale jo pasurore dhe b) pasojave pasurore. Doktrina shqiptare argumenton se, praktika ka treguar se pasojat që lë mbarimi i martesës tek bashkëshortët varen shumë nga gjinia e bashkëshortit/es (Mandro, 2014: 100).

V.2. Pasojat e zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët

Zgjidhja e martesës shoqërohet nga disa pasoja juridike, të cilat janë të rregulluara me ligj, të cilat shfaqen në një plan të dyfishtë. Një pjesë e tyre kanë të bëjnë me mbarimin e marrëdhënies martesore, ndërkohë që një pjesë tjetër i referohet ruajtjes apo lindjes së disa të drejtave të reja pas zgjidhjes së martesës. Në të njëjtën kohë, zgjidhja e martesës shuan për të ardhmen marrëdhënie martesore ndërmjet bashkëshortëve dhe për rrjedhojë të drejtat dhe detyrimet që buronin nga kjo martesë. Kështu, si pasojë e zgjidhjes së martesës, ish bashkëshortët nuk do të kenë më detyrimin për jetesë të përbashkët, për besnikëri bashkëshortore, për mbështetje emocionale, për bashkëpunimin në interes të familjes, e të tjera si këto. Shuarja e këtyre ndodh pra, automatikisht me vërtetimin e faktit të zgjidhjes së martesës (Omari, 2010: 225). Në këto rrethana, gjykata nuk duhet të parashikojë në vendimin e zgjidhjes së martesës përfundimin e secilës prej të drejtave e detyrimeve bashkëshortore. Ndryshe nga pavlefshmëria e martesës, e cila si rregull shuan pasojat jo vetëm për të ardhmen, por edhe për të shkuarën, zgjidhja e martesës nuk cenon ato pasoja që ka sjellë martesa që nga data e lidhjes së saj e deri në momentin kur vendimi i zgjidhjes së martesës merr formë të prerë.

Megjithëse zgjidhja e martesës i jep fund marrëdhënies juridike ndërmjet ish bashkëshortëve, disa nga të drejtat ekzistuese apo pjesë të veçanta nga këto të drejta, ruhen edhe pas zgjidhjes së martesës. Kështu për shembull, zotësia për të vepruar e fituar nga bashkëshorti i mitur si rezultat i lidhjes së martesës, ruhet edhe pas zgjidhjes së saj (Omari, 2010: 226). Ndërkohë ndërmjet bashkëshortëve ruhen disa nga të drejtat që kanë ekzistuar gjatë martesës. Sipas legjislacionit në fuqi, në kushte të caktuara mund të ruhet mbiemri, detyrimi për ushqim dhe e drejta e përdorimit të banesës së ish bashkëshortit tjetër. Në këto rrethana, disa gjurmë të marrëdhënies bashkëshortore do të ruhen edhe pas zgjidhjes së martesës, por vetëm në ato raste kur gjykata vendos t'i njohë ato. Pas zgjidhjes së martesës, në ngarkim të njërit ish bashkëshort mund të lind detyrimi për të dhënë një kontribut kompensues në favor të ish bashkëshortit tjetër. Sikurse do të trajtojmë më poshtë, e drejta për të përfituar kontributin kompensues që i njihet ish bashkëshortit pas zgjidhjes së martesës e ka burimin në marrëdhënien e mëparshme martesore, e cila edhe pse përfundon, nuk mund të konsiderohet se nuk ka ekzistuar kurrë. Në çdo rast, sikurse do të trajtojmë në vijim të këtij kapitulli secilën prej tyre, ndryshe nga shuarja e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjellta ndaj ish bashkëshortëve, lindja e të drejtave pas zgjidhjes së martesës paraqet dy veçori të posaçme:

- të drejtat që njihen ndërmjet bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës janë të njëanshme: ato njihen vetëm ndaj njërit ish bashkëshort dhe jo në mënyrë reciproke;
- të drejtat që njihen pas zgjidhjes së martesës, nuk rrjedhin *ex lege* nga data e zgjidhjes së martesës, por për njohjen e së cilës prej tyre, ish bashkëshorti i interesuar duhet t'i drejtohet me një kërkesë të veçantë gjykatës, kërkesë e cila si rregull i

bashkëngjitet kërkesë padisë për zgjidhjen e martesës: në këto kushte këto të drejta do të lindin vetëm nëse gjykata, pas një hetimi të plotë të rrethanave të çështjes në gjykim, do të vlerësojë njohjen e tyre.

V.2.1. Pasojat e zgjidhjes së martesës në marrëdhëniet personale jopasurore

Pas zgjidhjes së martesës, detyrimet personale që ekzistonin ndërmjet bashkëshortëve përfundojnë për të ardhmen. Kështu, pas marrjes formë të prerë të vendimit të zgjidhjes së martesës, bashkëshortët nuk i detyrojnë njëri tjetrit, jetesë të përbashkët, mbështetje morale dhe emocionale, bashkëpunim në interes të familjes, ruajtje të besnikërisë bashkëshortore ose ndonjë detyrim tjetër që rrjedh nga martesa (Mandro, 200: 325). Pasi vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ai i dërgohet zyrës së gjendjes civile ku bashkëshortët kanë vendbanim apo vendqëndrimin e tyre, me qëllim që të regjistrohet zgjidhja e martesës në regjistrin përkatës¹⁴⁰. Sa i përket personave të tretë, vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës i fillon efektet e tij nga data e regjistrimit të tij në zyrën e gjendjes civile. Pasojat juridike personale që kanë efekt të drejtpërdrejtë ndaj ish bashkëshortëve, duke filluar nga data që vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës ka marrë formën e prerë, janë: gjendja statusore; mbiemri; zotësia për të vepruar e fituar nga martesa; shtetësia e fituar si pasojë e martesës (Oruçi, 1994: 101).

Gjendja statusore. Pasi vendimi merr formën e prerë, ish bashkëshortët nuk gëzojnë më gjendje civile "i/e martuar". Sipas Ligjit për Gjendjen Civile të Republikës së

¹⁴⁰ Kështu, për shembull sipas nenit 14/2 në Ligjin shqiptar nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar: *Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij.*

Shqipërisë (neni 13/5), pas këtij momenti secili prej ish bashkëshortëve gëzon statusin e personit të shkurorëzuar. Nga ky moment secili prej ish bashkëshortëve mund të lidhë martesë të re, pasi statusi martesor i personit të martuar, i cili konsiderohet pengesë për lidhjen e martesës nuk ekziston më (Aliu & Gashi, 2007: 178).

Mbiemri. Problemi i kthimit të mbiemrit shfaqet kur mbiemrat e bashkëshortëve janë ndryshuar me rastin e martesës (Weisberg & Appleton, 1998: 269). Efektet juridike lidhur me mbiemrin e bashkëshortëve shkaktohen nëse njëri ose të dy bashkëshortët e kanë ndërruar mbiemrin me rastin e lidhjes së martesës. Bashkëshorti i cili e ka ndryshuar mbiemrin me rastin e lidhjes së martesës, pas shkurorëzimit ka të drejtë të mbajë mbiemrin martesor ose ta kthejë mbiemrin e mëparshëm para lidhjes së martesës. Të drejtën e kthimit të mbiemrit e kanë të dy bashkëshortët pavarësisht fajit të tyre. Sipas nenit 96 të LFRK, bashkëshorti i cili me rastin e lidhjes së martesës e ka ndryshuar mbiemrin, pas zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin e mëparshëm.

Deklarata për ndryshimin e mbiemrit i paraqitet zyrës së gjendjes civile. Kjo do të thotë se realizimi i kësaj të drejte varet posaçërisht nga vullneti i bashkëshortëve, nëse dëshirojnë ta rimarrin apo jo mbiemrin që kishin para lidhjes së martesës (Podvorica, 2006: 136). Në këtë rast, bashkëshorti i cili vendos të mbajë mbiemrin martesor edhe pas zgjidhjes së martesës, ka të drejtë të mbajë po këtë mbiemër edhe në qoftë se lidh martesë të re, pasi legjislacioni në fuqi nuk e ndalon një gjë të tillë (Trpenovska, 2008: 136). Kjo e drejtë mund të njihet nga gjykata, nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

- bashkëshorti që pretendon mbajtjen e mbiemrit të ish bashkëshortit, duhet ta ketë mbajtur dhe përdorur atë gjatë martesës: kështu, është e nevojshme të vërtetohet që ky bashkëshort ka përzgjedhur alternativën e mbajtjes së mbiemrit të bashkëshortit tjetër;

- mbajtja në vazhdimësi e mbiemrit duhet të përligjet nga interesi personal i bashkëshortit që pretendon njohjen e së drejtës apo i fëmijës: duhet theksuar se, sipas doktrinës, "vetëm vërtetimi i faktit se njëri bashkëshort ka mbajtur për shumë kohë mbiemrin e bashkëshortit tjetër, nuk mund të konsiderohet një shkak me rëndësi për të njohur të drejtën e mbajtjes së këtij mbiemri dhe pas zgjidhjes së martesës" (Filipescu, 1995: 24). Për sa i përket vërtetimit të interesit personal të ish bashkëshortit që pretendon ruajtjen e mbiemrit, në praktikë shfaqen raste kur për shkak të veprimtarisë artistike apo sportive, publikimeve shkencore, ose aktivitetit tregtar, ky bashkëshort identifikohet dhe njihet nëpërmjet mbiemrit të ish bashkëshortit. Në të gjitha këto rrethana apo të tjera të ngjashme me to, ndryshimi i mbiemrit pas zgjidhjes së martesës, mund t'i krijojë një dëm moral apo pasuror këtij ish bashkëshorti. Në drejtim të interesit të fëmijës, vërtetimi është relativisht më i lehtë, pasi në rastet kur këtij bashkëshorti i janë besuar fëmijët, ruajtja e të njëjtit mbiemër midis fëmijës dhe këtij prindi mund të konsiderohet e rëndësishme për interesat e fëmijës (Bonilini, 2002: 232). Duhet theksuar gjithashtu se mbajtja e mbiemrit të ish bashkëshortit pas zgjidhjes së martesës është një mundësi përjashtimore, ndaj gjykata duhet të vërë në balancë interesin e ish bashkëshortit të interesuar nga njëra anë, dhe cenimin e së drejtës personale apo dëmi që mund t'i shkaktohet ish bashkëshortit tjetër nga përdorimi në vazhdimësi i mbiemrit të tij, nga ana tjetër.

LFRK nuk bën dallimin mes anulimit dhe shkurorëzimit, por vetëm e përdor shprehjen në *"rast të zgjidhjes së martesës"*. Në këtë aspekt duhet bërë dallimin mes anulimit dhe shkurorëzimit, sepse vendimi gjyqësor, të rasti i anulimit të martesës ka fuqi juridike prapavepruese, pasojat juridike shkaktohen nga momenti i lidhjes së martesës *"ex tunc"* dhe jo nga momenti i zgjidhjes të martesës *"ex nunc"* (Aliu & Gashi, 2007: 178-179). Martesa e anuluar konsiderohet se nuk është lidhur asnjëherë dhe në rastin e anulimit të martesës bashkëshortët duhet t'i kthejnë mbiemrat e mëparshëm, pavarësisht dëshirës së tyre. Ndërsa të shkurorëzimi, kjo do të varet nga dëshira e bashkëshortëve për të ndryshuar mbiemrin martesor dhe kthyer mbiemrin e mëparshëm, për shkak se shkurorëzimi është zgjidhja e martesës së vlefshme. Vendimi i gjykatës për shkurorëzim ka efekt juridik për të ardhmen (*ex nunc*).

Në lidhje me çështjen e mbiemrit, doktrina shqiptare ka vënë në dukje problemet që lidhen me mbiemrin nga zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok, kur maresa është lidhur sa për të ndryshuar mbiemrin e bashkëshortit (Mandro, 2014: 86)¹⁴¹. Në një rast të trajtuar nga jurisprudenca vendase, nga faktet e paraqitura, martesa ka zgjatur vetëm 4 muaj dhe çifti nuk ka patur fëmijë. Doktrina (Mandro) komenton se:

pas zgjidhjes së martesës dhe mbajtjes së mbiemrit të gruas, (sepse martesa ishte zgjidhur me pëlqim reciprok), bashkëshorti është larguar gati menjëherë pas martese për në Austri, por në marrëveshjen e paraqitur, ai kërkon të mbajë mbiemrin e bashkëshortes dhe kjo e fundit nuk ka kundërshtime. Asnjë analizë nuk është kryer nga gjykata lidhur me interesin që ka bashkëshorti për të mbajtur këtë mbiemër.

Zotësia për të vepruar e fituar nga martesa. Sikurse është trajtuar edhe tek kushtet e lidhjes së martesës, sipas nenit 7 të KFRSH aktualisht në fuqi, në disa raste gjykata mund të autorizojë lidhjen e martesës së bashkëshortëve të cilët nuk kanë mbushur moshën

¹⁴¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 6042 datë 30.05.2013

madhore. Në zbatim të kësaj dispozite, neni 6 i K.C. shqiptar parashikon se i mituri që ka lidhur martesë fiton zotësi të plotë për të vepruar që nga data e lidhjes së martesës. Nëse martesë e lidhur në këto kushte zgjidhet para se bashkëshorti të ketë arritur moshën madhore, zotësia për të vepruar, edhe pse e fituar për shkak të martesës, nuk humbet (Omari, 2010: 228).

Shtetësia e fituar si pasojë e martesës. Sipas legjislacionit të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe i shumicës së shteteve, një nga pasojat e posaçme të lidhjes së martesës, mund të jetë dhe fitimi i shtetësisë nga bashkëshorti shtetas i huaj, në raste kur ky ka lidhur martesë me një shtetas të po atij vendi¹⁴². Nga ana tjetër, me rastin e zgjidhjes së martesës mes këtyre dy bashkëshortëve, nuk kemi si pasojë humbjen e shtetësisë së fituar me anë të lidhjes së martesës. Kjo është arsyeja pse ka një numër të lartë të martesave fiktive (dhe për rrjedhojë të zgjidhjeve fiktive të martesave, të cilat në të vërtetë, duhet të shpallen të pavlefshme), të lidhura me shtetas të huaj me qëllim të ndryshëm nga ai i jetesës së përbashkët si burrë dhe grua, siç është pikërisht ai i fitimit të një shtetësie të huaj me të gjitha avantazhet që rrjedhin prej saj.

V.2.2. Pasojat e zgjidhjes së martesës në marrëdhëniet personale pasurore

Pasojat në marrëdhëniet pasurore lidhen me: detyrimin e mbështetjes materiale, trashëgiminë, pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, *banesën familjare*, detyrimin ushqimor të bashkëshortit të pasiguruar; dhurimin, dëmshpërblimin (Oruçi, 1994: 101).

¹⁴² Megjithatë, rezulton se Maqedonia u mohon shqiptarëve shtetësinë me motivacionin se ata konsiderohen “persona që rrezikojnë integritetin dhe sigurinë e qytetarëve dhe të Republikës së Maqedonisë.” Për më gjerë shih <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=22025>, parë në datë 20 maj 2015.

Detyrimi i mbështetjes materiale. Si rezultat i zgjidhjes së martesës, detyrimi i kontributit material për përballimin e shpenzimeve të përditshme në familje do të pushojë së ekzistuari. Në këto kushte, si rregull secili nga ish bashkëshortët do të përballojë shpenzimet personale pas zgjidhjes së martesës.

E drejta e trashëgimisë. Si rregull, çështja e trashëgimisë ligjore dhe testamentare pas zgjidhjes apo anulimit të martesës, zgjidhet sipas dispozitave mbi trashëgiminë të tre shteteve të marra në analizë. Në kontekst të saj del se bashkëshortët pas zgjidhjes së martesës apo anulimit të saj, nuk kanë të drejtë në trashëgiminë ligjore. Kështu, për shembull sipas nenit 98 të LFRK, pas zgjidhjes apo anulimit të martesës me vendim të gjykatës, ish bashkëshortët e humbin të drejtën e trashëgimisë ligjore.

Në varësi të faktit se testamenti është përpiluar përpara apo pas zgjidhjes së martesës, edhe sa i përket trashëgimisë testamentare, në doktrinën juridike paraqiten dy situata juridike, të cilat në thelb dallojnë njëra prej tjetrës. Sipas *situatës së parë*, kur testamenti është përpiluar përpara zgjidhjes së martesës, ai nuk mund të krijojë efekte juridike (Omari, 2010: 229). Konsiderohet se me zgjidhjen e martesës, apo me anulimin e saj, testamenti është revokuar heshtazi. Edhe pse *de lege lata* zgjidhja është paradoksale dhe në kundërshtim me parimin e lirisë së vullnetit, ajo do të zbatohet deri në një ndryshim të saj *de lege ferenda* (Komar, *et.al.*, 1999: 178). Sipas *situatës së dytë*, nëse testamenti është përpiluar pas zgjidhjes apo anulimit të martesës, ai është i plotfuqishëm dhe krijohen efekte juridike në dy raste:

- nëse trashëgimtarët ligjor nuk kanë zotësi për të fituar nga testamenti, janë bërë të padenjë për të trashëguar, apo kanë hequr dorë nga trashëgimia;

- nëpërmjet testamentit i njihet e drejta e një legu, pra e një përfitimi pasuror mbi një send të caktuar apo mbi një të drejtë tjetër pasurore (Omari, 2010: 193).

Ndërkaq, në bazë të nenit 384 të K.C. shqiptar trashëgimlënësit i njihet e drejta që nëpërmjet testamentit të ngarkojë trashëgimtarët ligjorë të përmbushin një detyrim pasuror në drejtim të ish bashkëshortit. Në këtë hipotezë, edhe pse ish bashkëshorti nuk gëzon cilësinë e trashëgimtarit me titull të përgjithshëm - mbi të gjithë pasurinë apo një pjesë të caktuar të saj – atij mund t'i njihet cilësia e trashëgimtarit me titull të posaçëm (ajo e legatarit), e cila i jep të drejtën mbi një send të përcaktuar në testament apo një të drejtë tjetër pasurore të përcaktuar¹⁴³.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët. Zgjidhja e martesës ka si pasojë pjesëtimin apo ndarjen e pasurisë së përbashkët¹⁴⁴. Pasuria e përbashkët është pasuria e krijuar me punën e përbashkët të bashkëshortëve gjatë jetës bashkëshortore. Kjo pasuri mund të krijohet si te martesa e pavlefshme ashtu edhe te martesa e vlefshme deri në zgjidhjen e saj. Pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta mes bashkëshortëve, me përjashtim të rastit kur, me kërkesë të njërit bashkëshort, do të provohet se ai ka investuar më shumë në këtë pasuri (neni 212/3 LFRM). Nga studimet e kryera për Shqipërinë për periudhën janar 2011 – qershor 2012, rezulton se bashkëshortët janë më pak aktivë se sa bashkëshortet në paditë e pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore sepse ata gëzojnë *de facto* pasurinë dhe nuk kanë

¹⁴³ Neni 332 i KFRSH, sipas të cilit trashëgimtari mund të fitojë: a) të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit - kështu, trashëgimia fitohet me *titull universal*, pra mbi tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve, pavarësisht nga përmbajtja e pasurisë; b) një pjesë të trashëgimisë - edhe në këtë rast konsiderohet se trashëgimia fitohet me *titull universal*, pasi përmbajtja e të drejtave e detyrimeve të trashëgimisë do të vlerësohet konkretisht në hapjen e trashëgimisë, në varësi të pjesës së caktuar; c) një send të caktuar apo një të drejtë tjetër pasurore, gjithashtu të përcaktuar nga trashëgimlënësi - në këtë rast, e drejta fitohet me *titull të posaçëm*, pasi trashëgimarrësi ka të drejtë *vetëm mbi sendin e përcaktuar ut singuli*.

¹⁴⁴ Ligji Për barazi gjinore i Republikës së Kosovës nr. 2004/2, datë 19.02.2004, neni 16 paragrafi 16.10: *Në rast të shkëputjes së bashkëshortëve pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.*

“interes” nga pjesëtimi gjyqësish (Mandro, 2013: 45). Nga monitorimi i praktikës gjyqësore, rezulton gjithashtu edhe problematika e tejzgjatjes së procedimeve në zgjidhjet e martesës. Kjo sidomos në çështjet pronësore, me objekt nenin 207 të Kodit Civil mbi pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi, ku rezulton që një vendim të shkojë edhe deri në 10 vjet (Mandro, 2014: 35).

Si rregull, pjesëtimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortët e bëjnë me marrëveshje (Vardarski, 1980: 150). Ndërsa kur bashkëshortët nuk mund ta pjesëtojnë pasurinë me marrëveshje, këtë e bën gjykata kompetente në procedurë kontestimore. Fillimisht gjykata e vlerëson pasurinë e përbashkët, pastaj i spastron të gjitha detyrimet që e ngarkojnë pasurinë e përbashkët. Pjesa e mbetur e pasurisë ndahet nga gjykata, e cila cakton më parë pjesët e secilit bashkëshort në bazë të kontributit të tyre (nenet 90/95 LFRK).

Praktika gjyqësore shqiptare mbi pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore është e pasur, prandaj për efektet të evidentimit të kufizimeve që ka liria kontraktore, do të evidentojmë vetëm ato më të debatuarat. Kështu për shembull, është me interes çështja nëse mund të pjestohet pasuria bashkëshortore e përbërë nga shoqëri tregtare të krijuar gjatë martesës.¹⁴⁵

Në rastin konkret, Gjykata e Lartë argumenton se: kjo pasuri mund të pjestohet dhe se:

duhet zbatuar Kodi mbi Familjen ndaj Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare nr. 9901 të datës 14.04.2008, pasi ai qëndron më lart në hierarki për shkak të shumicës së cilësuar që kërkon votimi i tij në parlament.

¹⁴⁵ Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 340, datë 26.06.2012; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur *lejimin e pjesëtimin gjyqësor të pasurisë së përbashkët të vënë gjatë jetesës bashkëshortore, duke iu njohur dhe caktuar të drejta të barabarta në këtë pasuri të përbashkët me nga ½ pjesë takues (ideale) secili*. Gjykata e Apelit Tiranë (vendimi nr. 341 i datës 12.07.2011), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë plotësim: “Lejimin e pjesëtimin të kuotave të Shoqërisë “Ë” sh.p.k dhe Shoqërisë “Ë 1” sh.p.k.”

Një tjetër vendim shqiptar që sjell risi, është ai mbi trajtimin e bashkësisë ligjore të bashkëshortëve, sipas të cilës nuk mund të përjashtohen nga ky regjim juridik sende që përfitohen gjatë kohës që bashkëshortët mund të rrijnë të ndarë *de facto*, por ndërkohë rezulojnë të martuar (*de jure*)¹⁴⁶.

Mbi përcaktimin e sendeve si vetjake apo të bashkësisë praktika gjyqësore shqiptare konkludon se:

*pasuritë e vëna gjatë martesës nën regjimin e bashkësisë ligjore do të prezumohen në pjesë të barabarta, pavarësisht se në emër të kujt kjo pasuri figuron e regjistruar*¹⁴⁷.

E drejta e banimit. Në një martesë banesa ku bashkëshortët konsumojnë raportin e tyre martesor e familjar, kthehet në vendin më të rëndësishëm dhe më afinitiv familjar, edhe sikur të jetë pronë vetjake e njërit prej tyre. Doktrina shqiptare, e cila ka analizuar raste problematike të ndeshura në praktikë, ka argumentuar se *mosmarrëveshjet lidhur me vendbanimin e imponuar nga njëri bashkëshort, mund të bëhen shkak deri në zgjidhjen e martesës* (Mandro, 2014: 91)¹⁴⁸. Megjithatë, nga pikëpamja e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës, e drejta e përdorimit të banesës trajtohet nga legjislatori shqiptar në dy këndvështrime: si një e drejtë e lidhur ngushtësisht me interesat e fëmijëve ose si një e drejtë e lidhur me interesin e bashkëshortit jo pronar, i pakushtëzuar nga interesat e fëmijëve (Mandro, 2009: 331).

¹⁴⁶ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil i Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 395 datë 04.07.2013.

¹⁴⁷ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 138 datë 13.03.2012. Gjykata ka veçuar nga bashkësia ligjore pasurinë vetjake; ajo ka konstatuar ndër të tjera pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes së 30% të kuotave që zotëronte i padituri në Shoqërinë “A.C.” SHPK, tek i vëllai A.K. Gjykata analizon fakte që lidhen me persona të cilët nuk janë subjekte procedurale në këtë gjykim, A.K., të cilit i hiqet e drejta e pronësisë mbi një pasuri aksionesh të një shoqërie pa u thirrur si palë në gjykim. Njëkohësisht gjykata nuk ka respektuar në këtë rast urdhërimet e Vendimit Unifikues nr.9/2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kështu, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në mungesë të thirrjes si i paditur nga paditësja duhej të ishte thirrur në bazë të nenit 193 të K.Pr.C. të Shqipërisë si palë e tretë në proces edhe shtetasi A.K.

¹⁴⁸ Vendimi nr. 2843/19.03.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Çdo subjekt i njihet zotësia juridike të fitojë pronësinë mbi një banesë të caktuar, apo sipas rastit të fitojë përkohësisht të drejtën për të banuar në një banesë si rezultat i lidhjes së një kontrate-qiraje me pronarin e banesës. Për rrjedhojë, pas zgjidhjes së martesës, secili nga bashkëshortët duhet të banojë në banesën që ka në pronësi, që mund të fitojë në pronësi, apo mbi të cilën ka fituar të drejtën e banimit si rezultat i lidhjes së një kontrate me kundërshtëpërblim apo kontratë qiraje, apo pa kundërshtëpërblim, apo kontratë huapërdorje (Omari, 2010: 245). Me fjalë të tjera, në kushtet aktuale çështja e përcaktimit të vendbanimit të secilit ish bashkëshort pas zgjidhjes së martesës, është një çështje me karakter privat e për rrjedhojë duhet të zgjidhet në bazë të parimeve të përgjithshme të së drejtës civile, të cilat rregullojnë mënyrat e fitimit të pronësisë së një banese apo lirinë kontraktore për të fituar të drejtën e përdorimit mbi një sipërfaqe banimi.

Megjithatë duhet pranuar se, edhe pse teorikisht në kushtet aktuale të ekonomisë së tregut, çështja e banimit mund të zgjidhet në një nga hipotezat e parashtruara më sipër, praktikisht, ish bashkëshorti që nuk ka një banesë private dhe njëkohësisht nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të fituar një të tillë, do të ndodhet në situatën e personit të pastrehë. Duke qenë se banimi është vërtetuar të jetë një nga problemet sociale më të ndeshura në këto vite, hartuesit e KFRSH e kanë trajtuar me dispozita të posaçme duke e kthyer kështu në një marrëdhënie juridike çështjen e vendimit të banimit të ish bashkëshortit që gjendet në nevojë.

Raste nga praktika gjyqësore shqiptare

Një tjetër vendim nga praktika gjyqësore shqiptare, lidhet me të drejtën e qëndrimit në banesën familjare pas zgjidhjes së martesës¹⁴⁹. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i gjykatës së Apelit për të lejuar ish-bashkëshorten jopronare për të jetuar në banesën familjare është i drejtë:

për shkak të kontributit të të paditurës në familje gjatë ndërtimit të banesës dhe për faktin se nuk vërtetohet se e paditura të ketë ndonjë mundësi strehimi përveç asaj për t'u rikthyer në banesën familjare.

Ndërkaq, sipas neneve 90-95 të LFRK, nëse bashkëshortët nuk bien dakort mbi faktin se cilit prej tyre do t'i takojë e drejta e banimit, për ndarjen e pajisjeve të shfrytëzuara bashkërisht apo të sendeve të tjera shtëpiake, për këtë do të vendosë gjykata me kërkesë të njërit apo të të dy bashkëshortëve. Në çdo rast, si kriter bazë gjykata do të marrë mirëqenien e fëmijëve dhe pozitën sociale të bashkëshortëve, nevojat e bashkëshortëve dhe të anëtarëve tjerë të familjes të cilët nga bashkëshortët kishin fituar të drejtën e banimit si dhe shfrytëzimit të banesës, si dhe rrethana të tjera të lidhura me mirëmbajtjen e banesës. Sikurse në rastin e zgjidhjes së martesës, ashtu edhe kur ajo anulohet, nga momenti i blerjes, banesa bëhet pjesë përbërëse e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, prandaj në kontestin e rregullimit të ndarjes së pronës së përbashkët do të zgjidhet edhe çështja e banesës (Podvorica, 2006: 138).

¹⁴⁹ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 366 datë 10.07.2012. Gjykata vëren se palët kanë lidhur martesë më datë 13.02.1995 dhe nga kjo martesë u kanë lindur dy fëmijët djem. Pas largimit të paditësit në emigracion midis bashkëshortëve janë paraqitur mosmarrëveshje të cilat kanë arritur deri në atë shkallë sa që e kanë bërë të pamundur bashkëjetesën dhe kanë tronditur rëndë martesën sa që ajo e ka humbur qëllimin e saj. Kështu e paditura është larguar prej më se dy vitesh nga banesa bashkëshortore në banesën e prindërve të saj, arsye për të cilën paditësi ka kërkuar zgjidhjen e martesës me të.

Detyrimi për ushqim. Kjo e drejtë u është njohur bashkëshortëve nga legjislacionet e të tre shteteve të marra në analizë. Sipas legjislacionit shqiptar, ajo caktohet për një periudhë prej 6 muajsh nga data kur vendimi i zgjidhjes së martesës ka marrë formë të prerë (neni 200 KFRSH). Nga kjo rezulton se ligjvënësi ka përcaktuar një afat maksimal për përmbushjen e këtij detyrimi, i cili nuk mund të tejkalohet nga gjykata, pavarësisht nëse nevoja e ish bashkëshortit që kërkon një gjë të tillë do të vazhdojë edhe pas kësaj periudhe. Në këtë rast dispozitat ligjore kushtëzojnë caktimin e detyrimit për ushqim me faktin që paaftësia për punë dhe mungesa e mjeteve të jetesës të bashkëshortit në nevojë të jenë shfaqur gjatë martesës dhe jo pas zgjidhjes së martesës (neni 199 KFRSH).

Në kushte të caktuara KFRSH, parashikon se një pjesë e këtij detyrimi, dhe konkretisht një mbështetje materiale në ndihmë të ish bashkëshortit që gjendet në nevojë, ruhet edhe pas zgjidhjes së martesës. Duke qenë se, për një kuptim të plotë të detyrimit për ushqim ndërmjet ish bashkëshortëve është paraprakisht i nevojshëm trajtimi i detajuar i kushteve ligjore të lindjes së këtij detyrimi, veçoritë dalluese, kriteret e përcaktimit të këtij detyrimi e të tjera, kjo pasojë e zgjidhjes së martesës duhet të analizohet në atë pjesë të këtij punimi që i kushtohet institutit të detyrimit për ushqim. Megjithatë, për një kuptim të përgjithshëm mbi këtë detyrim që vazhdon edhe pas zgjidhjes së martesës, do të shqyrtojmë më poshtë disa nga veçoritë thelbësore të tij.

Detyrimi për ushqim ndërmjet ish bashkëshortëve përfaqëson detyrimin ligjor, në bazë të të cilit njëri ish bashkëshort detyrohet të sigurojë mjetet e jetesës ish bashkëshortit që është i paaftë për punë, dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar. Në LFRK, janë paraparë gati të njejtat kushte sa i përket mbështetjes financiare dhe ushqimit të njërit

bashkëshort nga ana e tjetrit, me rastin e zgjidhjes së martesës. Kështu, neni 279 i LFRK, i cili i referohet mbajtjes financiare parashikon se: *vetëm personat të cilat financiarisht nuk mund të mbajnë veten janë të pranueshëm për mbajtjen financiare.*

Edhe pse i kushton një titull të veçantë institutit të detyrimit për ushqim, KFRSH nuk përkufizon këtë nocion juridik¹⁵⁰. Në këto rrethana, literatura juridike, me kontributin krijues të praktikës gjyqësore, ka ravigjëzuar këtë koncept duke përcaktuar edhe elementet përbërës të këtij detyrimi. Sipas një opinioni që tashmë mund të konsiderohet i konsoliduar, *detyrimi për ushqim nënkupton gjithçka që është e domosdoshme për të plotësuar nevojat themelore të jetesës* (Omari, 2010: 230). Këto nevoja përfshijnë kërkesat materiale, shëndetësore e ndonjëherë edhe kulturore, të cilat synojnë sigurimin e një jetese në kushte normale të ish bashkëshortit në nevojë.

Sikurse mund të konstatohet, detyrimi për ushqim ka një përmbajtje më të gjerë se sa ajo që evokon emërtimin e këtij detyrimi. Në këtë kuptim, duhet të theksojmë se mjetet e nevojshme për t'u ushqyer janë vetëm njëri nga elementet e këtij detyrimi, i cili nuk shteron të gjithë përmbajtjen e tij. Detyrimi për ushqim përbëhet edhe nga elementë të tjerë si: nevojat për veshmbathje, banim, energji elektrike, nevoja shëndetësore, nevoja kulturore apo çdo nevojë tjetër jetësore që përfshihet në nevojat e domosdoshme të jetesës (Omari, 2010: 231). Duke qenë se përcaktimi i nevojave të ish bashkëshortit është çështje fakti, ato do të vlerësohen rast pas rasti nga gjykata, e cila do të caktojë detyrimin për ushqim.

¹⁵⁰ Një nocion të qartë nuk e hasim as në Ligjin mbi familjen i Republikës së Maqedonisë, e as në Ligjin mbi familjen të Republikës së Kosovës.

Detyrimi për ushqim ndërmjet ish bashkëshortëve nuk është pasojë që rrjedh *ex lege* nga zgjidhja e martesës, por është një detyrim që, nëse nuk është përcaktuar me marrëveshje duhet të vlerësohet dhe njihet nga gjykata. Për sa i përket momentit kur kërkohet detyrim për ushqim, *si rregull pretendimi për caktimin e detyrimit për ushqim ngrihet njëkohësisht me zgjidhjen e martesës* (neni 199/2 KFRSH). Në këtë kuptim, kërkesa për detyrim për ushqim mund t'i bashkëngjitet kërkesë padisë së zgjidhjes së martesës, kur ky pretendim ngrihet nga bashkëshorti paditës, apo mund të parashtrohet në kundërpadi apo gjatë gjykimit nga bashkëshorti i paditur. *Përgjatë kësaj, kërkesa mund të paraqitet edhe si një padi e veçantë pas zgjidhjes së martesës* (neni 199/3 KFRSH). Për shkak karakterit të theksuar personal të detyrimit për ushqim, ai nuk mund të kërkohet nga trashëgimtarët e bashkëshortit në nevojë, e as mund të pretendohet kundrejt trashëgimtarëve pas vdekjes së bashkëshortit që duhet të përmbushë këtë detyrim.

KFRSH parasheh kushtet ligjore për njohjen e detyrimit për ushqim, e që njëkohësisht në mënyrë të ngjashme, janë paraparë edhe me legjislacionin e Maqedonisë dhe atë të Kosovës. Për caktimin e detyrimit për ushqim ndërmjet ish bashkëshortëve ai parashikon përmbushjen e disa kushteve ligjore. Neni 280/1 i LFRK i referohet parimeve për dhënien e ushqimit:

personat të cilët duke marrë parasysh të gjitha detyrimet personale nuk janë në gjendje të sigurojnë mbajtje financiare pa rrezikuar mjetet e tyre financiare të arsyeshme, nuk janë të detyruar për mbajtje financiare.

Ky nen i referohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë detyrimit të ish bashkëshortit për mbajtje, por në mënyrë analoge mund të konkludohet se edhe kur ish bashkëshorti nuk ka mjete të mjaftueshme, nuk është i detyruar të përmbushë detyrimin për ushqim. Nga leximi

në tërësi i dispozitave që rregullojnë të gjitha kategoritë e detyrimit për ushqim rezulton se ato mund të ndahen në:

- a) kushte që duhet të përmbushë ish bashkëshorti që pretendon të përfitojë nga detyrimi për ushqim - ish bashkëshorti kreditor;
- b) kushte të cilat duhet të përmbushë ish bashkëshorti debitor në drejtim të ish bashkëshortit tjetër .

Gjithashtu, duhet pasur parasysh edhe një fakt me rastin e krijimit të detyrimit për dhënie të ushqimit: bashkëshorti i cili gjatë jetës bashkëshortore nuk ka kontribuar aspak në krijimin e pasurisë së përbashkët, është sjellë si plangprishës dhe nuk është kujdesur për familjen për shkaqe objektive, nuk mund të kërkojë ushqimin, duke qenë se kjo do të paraqitej si padrejtësi ndaj bashkëshortit tjetër (Aliu & Gashi, 2007: 181). Po kështu, bashkëshorti i pasiguruar ka të drejtë të kërkojë, që në aktvendimin e zgjidhjes së martesës, t'i caktohet shuma e caktuar në emër të mbështetjes materiale në ngarkesë të tjetrit bashkëshort në përputhje me mundësitë e tij.

Përfundimisht nga ky parim, bashkëshorti mundet që me padi, në afat prej një viti pas zgjidhjes së martesës, të kërkojë mbështetje materiale nga bashkëshorti tjetër, nëse kushtet për po këtë mbështetje kanë ekzistuar në momentin e caktimit të seancës kryesore gjatë procedurës së shkurorëzimit dhe kanë ekzistuar si të tilla deri te mbarimi i seancës kryesore të procedurës për mbështetje materiale (nenet 185-191 LFRM). Mbështetja materiale dhe të ushqyerit e bashkëshortit nevojtar në Maqedoni kanë një kohëzgjatje pesë vjeçare nga zgjidhja e martesës, por ky afat mund të vazhdohet me vendim të gjykatës nëse ekzistojnë kushte të arsyeshme, sidomos në qoftë se bashkëshorti i cili kërkon një gjë të tillë nuk ka

mundësi materiale që të kujdeset për veten (neni 190 KFRM). Ndërkohë që legjislacioni shqiptar dallon detyrimin për ushqim mes ish-bashkëshortëve, për një kohë jo më të gjatë se gjashtë vjet (neni 200 KFRSH)¹⁵¹, dhe kontributin kompensues, për të cilin nuk parashikohet një kohëzgjatje maksimale. Në fakt, sipas nenit 148 të KFRSH:

Kontributi kompensues caktohet sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues dhe burimeve të tjetrit, duke marrë në konsideratë gjendjen në çastin e zgjidhjes së martesës dhe kohëzgjatjen e saj në një të ardhme të parashikueshme. Kohëzgjatja e dhënies së kontributit kompensues caktohet nga gjykata, sipas nevojave të ishbashkëshortit përfitues.

Ndërkaq në Kosovë nuk është parashikuar ndonjë afat për kohëzgjatjen e ushqimisë apo mbështetjen materiale të bashkëshortit në nevojë¹⁵².

Sipas LFRM, bashkëshorti i cili nuk posedon mjete të mjaftueshme për ekzistencë materiale dhe është i paaftë për punë ose i pa punë pa fajin e tij, ka të drejtë në mbështetje materiale nga ana e bashkëshortit tjetër në përputhshmëri me mundësitë e tij materiale. Gjykata, duke pasur parasysh të gjithë rrethanat e rastit konkret, mund të refuzojë kërkesën për mbështetje materiale dhe ushqim, në qoftë se këtë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq ose pa shkaqe të arsyeshme ka braktisur bashkëshortin e tij, në qoftë se bashkëshortët një kohë të gjatë kanë pasur jetë të ndarë edhe para zgjidhjes së martesës dhe kanë siguruar mjete për mirëmbajtje personale si dhe shkaqe të tjera të parapara me ligj (Vardarski, 1980: 151).

a) Kushtet që duhet të përmbushë ish bashkëshorti kreditor - Për caktimin e detyrimit për ushqim, bashkëshorti që pretendon këtë duhet të përmbush dy kushte:

¹⁵¹ Sipas nenit 200 KFRSH: *Detyrimi për ushqim, sipas nenit 199 të këtij Kodi, caktohet për një kohë jo më të gjatë se 6 vjet pas zgjidhjes së martesës.*

¹⁵² Neni 312 i LFRKL parashikon se kjo e drejtë pushon nëqoftëse bashkëshorti në nevojë mund të sigurojë kushtet e nevojshme jetësore, kur koha për të cilën gjykata ka përcaktuar alimentacionin kalon, apo kur bashkëshorti i cili gëzon këtë të drejtë ri-martohet ose vdes.

- *Të mos ketë mjete të mjaftueshme për të jetuar.* Nga leximi i nenit 199 dhe 201 të KFRSH, detyrimi për ushqim mund të kërkohej nëse ish bashkëshorti nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar. Gjendja në nevojë apo mungesa e mjeteve të mjaftueshme për të jetuar, përfaqëson gjendjen materiale në të cilën gjendet ish bashkëshorti që nuk mund të përballojë nevojat e domosdoshme të jetesës së përditshme. Në këto rrethana, është e kuptueshme se do të konsiderohet në nevojë ai bashkëshort, i cili nuk ka të ardhura që rezultojnë nga puna e tij apo që rrjedhin nga pasuria e tij, ose nuk ka në pronësi sende të cilat mund të tjetërsohen për sigurimin e të ardhurave të nevojshme për të jetuar. Natyrisht, do të shqyrtojmë ato të drejta pasurore, të cilat nuk janë të domosdoshme për të jetuar (Omari, 2010: 231).

Gjendja në nevojë nuk nënkupton në çdo rast mungesën totale të të ardhurave të ish bashkëshortit kreditor. Do të konsiderohet se gjendet në nevojë, edhe ai bashkëshort i cili nuk disponon të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e domosdoshme të jetesës. Në këtë hipotezë, gjendja në nevojë përfaqëson diferencën ndërmjet mjeteve të domosdoshme të jetesës dhe atyre që është në gjendje të sigurojë vetë ish bashkëshorti kreditor. Në analizë të fundit, duhet theksuar se gjendja në nevojë është e ndryshme për persona të ndryshëm. Ajo varion në bazë të moshës, gjendjes shëndetësore, nevojave kulturore dhe kushteve të tjera në të cilat jeton ish bashkëshorti kreditor (Mandro, 2009: 329).

- *Të jetë i paaftë për punë:* për të përfituar detyrimin për ushqim ish bashkëshorti kreditor duhet të mos ketë mundësi t'i sigurojë të ardhurat e nevojshme për jetesë nëpërmjet punës së tij. Në këto rrethana, ai duhet të provojë se është i paaftë për të kryer

një punë apo aktivitet të pagueshëm, i cili do ti siguronte në vazhdimësi të ardhurat e nevojshme për jetesë. KFRSH edhe pse i referohet nocionit të paaftësisë për punë, nuk përcakton konceptin e "paaftësisë për punë"¹⁵³.

Në literaturën juridike është pranuar se do të konsiderohet i paaftë për punë ai person që: *për shkak të gjendjes fiziologjike, moshës apo gjendjes së tij shëndetësore nuk është në gjendje të sigurojë një marrëdhënie punësimi* (Begeja, 1984: 229; Filipescu 1995: 423). Ashtu si dhe kushti i gjendjes në nevojë, edhe ai i paaftësisë për punë, është një çështje fakti, ndaj do të shqyrtohet nga gjykata rast pas rasti. Në këtë kontekst, kujtojmë që paaftësia për punë nuk nënkupton në të gjitha rastet një paaftësi të plotë të këtij personi për të punuar, por edhe një paaftësi të pjesshme për punë. Në këtë hipotezë të dytë, detyrimi për ushqim do të mbushet proporcionalisht me shkallën e paaftësisë së ish bashkëshortit përfitues.

- *Të mos konsiderohet i padenjë për fitimin e detyrimeve për ushqim.* KFRSH parashikon padenjësinë e ish bashkëshortit si një rrethanë që çon në pushimin e detyrimit për ushqim para afatit të caktuar nga gjykata për përmbushjen e tij (neni 200/2 KFRSH). Mirëpo, nëse sjelljet e padenja të ish bashkëshortit pas caktimit të detyrimit për ushqim, mund të çojnë në pushimin e këtij detyrimin për të ardhmen, për të njëjtin shkak dhe në të njëjtën masë duhet pranuar se, nëse kjo padenjësi është treguar gjatë martesës, ajo mund të çojë në përjashtimin e ish bashkëshortit të padenjë nga përfitimi i detyrimit për ushqim, edhe nëse ky përmbush dy kushtet e trajtuara më sipër (Omari, 2010: 232).

¹⁵³ Një definicion të tillë nuk e hasim as në Ligjin mbi familjen të Republikës së Maqedonisë dhe as në atë të Republikës së Kosovës.

Në drejtim të konceptit të padenjesisë duhet theksuar se KFRSH nuk përkufizon këtë nocion as në mënyrë të drejtpërdrejtë, e as nëpërmjet ndonjë kriteri që do të çonte në vlerësimin e asaj. Në këto rrethana, gjykata është e lirë të çmojë sipas bindjes së saj të brendshme, se cilat janë ato sjellje të bashkëshortit të cilat e bëjnë atë të padenjë për të përfituar detyrimin për ushqim.

Gjejmë vendin të theksojmë se koncepti i padenjesisë për të përfituar nga detyrimi për ushqim, nuk duhet barazuar me nocionin e fajit për zgjidhjen e martesës (Omari, 2010: 233). Me fjalë të tjera, jo çdo shkelje e detyrimeve që rrjedhin nga martesa, do të konsiderohet sjellje e padenjë, e cila do të përjashtojë bashkëshortin fajtor nga përfitimi i detyrimit për ushqim. Në këtë kontekst kujtojmë se, në dallim nga ai i mëparshëm, KFRSH aktual nuk parashikon ekzistencën e fajësisë për zgjidhjen e martesës si një kusht ligjor, por njohjen e mbështetjes materiale të bashkëshortit në nevojë pas zgjidhjes së martesës¹⁵⁴. Në këto rrethana edhe bashkëshorti i cili ka qenë fajtor për zgjidhjen e martesës mund të përfitojë detyrimin për ushqim nga bashkëshorti tjetër, me kusht që të plotësojë kushtet ligjore të parashikuara nga KFRSH¹⁵⁵. Ndërkohë që legjislacioni kosovar nuk e parasheh një mundësi të tillë. Kështu, në nenin 298 paragrafi 2 të LFRK thuhet: *gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit mund të refuzojë kërkesën për ushqimi, nëse ushqimia është kërkuar nga bashkëshorti me keqbesim ose nëse ai e ka braktisur*

¹⁵⁴ Neni 83 i KFRSH i vitit 1982, parashikonte se: *Bashkëshorti, kur martesa është zgjidhur pa fajin e tij dhe është i paaftë për punë e pa mjete të mjaftueshme për të jetuar ka të drejtë të kërkojë detyrimin për ushqim nga bashkëshorti tjetër.*

¹⁵⁵ Ndërkaq LFRM parashikon refuzimin e kërkesës për ushqim nga ana e bashkëshortit i cili është fajtor me rastin e zgjidhjes së martesës.

bashkëshortin pa ndonjë arsye të bazuar. E njëjta vlen edhe për Maqedoninë (neni 185 i LFRM).

b) Kushtet që duhet të përmbushë ish bashkëshorti debitor. Duke iu referuar legjislacionit shqiptar, nga leximi i kombinuar i neneve 192 dhe 201 të KFRSH, ish bashkëshorti debitor do të përmbushë detyrimin për ushqim, nëse në drejtimin të tij përmbushen gjithashtu dy kushte: a) të ketë një gjendje ekonomike që ia lejon përmbushjen e detyrimit për ushqim; b) të mos ketë një tjetër person tjetër që detyrohet sipas ligjit përpara ish bashkëshortit debitor për përmbushjen e detyrimit për ushqim ndaj ish bashkëshortit në nevojë. Sipas nenit 207 të KFRSH, secili nga ish bashkëshortët mund të kërkojë sipas rastit heqjen, pakësimin apo shtimin e detyrimit për ushqim, nëse rrethanat në bazë të të cilave është caktuar ky detyrim kanë ndryshuar. Në dallim nga rrethanat që çojnë në ndryshimin e detyrimit për ushqim, të cilët në çdo rast shqyrtohen dhe vlerësohen nga gjykata, rrethanat që çojnë në pushimin e detyrimit për ushqim ndërmjet ish bashkëshortëve ndahen në dy kategori (Omari, 2010: 233):

- rastet e pushimit të detyrimit për ushqim të vlerësuara nga gjykata: ku ndër të tjera përfshihet edhe padenjësia për të përfituar në vazhdimësi detyrimin për ushqim;

- raste të pushimit ex lege të detyrimit për ushqim: në këto raste detyrimi për ushqim pushon që në çastin kur vërtetohet rrethana e përcaktuar me ligj si shkak i përfundimit të detyrimit për ushqim; këto rrethana ligjore janë: kur përfundon afati i caktuar në vendimin e gjykatës për përmbushjen e këtij detyrimi¹⁵⁶, kur ish bashkëshorti përfitues lidh martesë

¹⁵⁶ Edhe pse nuk parashikohet shprehimisht, ky rast i përfundimit të detyrimit për ushqim rezulton nga logjika e nenit 199 të KFRSH, që përcakton përmbushjen e këtij detyrimi për një afat të caktuar.

të re ¹⁵⁷, si dhe kur vdes ish bashkëshortit përfitues apo ish bashkëshortit që përmbush detyrimin për ushqim ¹⁵⁸.

Kontributi kompensues. Kontributi kompensues përfaqëson detyrimin që buron pas zgjidhjes së martesës në ngarkim të njërit ish bashkëshort për dhënien e një shume të hollash apo kalimin e një të drejte tjetër pasurore ish bashkëshortit tjetër, detyrim i cili ka për qëllim të ekuilibrojë pabarazinë që sjell për njërin bashkëshort zgjidhja e martesës dhe pjesëtimi i sendeve të përbashkët ¹⁵⁹. Kontributi kompensues është detyrim që lind pas zgjidhjes së martesës dhe caktohet nga gjykata, nëse vërtetohen kushtet e parashikuara me ligj. Bashkëshorti paditës apo ai i paditur mund t'i bashkojë kërkesë padisë kryesore për zgjidhjen e martesës kërkesën për vlerësimin e kontributit kompensues dhe detyrimin e bashkëshortit tjetër për pagimin e këtij kontributi ¹⁶⁰.

Sipas nenit 147 të KFRSH:

gjykata mund të detyrojë njërin nga ish bashkëshortët të derdhë për llogari të tjetrit një kontribut të destinuar për të kompensuar sa të jetë e mundur, pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim.

¹⁵⁷ Sipas nenit 200 i KFRSH, ky detyrim përfundon me lidhjen e një martese të re nga ana e ish bashkëshortit përfitues, duke qenë se bashkëshorti nga martesa e dytë e përfituesit për detyrim për ushqim është personi që duhet të përmbushë këtë detyrim ndaj bashkëshortit në nevojë.

¹⁵⁸ Pasi që siç theksuam edhe më lartë, ky detyrim është personal i cili lidhet ngushtë me cilësinë e subjekteve të këtij detyrimi dhe nuk mund të kalojë si e drejtë apo detyrim tek trashigimtarët.

¹⁵⁹ Ky institut parashikohet për herë të parë nga KFRSH, dhe është rrjedhojë e ndryshimeve të nivelit ekonomik që ndodhen në Shqipëri pas ndryshimeve politike të viteve '90. Ndërkaq, në legjislacionin e mëparshëm, i cili bazohej në ekonominë socialiste, parashikimi i kontributit kompensues ishte i panevojshëm si para, ashtu edhe pas zgjidhjes së martesës duke qenë se, kushtet ekonomike ndërmjet bashkëshortëve ishin në mos të njehta, të përafërta. Në ato rrethana, detyrimi për ushqim ndaj ish bashkëshortit në nevojë përfaqësonte një instrument ligjor të mjaftueshëm për ekuilibrimin e gjendjes ekonomike të ish bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës.

¹⁶⁰ Kontributi kompensues dhe kushtet në të cilat ai njihet nga gjykata janë të përcaktuara te KFRSH, në nenin 147 deri 152.

Kontributi kompensues paraqet një mjet juridik të posaçëm të së drejtës familjare në mbrojtje të bashkëshortit më të dobët ekonomikisht (Omari, 2010: 235). Sipas gjykimit tonë gjykata, duhet të zbatojë me kujdes të veçantë këtë detyrim ligjor duke vlerësuar dhe përcaktuar masën e këtij kontributi sipas kërkesave të arsyes. Në emër të solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve nuk mund të cenohen të drejtat pasurore të ish bashkëshortit tjetër, i cili nuk ka asnjë faj në drejtim të gjendjes ekonomike të ish bashkëshortit të tij. Kushtet që duhet plotësuar me qëllim që të përcaktohet nga gjykata kontributi kompensues janë:

- *Pabarazia ndërmjet kushteve të mëparshme të jetesës dhe atyre pas zgjidhjes së martesës.* Pabarazia që shkaktohet nga ndarja e pasurisë përfaqëson dëmin që i krijohet bashkëshortit që pretendon kontributin kompensues¹⁶¹. Kriteri në bazë të të cilit vlerësohet "pabarazia" në jetën e bashkëshortit që pretendon kontributin kompensues, është se gjykata duhet të krahasojë dy gjendje faktike: kushtet e jetesës së bashkëshortit pas zgjidhjes së martesës do të krahasohen me ato që ky bashkëshort gëzonte gjatë martesës. Në dallim nga detyrimi për ushqim, kriteri i vlerësimit të "gjendjes në nevojë" është objektiv; ai i referohet mjeteve minimale për jetesë. Në të kundërt, në rastin e kontributit kompensues, kriteri bazë për vlerësimin e gjendjes në nevojë do të jetë kriteri subjektiv i jetës së mëparshme të këtij ish bashkëshorti (Omari, 2010: 236). Me fjalë të tjera, gjendja në nevojë në rastin e kontributit kompensues përfaqëson mungesën e atyre mjeteve të jetesës të cilat sjellin për pasojë mos ruajtjen e të njëjtave kushte jetese.

¹⁶¹ Ish bashkëshorti nuk mund të pretendoj kontribut kompensues për shkaktimin e një dëmi jo material të pësuar nga zgjidhja e martesës. Kështu, cënimi i nderit, dinjitetit, apo vuajtjet shpirtërore që mund të rezultojnë pas zgjidhjes së martesës, nuk mund të kompenzohen nëpërmjet kontributit kompensues.

- *Pamundësia objektive e sigurimit të mjeteve për një jetesë dinjitoze nga bashkëshorti që pretendon kontributin kompensues.* Për të vlerësuar nëse bashkëshorti tjetër duhet të përmbushë kontributin kompensues, gjykata duhet të hetojë se cilat janë shkaqet që çojnë në pamundësinë e këtij bashkëshorti për t'i siguruar vetë mjetet e nevojshme të cilat mund t'i sigurojnë atij një jetesë të ngjashme me atë që gëzonte gjatë martesës. Gjykata do të konstatojë këtë pamundësi në rast se vërteton që, në drejtim të këtij bashkëshorti, ekzistojnë një apo më shumë pengesa të cilat e përjashtojnë objektivisht mundësinë e fitimit të të ardhurave të nevojshme nëpërmjet punës së tij. Kështu, nga interpretimi i nenit 149 të KFRSH, rezulton se masa e kontributit kompensues varet nga të ardhurat që ish bashkëshorti që pretendon këtë detyrim, siguron apo mund të sigurojë nga puna dhe pasuria e tij.

Do të konsiderohen të ardhura ato që fitohen nga puna, bazuar në një marrëdhënie pune apo aktivitet privat të këtij bashkëshorti si edhe çdo e ardhur tjetër me karakter të qëndrueshëm që rrjedh nga pasuria apo aktivitete të tjera nga pasuria e këtij bashkëshorti. Sipas literaturës juridike, do të përfshihen nga të ardhurat e ish bashkëshortit në nevojë edhe të ardhurat që përfitohen nga personat e tretë (Bonilini, 2002: 205). Konsiderohen të tretë, të afërmit e këtij bashkëshorti apo edhe personi me të cilin ai bashkëjeton. Një tjetër hipotezë e mbulimit të kësaj pabarazie nga persona të tretë, do të jetë edhe rasti kur ish bashkëshorti mund t'i sigurojë të ardhurat e nevojshme nga një kompani sigurimesh¹⁶².

¹⁶² Kështu për shembull, në eventualitetin që ky bashkëshort është siguruar nëpërmjet një sigurimi vullnetar, në kushtet e nenit 1113 të K.C. të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se, ngjarja me vërtetimin e secilës siguresi duhet të përmbushë detyrimin është zgjidhja e martesës, apo çdo ngjarje tjetër e cila çon në pakësimin e mjeteve të jetesës, nëse shuma e përfituar nga sigurimi mbulon në një masë të caktuar

Që të caktohet ky detyrim është e nevojshme të përcaktohet se ish bashkëshorti debitor ka të ardhura që ia lejojnë mundësinë e përmbushjes së këtij detyrimi. Pamundësia e përkohshme e mundësive ekonomike nuk do të përbëjë shkak për refuzimin e kontributit kompensues. Një pamundësi e këtillë pezullon përmbushjen e kontributit të përcaktuar nga gjykata (Bonilini, 2002: 236). Si rregull, kontributi kompensues kërkohet gjatë gjykimit të zgjidhjes së martesës, në formën e kërkesës dytësore që i bashkëngjitet padisë së zgjidhjes së martesës. Në rastet kur gjykimi paraqet vështirësi, gjykata mund ta veçojë gjykimin e kontributit kompensues. Në vendimin që pranon përmbushjen e kontributit kompensues gjykata do të përcaktojë: masën e kontributit, kohëzgjatjen e tij dhe mënyrën e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjatë përcaktimit të *masës së kontributit*, gjykata do të ketë parasysh nevojat e bashkëshortit kreditor dhe burimet e bashkëshortit debitor. Në momentin që gjykatësi do të vërtetojë se, me rastin e zgjidhjes së martesës është shkaktuar pabarazi në aspektin ekonomik ndaj bashkëshortëve, ai do të përcaktojë se sa është shuma e nevojshme që duhet të përmbushet që ish bashkëshorti kreditor të jetojë një jetë të ngjashme edhe pas zgjidhjes së martesës. Ndërkaq, me këtë rast duhet vlerësuar edhe të ardhurat e bashkëshortit debitor, qoftë në rastin kur duhet vlerësuar nëse duhet të jepet kontributi kompensues, ashtu edhe për përcaktimin e masës së këtij kontributi.

Kohëzgjatjen e kontributit kompensues, e përcakton gjykata me vendim të saj. Sipas parimeve të përgjithshme, kontributi kompensues fillon të llogaritet dhe përmbushet nga momenti kur vendimi i gjykatës është bërë i plotfuqishëm. Në këtë rast nuk mund të

pabarazinë e krijuar pas zgjidhjes së martesës, bashkëshorti përfitues nuk mund të pretendoj në të njëjtën kohë edhe kontributin kompensues.

zbatohet dispozita e nenit 2010 KFRSH për fillimin e detyrimit për ushqim, i cili fillon të përmbushet nga data që është ngritur padia. Ky është një rregull përjashtimor, prandaj sipas parimit *exemptio est strictissima interpretationis*, duhet interpretuar ngushtësisht vetëm në drejtim të detyrimit për ushqim, duke përjashtuar zbatimin me analogji për detyrime të tjera pasurore që lindin pas zgjidhjes së martesës (Omari, 2010: 241).

Ndryshe nga detyrimi për ushqim, i cili caktohet për një kohë jo më të gjatë se 6 vjet pas zgjidhjes së martesës, dispozitat ligjore për kontributin kompensues nuk parashikojnë një afat maksimal për dhënien e këtij detyrimi. Në këtë rast, gjykata do të përcaktojë kohëzgjatjen e këtij kontributi në varësi të nevojave të bashkëshortit përfitues, për aq kohë sa këto nevoja janë të parashikueshme për të ardhmen. Ky afat mund të kufizohet në një afat të caktuar apo për gjithë jetën e ish bashkëshortit përfitues.

Kontributi kompensues *përfundon* në afatin e parashikuar nga ana e gjykatës, e cila me vendim të saj cakton një datë të caktuar, ose me vërtetimin e një ngjarje të sigurtë, siç është vdekja e ish bashkëshortit përfitues. Ky kontribut mund të përfundojë edhe para afatit të parashikuar nga gjykata¹⁶³.

Mbi kontributin kompensues, në një rast konkret nga jurisprudenca e pakët shqiptare në këtë drejtim, pretendimi për ta përfituar atë është hedhur poshtë, duke argumentuar se¹⁶⁴:

pala paditëse nuk ka vërtetuar dëmin e krijuar nga zgjidhja e martesës, pra ndryshimin e kushteve të jetesës lidhur me nivelin e mëparshëm të jetesës bashkëshortore dhe nivelin aktual të jetesës së kësaj

¹⁶³ Kështu për shembull, në rastet kur ish bashkëshorti përfitues lidh martesë të re; rrethana të tjera objektive të cilat e bëjnë të panevojshme apo të pamundur përmbushjen e kontributit kompensues siç mund të jetë fitimi i ndonjë pasurie nga ana e ish bashkëshortit përfitues apo ndryshimi i të ardhurave të ish bashkëshortit debitor; vërtetimi i rrethanave subjektive të cilat e bëjnë të padenjë ish bashkëshortin përfitues të kontributit kompensues.

¹⁶⁴ Gjykata e Apelit Tiranë, Vendimi nr. 1537, datë 14.06.2012.

*pale; nga kjo palë nuk është paraqitur asnjë kontratë qiraje për banesën ku ajo banon aktualisht (...)*¹⁶⁵.

Dhurimet. Me rastin e zgjidhjes së martesës, bashkëshortët mund të kryejnë dhurime ndaj të tretëve ose ndaj njëri tjetrit. Ajo që është e rëndësishme të përcaktohet është pjesa që secili prej tyre mund të dhurojë, për sa kohë gjen zbatim regjimi i bashkësisë ligjore.

Sipas vendimit shqiptar unifikues Sipas Kodit Civil të vitit 1929¹⁶⁶:

pasuria e vënë gjatë martesës nuk prezumohej si bashkëpronësi midis bashkëshortëve vetëm për shkak të martesës; kjo pasi, duke iu referuar dispozitave të këtij Kodi, del qartë se secili bashkëshort gjatë martesës kishte të drejtë të kishte pasuri ekskluzive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme. Në rastet kur mungojnë pakte të posaçme të hartuara me akt publik para noterit dhe para martesës dhe prona e vënë gjatë martesës figuron në emër të njërit prej bashkëshortëve, kjo pronë i takon bashkëshortit në emër të të cilit është regjistruar.

Kufizimet që lidhen me dhurimin si pjesë e pasurisë që përjashtohet nga bashkësia ligjore, janë argumentuar nga vendimi shqiptar unifikues, sipas të cilit:

*Në rastet kur objekt i dhurimit janë sende që bëjnë pjesë në bashkësinë ndërmjet bashkëshortëve, do të konsiderohet se objekt i dhurimit është pjesa ideale mbi sendet në bashkëpronësi, e cila pas lidhjes së kontratës së dhurimit bashkohet me pjesën ekzistuese që gezonte bashkëshorti përfitues mbi sendin, duke u kthyer kështu në pasuri ekskluzive të këtij të fundit. Titullar i sendit të dhuruar, është vetëm bashkëshorti përfitues i dhurimit. Sendi i përfituar nuk bën pjesë në bashkëpronësinë bashkëshortore e, si të tillë, bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë i vetëm kundrejt çdo subjekti, pa marrë pëlqimin e bashkëshortit dhurues*¹⁶⁷.

Kur bashkëshortët i kanë dhënë dhurata njëri tjetrit, shtrohet çështja e kthimit të tyre. Çështja e dhuratave të thjeshta, zakonisht nuk shtrohet si problem. Mirëpo, kur bëhet fjalë për dhurata që kanë një vlerë të konsiderueshme, si për shembull ari në forma të ndryshme, veturë, banesë, atëherë kërkohet kthimi i tyre nga ana e bashkëshortëve. Lidhur me këto, në

¹⁶⁵ Gjykata argumenton gjithashtu se: *ka rezultuar se pala e paditur, apo bashkëshorti debitor nuk ka nivel të ardhurash në nivel të tillë të cilat do të ishin të mjaftueshme për t'i plotësuar atij një nivel jetese me atë që gëzonte gjatë martesës; për të përmbushur detyrimin për ushqim për fëmijët si edhe detyrimin për kontribut kompesues ndaj paditëses. Aktualisht, të ardhurat e palës së paditur janë në masën 30.000 lekë në muaj, nga të cilat 15.000 lekë në muaj atij i duhen për të përmbushur detyrimin për ushqim për fëmijët.*

¹⁶⁶ Gjykata e Lartë, Vendimi unifikues nr. 5 i datës 20.01.2009.

¹⁶⁷ Gjykata e Lartë, Kolegji, vendimi nr. 3 i datës 03.02.2006.

doktrinën juridike ekzistojnë dy opinione, që dallojnë njëri nga tjetri, në varësi të *vlerës së dhuratave* dhe *fajit* lidhur me zgjidhjen e martesës (Podvorica, 2006: 137). Elementi i parë, *vlera e dhuratës* e cila paraqitet si pronë e përbashkët apo e veçantë nuk paraqet risi në këtë sferë, për shkak se praktika gjyqësore është shërbyer me të edhe më herët, me rastin e vendosjes për kthimin e dhuratave (Trpenovska, 2008: 139). Elementi i dytë, *fajësia* është fakt juridik relevant me rastin e vendosjes për kthimin e dhuratave të një vlere të lartë. Bashkëshorti i shpallur fajtor detyrohet t'i kthejë dhuratat e marra dhe nuk ka të drejtë të kërkojë dhuratat e dhuruara bashkëshortit të pafajshëm për zgjidhjen e martesës.

Nëse, në mënyrë analoge, zbatohen dispozitat e nenit 13 të LFRK, lidhur me kthimin e dhuratave, atëherë konstatojmë se ligjvënësi është përcaktuar për variantin e dytë, pra, kthimin e dhuratave kur është fjala për dhuratat e një vlere të lartë. Sipas dispozitave të po këtij neni, del se detyrimi i gjykatës që në rastin konkret t'i zbatojë rregullat e pasurimit pa bazë. Ndërsa në rastin kur nuk kemi elementë të fajit, në mënyrë specifike, kur të dy bashkëshortët janë të pafajshëm, që të dy i mbajnë dhuratat që kanë marrë nga njëri tjetri. Dhe e kundërta, kur të dy janë shpallur fajtorë për zgjidhje të martesës, atëherë që të dy janë të detyruar t'i kthejnë dhuratat (Oruçi, 1994: 103).

Legjislacionet e vendeve në fjalë nuk e kanë të rregulluar taksativisht këtë pasojë që lind me rastin e zgjidhjes së martesës. Ky rregull është më tepër i njohur nga doktrina juridike dhe praktika gjyqësore. Kështu, neni 13 i LFRK, i referohet vetëm kthimit të dhuratave ndërmjet të fejuarve, në qoftë se ato nuk lidhin martesë¹⁶⁸. Sipas këtij neni *nëse fejesa nuk përfundon me martesë, të fejuarit kanë të drejtë t'i kërkojnë dhuratat*. Në rastin

¹⁶⁸ Neni 217 i LFRM parasheh që: "*dhuratat e bëra nga bashkëshortët njëri tjetrit para dhe pas lidhjes së martesës, të mos kthehen*".

e tillë, ashtu si dhe në Shqipëri zbatohen rregullat e begatimit pa shkak (*pasurimit të pabazë*).

Dëmshpërblimi - dëmshpërblimi është një e drejtë që iu njihet bashkëshortëve me legjislacionin kosovar në rast të zgjidhjes së martesës¹⁶⁹. Kjo e drejtë i njihet bashkëshortit i cili, gjatë jetës bashkëshortore, ka pësuar qoftë dëm material ose moral të shkaktuar nga bashkëshorti tjetër. Kështu për shembull, nëse njëri bashkëshort dëmtuar pasurinë vejtake të bashkëshortit tjetër ose i ka shkaktuar atij dëmtime fizike ose psikike, për të cilin dëm bashkëshorti është i detyruar të mjekohet. Në raste të tilla gjykata do të vendosë me procedurë kontestimore nëse bashkëshortët e kanë paraqitur kërkesën për dëmshpërblim. Bashkëshorti fajtor detyrohet t'i shpërblejë dëmin bashkëshortit të dëmtuar (Aliu & Gashi, 2007: 182).

V.3. Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët

Edhe pse marrëdhënia prindërore është e veçantë nga marrëdhënia bashkëshortore, dhe si e tillë nuk duhet të cenohet nga shuarja e kësaj të fundit, pasojat e zgjidhjes së martesës në drejtim të fëmijëve shkaktohen me faktin se nga martesë lindin disa detyrime ligjore që lidhen në mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nga ana të dy prindërve¹⁷⁰.

¹⁶⁹ Tek LFRM dhe KFRSH, këtë të drejtë nuk e hasim .

¹⁷⁰ Sikurse do të trajtojmë në këtë kapitull kushtuar marrëdhënies prindërore, kjo e fundit nuk lind si rezultat i martesës, por i faktit juridik të lindjes apo veprimit juridik të birësimit. Me fjalë të tjera martesë si veprim juridik, edhe pse nuk sjell asnjë pasojë në drejtim të përmbajtjes së marrëdhënies prindërore-të drejtave dhe detyrime të fëmijës-, sjell disa pasoja në drejtim të mënyrës së ushtrimit të këtyre të drejtave e përmbushjes së detyrimeve përkatëse. Për rrjedhojë, edhe zgjidhja e martesës nuk do të ketë asnjë efekt në drejtim të përmbajtjes së këtyre të drejtave. Kështu në KFRSH, neni 154 thuhet se zgjidhja e martesës nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre.

Përgjegjësia prindërore për fëmijën e lindur nga martesë jo vetëm që u përket si obligim të dy prindërve, por edhe ushtrohet së bashku. Të dy prindërit kanë të drejta të barabarta dhe njëkohësisht ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Ky ushtrim i përbashkët i detyrimeve ndaj fëmijës, bazohet së pari në jetesën e përbashkët të prindërve me fëmijën gjatë martesës. Në këto rrethana zgjidhja e martesës, e cila shoqërohet me përfundimin e jetesës së përbashkët ndërmjet prindërve të fëmijës, do të ndikojë edhe në ushtrimin e përbashkët të përgjegjësisë prindërore. Kjo sepse, rrethana se fëmija nuk mund të jetojë njëkohësisht me të dy prindërit, do të sjellë pasoja në drejtim të përcaktimit të prindit me të cilin do të banojë fëmija si edhe mënyrën se si do të ushtrohen të drejtat nga prindi që nuk bashkëjeton me fëmijën.

Zgjidhja e martesës, përveç pasojës kryesore të shuarjes së marrëdhënies bashkëshortore, sjell pasoja juridike edhe ndaj fëmijëve që kanë lindur nga ajo martesë dhe në drejtim të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (Qendra për Çështje të Informimit Publik, 2012: 432)¹⁷¹. Padyshim se në rast të zgjidhjes së martesës, më të prekur janë fëmijët të lindur nga ajo martesë, pasi që në këtë rast fëmija privohet nga e drejta për të jetuar dhe për t'u rritur së bashku me të dy prindërit. Përgjithësisht, çështja e mbikëqyrjes dhe e mbajtjes së fëmijëve nuk është vetëm një problem teorik dhe ligjor, por problem mjaft i ndërlikuar praktik që ndërlidhet me caktimin e fëmijës njërit prind, pasurinë e fëmijës dhe mbajtjen apo alimentacionin (Harris & Teitelbaum, 2000: 561; Weisberg, &

¹⁷¹ Sipas përkufizimit të nenit 3 d) të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, nr. 10347 i datës 04.11.2010, "Fëmijë" është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç. (...)"

Appleton, 1998: 159)¹⁷². Në këtë drejtim, janë të shumta konventat e ratifikuara, lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi, dhe të fëmijëve në veçanti. Në bazë të Kushtetutës këto instrumente quhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim. Ajo çka konstatohet është se, niveli i njohjes së tyre dhe zbatimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i kufizuar. Kjo sjell mos aplikimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemi i drejtësisë dhe mosvënien e tyre në shërbim të atyre që kërkojnë akses në drejtësi. Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në Shqipëri ka rezultuar se përgjithësisht referimi tek këto Konventa është në nivele tepër të ulëta (Mandro, 2008: 5-7).

Sipas nenit 154 të K.F. shqiptar, zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që prindërit kanë ndaj fëmijëve të tyre. Sips nenit 4 të Konventës Europiane për Marrëdhëniet me Fëmijët¹⁷³:

Një fëmijë dhe prindërit e tij kanë të drejtë të marrin dhe të mbajnë marrëdhënie të rregullta me njëri tjetrin. Këto marrëdhënie mund të kufizohen ose përjashtohen kur kjo kërkohet nga interesat e larta të fëmijës. Kur nuk është në favor të interesave të larta të një fëmije që ky të mbajë marrëdhënie të pambikëqyrura me një nga prindërit e tij ose të saj, konsiderohet mundësia e marrëdhënieve personale të mbikëqyrura ose forma të tjera të marrëdhënieve me këtë prind.

Kjo nënkupton se të dy prindërit, edhe më tej, gëzojnë cilësinë e titullarit të përgjegjësisë prindërore. Kështu, bashkëshortët në marrëveshjen me të cilën përcaktohet se me cilin prind do të jetojnë fëmijët, nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që

¹⁷² Mbajtja dhe përkujdesja ndaj fëmijëve vazhdon edhe pas zgjidhjes së martesës. Mirëpo, vendosja lidhur me mbikëqyrjen e fëmijëve dhe besimi i mbikëqyrjes nga njëri prind është një çështje mjaft problematike në praktikë. Në këtë rast, gjykata duhet t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat relevante siç janë: vendimi mbi besimin e fëmijëve për mbikëqyrje, kontaktet me fëmijët e tyre etj. Ndërsa kjo çështje jo rallë është mjaft e vështirë për t'u realizuar në praktikë, për shkak të prishjes së raporteve të ish bashkëshortëve me rastin e shkurorëzimit.

¹⁷³ Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën me ligjin nr. 9359, datë 24.3.2005, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, Viti 2005, Faqe 1063. Konventa Ka hyrë në fuqi më datë 1 Shtator 2005.

rrjedhin nga përgjegjësia prindërore¹⁷⁴. Por, njëherit objekt i kësaj marrëveshje janë (Omari, 2010: 258):

- kontributi material i secilit prind për mirërritjen e fëmijës;
- mënyra e ushtrimit të përfaqësimit ligjor dhe administrimit të pasurisë;
- mënyra e vendimmarrjes lidhur me zgjidhjet për edukim dhe arsimimin e fëmijës
- rregullat e ushtrimit të marrëdhënieve vetjake me fëmijën lidhur me prindin që nuk banon me të etj.

Kontributi material i secilit prind për mirërritjen e fëmijës. Secili prej prindërve ka detyrimin ligjor të kontribuojë në shpenzimet që lidhen me rritjen, edukimin, shkollimin dhe kërkesa të tjera që lidhen me përgatitjen e fëmijës. Ky detyrim buron nga fakti i lindjes apo birësimit të fëmijës, e jo nga martesë, prandaj zgjidhja e martesës nuk mund të sjellë asnjë pasojë në përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e të dy prindërve¹⁷⁵. Si rregull, prindi të cilit i është besuar fëmija, e përmbush vullnetarisht këtë detyrim duke kryer të gjithë shpenzimet që lidhen me fëmijën. Në aktgjykimin për shkurorëzim caktohet edhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën¹⁷⁶. Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton

¹⁷⁴ Kështu për shembull, ata nuk mund të bien dakord që njëri nga prindërit të përjashtohet nga ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, pasi të drejtat që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore janë të padisponueshme.

¹⁷⁵ Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të Republikës së Shqipërisë nr.10347 datë 04.11.2010, në nenin 28 të tij parashikon se, *Prindi/përfaqësuesi ligjor ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj. Prindi/përfaqësuesi ligjor, për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ka të drejtë të kërkojë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës.*

¹⁷⁶ Detyrimi për ushqim i prindit ndaj fëmijës së mitur, përfshin si fëmijët që lindin nga martesë ashtu edhe ata jashtë martesës; si hipotezën kur prindërit jetojnë sëbashku, ashtu edhe kur ata jetojnë faktikisht të veçuar apo kur kjo vjen si rezultat i zgjidhjes së martesës.

se caktimi i shumës së nevojshme për shpenzimet që lidhen me fëmijën, do të shqyrtohet nga gjykata edhe në rast se palët nuk e kërkojnë¹⁷⁷.

Në doktrinën shqiptare është shtruar për zgjidhje problemi nëse prindi është i detyruar të kontribuojë vetëm për sigurimin e nevojave të domosdoshme të fëmijës, apo ky kontribut duhet të përfshijë edhe nevojat të tjera që tejkalojnë kufirin e atyre të domosdoshme (Omari, 2010: 261). Në këto rrethana, është e kuptueshme që *kujdesi për mirërritje e fëmijës, nuk do të përfshijë vetëm "detyrimin për ushqim" në kuptimin literal të këtij nocioni, apo shpenzime të nevojshme ose të domosdoshme për të përballuar një minimum nevojash jetësore, por edhe çdo shpenzim të dobishëm që lidhet me mirërritjen; edukimin apo shkollimin e fëmijës, në përputhje me kushtet bashkëkohore të momentit kur përcaktohet ky kontribut* (Omari, 2010: 262)¹⁷⁸.

Duke qenë se ky detyrim ka karakter të vazhdueshëm, do të përcaktohet për një interval të caktuar kohe, i cili si rregull është mujor. Gjkata pasi ka përcaktuar shumën mujore të nevojshme, mund të detyrojë prindin debitor të paguajë një shumë unike, e cila përfaqëson tërësinë e shumave mujore të llogaritur për të gjithë periudhën që zgjat ky detyrim, nëse kjo është e vetmja zgjidhje në interes të fëmijës (Save the Children & Shkolla e Magjistratures, 2009: 70).

Duhet dalluar përcaktimi i një shume unike nga gjykata, nga rastet praktike kur vetë prindërit me marrëveshje bien dakord që detyrimi i përmujshëm për fëmijun, të

¹⁷⁷ Kështu sipas neni 99 të KFRSH, "gjykata, kur vendos zgjidhjen e martesës cakton edhe sasinë e kontributit të nevojshëm për rritjen dhe edukimin e fëmijëve".

¹⁷⁸ Sipas autores, *objekt i kontributit material i caktuar për fëmijën pas zgjidhjes së martesë, përfaqëson shumën e parave që duhet të paguajë prindi të cilit nuk i është besuar fëmija, shuma që është e destinuar të përdoret për shpenzimet e nevojshme dhe të dobishme në drejtim të mirërritjes, edukimit e arsimimit të këtyre fëmijëve nga prindi apo subjekti të cilit i është besuar fëmija*.

përbushet paraprakisht në formën e një shume totale, që përfaqëson tërësinë e detyrimeve periodike, për gjithë kohën që sipas vendimit të gjykatës duhet përbushur ky detyrim. Në përcaktimin e shumës së këtij detyrimi gjykata do të bazohet si në kriteret e parashikuara nga neni 201/2 dhe 158 të K.F. shqiptar. Kështu mbështetja materiale e prindit për fëmijën caktohet në bazë të *nevojave të fëmijës*, përcaktimi i të cilave realizohet në raport me rrethanat konkrete të secilit fëmijë, duke pasur parasysh: moshën, gjendjen shëndetësore, nivelin e intelektit, apo rrethana të tjera që e individualizojnë fëmijën. Një nga faktorët kryesorë, padyshim që është mosha e fëmijës, pasi në bazë të saj gjykata vlerëson nivelin e shpenzimeve të prindit të cilit i është besuar fëmija. Mirëpo, gjendja jo e mirë shëndetësore e fëmijës mund të ndikojë gjithashtu në përcaktimin e një shume më të madhe, të nevojshme për të përballuar shpenzimet rreth mjekimit të tij.

Gjendja statusore e fëmijës – Bazuar në tërësinë e dispozitave ligjore, do të konsiderohen si fëmijë të përbashkët të bashkëshortëve:

fëmija që ka lindur nga kjo martesë, fëmija i birësuar nga të dy bashkëshortët para apo pas lidhjes së martesës, si edhe fëmija biologjik i njërit bashkëshort, nëse ky është birësuar nga bashkëshorti tjetër " (Omari, 2010: 254).

Në të tre vendet objekt analize, fëmija i lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës do të konsiderohet se ka për baba bashkëshortin e nënës, derisa të kundërshtohet (prezumimi i atësisë së fëmijës)¹⁷⁹. Ndërsa kur fëmija është lindur në martesën e mëvonshme (martesën e re) të nënës pas kalimit të këtyre afateve, babai i fëmijës do të konsiderohet burri i nënës nga martesa e mëparshme, përveç në rastet kur burri i nënës nga martesa e mëvonshme me pëlqimin e nënës së fëmijës e pranon fëmijën për të vetin. Në

¹⁷⁹ Respektivisht neni 180 i KFRSH, neni 99/1 i LFRK dhe neni 50 i LFRM

Kosovë ky afat varion nga 270-300 ditë ¹⁸⁰. Prandaj fëmijët e lindur në martesë, pas shkurorëzimit së prindërve të tyre, e ruajnë statusin e fëmijëve martesorë, e njëherit kanë të gjitha të drejtat sikur fëmijët martesorë (Aliu & Gashi, 2007: 183).

Përcaktimi i prindit të cilit do t'i besohet rritja dhe edukimi i fëmijës pas zgjidhjes së martesës - Në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të rritur, pas zgjidhjes së martesës shtrohet për zgjidhje çështja se si do të ushtrohet përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës. Çështja parësore që shtrohet për zgjidhje është se cilit prej prindërve do t'i lihet fëmija për rritje dhe edukim. GjEDNj, prej vitesh tashmë ka theksuar rëndësinë e mbajtjes së kontaktit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, gjatë lënies së fëmijë për rritje dhe edukim (Kikelly, 2003: 56)¹⁸¹. Këtë çështje në mënyrë vullnetare mund ta përcaktojnë prindërit e fëmijës nëpërmjet:

- marrëveshjes së bashkëshortëve,
- përcaktimit gjyqësor, i cili vlerësohet nga gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit.

Në rastin e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve, ekzistenca e projekt-marrëveshjes për përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, është kusht *sine qua non* për zgjidhjen e martesës. Kjo marrëveshje duhet të vlerësohet detyrimisht nga gjykata, për të konkluduar nëse ajo është ose jo në interes të fëmijëve. Në Kosovë dhe Maqedoni, kur gjykata gjen se marrëveshja nuk është në interes të fëmijëve, ajo mund ta ndryshojë atë në përputhje me interesat e fëmijëve (Podvorica, 2006: 139). Ky përcaktim përbën dallim me legjislacioni shqiptar, ku projekt-marrëveshja vetëm mund të pranohet ose refuzohet nga gjykata, por jo të ndryshohet.

¹⁸⁰ Neni 99/2 i LFRK

¹⁸¹ Shih çështjen *Andersson kundër Suedisë*, gjykimi i 25 shkurtit 1992.

Rregullimi i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore me pëlqim të përbashkët, mund të realizohet jo vetëm kur martesë zgjidhet me pëlqim të ndërsjelltë, por edhe kur ajo kërkohet nga njëri prej tyre¹⁸². Përcaktimi nga ana e gjykatës se cilit prind do t'i besohet fëmija ka karakter përjashtimor. Gjykata do të vendosë për këtë çështje në këto raste:

- a) bashkëshortët nuk kanë arritur një marrëveshje;
- b) marrëveshja vlerësohet nga gjykata se është në kundërshtim me interesin e fëmijës;
- c) nëse pretendohet nga palët apo persona të tretë pavlefshmëria e projekt-marrëveshjes së prindërve (Omari, 2010: 255).

Në Kosovë dhe Maqedoni, gjykata do të marrë edhe mendimin e organeve të tjera, respektivisht të Organit të Kujdestarisë dhe të Qendrës për Punë Sociale¹⁸³. Nëse prindërit nuk kanë arritur marrëveshje midis tyre për përcaktimin mbi mbajtjen e fëmijës, ose kur marrëveshja e prindërve nuk është në interes të fëmijës, gjykata pasi merr mendimin këtyre organeve, dhe duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat mund të vendosë që: të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim të njëri prind; që disa fëmijë të mbesin te nëna kurse disa te i ati; si dhe që disa ose të gjithë fëmijët t'i besohen një personi të tretë (Trpenovska, 2008: 141).

Me aktgjykim, gjykata do të vendosë se cilit prind do t'i takojnë fëmijët për mbajtje duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të fëmijës, rritjen, edukimin dhe shkollimin e tij¹⁸⁴. Sipas LFRK (neni 93),

¹⁸² Në kushtet e përcaktuara në nenin 129 apo 132 KFRSH, neni 78 të LFRM

¹⁸³ Neni 140, par. 2 LFRK dhe neni 76 LFRM.

¹⁸⁴ Në këtë kuadër, ajo do të marrë parasysh: moshën dhe dëshirën e fëmijëve, gjendjen shëndetësore të fëmijëve dhe prindërve, kushtet e jetesës dhe kushtet materiale të secilit prind, veçanërisht aftësitë e tyre për ruajtje, edukim, mirërritje, shkollim dhe për mbajtje të fëmijëve.

bashkëshortit të cilit i besohen fëmijët e përbashkët për ruajtje dhe edukim, përveç pjesës së tij, i jepen edhe sendet që u shërbejnë vetëm fëmijëve ose që janë të destinuara vetëm për përdorimin e tyre të drejtpërdrejtë. Përfundimisht bën rasti kur vlera e tyre është jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët (Podvorica, 2006: 139). Gjithashtu gjykata do të vendosë për këtë çështje pa marrë parasysh fajësinë me rastin e zgjidhjes së martesës (Vojislav, 1980: 212).

Megjithatë, prindi të cilit nuk i besohen fëmijët për ruajtje dhe edukim, ka të drejtë që të mbajë kontakte me fëmijët, çështje kjo të cilën gjykata gjithashtu do ta rregullojë me aktgjykim¹⁸⁵. Prindi të cilit i besohen fëmijët për rritje dhe edukim, e ushtron fizikisht të drejtën prindërore. Ndërsa prindi të cilit nuk i besohen fëmijët për mbikëqyrje, e ushtron të drejtën prindërore juridikisht, i cili përveç të drejtave të tij ndaj fëmijëve ka edhe obligime si për shembull: dhënien e ushqimit, si fëmijëve ashtu edhe ish bashkëshortit të cilit i janë besuar fëmijët për ruajtje; dhënien e kontributit për shëndetin dhe shkollimin e fëmijëve të tij¹⁸⁶. Prindi nuk shkarkohet nga detyra për të ushqyer fëmijët e tij edhe sikur t'i hiqet e drejta prindërore apo të zgjidhet martesë (Zaçë, 1996: 154).

Prindi të cilit nuk i janë besuar fëmijët për mbikëqyrje, përveçse ka për detyrë dhënien e ushqimit dhe përkujdesjen ndaj fëmijës, ka edhe të drejtë të parashtrojë kërkesë për ndryshimin e vendimit për vendosjen e fëmijëve për mbikëqyrje, ose të kërkojë nga Organi i Kujdestarisë mbikëqyrjen e përkujdesjes së fëmijëve nga prindi tjetër¹⁸⁷. Kjo çështje, rreth mbajtjes së kontakteve personale me fëmijët mund të rregullohet me marrëveshje mes

¹⁸⁵ Neni 76 i LFRM përcakton si organ kompetent Qendrën për punë sociale.

¹⁸⁶ Gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit duhet të përcaktojë edhe masë të përkohshme për mbrojtjen e interesave dhe mbajtjen e fëmijëve derisa të merret vendimi përfundimtar lidhur me shkurorëzimin.

¹⁸⁷ Ligji mbi familjen i Kosovës neni 140, par. 3 dhe 4.

ish bashkëshortëve, mirëpo në mënyrë përfundimtare për to vendos gjykata me aktgjykim të plotfuqishëm. Për shkaqe me rëndësi, prindi mund të kërkojë ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të së drejtës së takimit me fëmijën. Ky ndryshim mund të ketë për objekt vendin e takimit, kohëzgjatjen apo të dy këto komponentët. Një ndryshim të tillë mund të kërkojë si prindi të cilit i është besuar fëmija, ashtu edhe prindi i cili ka të drejtën e takimit.

Raste nga praktika gjyqësore shqiptare

Në lidhje detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve që kanë mbushur moshën madhore, jurisprudenca shqiptare ka theksuar se “detyrimi për ushqim fillon nga dita e ngritjes së padisë” dhe se ai duhet të përmbushet *deri në moshën njëzetepesë vjeç*, vetëm kur ngrihet pretendimi konform nenit 197 paragrafi 3, sipas të cilit: *fëmijët madhore ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, ku përcaktohet se:*

*Detyrimi për ushqim i fëmijëve vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhore ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç*¹⁸⁸.

Në lidhje me vlerësimin e kushteve për ndryshimin e detyrimit për ushqim ndaj fëmijëve, pas zgjidhjes së martesës, bazuar në nenet 2 dhe 207 të KFRSH, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: *vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për caktimin e detyrimit për ushqim në masën 3000 lekë në muaj është marrë në kushtet kur i padituri V. P. nuk përfitonte të ardhura pasi ishte i papunë. Aktualisht, kushtet kanë pësuar ndryshime, të*

¹⁸⁸ Gjykata e Apelit Tiranë, vendimi nr. 258, datë 05.02.2013, sipas së cilës: *Gjykata e Rrethit në vendimin e saj, i cili ka pranuar padinë e paditesës duke detyruar të paditurin që të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijët nga data 07.04. 2011 ka shkelur kërkesat e nenit 210 të K. F. i cili pashikon se “detyrimi për ushqim fillon nga dita e ngritjes së padisë (...). Fëmija ishte e datëlindjes 05.08.1993, në momentin e ngritjes së padisë për detyrim ushqimor datë 09.01.2012 ajo ka qenë madhore pasi e kishte mbushur moshën 18 vjeç. Në gjykim nuk është paraqitur asnjë akt apo pretendim se fëmija R. M. vazhdon shkollën e mesme apo të lartë në mënyrë që të jemi përpara kërkesave të nenit 197/3 të K. F.*

*cilat bëjnë të domosdoshme ndryshimin e shumës për të cilën i padituri duhet të detyrohet për fëmijën*¹⁸⁹.

Në një tjetër vendim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke u mbështetur në nenin 210 të KFRSH - sipas të cilit detyrimi për ushqim fillon nga data e ngritjes së padisë - vlerëson se:

*nuk ka vend për shtimin e detyrimit të të paditurit për ushqim, për shkak se i padituri ka të ardhura shumë herë më të pakta se sa paditësja H. S., i ka lindur nga martesë e dytë dhe një fëmijë tjetër, ndërkohë që për shkak të së ardhurave shumë të larta të paditëses, mundësitë për mirërritjen e fëmijës prej saj janë shumë të mira*¹⁹⁰.

Me rëndësi të veçantë, në lidhje me përcaktimin e detyrimit për ushqim, është edhe njohja e vendimeve të huaja¹⁹¹. Në një nga rastet e shqytuara nga gjykatat shqiptare, paditësi pretendonte se, rrethanat në bazë të të cilave ishte dhënë vendimi i gjykatës së huaj në lidhje me masën e detyrimit për ushqim, kishin ndryshuar. Në kushtet e ndryshuara, ai nuk kishte patur mundësi të përmbushte detyrimin ndaj fëmijës së tij për shkak se jetonte në Shqipëri dhe të ardhurat e tij nuk e mundësonin përmbushjen e detyrimit. Sipas Gjykatës së Lartë, “vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka nxjerrë jashtë juridiksionit të gjykatës shqiptare, është e drejtë, pasi me të drejtë në të arsyetohet se:

¹⁸⁹ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 116, i datës 14.02.2013

¹⁹⁰ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 276, i datës 24.05.2012. Sipas këtij vendimi, *pakësimi ose heqja e detyrimit për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë dhe të pa ekzekutuar, fillon nga data kur kanë ndryshuar rrethanat, në bazë të së cilave është dhënë vendimi, kurse shtimi i tij fillon nga data e ngritjes së padisë*”.

¹⁹¹ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 245, i datës 12.05.2011. Me vendimin nr. 18 të datës 28.04.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur njohja e vendimit të Gjykatës së Shtetit Einskonsin SH.B.A. me të cilin është vendosur zgjidhja e martesës midis tyre, lënien e fëmijës S.V. K. për rritje dhe edukim të paditurës N. R., detyrimin e paditësit të paguajë pension ushqimor për fëmijën në masën 710 dollarë në muaj (...).

vendimet e gjykatave të huaja vetëm mund të njihen dhe të zbatohen në Republikën e Shqipërisë, por ato nuk mund të ndryshohen. (...), në përputhje me përcaktimet e neneve 393 dhe 397 të K.Pr.Civile. Gjykata e Lartë arsyeton ndër të tjera se: Duke mbajtur parasysh frymën e Konventës së Hagës datë 19 Tetor 1996 “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, të Kodit të Familjes dhe dispozitat e K.Pr.Civile, rezulton se parësore është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës (...)¹⁹².

Lidhur me të drejtën e takimit me prindin, Gjykata e Lartë shqiptare është shprehur se:

vendimi që njëri prind (në rastin konkret babai) të takohet me fëmijën e tij një herë në vit, është në kundërshtim me dispozitat ligjore e njëherit edhe me pasoja negative psikologjike dhe emocionale si për fëmijën e mitur ashtu edhe për prindit e tij¹⁹³

.

Me rëndësi në praktikën gjyqësore është edhe qëndrimi i gjykatës ndaj mendimit të ekspertit psikolog. Sipas praktikës gjyqësore shqiptare, bazuar në kërkesat e nenit 224/b të K.Pr.Civile: “Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën. Kur kjo ka mendim të ndryshëm me ekspertin, duhet ta arsyetojë këtë mendim.”¹⁹⁴.

Gjykata e Lartë shqiptare është shprehur në lidhje me përcaktimin e gjykatës kompetente në çështjet që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore¹⁹⁵. Në këtë

¹⁹² Kështu, argumentohet në vendim, *duke qenë se fëmija i palëve jeton në SHBA, me nënën e saj, çdo rrethanë që i përket prekjes së interesave të fëmijës duhet të shqyrtohet nga gjykata e vendbanimit të fëmijës, e cila shqyrton kushtet dhe rrethanat ku jeton fëmija, kërkesat për mirërritjen e saj.*

¹⁹³ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 145 i datës 17.04.2014

¹⁹⁴ Gjykata e Lartë Tiranë, vendimi nr. 195. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, duke mos qenë dakord me mendimin e ekspertit ka arsyetuar mbi shkaqet që e kanë çuar atë gjykatë të mos pranojë konkluzionet e ekspertit nisur edhe nga fakti që kur çështja gjykohej në atë gjykatë, ndryshe nga gjykimi në shkallë të parë, ka rezultuar se vajza prej kohësh jetonte me të paditurën, fakt që është pranuar edhe nga ana e paditësit. Edhe pretendimi i paditësit se gjykata e apelit e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të palës së paditur nuk qëndron dhe vjen ndesh me kërkesat e nenit 90/2 të K.Pr.Civile, sipas të cilit askush nuk mund të përfaqësojë të drejtat e të tjerëve pra edhe paditësi nuk ka pasur ndonjë tagër të përfaqësojë interesat e të paditurës. Po kështu rezulton e provuar se gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë është bërë konform parashikimeve të nenit 460 të K.Pr.Civile.

¹⁹⁵ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 255 i datës 17.05.2012. Sipas këtij vendimi, (...) *nuk mund të përbëjë shkak ligjor që çështja objekt gjykimi të jetë në kompetencën tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat fakti se fëmija, për të cilin kërkohet ndryshimi i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, jeton aktualisht me paditësin, të atin, i cili ka vendbanimin e tij në Berat. Në këtë aspekt ky Kolegj e gjen të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi vendbanimi i fëmijës është Durrësi (...).*

vendim merr rëndësi dallimi mes ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, heqjes apo kthimit
kësaj përgjegjësie dhe institutit të kujdestarisë. Sipas saj:

Gjykata gabon kur referon në nenin 350 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë nuk përcakton gjykatën kompetente nga pikëpamja territoriale në rastet kur kërkohet ndryshimi i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por për rastet kur kërkohet heqja apo kthimi i kësaj përgjegjësie. Për rastin konkret kërkohet ndryshimi i mënyrës apo kushteve të ushtrimit të saj në lidhje me njërin nga prindërit (...) Po kështu nuk mund të zgjidhet çështja e kompetencës tokësore bazuar në nenin 350 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë, në paditë që kanë për objekt vendosjen ose heqjen e kujdestarisë, ka përcaktuar si gjykatë kompetente seksionin përkatës të gjykatës së shkallës së parë ku banon i mituri (...).

Në lidhje me identifikimin rast pas rasti të interesit më të lartë të fëmijës, Gjykata e Lartë shqiptare ka marrë në shqyrtim rastin e një fëmijë për të cilin kërkohet ndryshimi i përcaktimit të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në favor të babait të saj¹⁹⁶. Sipas Gjykatës së Lartë:

*lëvizja e fëmijës në një moshë kaq të vogël dhjetë herë në muaj nga njëri prind tek tjetri nuk ndikon aspak mirë në gjendjen emocionale të saj, pasi ajo realisht nuk është stabilizuar tek asnjëri prej prindërve të saj, sepse sa mësohet me njërin, duhet të lëvizë tek tjetri, etj.(...)*¹⁹⁷.

Po kështu, në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe identifikimin rast pas rasti të interesit më të lartë të fëmijës, Gjykatës së Lartë: shprehet se:

*gjykata duhet të arsyetojë dhe të argumentojë në vendimin e saj kur i duhet të zgjidhë mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke mos u mjaftuar vetëm me argumentat që ajo në fakt ka arsyetuar, duke zgjeruar më tej hetimin gjyqësor në këtë drejtim në vijim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës (...)*¹⁹⁸.

¹⁹⁶ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 78, i datës 29.01.2013. Gjykata e shkallës së parë pasi analizoi provat e marra gjatë gjykimit, mendimin e psikologes dhe të palëve, faktin që i padituri aktualisht është pa punë çmon se fëmija duhet ti lihet për rritje dhe edukim paditëses. Gjykata e apelit ndërmjet të tjerave arsyeton se: (...) takimet e shpeshta prindërore të të paditurit me fëmijën jo vetëm që janë lehtësisht të mundshme, por çmohet se do të ishte i dëmshëm mosrealizimi i tyre, për sa kohë nuk ekzistojnë rrethana të tjera që do të ndikonin negativisht në zhvillim e plotë dhe harmonik të personalitetit të fëmijës apo në realizimin e të drejtës së saj për t'u rritur në një mjedis familjar, atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi (...).

¹⁹⁷ Gjykata argumenton gjithashtu se: Mosha e vogël që ka fëmija A. P. tregon mjaft qartë se ajo ka një nevojë më të madhe për përkujdesjen e nënës, sepse në vitet e para të jetës së fëmijës ndodh atashimi i figurës amësore (Kompleksi i Elektrës-Fjord), pra çka do të thotë që fëmija në vitet e para të jetës është shumë herë më e lidhur me nënën se sa me të atin, pa përmendur këtu nevojën që ajo ka për shërbimin e nënës, por pa harruar asnjëherë kontaktet me të atin (...).

¹⁹⁸ Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, vendimi nr. 262 i datës 19.05.2011. Në argumentimin e saj Gjykata i referohet, ndër të tjera, faktit se: gjykimi është bërë në mungesë të së paditurës dhe për t'i dhënë asaj të

Raste nga praktika gjyqesore kosovare

Vendimi nr. 63/2010 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i sjellë në bazë të ankësës së të paditurës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë për pjesën që ka të bëjë me kontaktin personal të paditurës me fëmijët e mitur¹⁹⁹. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur fëmijët e mitur i janë besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim babait – paditësit:

*ngase vetë e paditura është pajtuar që fëmijët t'i besohen paditësit, duke i hetuar në mënyrë të përshtatshme edhe të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik e fizik dhe për edukimin e fëmijëve, në radhë të parë është nisur nga interesi i fëmijëve, duke marrë parasysh edhe nevojat emocionale dhe dëshirat e tyre*²⁰⁰.

Vendimi 126/12, data 13 dhjetor 2012 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është sjellë në bazë të ankesës së nënës së tyre lidhur me rritjen dhe edukimin e fëmijëve paditëses²⁰¹. Gjykata konkludon se:

drejtën e mbrojtjes para gjykatës, duke parashtruar pretendimet e veta dhe sqaruar edhe rrethanat në lidhje me kushtet e rrethanat në të cilat jeton e paditura, si dhe pretendimin se dokumentat i janë mbajtur nga kunati i saj dhe nuk mund të shkojë në Itali, duke bërë të pamundur takimin e fëmijës sipas dispozitivit të vendimit të gjykatës, moment ky që ka të bëjë tërësisht me interesin e fëmijës që të jetë në kontakt me të dy prindërit për të ndjerë nga afër dashurinë prindërore, kjo dhe duke pasur parasysh dhe moshën e fëmijës (rreth pesë vjeç).

¹⁹⁹ Gjykata e Qarkut në Prizren, aktgjykimi C.nr.28/2010 i datës 07.07.2010, është zgjidhur martesa në mes paditësit dhe të paditurës dhe fëmijët e mitur i janë besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim babait. Është obliguar paditësi që të mundësojë kontaktet e fëmijëve të mitur me të ëmën.

²⁰⁰ Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykata e shkallës së parë, në pjesën III të dispozitivit, që ka të bëjë me kontaktin personal të të paditurës me fëmijët e mitur, duhet ndryshuar, duke i çmuar të pabazuara thëniet në ankesën e të paditurës që kanë të bëjnë me kontaktin personal, për arsye se në këtë pjesë gabimisht është zbatuar e drejta materiale me caktimin e kontakteve personale një herë në muaj.

²⁰¹ Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë C.nr. 82/09, data 24 qershor 2009, është zgjidhur martesa në mes paditëses dhe të paditurit e lidhur më 01 korrik 2002 në Shërbimin e Ofiqarisë në Skënderaj. Fëmijët e tyre të mitur B. e lindur më 01 mars 2001 dhe K. e lindur më 07 mars 2003, i janë besuar në ushqimi, ruajtje dhe edukim paditëses²⁰¹. Është caktuar që pranimi dhe dorëzimi i fëmijëve të bëhet në Qendrën për Punë Sociale në Skënderaj²⁰¹. Kundër këtij aktgjykimi, i padituri ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndryshojë vendimin që ka të bëjë me besimin e fëmijëve, që edhe fëmija tjetër, e mitura B. t'i besohet në ushqimi, ruajtje dhe edukim të paditurit, ndërsa kontaktet personale të paditëses M. me fëmijët e mitur të

për faktin se e mitura K. është te i padituri, nuk mund të konkludohet se ndërrimi i ambientit të fëmijës duke kaluar nga kujdesi i babait në kujdesin e nënës të ketë pasoja për zhvillimin e saj psikik e fizik, sepse K. është e moshës 7 vjeçare, ashtu që në rastin konkret kujdesi i nënës për fëmijën e mitur është i domosdoshëm, duke pasur parasysh moshën e fëmijëve të mitur dhe lidhjen emocionale të tyre me paditësen dhe në mes vete si motra.

Nga vendimi i lartëpërmendur shohim se gjykata gjatë procedurës për zgjidhje të martesës dhe në rast të caktimit të besimit të fëmijëve njërit prind, ka parasysh para së gjithash interesin e fëmijëve. Kështu, pa marrë parasysh dëshirat e prindërve që fëmijët t'i besohen njërit apo tjetrit prind, gjykata në këtë rast ka pasur parasysh nevojat e fëmijëve. Kështu duke iu referuar moshës së tyre, gjykata konkludon se është më e dobishme për fëmijët që ato t'i besohet për rritje dhe edukim nënës së tyre. Për më tepër, nuk do të ishte aspak e arsyeshme që fëmijët të ndaheshin nga njëri tjetri.

Rast nga praktika gjyqesore e RM-së

Nga vendimi nr. P115/14 i Gjykatës themelore të Tetovës, vërejmë rolin e Qendrës për Punë Sociale në përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj të miturve. Pas marrjes në pyetje të palëve dhe fëmijët e mitur, duke pasur parasysh rrethanat dhe kushtet e të dy prindërve, Qendra për punë sociale në bazë të nenit 78 të LFRM çmon se:

fëmijëve të mitur duhet që t'u përcaktohet një kujdestar i përkohshëm, pasi që në një gjendje të tillë, ku babai, pra ish bashkëshorti, gjendet në Qendër për rehabilitim nga alkooli, ndërkaq nëna punon si këngëtare në një klub nate dhe nuk ka kushte esenciale për jetesë, asnjëri nga prindërit nuk janë të aftë për përkujdesjen dhe rritjen e fëmijëve.

caktohen si në aktgjykimin e atakuar, ose lënda të prishet dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

KAPITULLI VII

KONKULUZONE DHE REKOMANDIME

7.1. Tabelë përmbledhëse mbi gjetjet e punimit

Në tabelën e mëposhtme (Tabela nr. 1) janë përmbledhur në mënyrë të sintetizuar gjetjet kryesore të këtij punimi, të nxjerra nga analiza krahasimore mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, në lidhje me:

- 1) Autoritetin kompetent për zgjidhjen e martesës: cili është autoreiteti kompetent për zgjidhjen e martesës?
- 2) Mënyrat dhe shkaqet për zgjidhjen e martesës: sa mënyra parashikohen për zgjidhjen e martesës?
- 3) Zhvillimin e seancës pajtimore dhe efikasitetin e saj në praktikë: ku zhvillohet seanca pajtimore dhe sa efikase është ajo në praktikë?
- 4) Zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok: kur do të konsiderohet si e tillë?
- 5) Domosdoshmërinë ose jo të projekt-marrëveshjes: projekt-marrëveshja do të konsiderohet *conditio sine qua non* vetëm në rastet kur nga martesë kanë lindur fëmijë, apo dhe në rastin e kundërt? Cila duhet të jetë përmbajtja minimale e saj?
- 6) Rolin e gjykatës në pasojat e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok: a mundet të plotësojë apo ndryshojë gjykata përmbajtjen e projekt-marrëveshjes?
- 7) Afatin e ndërprerjes së jetës së përbashkët, si një mënyrë (në Shqipëri dhe Maqedoni) ose shkak (në Kosovë) për zgjidhjen e martesës: cili Shtet parashikon afate më të gjata kohore?

8) Shkaqet e parashikuara në rastin e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok: në cilin Shtet ato rezultojnë më kufizuese për bashkëshortët?

9) Kohëzagjatjen minimale të detyrimit për ushqim dhe të të kontributit kompensues.

Tabela nr. 1 - Përmbledhje mbi gjetjet e punimit

	Shqipëri	Kosovë	Maqedoni	Konkluzione
1.Procedura dhe autoriteti kompetent	Përcaktohet me ligj dhe kompetente është <i>vetëm gjykata.</i>	Përcaktohet me ligj dhe kompetente është <i>vetëm gjykata.</i>	Përcaktohet me ligj dhe kompetente është <i>vetëm gjykata.</i>	Në të tre vendet parashikohet <i>vetëm</i> mundësia e zgjidhjes së martesës <i>me vendim gjyqësor.</i>
3.Mënyrat e zgjidhjes së martesës	Tre: me pëlqim reciprok, për ndërprerje të jetës së përbashkët, më kërkesë të njërit bashkëshort.	Dy: me marrëveshje të dyanshme dhe me kërkesë të njërit bashkëshort.	Tre: me pëlqim reciprok, për ndërprerje të jetës së përbashkët, më kërkesë të njërit bashkëshort.	Kosova, në dallim nga Shqipëria dhe Maqedonia, e përfshin ndërprerjen e jetës së përbashkët ndër shkaqet e

				zgjidhjes së martesës ²⁰² .
4.Seanca pajtimore	Seanca pajtimore zhvillohet në gjykatë në çdo rast ²⁰³ .	Seanca pajtimore para Organit të Kujdestarisë ²⁰⁴	Seanca pajtimore para Qendrës për punë sociale.	Seanca pajtimore në Shqipëri, në dallim nga Kosova dhe Maqedonia, rezulton jo efikase.
5.Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok	Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok, duhet kërkuar domosdoshmërisht nga të dy	Nëse nuk kundërshtohet zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit	Nëse nuk kundërshtohet zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit	Në mendimin tonë, nuk mund të barazohet moskundërshti mi i zgjidhjes së martesës me

²⁰² Neni 69/2 L.F. kosovar përfshin ndër shkaqet për zgjidhjen e martesës edhe marrëveshjen e dyanshme të bashkëshortëve duke mos bërë dallim mes mënyrave dhe shkaqeve të zgjidhjes së martesës.

²⁰³ Si në rastin kur nga martesa kanë lindur fëmijë ashtu edhe kur bashkëshortët nuk kanë fëmijë.

²⁰⁴ Veçori në legjislacionin kosovar është se në zgjidhjen e martesës me marrëveshje të dyanshme, *gjykata mund të vendosë që të zhvillohet procedura e provave*, sikurse sipas padisë për shkurorëzim, *nëse në procedurën e pajtimet çmon se për arsye fundamentale fëmijët e përbashkët të mitur kërkojnë që të ruhet martesa* (neni 84/1 L.F. kosovar).

	bashkëshortët.	bashkëshort ajo konsiderohet si shkurorëzim me marrëveshje.	bashkëshort ajo konsiderohet si shkurorëzim me marrëveshje.	pëlqimin reciprok ²⁰⁵ .
6.Projekt marrëveshja dhe përmbajtja minimale e saj.	E domosdoshme në çdo rast ²⁰⁶ . E debatueshme përmbajtja minimale e saj ²⁰⁷ .	E domosdoshme vetëm nëse ka fëmijë të përbashkët nën përkujdesje. Përmbajtja minimale – përcaktimet	E domosdoshme vetëm nëse ka fëmijë të përbashkët nën përkujdesje. Përmbajtja minimale – përcaktimet	Në Shqipëri, në dallim nga Kosova dhe Maqedonia formulimi i dispozitave ligjore lë vend për debat dhe për

²⁰⁵ Kjo për sa kohë nuk dihen arsyet e moskundërshtimit dhe sepse të zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok mund të ketë dakortësi edhe mbi pasojat e zgjidhjes së martesës.

²⁰⁶ Nuk parashikohet rasti i fëmijëve ndaj të cilëve vazhdon përgjegjësia prindërore edhe pas moshës madhore (18-24 vjeç).

²⁰⁷ Neni 127/2 i K.F. shqiptar parashikon domosdoshmërinë e përfshirjes në projekt marrëveshje të përcaktimeve në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe me kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar. Nuk është e qartë nëse ky kontribut i referohet detyrimit për ushqim apo kontributit kompensues. Ndërkohë që rregullimi i marrëdhënieve pasurore mes ish-bashkëshortëve është eventual, nëse është rasti dhe nëse është e mundur.

		mbi fëmijët.	mbi fëmijët.	rekomandime për ndryshim ²⁰⁸ .
7.Roli i gjykatës mbi pasojat e zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok	Gjykata nuk mund të plotësojë projekt-marrëveshjen por vetëm t'ua kthejë palëve për rishikim ²⁰⁹ .	Projekt-marrëveshja kërkohet vetëm kur ka të mitur (roli i Organit të Kujdestarisë)	Projekt-marrëveshja kërkohet vetëm kur ka të mitur (roli i Qendrës për punë sociale)	Në Shqipëri, në dallim nga Kosova dhe Maqedonia, gjykata nuk ndërhyt dot në përmbajtjen e projekt-marrëveshjes.
8.Ndërprerja e jetës së përbashkët	Tre vjet	Një vit	Një vit	Legjislacioni shqiptar rezulton më kufizues.
8.Zgjidhja e martesës me kërkesën e	Shkaqe specifike dhe jetesë e pamundur dhe	Çrregullim serioz ose i vazhdueshëm	Përkeqësim i marrëdhënieve dhe jeta e	Shqipëria rezulton më kufizuese në

²⁰⁸ Në lidhje me përmbajtjen e projekt-marrëveshjes, LFRK (ashtu si dhe LFRM), në dallim nga KFRSH përfshin rregullimet jo vetëm në lidhje fëmijët e mitur (me përcaktimin e mëtejshëm "të përbashkët"), por edhe fëmijët e rritur ndaj të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore. Jemi të mendimit se edhe në legjislacionin shqiptar duhet të përfshihet kjo kategori. Shih gjithashtu edhe rekomandimin e përfshirë në referencën më sipër.

²⁰⁹ Sipas nenit 128 të K.F. shqiptar, kjo mund të ndodhë kur projekt-marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve apo të njërit bashkëshort.

njërit bashkëshort	martesa ka humbur qëllimin e saj.	ose kur zgjidhja është e pakthyeshm ²¹⁰ .	padurueshme.	raport me Kosovën dhe Maqedoninë ²¹¹ .
9. Detyrimi për ushqim dhe kontributi kompensues	6 vjet për detyrimin për ushqim; nuk ka aft për kontributin kompensues	Nuk ka afat as për detyrimin për ushqim dhe as për kontributin kompensues	5 vjet për detyrimin për ushqim dhe për mbështetjen materiale	Në Kosovë duhet përcaktuar një afat minimal për dhënien e detyrimit për ushqim.

²¹⁰ Sipas neni 70/3 i L.F. kosovar, *në raste të veçanta, për interesin e fëmijës, leja për shkurorëzim mund të mos jepet ose mund të shtyhet.*

²¹¹ Bashkë-egzistenca në legjislacionin shqiptar e disa kushteve e bën më të vështirë argumentimin nga bashkëshorti pasitës të ploësimit të kushteve për zgjidhjen e martesës.

7.2 Konkluzione dhe Rekomandime

Nga analiza e institutit të zgjidhjes së martesës në vështrim krahasimor rezulton se:

1. *Të dhënat statistikore* për periudhën 2009-2013 tregojnë për një rritje të numrit të zgjidhjes së martesave në të tre vendet e marra në analizë. Ky numër, në Kosovë dhe Maqedoni është më i lartë në martesat pa fëmijë. Në këto dy vende vihet re një rritje e numrit të zgjidhjeve të martesës ndër vite për kategorinë e martesave me një kohëzgjatje që shkon nga 5 vjet deri në mbi 15 vjet. Nga krahasimi mes Kosovës dhe Maqedonisë rezulton se numri i zgjidhjeve të martesës është më i lartë në këtë të fundit dhe se martesat fiktive përbëjnë një fenomen të përhapur në këto vene. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në zgjidhjen e martesës për të tre vendet e marra në analizë renditen migracioni dhe arsyet ekonomike.

2. *Liria kontraktore e bashkëshortëve në zgjidhjen e martesës*, në të tre vendet e marra në analizë, ndeshet me kufizime që lidhen si me mënyrat e zgjidhjes së martesës ashtu edhe me pasojat që rrjedhin prej saj. Këto kufizime evidentohen si në të drejtën materiale ashtu edhe në atë procedurale. Liria për të zgjidhur martesë, rezulton të jetë më e kufizuar në Shqipëri sesa në Kosovë dhe Maqedoni. Kjo vihet re:

a) në zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, ku shkaqet janë më të detajuara për Shqipërinë dhe më të përgjithshme për Kosovën dhe Maqedoninë (sipas Tabelës me gjetjet kryesore të punimit në pikën 7.1);

b) në rastin e zgjidhjes së martesës për ndërprerje të jetës së përbashkët: nëse në Kosovë dhe Maqedoni kohëzgjatja e ndërprerjes së jetës së përbashkët që legjitimon

bashkëshortët për të kërkuar zgjidhjen e martesës është një vit, në Shqipëri ky afat shtrihet në tre vjet.

Prandaj, nëse bashkëshortët nuk bien dakord dhe nëse nuk plotesohen kushtet e parashikuara në nenin 132 të KFRSH, për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, bashkëshorti i cili kërkon të zgjidhë martesë për ndërprerje të jetës së përbashkët do të gjendet i shtrënguar të qëndrojë për një kohë të gjatë (tre vjet), i lidhur *de jure* në një marrëdhënie të padëshiruar, me pasojën tjetër eventuale dhe negative të pamundësisë për të legjitimuar një lidhje faktike me një person tjetër. Ky afat nuk duket i përshtatshëm për garantimin e të drejtës për të zgjidhur martesë, në kuadrin edhe të propozimeve të CEFL-it. Prandaj rekomandohet që në legjislacionin shqiptar të reduktohet nga tre vjet në një vit afati i ndërprerjes së jetës së përbashkët, me qëllim zgjidhjen e martesës mbi bazën e këtij shkak.

3. Për sa i përket *seancës pajtimore*, si fazë e detyrueshme për zgjidhjen e martesës, ajo është domethënëse në lidhje me kufizimet me të cilat ndeshet liria e bashkëshortëve në zgjidhjen e martesës. Ajo lidhet me mbrojtjen e veçantë që dispozitat kushtetuese i garantojnë martesës dhe familjes. Në këtë drejtim, analiza krahasimore evidentoi dallimin mes tre vendeve të marra në shqyrtim:

- a) në Maqedoni seanca pajtimore zhvillohet pranë Qendrës për Punë Sociale;
- b) në Kosovë kjo tentativë zhvillohet përpara Organit të Kujdestarisë;
- c) në Shqipëri seanca e detyrueshme pajtimore zhvillohet në *gjykatë*, me praninë e detyrueshme të psikologut në çështjet që i përkasin të miturve.

Rekomandimi ynë është që të adoptohet zgjidhja e Maqedonisë edhe për Shqipërinë, pasi ajo rezulton më efikase duke garantuar një tentativë pajtimi efektive dhe jo formale mes palëve.

4. Për sa i përket *mundësisë që zgjidhja e martesës – kur nuk janë përfshirë të miturit – të realizohet jashtë rrugës gjyqësore*, duke e zëvendësuar atë me praninë e noterit (për shembull, rasti i Francës), avokatit apo nëpunësit të gjendjes civile (rasti i Italisë), nuk gjen rregullim normativ në asnjë prej vendeve të marra në analizë. Vendimi i gjykatës është i domosdoshëm edhe në rastet kur bashkëshortët nuk kanë fëmijë dhe kanë rënë dakord për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok.

Jemi të mendimit se kjo qasje e kontrollit gjyqësor të zgjidhjes së martesës mund të jetë më garantuese ndaj pasojave të zgjidhjes së martesës për bashkëshortin më të dobët ekonomikisht.

5. Në rastin e *zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok*, zgjidhja e të drejtës kosovare dhe asaj maqedonase - sipas të cilës, *projekt-marrëveshja është e domosdoshme vetëm kur nga martesa kanë lindur fëmijë* – duket më e përshtatshme sesa zgjidhja shqiptare - sipas të cilës projekt-marrëveshja përbën *conditio sine qua non* për zgjidhjen e martesës në çdo rast, si në rastin kur nga martesa kanë lindur fëmijë ashtu edhe në rastin e kundërt. Kjo për faktin se ushtrimi i përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës është determinant në ruajtjen e marrëdhënieve prind-fëmijë të cilat mbeten të tilla edhe pas zgjidhjes së martesës.

Prandaj, rekomandimi ynë është që edhe në të drejtën shqiptare, ashtu si në të drejtën kosovare dhe atë maqedonase, të dallohen të dy rastet nga njëri-tjetri, duke parashikuar si

të domosdoshme projekt-marrëveshjen vetëm në ato raste kur nga martesë kanë lindur fëmijë.

6. Në lidhje me *zgjidhjen e martesës me kërkesë të përbashkët të bashkëshortëve*, roli i gjykatës në shqyrtimin e projekt-marrëveshjes gjen kufizim në ato detyrime KFRSH, LFRK apo LFRM i parashikojnë si taksative. Në fakt, në lidhje me nenin 127 të KFRSH, nuk është e qartë nëse “kontributi” që njëri bashkëshort i detyrohet bashkëshortit tjetër në nevojë i referohet detyrimit për ushqim, kontributit kompensues apo të dy përbërësve.

Për këtë arsye rekomandohen ndryshime për një formulim më të qartë të dispozitave ligjore, duke i parashikuar shprehimisht si detyrimin për ushqim ashtu edhe kontributin kompensues si elemente që duhet të përfshihen domosdoshmërisht në projekt-marrëveshje. Në të kundërt, do të rezultonte një trajtim i diferencuar mes bashkëshortëve që zgjidhin martesë me kërkesë të njërit bashkëshort (për të cilët gjykata shprehet në lidhje me detyrimin për ushqim dhe kontributin kompensues).

Në lidhje me këtë çështje, në vendet objekt analize të Rajonit vihet re një qasje më “garantuese” ndaj ish-bashkëshortit nevojtar sesa ajo e parashikuar në nivel evropian, ku vlen parimi sipas të cilit ish-bashkëshortët duhet t’i përballojnë vetë shpenzimet e nevojshme për jetesë.

7. Mbi *përcaktimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok*, gjykata në Shqipëri, ndryshe nga Kosova dhe Maqedonia, nuk mund të plotësojë projekt-marrëveshjen, por vetëm ta miratojë ose ta refuzojë atë.

Kjo zgjedhje e ligjvënësit shqiptar argumentohet me faktin se, thjeshtimi i procedurës së zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok justifikohet me efikasitetin e pasojave të

dëshiruara dhe pranuar nga vetë bashkëshortët, dhe jo të imponuara nga një vendim gjykate. Megjithatë, kjo sjell për pasojë se bashkëshortët, në mungesë të dakordësisë mbi pasojat, do të duhet të kërkojnë zgjedhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort ose për ndërprerje të jetës së përbashkët, (të cilat u argumentuan në pikën 1 të këtyre konkluzioneve), të jenë më të kufizuara se në dy vendet e tjera.

Nga ana tjetër, zgjedhja e Kosovës dhe e Maqedonisë rezulton në përputhje edhe me parimet e hartuara nga CEFL-i, pasi gjykata nuk kufizohet vetëm në pranimin ose refuzimin e projekt-marrëveshjes *in toto* por mund të vendosë edhe mbi pasojat që lidhen me fëmijët nëse këtë e kërkojnë vetë palët. Prandaj, rekomandohet që kjo zgjidhje të adoptohet edhe në legjislacionin shqiptar.

8. Në lidhje me *qasjen e gjyqësorit ndaj provave të cilat duhen nxjerrë në procedurë, sipas parimit të oficialitetit*, praktika gjyqësore e të tre vendeve të marra në analizë dëshmon se gjykatat shpesh herë nuk veprojnë *ex officio* për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të qartësuar situata specifike të nevojshme për marrjen e vendimit. Kështu, në vendet objekt analize është paraqitur një dukuri tejet negative, ajo e *shkurorëzimeve fiktive*. Praktika ka treguar se lidhja e martesës dhe zgjidhja e saj me pëlqim reciprok janë përdorur në mënyrë abuzive edhe për të ndryshuar mbiemrin, dhe për rrjedhojë identitetin e personave. Kjo e fundit si praktikë është tejet e dëmshme, duke qenë se gjykatësi bën juridikisht shkurorëzimin e një çifti i cili nuk është i kurorëzuar.

Prandaj, rekomandohet që *lidhja e martesës pa patur si qëllim jetën e përbashkët, por për të tjera efekte*, ashtu siç evidentuan analizat e praktikës gjyqësore, *duhet të kalojë nën një kontroll më efektiv nga ana e gjykatës*. Kjo me qëllim që shkurorëzimi, si institut që

gëzon mbrojtje si nga e drejta private ashtu edhe ajo publike, të mos keqpërdoret. Rekomandohet gjithashtu që, me rregullativën *de lege ferenda*, të parashikohen sanksione më të rrepta. Përveç sanksionit të shkarkimit nga pozita e gjyqtarit, vendimet konkrete me të cilat martesa shkurorëzohet në mënyrë fiktive në brendësinë e tyre kanë elemente të veprave konkrete penale. Faktikisht, në parim, këto shkurorëzime bëhen edhe me anë të korrupsionit, që fatkeqësisht është një dukuri në gjyqësorin e disa vendeve të Rajonit.

9. E lidhur me çështjen e mësipërme është gjithashtu *përdorimi i zgjidhjes së martesës në vend të shpalljes së pavlefshmërisë së martesës*, me pasojat e ndryshme që sjell secila prej tyre. Ky punim evidentoi një ndryshim të rëndësishëm të legjislacioneve të të tre vendeve objekt analize në lidhje me dallimin mes pavlefshmërisë së martesës dhe zgjidhjes së saj:

a) legjislacioni kosovar dhe ai maqedonas e renditin anulimin e martesës së bashku me zgjidhjen e martesës (apo shkurorëzimin) si një nga shkaqet e mbarimit apo shuarjes së martesës;

b) legjislacioni shqiptar i ndan qartësisht këto dy koncepte nga njëra-tjetra, për kuptimin dhe pasojat që ato sjellin.

Prandaj, për një qartësim të kuptimit të institutit të zgjidhjes së martesës dhe të pasojave që ai sjell, rekomandohet adoptimi i zgjidhjes shqiptare si në të drejtën kosovare ashtu edhe në atë maqedonase. Rekomandohet gjithashtu edhe trajnimi i avokatëve dhe i gjyqtarëve në të tre vendet objekt analize, mbi dallimin e qartë të rasteve të pavlefshmërisë së martesës dhe atyre të zgjidhjes së martesës. Kjo edhe për shkak të evidentimit të përdorimit të pakët që i bëhet institutit të pavlefshmërisë së martesës në praktikë.

10. Në lidhje me *besimin e fëmijëve në përkujdesje*, si çështja më delikate e zgjidhjes së martesës, praktika e deritanishme tregon se në shumë raste gjyqësori dështon në vlerësimin e kushteve për një jetë më të mirë të fëmijëve të mitur. Edhe këtu duhet të zbatohet *parimi i oficialitetit*, pra gjyqësori, sipas detyrës zyrtare, duhet të nxjerrë prova të konsiderueshme për vërtetimin e rrethanave juridikisht relevante dhe për marrjen e vendimit për besimin e fëmijëve të mitur në përkujdesje.

11. Rregullimi normativ aktual në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni paraqitet më tradicional dhe konservator sesa ai propozuar në nivel evropian nga parimet e *CEFL*. Kjo evidentohet në rolin vendimtar që legjislacioni i vendeve objekt analize i atribuon ndërhyrjes publike duke kufizuar lirinë kontraktore të bashkëshortëve në zgjidhjen e martesës. Jemi të mendimit që duhet preferur kjo qasje, me qëllim mbrojtjen e bërthamës familjare nga një “privatizim” i zgjidhjes së martesës, e realizuar me një procedurë të përsheptuar, e cila bie në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes së veçantë që martesa dhe familja gëzojnë nga Shteti. Kjo me qëllim jo vetëm ruajtjen e vlerave të familjes por edhe për të shmangur nga abuzimet e mundshme, sidomos në rastet e martesave fiktive.

BIBLIOGRAFIA

I Literaturë juridike

- Abazi I, *et al.*, (1996) *E drejta familjare në Islam*, Shkup.
- Abdul'ati H & Haxhi., (1995) *Struktura familjare në Islam*, Shkup.
- Aliu A., Gashi H., (2007) *E drejta familjare*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Ahmeti Sh., (1988) *KUR'AN-i, Përkthimi me komentim në gjuhën shqipe*, Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame.
- Amram M., D'Angelo A., (2011). *La famiglia e il diritto fra diversità nazionali ed iniziative dell'Unione Europea*, Milano: Cedam.
- Auletta T., (2007). *Bilanci e prospettive di diritto di famiglia a trent'anni dalla riforma*, Milano: Giuffrè.
- Bakic V., (1979). *Porodичno pravo, dvanaesto dopolneto i izmeneto izdanje*, Beograd: Savremena administracija.
- Bakievska M., (2007) *Brakot kako institucija vo Republika Makedonija*, Manastir.
- Begeja K., (1985) *E drejta familjare e RPS të Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar.
- Beqja H., (2000). *Divorci. Vrojtme e refleksione*. Tiranë: Dudaj & Rinia.
- Berisha R. Gashi H., (2014) *Komentar i Ligjit nr. 03/L-182 "Për mbrojtje nga dhuna në familje"*, Prishtinë.
- Berzani A., Osmani E., (2012) *Raport i studimit bazë mbi dhunën në familje dhe policinë e shtetit shqiptar*, Instituti Studimor Data Centrum.

- Boele-Woelki K., (2005) *European Family Law in action, Vol. III, Parental responsibilities*, Antwerp-Oxford: Intersentia.
- Bonilini G., (2002) *Manuale di diritto di famiglia*, Torino: UTET.
- Brestovci F., (2006) *E drejta procedurale civile II*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik.
- Canaj E., (2014) *Lëvizja e lirë e personave në Bashkimin Europian*, Tiranë: UETPress.
- Cassano G., (2009) *Separazione, divorzio, invalidità del matrimonio. Il sistema delle tutele sostanziali e processuali*, Padova: Cedam.
- Cerutti D., (2014) *Verso una «privatizzazione» del divorzio? Ipotesi di riflessione*, in *Rivista ticinese di diritto* II: 945-972.
- Cretny S. M., (1986) *Principles of family law*, London: Sweet and Maxwell.
- Çalijs B., (1986) *Gragjansko procesno pravo*, Sarajevo.
- Çavdar K., (1998) *Komentar na zakonot za semjestvoto so sudska praktika*, Obrasci za praktična primena, Predmeten registar i pridružni propisi, Skopje: Agencija "Akademik".
- Daci J., (2011) *Të drejtat e njeriut, (Human Rights Law)*, botimi III, Tiranë: Julvin II.
- De Singley F.R., (1985) *Sociologie de la famille contemporaine*, Paris: Edithion Nathan.
- Elezi I., (2006) *Kanuni i Labërisë*, Tiranë: Toena.
- Fantetti F., (2011) *Diritto di famiglia e diritti dei familiari*, 8 ed. Rimini: Maggioli.
- Filipescu I., (1995) *Tratat de Dreptul familiei*, Bukuresht: ALL.

- Gagacef B., (1994) *Protivtuzba vo bracnite sporovi, Semejnoto zakonodavstvo na Republika Makedonija*, Referati za Republicko sovetuvanje, Vrhoven sud na Republika Makedonija, Skopje.
- Galgano F., (1999) *E drejta private (pjesa e marrëdhënieve familjare)* Tiranë: Shtëpia botuese Luarasi.
- Gashi H., Berisha R., (2014) *Komentar i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje*, Prishtinë: Agjencia për Barazi Gjinore.
- Georgievski S., (2000) *Gragjansko procesno pravo*, Skopje.
- Gjeçovi Sh., (1989) *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Tiranë.
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (2014), Buletini i Praktikës Gjyqësore 2013, vëllimi I: 916-921.
- Glendon M.A., (1989) *The transformations of Family-State, Law and Family in the United State and Western Europe*, Chicago and London: The University of Chicago Press.
- Gorgoni A., (2009) *Accordi traslativi e crisi coniugale*, Giuffrè.
- Harris J. L., Lee E. Teitelbaum, (2000) *Parent-child support-Family Law*, New York: Aspen Law and Bussiness.
- Ikonomi L., (2009) *E drejta migratore. Manual trajnues*, Tiranë: IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin)
- Janevski A., Kamiloska Z. T., (2009) *Gragjansko procesno pravo*, Kniga I, Parnicno pravo, Skopje: Praven Fakultet "Justinijan Prvi".

- Kilkelly U., (2003) *E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Tiranë: Këshilli i Evropës.
- Komar J. et al., (1999) *Porodичno pravo*, Izdavacko preduze HHce, Beograd: Homoc d.o.o.
- Lamçe J., (2009) *Il matrimonio islamico ed i suoi effetti giuridici in Italia*, (Disertacion doktoral), Macerata: Università degli Studi di Macerata.
- Lamçe J., (2013) *The rights and obligations of spouses in Islamic classic law*, in Iliria International Review (IIR), vol. 2, 2013, Felix–Verlag, Holzkirchen, Germany and Iliria College, Prishtinë: 183-191.
- Lamçe J., (2014) *Cikël leksionesh për nivelin Doktoraturë*, viti akademik 2013-2014, UET, Tiranë.
- Lamçe J., (2015) *Zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok në Shqipëri. Vështrim krahasimor me Parimet e CEFL*, në revistën Avokatia n.16, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tiranë: 71-86.
- Maccoby E. & Mnooking H., (1992) *Dividing the Child Social and Legal Dilemmas of Custody*, Cambridge: Harvard University Press.
- Mandro A. et al., (2006) *E drejta familjare*, Tiranë: Kristalina-KH.
- Mandro A., (2014) *Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij*, Tiranë: Shkolla e Magjistraturës & UNDP.
- Mandro A., (2013) *Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor. Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të*

shkallës së I-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, 1 Janar 2011-1 qershor 2012, Tiranë: Qendra për nisma ligjore qytetare.

- Mladenovic M., (1982) *Porodicno pravo*, Beograd: Shtëpia botuese Dosije.
- Mladenovic M., (1990) *Porodicno pravo u socijalistickim zemljama*, Beograd.
- Mladenovic M., (1974) *Razvod Braka i uzroci za razvod braka*, Beograd: Shtëpia botuese Rad.
- Molla A., (2015) *Causes of divorces in Albania* in *European Scientific Journal*, vol.11, No.23: 442-450.
- Mughal A. G., (2015) *Muslim Population of the Republic of Macedonia: A Demographic and Socio-economic Profile*, in *Balkan Social Science Review*, Vol. 5: 87-129.
- Nerimana T., Suzana B., (2007) *Roditeljsko i starateljsko pravo*, Pravni fakultet, Sarajevo.
- Oberto G., (2012) *Gli aspetti di separazione e divorzio nella famiglia*, Trento: Cedam.
- Omari S., (2010) *E drejta familjare*, Botimi i parë, Tiranë: Universiteti i Tiranës.
- Oruçi G., (1994) *E drejta familjare-Ligjerata të autorizuar*, Prishtinë.
- OSBE., (2013) *Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje*. Tiranë; Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.
- Patti S., Cubeddu M. G., (2011) *Introduzione al diritto della famiglia in Europa*, Milano: Giuffrè.
- Podvorica H., (2006) *E drejta familjare*, Prishtinë: Universiteti Iliria.
- Poznić V., (1999) *Gragjansko procesno pravo*, Beograd.

- Puhan I., (1996) *E drejta romake*, Kroaci
- Qendra për Çështjet e Informimit Publik (2012). *Legjislacioni për fëmijët në Republikën e Shqipërisë, 1992-2012*. Tiranë: ALBPAPER
- Qendra për nisma ligjore qytetare (2006). *Zbatimi i Ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006). Periudha e monitorimit 30.04.2008-01.06.2009 (Raport)..*
- Raleviq S., (1991) *Brak i Razvod*, Dobra vest, Novi sad.
- Save the Children dhe Shkolla e Magjistraturës., (2009). *Manual mbi zbatimin e Kodit mbi Familjen dhe legjislacionit civil në lidhje me çështjet për të miturit*. Tiranë: Shkolla e Magjistraturës.
- Stone, L., (1990) *Road to divorce*, England 1530-1987, Oxford: Oxford Press.
- Stojčevski S., (1994) *Postapka vo braçnite sporovi*, Semejnoto zakonodavstvo na R.M, referati za republičko sovetuvanje, Vrhoven sud na R.M, Skopje.
- Topallogllu B.,(1995) *Gruaja në Islam*, Shkup: Logos.
- Totaj A., Hamzaj A, (2009) *Shkurorëzimet në Kosovë*, Justicia, viti I, Numri 1, Prishtinë: Instituti Gjyqësor i Kosovës: 111-116.
- Trpenovska S.L., (2008) *Semejno pravo*, Skopje: Praven Fakultet "Justinijan Prvi".
- Tushi G., (2012) *Martesa, familja, seksualiteti*, Tiranë: Natyra.
- Vardarski V., Haxhi M., (1980) *Semejno Pravo – Vtoro izmeneto i dopolneto izdanie* - Skopje: Kultura.
- Velletti M., Calò E., (2012) *Il ruolo del notaio nel divorzio europeo. Aspetti personali e patrimoniali. Patti prematrimoniali*, Milano: IPSOA.

- Vojisllav B., (1980) *Porodicno pravo*, Savremena administracija, Beograd.
- Weisberg D. K., Appleton S. Z., (1998) *Modern family law-cases and materials*, New York: Aspen Law and Business.
- Zaçe V., (1996) *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Tiranë: Logoreci.
- Zatti P., (2011) *Trattato di diritto di famiglia, Vol. I, Famiglia e matrimonio*, Milano: Giuffrè.
- Zavod za socijalni dejnosti (2007) *Koncept za struçna rabota na centarot za socijalna rabota vo postapkata za mirenje na braçni drugari*, Struçno-metodoloshki upatstva i priraçnici, Kniga 1 - tom 1, JU Zavod za socijalni dejnosti, Skopje.
- Zyberi G., (2011) *E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*, Tiranë: Botart.

II. Kuadri normativ

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”.
- Konventa e Hagës “Për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore”
- Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”

- Konventa Europiane “Për Marrëdhëniet me Fëmijët”
- Konventa Europiane “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”
- Rregullorja (BE) n. 1259/2010 e Këshillit, e datës 27 dhjetor 2010, “Mbi vendosjen e bashkërendimit mbi ligjin e zbatueshëm përsa i përket marrëdhënieve familjare dhe divorcit” (“Roma III”).
- Rregullorja KE nr. 2201/2003 e Këshillit, e datës 27 nëntor 2003, “Mbi kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën e marrëdhënieve bashkëshortore dhe përgjegjësinë prindërore” (“Bruxelles II bis”).
- Kodi mbi Familjen i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, nr. 6599, datë 29.06.1981.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, nr. 9062, datë 08.05.2003, i ndryshuar.
- Kodi Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, nr. 8116, datë 29.03.1996, i ndryshuar.
- Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, Botimet Papirus, “Albpaper”, 2010.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.
- Ligji “Mbi familjen i Republikës së Kosovës”, nr. 2004/32, datë 1.09.2006.
- Ligji “Mbi familjen i Republikës së Maqedonisë”, nr. 80, datë 22.12. 1992.
- Ligji “Mbi familjen i Republikës së Maqedonisë”, nr. 157 datë 22.12.2008, i ndryshuar.
- Ligji shqiptar “Mbi ndalimin e shkurorëzimeve të ndodhur para hyrjes në fuqi të Kodit Civil të ri“ nr. 15190, datë 06.03.1931.

- Ligji “Mbi procedurën kontestimore i Republikës së Maqedonisë”, nr. 79, datë 21.09.2005.
- Ligji “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve i Republikës së Shqipërisë”, nr. 10385, datë 24.2.2011, i ndryshuar.
- Ligji “Për barazi gjinore” i Republikës së Kosovës, nr. 2004/2, datë 19.02.2004.
- Ligji “Për shërbimet sociale dhe familjare” i Republikës së Kosovës, nr. 02/17, datë 21 prill 2005.
- Ligji “Mbi raportet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve” i Republikës së Shqipërisë, nr. 604, datë 20.5.1984.
- Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” i Republikës së Shqipërisë, nr. 9970 datë 24.07.2008.
- Ligji Për gjendjen civile i Republikës së Shqipërisë, nr. 10129, datë 11.05.2009, i ndryshuar.
- Ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” i Republikës së Shqipërisë, nr. 10347 datë 04.11.2010.

III. Vendime gjyqësore

- GjEDNj, çështja *Bacuzzi kundër Italisë*, datë 24 maj 2014, aplikimi nr. 43817/2004.
- GjEDNj, Çështja *V.K kundër Kroacisë*, 27 nëntor 2012, aplikimi nr. 38380/08.
- GjEDNj, çështja *Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 17 tetor 1986, aplikimi nr. 9532/81.

- GjEDNj, çështja *Bajrami kundër Shqipërisë*, datë 12 dhjetor 2006, aplikimi nr. 35853/04.
- GjEDNj, çështja *O'Donoghue dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 14 dhjetor 2010, aplikimi 34848/07.
- GjEDNj, çështja *H. kundër Finlandës*, datë 13 nëntor 2012, aplikimi nr. 37359/09.
- GjED, çështja C-218/14, *Kuldip Singh and Others v. Minister for Justice and Equality*, vendimi datë 16 korrik 2015.
- Gjykata Kushtetuese e Italisë, vendimi nr. 170 i datës 11.06.2014
- Gjykata e Lartë e Italisë, vendimi nr. 15486, i datës 20.06.2013
- Gjykata e Lartë e Italisë, vendimi nr. 14329, i datës 06.06.2013
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, vendimi nr.109 i datës 07.10.2013
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 24, i datës 21.4.2014
- Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, vendimi unifikues nr. 5, i datës 20.01.2009
- Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara vendimi unifikues nr. 3, i datës 03.02.2006
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 145 i datës 17.04.2014
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 172, i datës 24.04.2014
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 78, i datës 29.01.2013
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 116, i datës 14.02.2013

- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 395, datë 04.07.2013
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 195, datë 19.04.2012
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 255, datë 17.05.2012
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 276, datë 24.05.2012
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 340, datë 26.06.2012
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 245, datë 12.05.2011
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 91, datë 02.03.2010
- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 206, datë 09.06.2009
- Gjykata e Apelit Tiranë, vendimi nr. 258, datë 05.02.2013
- Gjykata e Apelit Tiranë, vendimi nr. 1537, datë 14.06.2012
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 4759 , datë 06.06.2011
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 655, datë 31.01.2012
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 4329, datë 02.05.2012
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendimin nr.284/10.02.2010

- Gjykata e Gostivarit, vendimi nr. P2 58/12, datë 15.04.2010.
- Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi nr. 51, datë 12.04.2012
- Gjykata Themelore Kërçovë, vendimi nr. 106, datë 08.11.2012
- Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi nr. 140, datë 26.10.2011
- Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi nr. 169, datë 26.10.2011
- Gjykata e Qarkut Prishtinë, vendimi nr. 37, datë 05.10.2012
- Gjykata e Qarkut Prizren vendimi nr. 125 datë 27 korrikut 2012
- Gjykata Supreme e Kosovës, vendimi nr. 65 datë 29 tetor 2012.
- Gjykata Supreme e Kosovës, vendimi nr. 41/2009 datë 14.09.2010
- Gjykata Supreme e Kosovës, vendimi nr. 63/2010 datë 07.07.2010
- Gjykata e Gostivarit, vendimi nr. 90, datë 27.09.2012
- Gjykata e Gostivarit, vendimi nr. P2 62/13, datë 15.02.2012

IV. Burime nga Internet

- Belletti F., *No a «privatizzazione famiglia e divorzio»*, shkarkuar në datë 21.11.2015 në <http://www.toscanaoggi.it/Italia/Giustizia-Belletti-Forum-no-a-privatizzazione-famiglia-e-divorzio#sthash.UTmGQJ1E.dpuf>
- Bërxfholi A., Divorci, shkaqet dhe pasojat (2015), në <http://www.panorama.com.al/divorci-shkaqet-dhe-pasojat/>, parë në datë 22.11.2015.
- Castellaneta M., *Anche Malta dice sì al divorzio* në <http://video.corriere.it/malta-si-referendum-oggi-si-puo-divorziare-/c5b85914-89f8-11e0-876c-02d907656fb0>, parë në datë 05.09.2015;

- Castellaneta M., *Forum shopping per il divorzio breve: stop dai giudici inglesi*, në <http://www.marinacastellaneta.it/blog/forum-shopping-per-il-divorzio-breve-stop-dai-giudici-inglesi.html> parë me datë 22.02.2015.
- Castellaneta M., *Forum shopping per il divorzio breve: stop dai giudici inglesi*, <http://www.marinacastellaneta.it/blog/forum-shopping-per-il-divorzio-breve-stop-dai-giudici-inglesi.html>, parë në datë 16.10.2015.
- Daka D., *Divorci, tendenca rritëse, si zgjidhet problemi i ndarjes së pasurisë*, në <http://www.monitor.al/?p=141894> , parë në datë 25.07.2015.
- Enti Statistikor i Kosovës (ESK) - <http://www.ks-gov.net/esk>
- Enti Shtetëror i Statistikave i Maqedonisë <http://www.stat.gov.mk>
- Instituti i Statistikave të Shqipërisë - <http://www.instat.gov.al>
- Lyster E. M., “Spare the Custody Fight, Save the children”, Lectric Law Library’s Stacks, <http://www.lectlaw.com>, parë në datë 10.02.2015.
- *Marriage and divorce statistics*, në http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Marriage_and_divorce_statistics, parë në datë 20.12.2015.
- *Principles of European Family Law*, parë me datë 21.11.2015 nga <http://ceflonline.net/principles/>
- Selmani A. (2009), *Ndihma juridike pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit*, parë me datë 22.11.2015 nga http://www.ajls.org/doc/9.%20ASelmani_Shkurorëzimi.pdf
- *Shtimi i divorceve në Shqipëri, si po e ndikon negativisht rritjen ekonomike*, në <http://www.monitor.al/divorci-si-e-ndikon-negativisht-rritjen-ekonomike-2/>, parë në datë 16.11.2015.